



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI VJETOR 2025

Prishtinë,
Qershor 2026

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2025

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

PËRMBAJTJA

1. Fjala e Kryetarit të Bordit të Bankës Qendrore	13
2. Fjala hyrëse e Guvernatorit	15
3. Përmbledhje ekzekutive	17
4. Misioni, Vizioni dhe Vlerat e BQK-së	19
5. Plani Strategjik 2024-2028	20
6. Struktura organizative e BQK-së, efektive nga 31 dhjetor 2025	21
I. Ekonomia e Kosovës në vitin 2025	22
1. Përmbledhje Makroekonomike	23
1.1. Eurozona	23
1.2. Ballkani Perëndimor	25
1.3. Sektori real	26
1.4. Sektori fiskal	30
1.5. Sektori i jashtëm	31
II. Aktiviteti i BQK-së në vitin 2025	34
1. Stabiliteti Financiar	34
1.1. Sektori financiar	34
2. Mbikëqyrja Financiare	35
2.1. Aktivitetet Mbikëqyrëse të sektorit bankar	35
2.2. Aktivitetet mbikëqyrëse të sektorit të sigurimeve	48
2.3. Aktivitetet Mbikëqyrëse të Sektorit të Pensioneve	54
2.4. Aktivitetet Mbikëqyrëse të Sektorit të Tregjeve, IMF, IFJB, IP dhe IPE	57
2.5. Aktivitetet në fushën e Stabilitetit Financiar, Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike	62
2.6. Aktivitetet Mbikëqyrëse për Parandalimin e pastrimit të parave dhe LFT	64
2.7. Aktivitetet Mbikëqyrëse të Sistemeve të TI të Institucioneve Financiare	66
2.8. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare	68
2.9. Regjistri Kreditor	68
3. Licencimi dhe rregullimi i Institucioneve Financiare	71
3.1. Licencimi	71
3.2. Rregullimi i Institucioneve Financiare	78
4. Sistemi i Pagesave	87
4.1. Operimi i Sistemit të Pagesave Ndërbankare	87
4.2. Regjistri i Llogarive Bankare	90
4.3. Mbikëqyrja dhe analizat e sistemeve të pagesave	91
4.4. Instrumentet e pagesave dhe infrastruktura bankare për shërbime të pagesave	91
4.5. Roli i BQK-së si katalizator i sistemit të pagesave	94

4.6. Bashkëpunimi me institucione tjera vendore dhe ndërkombëtare	96
5. Edukimi Financiar dhe Mbrojtja e Konsumatorit	97
5.1. Promovimi i Edukimit Financiar dhe Përfshirjes Financiare	97
5.2. Mbrojtja e konsumatorit	99
6. Aktivitetet në fushën e Statistikave	102
7. Menaxhimi i Rezervave dhe Operacionet Bankare	105
7.1. Menaxhimi i Mjeteve dhe Rezervave	105
7.2. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme	110
III. Qeverisja dhe zhvillimet e brendshme të BQK-së	123
1. Bordi i Bankës Qendrore dhe komitetet e tij	123
1.1. Komiteti i Auditimit (KA)	124
1.2. Komiteti për qeverisje, etikë dhe burime njerëzore	126
2. Bordi Ekzekutiv	128
3. Auditimi i Brendshëm	129
4. Funkcioni i Menaxhimit të Rrezikut	131
4.1. Menaxhimi i Rrezikut Operacional	132
4.2. Menaxhimi i Rrezikut Financiar	134
4.3. Aktiviteti i BQK-së në aspektin e pajtueshmërisë	136
5. Burimet Njerëzore	138
6. Teknologjia informative dhe siguria e informacionit	140
7. Komunikimi me publikun dhe transparenca institucionale	142
7.1. Tryezë bashkëbisedimi me gazetarët e ekonomisë	143
7.2. Konferenca e Fundvitit me mediet	144
8. Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Integrimet Evropiane	145
8.1. Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare dhe Asistencat Teknike	145
8.2. Aktiviteti lidhur me Integrimet Evropiane	148
8.3. Konferencat ndërkombëtare dhe rajonale	150
8.4. Anëtarësime dhe marrëveshje të reja	154
8.5. Vizitat bilaterale në institucionet homologe	155
9. Qëndrueshmëria financiare e BQK-së	158
IV. Pasqyrat Financiare	159
V. Shtojca Statistike	223

LISTA E SHKURTESAVE

AB	Auditimi i Brendshëm
ACH	Sistemi Automatik i Pagesave Individuale (Automated Clearing House)
AMIK	Asociacioni i Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës
AJN	Asetet e Jashtme Neto
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
APR	Asetet e Peshuara ndaj Riskut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
ATP	Agjencionet për Transferimin e Parave
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BEC	Kategoritë Kryesore Ekonomike (angl. Broad Economic Categories)
BEEP	Projekti mbi Përmirësimin e Ambientit Biznesor (angl. Business Environment Enhancement Project)
BEK	Bordi Ekzekutiv i BQK-së
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BIC	Business Identifier Code
BIS	Banka për Rregullimin Ndërkombëtar (angl. Bank for International Settlements)
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimeve
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (angl. Central European Free Trade Agreement)
COREP	Common Reporting Framework (EBA)
DJI	Dow Jones Industrial Average
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DST	Drejtat Speciale të Tërheqjes
EFSE	Fondi Evropian për Evropën Juglindore (angl. European Fund for Southeastern Europe)
EACHA	Shoqata Evropiane e Shtëpive të Kliringut të Pagesave
EJL	Evropa Juglindore

EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
EUROSTAT	Drejtoria Gjenerale për Statistika Evropiane
FINREP	Financial Reporting framework (EBA)
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
GBP	Funta Britanike (ang. Great Britain Pound)
IAIS	Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (angl. International Association for Insurance Supervisors)
ICAAP	Procesi i Brendshëm i Vlerësimit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. the Internal Capital Adequacy Assessment Process)
IÇI	Indeksi i Çmimeve të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IÇP	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IHH	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IJSHEF	Institucione Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
IFJB	Institucione Financiare Jobankare
IOPS	Organizata Ndërkombëtare për Mbikëqyrje të Pensioneve (angl. International Organisation of Pension Supervisors)
KA	Komiteti i Auditimit
KJP	Kreditë Joperformuese
KKP	Këshilli Kombëtar i Pagesave
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MTPL	Sigurimi i Autopërgjegjësive
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
NREK	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PNI	Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve
POS	Pikë e Shitjes (angl. Point of Sale)
pp	Pikë Përqindje
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
RTGS	Shlyerja e Pagesave në Kohë Reale (angl. Real Time Gross Settlement)

SEBQ	Sistemi Evropian i Bankave Qendrore (angl. European System of Central Banks)
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut ndër bankar
SEPA	Zona Unike e Pagesave në Euro (angl. Single Euro Payments Area)
SHBK	Shoqata e Bankave të Kosovës
SFR	Franga Zvicerane (Swiss Franc)
SREP	Procesi i Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës (angl. Supervisory Review and Evaluation Process)
SRK	Sistemi i Regjistrimit të Kontabilitetit
SWIFT	Shoqëria për Telekomunikim Financiar Ndërbankar Botëror (Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication)
TIPS	TARGET Instant Payment Settlement
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TPL	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë (angl. Third Party Liability)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (angl. United States Agency for International Development)
VPN	Teknologjia e Enkriptimit dhe Lidhjeve Virtuale

LISTA E GRAFIKËVE

1.	Inflacioni në Eurozonë sipas kategorive kryesore	24
2.	Rritja vjetore e BPV-së në Ballkanin Perëndimor	25
3.	Norma e rritjes së BPV-së reale	26
4.	Inflacioni në Kosovë sipas kategorive kryesore	27
5.	Inflacioni bazë dhe i përgjithshëm	28
6.	Inflacioni i brendshëm dhe i importuar	28
7.	Regjistri i bizneseve	29
8.	Struktura e ndërmarrjeve të reja	29
9.	Eksportet, importet dhe bilanci tregtar i mallrave	31
10.	Eksporti i mallrave sipas kategorive	32
11.	Importi i mallrave sipas kategorive	32
12.	Remitencat	33
13.	Investimet e huaja direkte	33
14.	Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës	34
15.	Zërat kryesorë të aseteve të sektorit bankar	41
16.	Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare	42
17.	Pjesëmarrja e kredive sipas sektorëve ekonomikë	42
18.	Stoku i kredive sipas sektorëve ekonomikë	42
19.	Kreditë e reja, ndryshimi vjetor	43
20.	Struktura e depozitave	44
21.	Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita	45
22.	Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve	45
23.	Norma mesatare e interesit në depozitat	45
24.	Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve	45
25.	Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare	45
26.	Stoku i kredive, sipas normave të interesit fikse apo variable	46
27.	Profiti neto i sektorit bankar	46
28.	Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar	46
29.	Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar	47
30.	Treguesit e kualitetit të portofios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve	47
31.	Asetet e sektorit të sigurimeve	50
32.	Primet e shkruara dhe dëmet e paguara	52
33.	Asetet e sektorit pensional	55
34.	Performanca e FKPK-së	55
35.	Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale	56
36.	Investimet e FKPK-së	56
37.	Investimet e FSKP-së	56
38.	Asetet e sektorit mikrofinanciar dhe jobankar	59

39.	Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive-----	59
40.	Rritja e kredive ndaj korporatave jofinanciare -----	59
41.	Lizingjet-----	59
42.	Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar -----	60
43.	Norma mesatare e interesit në kredi-----	60
44.	Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar dhe jobankar-----	60
45.	Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar -----	61
46.	Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore-----	61
47.	Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së -----	69
48.	Numri i kredive të aprovuara në sistemin e RKK-së -----	69
49.	Numri i kërkesave për raporte kreditore -----	70
50.	Rrjeti bankar sipas numrit të degëve/zyrave-----	72
51.	Shpërndarja e popullsisë në Kosovë sipas regjioneve -----	74
52.	Rrjeti i siguruesve-----	75
53.	Numri i transaksioneve sipas sesioneve në KIPS -----	88
54.	Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në KIPS -----	88
55.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave -----	88
56.	Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave-----	88
57.	Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në KIPS -----	89
58.	Mesatarja vjetore e vlerës së transaksioneve në KIPS -----	89
59.	Numri i transaksioneve sipas sesioneve në KIPS -----	89
60.	Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në KIPS -----	89
61.	Raporti i kredisë brenda ditore ndaj totalit së vlerës së shlyer në RTGS-----	90
62.	Numri i kartelave të debitit sipas llojit-----	92
63.	Numri i kartelave të kreditit sipas llojit -----	92
64.	Numri i terminalave ATM-----	92
65.	Numri i terminaleve POS-----	92
66.	Numri i transferove të kreditit në formë elektronike në raport me transferet formë letër-----	92
67.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave -----	93
68.	Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave -----	93
69.	Numri i llogarive me qasje në internet në raport me numrin e përgjithshëm të llogarive -----	93
70.	Portfolio e rezervave (EUR) të BQK-së -----	105
71.	Saldo përfundimtare e mjeteve në EUR -----	106
72.	Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara në USD -----	107
73.	Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit në EUR të BQK-së-----	107
74.	Raporti i shpërndarjes së portfolios investuese në EUR të BQK-së -----	107
75.	Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fund vit -----	108
76.	Struktura e Letrave me Vlerë sipas afatit të maturimit -----	109
77.	Struktura e investitorëve nën Ankandet e Letrave me Vlerë-----	109

78.	Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2024 dhe 2025	109
79.	Ankandet e letrave me vlerë gjatë vitit 2025	109
80.	Furnizimi me para të gatshme-vlera	111
81.	Furnizimi me para të gatshme -vëllimi	111
82.	Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve	111
83.	Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve	111
84.	Pranimi i parave të gatshme-vlera	112
85.	Pranimi i parave të gatshme-vëllimi	112
86.	Pranimi i kartëmonedhave euro sipas denominimeve	112
87.	Pranimi i monedhave euro sipas denominimeve	112
88.	Eksporti i parave të gatshme-vlera	113
89.	Eksporti i parave të gatshme-vëllimi	113
90.	Importi i parave të gatshme-vlera	113
91.	Importi i parave të gatshme-vëllimi	113
92.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi-vëllimi	114
93.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar	114
94.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi-numri i copëve	114
95.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar	114
96.	Kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim-vëllimi	115
97.	Kartëmonedha të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara-vëllimi	115
98.	Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim	115
99.	Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim në raport me gjithsej të furnizuara	115
100.	Kartëmonedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim	116
101.	Kartëmonedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim, sipas denominimeve	116
102.	Monedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim	116
103.	Monedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim, sipas denominimeve	116
104.	Vëllimi i transaksioneve vendore dalëse	120
105.	Vlera e transaksioneve vendore dalëse	120
106.	Vëllimi i transaksioneve vendore hyrëse	121
107.	Vlera e transaksioneve vendore hyrëse	121
108.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare dalëse	121
109.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare dalëse	121
110.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare hyrëse	122
111.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare hyrëse	122
112.	Burimet e rreziqeve	133
113.	Struktura e rezervave të BQK-së, me 31 dhjetor 2024	134
114.	Struktura e rezervave të BQK-së, me 31 dhjetor 2025	134
115.	Klasifikimi kreditor i rezervave të BQK-së, 31 dhjetor 2025	134
116.	Klasifikimi kreditor i rezervave të BQK-së, 31 dhjetor 2024	134
117.	Humbja e pritur kreditorë sipas llojit të ekspozimeve	135
118.	Humbja e pritur kreditorë në raport me vlerën e ekspozuar sipas llojit të ekspozimeve ECL/EAD	135
119.	Përbërja e rezervës sipas valutës, 31 dhjetor 2025	135
120.	Përbërja e rezervës sipas valutës, 31 dhjetor 2024	135

121. Rezervat sipas maturitetit-----	136
122. Struktura sipas edukimit-----	138
123. Shpërndarja e stafit sipas funksioneve-----	139
124. Neto rezultati financiar dhe shpërndarja e te ardhurave të ndashëm ndaj buxhetit shtetëror (periudha 2016 - 2025)-----	158
Figura 1. Struktura e Institucioneve Financiare që operojnë në tregun financiar në Kosovë-----	72
Figura 2. Njësitë organizative-bartësit e proceseve-----	131

LISTA E TABELAVE

1. Indikatorët bazë makroekonomikë në Eurozonë-----	24
2. Indikatorët bazë makroekonomikë në BP -----	26
3. Numri i ekzaminimeve në banka-----	35
4. Struktura e aseteve të sektorit bankar-----	41
5. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar-----	44
6. Numri i ekzaminimeve të sektorit të sigurimeve-----	49
7. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	51
8. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve -----	51
9. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit -----	52
10. Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit -----	53
11. Rezultatet financiare -----	53
12. Numri i ekzaminimeve të sektorit të pensioneve-----	55
13. Numri i ekzaminimeve të sektorit të IMF, IFJB, IP dhe IPE -----	58
14. Numri i ekzaminimeve për pastrimin e parasë -----	65
15. Numri i institucioneve financiare -----	72
16. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të bankave -----	75
17. Shpërndarja gjeografike e filialeve të siguruesve-----	75
18. Rrjeti i IMF-ve sipas shpërndarjes gjeografike -----	76
19. Rrjeti i IFJB-ve (zyra dhe agjent) sipas shpërndarjes gjeografike -----	76
20. Struktura e kërkesave të sistemit financiar të miratuara/refuzuara nga BQK -----	77
21. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në KIPS -----	89
22. Rastet e procesuara në regjistrin e llogarive bankare -----	90
23. Numri i llogarive -----	93
24. Numri i llogarive të parasë elektronike -----	94
25. Numri dhe vlera e pagesave të parave elektronike -----	94
26. Numri i ankesave ndër vite -----	101
27. Numri i ankesave sipas kanalit të pranimit -----	101
28. Numri i ankesave sipas statusit -----	102
29. Shuma dhe vëllimi i aktiviteteve të përgjithshme të operacioneve me para të gatshme-----	110
30. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave -----	120
31. Niveli i depozitave të klientëve kryesorë -----	122

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

1. Fjala e Kryetarit të Bordit të Bankës Qendrore

Kam kënaqësinë t'ju drejtohem në kuadër të Raportit Vjetor 2025 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në emër të Bordit të Bankës Qendrore. Ky raport pasqyron punën, zhvillimet kryesore dhe angazhimin institucional të BQK-së gjatë vitit 2025 në përmbushje të mandatit të saj për ruajtjen e stabilitetit financiar, funksionimin e sigurt të sistemit të pagesave dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Gjatë vitit 2025, Bordi i Bankës Qendrore ka ushtruar rolin e tij mbikëqyrës dhe strategjik me përgjegjësi të lartë institucionale. Në kuadër të mandatit të tij ligjor, Bordi ka shqyrtuar zhvillimet kryesore financiare dhe institucionale, ka dhënë orientim strategjik për prioritetet e Bankës Qendrore dhe ka mbështetur vendimmarrjen që synon forcimin e stabilitetit, transparencës, qeverisjes së brendshme dhe përafrimit me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Viti 2025 ishte vit i konsolidimit të mëtejshëm për sistemin financiar të Kosovës. Sektori financiar vazhdoi të zgjerohet mbi baza të qëndrueshme, ndërsa sektori bankar ruajti nivel të mirë të kapitalizimit, likuiditetit dhe cilësisë së portofolit kreditor. Këto zhvillime dëshmojnë se sistemi financiar ka vazhduar të mbështesë ekonominë reale, qytetarët dhe bizneset, duke ruajtur besimin e publikut dhe qëndrueshmërinë ndaj sfidave të jashtme.

Bordi ka mbështetur fuqishëm avancimin e kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse, me fokus në mbikëqyrjen e bazuar në rrezik, përgatitjet për standardet FINREP, COREP dhe SREP, forcimin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, sigurinë kibernetike, inovacionin financiar, mbrojtjen e konsumatorit dhe përfshirjen financiare. Këto prioritete janë thelbësore për ndërtimin e një sistemi financiar më të sigurt, më transparent dhe më të përafruar me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Një rëndësi e veçantë gjatë vitit i është kushtuar modernizimit të sistemit të pagesave dhe integritetit financiar evropian. Përgatitjet për SEPA, avancimi i projektit për pagesa të menjëhershme dhe rritja e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave përfaqësojnë hapa të rëndësishëm drejt rritjes së efikasitetit, uljes së kostove dhe zgjerimit të qasjes në shërbime financiare moderne.

Duke parë përpara, Bordi mbetet i përkushtuar të mbështesë Bankën Qendrore në forcimin e mëtejshëm të stabilitetit financiar, avancimin e integritetit në infrastrukturën financiare evropiane, rritjen e qëndrueshmërisë kibernetike, zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, përmirësimin e transparencës institucionale dhe forcimin e llogaridhënies. Këto fusha do të vazhdojnë të jenë caqe të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të institucionit.

Në emër të Bordit të Bankës Qendrore, falënderoj Guvernatorin, Bordin Ekzekutiv dhe të gjithë stafin e BQK-së për përkushtimin, profesionalizmin dhe punën e tyre gjatë vitit 2025. Po ashtu, shpreh mirënjohje për institucionet e Republikës së Kosovës, partnerët ndërkombëtarë dhe publikun për bashkëpunimin dhe besimin e vazhdueshëm.

Me respekt,

Bashkim Nurboja, Dr. Sc.,



Kryetar i Bordit
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

2. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Të nderuar lexues, qytetarë, drejtues e përfaqësues institucionalë, partnerë ndërkombëtarë,

Me respekt dhe përkushtim të lartë institucional, kam kënaqësinë të paraqes Raportin Vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2025. Ky raport pasqyron punën, vendimmarrjen dhe angazhimin e Bankës Qendrore në përmbushjen e mandatit të saj kushtetues dhe ligjor për ruajtjen e stabilitetit financiar, forcimin e besimit publik dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Viti 2025 ishte vit i konsolidimit të mëtejshëm institucional dhe i avancimit të reformave në një mjedis ekonomik e financiar ndërkombëtar që mbeti i karakterizuar nga pasiguria, presionet e jashtme dhe zhvillimet e shpejta teknologjike. Në këtë kontekst, Banka Qendrore veproi me maturi, përgjegjësi dhe orientim të qartë strategjik, duke ruajtur stabilitetin e sistemit financiar dhe duke avancuar kornizat rregullative, mbikëqyrëse dhe operationale në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, me mbështetje të fortë nga partnerët ndërkombëtarë.

Gjatë këtij viti, sistemi financiar i Kosovës dëshmoi qëndrueshmëri dhe kapacitet të lartë për të mbështetur ekonominë reale. Roli i BQK-së ishte i përqendruar në forcimin e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, avancimin e vlerësimeve dhe analizave makroprudenciale dhe rritjen e qëndrueshmërisë së institucioneve financiare ndaj rreziqeve të mundshme. Kjo qasje ka qenë thelbësore për ruajtjen e besimit në sistemin financiar dhe për garantimin e funksionimit të sigurt të tregut financiar.

Një pjesë e rëndësishme e angazhimit tonë gjatë vitit 2025 lidhet me avancimin në harmonizimin e kornizës ligjore dhe rregullative me standardet e Bashkimit Evropian. Përgatitjet për zbatimin e standardeve të avancuara mbikëqyrëse, përfshirë SREP, FINREP dhe COREP, si dhe forcimi i kornizës për rimëkëmbje dhe përmbyllje si funksione të reja, përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt një sistemi financiar më të qëndrueshëm, më transparent dhe më të përafuar me praktikën më të mira ndërkombëtare. Pikërisht për këtë qëllim është nisur projekti i ekuivalentimit të rregullativës sonë me atë të Bashkimit Evropian, përkatësisht me standardet dhe kërkesat e Autoritetit Bankar Evropian.

Në fushën e pagesave dhe integriteteve financiare evropiane, BQK-ja vazhdoi përgatitjet për anëtarësim në SEPA dhe avancoi projektin për pagesa të menjëhershme në euro përmes iniciativës TIPS Clone. Këto zhvillime përfaqësojnë më shumë se modernizim teknik; ato janë hapa strategjikë drejt avancimit të infrastrukturës kritike shtetërore me partner nga BE, uljes së kostove të transaksioneve, rritjes së efikasitetit të pagesave, forcimit të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave, nxitjes së konkurrencës dhe integritetit gradual të Kosovës në infrastrukturën financiare evropiane.

BQK-ja i kushtoi vëmendje të veçantë edhe inovacionit financiar dhe zhvillimeve të reja teknologjike. Krijimi i kornizës rregullative për licencimin e operatorëve në fushën e kriptoseteve, avancimi i sigurisë kibernetike në BQK dhe në sektorin financiar, përgatitjet për bankimin e hapur dhe digjitalizimi i mëtejshëm i shërbimeve financiare janë trajtuar me qasje të balancuar, duke mbështetur inovacionin, por njëkohësisht duke mbrojtur stabilitetin financiar, konsumatorët dhe integritetin e sistemit.

Mbrojtja e konsumatorit dhe përfshirja financiare mbetën ndër prioritetet kryesore të Bankës Qendrore. Përmes forcimit të mbikëqyrjes së praktikave të tregut, trajtimit të ankesave të konsumatorëve, avancimit të edukimit financiar dhe funksionalizimit të platformës për krahasimin e produkteve dhe shërbimeve financiare, BQK-ja synon të fuqizojë qytetarin në raport me institucionet financiare dhe të rrisë transparencën në treg.

Në aspektin e integritetit financiar, Banka Qendrore vazhdoi të ndërmarrë masa për mbrojtjen e euros, luftimin e parasë së falsifikuar, parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Përgatitjet dhe aktivitetet për themelimin e Qendrës Kombëtare kundër Falsifikimit të parasë, si dhe bashkëpunimi me Bankën Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore partnere, janë dëshmi e përkushtimit tonë për ruajtjen e besueshmërisë së parasë në qarkullim dhe të integritetit monetar të vendit. Në këtë drejtim, projekti i ri me Bashkimin Evropian, i cili po zhvillohet në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kroacisë, mundësoi edhe nënshkrimin e marrëveshjes historike me Bankën Qendrore Evropiane.

Reformat e brendshme institucionale ishin po ashtu pjesë e rëndësishme e punës sonë gjatë vitit. Fuqizimi i qeverisjes së brendshme, menaxhimit të rrezikut, auditimit, pajtueshmërisë, burimeve njerëzore, sigurisë kibernetike dhe menaxhimit të projekteve ka ndihmuar në ngritjen e efikasitetit institucional dhe në përgatitjen e BQK-së për sfidat e ardhshme. Këto reforma e bëjnë Bankën Qendrore më moderne, më transparente dhe më të aftë për të përmbushur mandatin e saj në një mjedis gjithnjë e më kompleks. Kodi i Transparencës i FMN-së për bankat qendrore vlerësoi lart këto aspekte, duke ofruar njëkohësisht rekomandime për avancim të mëtejme në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Në planin ndërkombëtar, viti 2025 shënoi forcim të mëtejme të kredibilitetit të Kosovës dhe të Bankës Qendrore. Bashkëpunimi me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, Bankën Qendrore Evropiane, BERZH-in, IFC-në dhe bankat qendrore homologe u zgjerua në fusha të rëndësishme si stabiliteti financiar, pagesat, menaxhimi i rezervave, siguria kibernetike, mbikëqyrja dhe zhvillimi institucional. Po ashtu, sigurimi i vazhdimtë të linjës së likuiditetit EUREP nga Banka Qendrore Evropiane, heqja e Kosovës nga lista e Bankës Botërore për vendet në situata të brishtësisë dhe konfliktit, si dhe ri-konfirmimi i vlerësimit kreditor sovran “BB-”, përbëjnë zhvillime me rëndësi të veçantë për kredibilitetin financiar të vendit.


BQK-ja ka vazhduar të sigurojë qëndrueshmërinë e saj financiare dhe buxhetore, si parakusht për ruajtjen e pavarësisë institucionale. Menaxhimi i kujdesshëm i burimeve, forcimi i rezervave dhe kontributi në buxhetin e Republikës së Kosovës dëshmojnë se Banka Qendrore vazhdon të veprojë me përgjegjësi, efikasitet dhe përkushtim ndaj interesit publik. Prandaj, për të tretin vit me radhë, BQK-ja do të ndajë të ardhurat e ndashme në buxhetin e shtetit, sipas përcaktimeve ligjore.

Duke shikuar përpara, prioritetet tona mbeten të qarta: avancimi i ruajtjes së stabilitetit financiar, integrimi në sistemin financiar evropian përmes nismave si SEPA, modernizimi i infrastrukturës së pagesave përmes TIPS Clone, fuqizimi i mbrojtjes së konsumatorit, zhvillimi i inovacionit të sigurt financiar, rritja e qëndrueshmërisë kibernetike dhe forcimi i kapaciteteve institucionale. Në përmbushjen e këtyre objektivave, BQK-ja do të vazhdojë të veprojë gjithnjë si institucion i pavarur kushtetues, profesional, transparent dhe në shërbim të qytetarëve dhe ekonomisë së Republikës së Kosovës. Në përmbyllje, dëshiroj të falënderoj stafin dhe drejtuesit e Bankës Qendrore për angazhimin dhe profesionalizmin e treguar gjatë vitit 2025, Bordin e Bankës Qendrore për bashkëpunimin, mbështetjen dhe orientimin strategjik. Gjithashtu falënderoj institucionet e Republikës së Kosovës për bashkëpunimin ndërinstitucional, partnerët tanë ndërkombëtarë për mbështetjen e vazhdueshme, si dhe publikun, mediat, shoqërinë civile dhe akademinë për kontributin në forcimin e transparencës dhe besimit publik.

Me përkushtim të vazhdueshëm për stabilitet, integritet, transparencë dhe zhvillim gjithëpërfshirës, BQK-ja do të vazhdojë të jetë garantuese e stabilitetit financiar dhe kontribuuese aktive në zhvillimin ekonomik, institucional dhe evropian të vendit.

Me respekt,

Ahmet Ismaili,



Guvernator

Kryesues i Bordit Ekzekutiv

3. Përmbledhje ekzekutive

Viti 2025 u karakterizua nga vazhdimësia e qëndrueshme e zhvillimit ekonomik dhe konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit financiar në Republikën e Kosovës, në një mjedis ndërkombëtar me sfida dhe me ritëm më të moderuar të aktivitetit ekonomik. Ekonomia shënoi rritje reale prej 3.6%, e mbështetur kryesisht nga konsumi dhe investimet, ndërsa inflacioni u përshpejtua në 3.9%, duke reflektuar presionet nga çmimet e ushqimit dhe energjisë.

Sistemi financiar vijoi zgjerimin e qëndrueshëm, me asete që arritën rreth 14.6 miliardë euro. Sektori bankar mbeti dominues, ndërsa sektorët pensional, i sigurimeve dhe mikrofinanciar kontribuan në thellimin e ndërmjetësimit financiar dhe diversifikimin e burimeve të financimit.

Sektori bankar vazhdoi të jetë i qëndrueshëm, likuid dhe mirë i kapitalizuar. Stoku i kredive arriti rreth 6.7 miliardë euro, me rritje vjetore prej 14.7%, ndërsa depozitat vijuan zgjerimin e qëndrueshëm, duke reflektuar besim të lartë të publikut. Norma e kredive joperformuese mbeti e ulët, rreth 2%, ndërsa treguesit e likuiditetit dhe kapitalizimit qëndruan mbi kërkesat rregullative. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) u përforcua edhe nga shtesat makroprudenciale, duke rritur rezistencën e sistemit ndaj goditjeve të mundshme.

Paralelisht, u avancua sistemi i sigurimit të depozitave përmes rritjes së kontributit të bankave përmes premive në FSDK, që variojnë nga 0.75% deri në 1.5%, duke kontribuar në kapitalizimin e mëtejshëm të FSDK, disiplinën e tregut dhe stabilitetin financiar.

Sektorët e tjerë financiarë shënuan performancë pozitive. Asetet e sektorit pensional arritën rreth 3.8 miliardë euro, të mbështetura nga kthime solide nga investimet, ndërsa sektori i sigurimeve dhe ai mikrofinanciar vijuan rritjen, duke mbështetur ndërmarrjet dhe ekonominë familjare.

BQK intensifikoi aktivitetet mbikëqyrëse në të gjitha segmentet e sistemit financiar. Gjatë vitit 2025 u realizuan gjithsej 30 ekzaminime në vend, duke përfshirë sektorin bankar, të sigurimeve, pensione, institucionet mikrofinanciare dhe jobankare, si dhe fusha si teknologjia e informacionit dhe parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Fokus i veçantë iu kushtua vlerësimit të rreziqeve, qeverisjes korporative, sigurisë kibernetike dhe pajtueshmërisë rregullative.

Në aspektin rregullativ dhe institucional, BQK avancoi harmonizimin me kornizën e Bashkimit Evropian, përfshirë zhvillimin e standardeve FINREP/COREP dhe zbatimin gradual të modelit SREP. U forcua funksioni i hulumtimeve dhe u miratua Politika e Investimeve e BQK-së, duke përmirësuar menaxhimin e rezervave, dhe hapur rrugë menaxhimit aktiv të rezervave.

Në kuadër të zhvillimit të tregut financiar, u miratuan dokumente të rëndësishme, si Udhëzimi metodologjik për raportimin në Regjistrin e Kredive, Letra këshilluese për kreditë e sindikuara dhe Strategjia trevjeçare për menaxhimin e rreziqeve klimatike.

Në aspektin e mbrojtjes së konsumatorit, gjatë vitit 2025 u avancuan proceset e mbikëqyrjes së praktikave të tregut, shqyrtimit të ankesave, ku trajtuan 1,188 ankesa, ndërsa pjesa më e madhe e tyre lidhej me bankat dhe kompanitë e sigurimeve, duke nënvizuar rëndësinë e mbikëqyrjes së praktikave të tregut.

Në fushën e transparencës, u miratua Rregullorja për Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare, si dhe u ndërmorën hapa për funksionalizimin e saj, krahas aktiviteteve të edukimit financiar dhe zgjerimit të qasjes në financa.

Sistemi i pagesave shënoi progres të rëndësishëm drejt digjitalizimit, me përgatitje për zhvillimin e infrastrukturës së re. Sistemi Ndërbankar i Pagesave (KIPS) procesoi mbi 21 milionë

transaksione, me vlerë mbi 27 miliardë euro, ndërsa përdorimi i instrumenteve elektronike dhe shërbimeve digjitale, përfshirë Apple Pay dhe Google Pay, u rrit ndjeshëm.

Një zhvillim strategjik ishte avancimi i projektit për pagesa të menjëhershme përmes TIPS Clone, si dhe përgatitjet për anëtarësim në SEPA, të cilat përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt integritimit financiar evropian. Kufizimet në mos shpalljen e ligjeve për shkak të shqyrtimit kushtetues, pamundësuan aplikimin final në SEPA, dhe për rrjedhojë, humbjen e mundësisë që të jemi në trend me vendet fqinje, në një proces që do të sillte përfitime shumë të larta për vendin.

Në fushën e inovacionit financiar, u miratua korniza e parë rregullative për krypto-asetet, duke vendosur bazën për licencimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në aspektin e sigurisë dhe integritetit financiar, u inicua nisma për Njësinë kundër Falsifikimit dhe u nënshkrua memorandum bashkëpunimi me Bankën Qendrore Evropiane, si një marrëveshje historike e nivelit të tillë, pikërisht në çështjen e ruajtjes së integritetit të valutës euro në Kosovë.

Në planin ndërkombëtar, u forcua bashkëpunimi me partnerët strategjikë. U sigurua linja e likuiditetit EUREP prej 100 milionë euro nga BQE, ndërsa FMN miratoi rishikimin e katërt të marrëveshjeve SBA dhe RSF.

Një zhvillim i rëndësishëm ishte heqja e Kosovës nga Lista e Bankës Botërore për Vendet në Situata të Brishtësisë dhe Konfliktit (FCS/FCV), si dhe konfirmimi i vlerësimit kreditor sovran “BB-” nga agjencia Fitch Ratings, duke reflektuar stabilitetin makroekonomik dhe rritjen e besimit ndërkombëtar.

Në aspektin fiskal dhe të jashtëm, borxhi publik mbeti në nivel të ulët, prej rreth 16.4% të BPV-së, ndërsa remitencat dhe investimet e huaja direkte vazhduan të kenë rol stabilizues.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025 u ndërморën masa për formalizimin e ekonomisë, përfshirë tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave prej 500 eurosh, përkatësisht 169.5 mijë copë, në vlerë prej 84.75 milionë euro, si dhe rregullimin e transportit ndërkufitar të parasë së gatshme, përmes licencimit të 5 institucioneve dhe lëshimit të 266 autorizimeve për eksport.

Me gjithë zhvillimet pozitive, perspektiva mbetet e shoqëruar me pasiguri nga mjedisi i jashtëm, veçanërisht për shkak të tensioneve gjeopolitike dhe luhatjeve të çmimeve të energjisë. Në këtë kontekst, BQK mbetet e përkushtuar për të ruajtur stabilitetin financiar, për të avancuar kornizën rregullative dhe për të thelluar integritetin në sistemin financiar evropian, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

4. Misioni, Vizioni dhe Vlerat e BQK-së

Misioni

Misioni i BQK-së është të sigurojë dhe të ruajë stabilitetin financiar dhe të çmimeve, të ofrojë sistem efektiv të pagesave, si dhe të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Republikën e Kosovës.

Vizioni

BQK synon të vazhdojë të jetë një institucion i pavarur, i besueshëm dhe transparent, që vepron me përgjegjësi ndaj publikut, si dhe të jetë sinonim i profesionalizmit, inovacionit dhe gjithë përfshirjes.

Vlerat

BQK mbështetet në vlerat e mëposhtme:

- **Integriteti dhe etika** – Staf i BQK-së është i përkushtuar të punojë me ndershmëri sipas standardeve më të larta të integritetit dhe sjelljes profesionale në të mirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.
- **Pavarësia, kompetenca dhe profesionalizmi** - Për t'i përmbushur objektivat e saj, BQK sigurohet që veprimtarinë e saj ta udhëheqë përmes qasjes së pavarur, ekspertizës dhe profesionalizmit
- **Puna në grup dhe inovacioni** - BQK nxit bashkëpunimin dhe promovimin e ideve të reja për të përballuar sfidat me zgjidhje të qëndrueshme
- **Promovimi i interesit publik** - BQK vepron me transparencë në vendimmarrje dhe në interes të së mirës së përbashkët
- **Efektiviteti dhe efikasiteti** - Arritja e objektivave përmes përdorimit efikas të burimeve me rezultate të matshme
- **Cilësia dhe përkushtimi** - BQK punëson staf të kualifikuar që ofron punë të lartë cilësore dhe përkushtim të vazhdueshëm.

5. Plani Strategjik 2024-2028

Plani Strategjik 2025-2028 është bazuar në Politikën për Planifikim Strategjik në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Ai është një shprehje e vizionit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe një kornizë dinamike që pasqyron dedikimin tonë ndaj qëndrueshmërisë së sistemit financiar, inovacionit në funksion të rritjes së efikasitetit të shërbimeve financiare dhe mirëqenies së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ky Plan Strategjik është hartuar me kontribut dhe gjithë-përfshirje të personelit të BQK-së. Ai merr parasysh të gjitha kërkesat e nevojshme të kohës dhe shërben si udhërrëfyes për të adresuar çështjet që lidhen me: (a) qëndrueshmërinë dhe stabilitetin financiar, (b) modernizimin e infrastrukturës së tregut financiar, (c) edukimin dhe përfshirjen financiare, (ç) avancimin e mbrojtjes së konsumatorit, si dhe (d) zgjerimin e bashkëpunimit dhe ndikimit në fushat e përgjegjësisë.

Plani strategjik i është nënshtruar një rishikimi që përmban tri elemente shtesë që janë të reflektuara tek qëllimet strategjike numër 2 dhe 3 përkatësisht integrimi i teknologjive të inteligjencës artificiale, Monedhës Digjitale të Bankës Qendrore si dhe rregullimin dhe mbikëqyrjen e krypto-aseteve.

Më poshtë janë listuar pesë qëllimet strategjike të planit:

Qëllimi 1: Forcimi i qëndrueshmërisë dhe stabilitetit financiar

Avancimi i kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse për të identifikuar dhe reaguar me kohë ndaj rreziqeve të institucioneve financiare në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar.

Qëllimi 2: Ngritja e kapaciteteve, përkushtimi ndaj personelit, digjitalizimi dhe modernizimi i proceseve

Modernizimi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në funksion të ngritjes së nivelit të qeverisjes korporative, kapaciteteve njerëzore, kontrollës së brendshme, menaxhimit të riskut, transparencës, proceseve dhe operacioneve të punës.

Qëllimi 3: Modernizimi i infrastrukturës së tregut financiar dhe konkurrueshmëria

Avancimi i infrastrukturës për shlyerjen e pagesave dhe Letrave me Vlerë dhe për digjitalizimin e shërbimeve të pagesave në funksion të nxitjes së konkurrencës dhe zhvillimit të tregut.

Qëllimi 4: Avancimi i mbrojtjes së konsumatorit, edukimi financiar dhe përfshirjes financiare


Promovimi i edukimit financiar, qasjes në financa dhe gjithëpërfshirjes financiare si dhe praktikave më të mira të ofrimit të shërbimeve nga institucionet financiare.

Qëllimi 5: Zgjerimi i bashkëpunimit, përfshirjes dhe ndikimit në fushat e përgjegjësisë

Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me akterët e jashtëm, institucionet financiare, autoritetet rregullatore, institucionet financiare ndërkombëtare dhe institucionet tjera përkatëse me interes të përbashkët.

Dokumentin e plotë e gjeni në veçzën e faqes zyrtare të BQK-së: SHQ_PlaniStrategjik 2024-2028 (bqk-kos.org)

6. Struktura organizative e BQK-së, efektive nga 31 dhjetor 2025



*vetëm funksion

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

I. Ekonomia e Kosovës në vitin 2025

1. Përmbledhje Makroekonomike

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2025 vazhdoi të rritet me ritëm më të moderuar. Sipas ASK-së, BPV reale u rrit për 3.6 përqind, e mbështetur kryesisht nga konsumi dhe investimet, ndërsa eksportet neto kishin ndikim negativ për shkak të rritjes së lartë të importeve. Konsumi kontribuoi me 3.9 pikë përqindje në rritjen ekonomike, ndërsa investimet me 2.9 pikë përqindje. Importet u rritën ndjeshëm, duke thelluar deficitin tregtar, ndërsa eksporti i shërbimeve u mbështet nga shpenzimet e diasporës. Për vitin 2026, BQK parashikon rritje reale të BPV-së prej 3.5 përqind, e mbështetur kryesisht nga konsumi privat dhe rikuperimi i eksportit të mallrave, si dhe nga ngadalësimi i rritjes së importit. Megjithatë, pasiguritë mbeten të larta, sidomos për shkak të përshkallëzimit të konfliktit në Lindjen e Mesme, duke rritur rreziqet për çmimet e energjisë, ushqimit dhe ritmin e rritjes ekonomike.

Gjatë vitit 2025, inflacioni mesatar arriti në 3.9 përqind, nga 1.6 përqind në vitin 2024, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të ushqimit dhe energjisë elektrike. Inflacioni bazë u ngadalësua në 1.9 përqind. Parashikimet e BQK-së për vitin 2026 tregojnë përshpejtim të inflacionit në 6.7 përqind, por rreziqet ende mbeten të larta për shkak të tensioneve gjeopolitike dhe zhvillimeve në Lindjen e Mesme, të cilat mund të ndikojnë mbi çmimet e energjisë dhe ushqimit.

Sektori i ndërmarrjeve shënoi rritje të qarkullimit prej 6.9 përqind dhe numër më të lartë të ndërmarrjeve të reja të regjistruara, duke reflektuar përmirësim të klimës së biznesit. Në sektorin fiskal, të hyrat buxhetore u rritën për 7.6 përqind, ndërsa shpenzimet për 9.9 përqind, ndërkohë që borxhi publik mbeti në nivel të qëndrueshëm prej 16.4 përqind të BPV-së. Në sektorin e jashtëm, deficitin e llogarisë rrjedhëse u thellua si pasojë e rritjes së importit të mallrave, ndonëse bilanci i shërbimeve, remitencat dhe investimet e huaja direkte shënuan rritje.

1.1. Eurozona

Ekonomia e Eurozonës u rrit me një ritëm të përshpejtuar në vitin 2025, duke tejkaluar projeksionet e Eurostat për këtë vit. Sipas të dhënave preliminare, rritja ekonomike ishte 1.5 përqind, kundrejt 0.9 përqind në vitin paraprak. Rritja u mbështet fillimisht nga eksportet, të cilat i paraprinë tarifave të reja nga SHBA-të. Investimet gjithashtu performuan më mirë sesa pritej në shumë shtete, sidomos në Irlandë. Zhvillimet pozitive gjatë tërë vitit dëshmojnë qëndrueshmërinë e ekonomisë së eurozonës për t'i menaxhuar ngjarjet e papritura.

Anketat e Komisionit Evropian të publikuara në tetor sugjerojnë se ky ritëm pritet të vazhdojë edhe në tremujorët në vijim. Rritja mbështetet nga një treg i punës stabil, ngadalësimi i inflacionit dhe kushte të mira të financimit. Gjithashtu, politikat mbështetëse dhe financimi i vazhdueshëm nga BE-ja kanë ndihmuar në zbutjen e efektit të politikave fiskale shtrënguese në disa vende anëtare.

Dinamikat e rritjes ekonomike ishin kryesisht pozitive për vendet anëtare. Austria, e cila kishte paraparë turrje të ekonomisë për 0.3 përqind, në fakt shënoi rritje prej 0.6 përqind. Gjithashtu, Gjermania, Franca dhe Spanja tejkaluan parashikimet, duke regjistruar rritje prej 0.2, 0.8 dhe 2.9 përqind, respektivisht.

Para fillimit të luftës në Lindjen e Mesme, ekonomia e eurozonës tregoi stabilitet dhe qëndrueshmëri. Mirëpo, me fillimin e luftës me Iranin, projeksionet e BQE-së janë rishikuar poshtë dhe sugjerojnë rritje ekonomike prej 0.9 përqind në vitin 2026, në krahasim me 1.2 përqind sa ishte paraparë në dhjetor 2025. Gjithashtu, varësisht nga zhvillimet e mëtejshme të luftës,

BQE-ja ka përgatitur skenarë alternativ ku rritja ekonomike arrin 0.6 përqind apo edhe 0.4 përqind në skenarin e përkeqësuar. Këta skenarë reflektojnë ndikimin e luftës në tregjet ndërkombëtare, të ardhurat reale të ekonomive familjare dhe besimin e konsumatorëve. Në anën tjetër, papunësia e ulët, sektori privat stabil dhe shpenzimet publike në mbrojtje dhe siguri do të mbështesin rritjen.

Tregu i punës vazhdoi të karakterizohet nga zhvillime pozitive gjatë vitit 2025. Norma e papunësisë vazhdoi të mbetet 6.3 përqind, duke qëndruar në nivele historikisht të ulëta. Rritja e punësimit, e bazuar mbi pritshmëritë për rikuperim të aktivitetit ekonomik dhe rritjen e pagave reale, ishte 0.7 përqind në vitin 2025 nga 0.6 përqind në vitin e mëparshëm. Ky zhvillim sinjalizon stabilizim në tregun e punës pas një periudhe me rritje të fortë të punësimit, pasi dinamikat ciklike që nxitën punësimin pritet të zbehen gradualisht dhe pritet ngadalësim në 0.5 përqind në 2026.

Tabela 1. Indikatorët bazë makroekonomik në Eurozonë


Përshkrimi	BPV reale (%)					Inflacioni (%)					Papunësia (%)				
	2022	2023	2024	2025p	2026p	2022	2023	2024	2025	2026p	2022	2023	2024	2025	2026p
Eurozona	3.5	0.4	0.9	1.5	0.9	8.4	5.4	2.4	2.1	2.6	6.8	6.6	6.4	6.3	6.2
Austria	5.4	-0.7	-0.8	0.6	0.8	8.6	7.7	2.9	3.6	2.4	4.8	5.1	5.2	5.6	5.5
Franca	2.8	1.6	1.1	0.8	1.0	5.9	5.7	2.3	0.9	1.3	7.3	7.3	7.4	7.6	8.0
Gjermania	1.9	-0.7	-0.5	0.2	0.6	8.7	6.0	2.5	2.3	2.2	3.2	3.1	3.4	3.6	3.5
Greqia	5.5	2.1	2.1	2.1	2.1	9.3	4.2	3.0	2.8	2.1	12.5	11.1	10.1	9.3	8.6
Italia	5.0	1.1	0.5	0.6	0.6	8.7	5.9	1.1	1.7	1.4	8.1	7.7	6.5	6.2	6.1
Spanja	6.4	2.5	3.5	2.9	2.2	8.3	3.4	2.9	2.7	2.1	13.0	12.2	11.4	10.4	9.8

Burimi: BQE (Shkurt 2026) dhe Komisioni Evropian (Janar 2026).

Të dhënat janë sipas vlerësimeve dhe parashikimeve të BQE-së dhe Komisionit Evropian.

Inflacioni vazhdoi me ngadalësim në vitin 2025, duke rënë në 2.1 përqind nga 2.4 përqind në vitin paraprak. Rënia e çmimeve të energjisë bashkë me ngadalësimin e çmimeve të ushqimit, si dhe zbutja e inflacionit bazë kontribuan në këtë zhvillim. Megjithatë, përkundër ngadalësimit, inflacioni në sektorin e shërbimeve mbeti relativisht i lartë, i nxitur kryesisht nga rritja e pagave (shih grafikun 1).

Grafik 1. Inflacioni në Eurozonë sipas kategorive kryesore



Burimi: Eurostat (2026)

Projeksionet e BQE-së sugjerojnë se inflacioni pritet të tejkalojë objektivat afatmesme të këtij institucioni duke arritur normën mesatare rreth 2.6 përqind për 2026 dhe më pas të stabilizohet në 2.0 përqind në 2027. Projeksionet janë rishikuar për lart si pasojë e rritjes së çmimeve të energjisë nga konflikti në Lindjen e Mesme. Inflacioni bazë parashikohet të arrijë normë mesatare prej 2.3 përqind në 2026 dhe 2.2 përqind në 2027. Edhe këto projeksione janë më të larta se ato të dhjetorit 2025, kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë të cilat ndikojnë në mënyrë indirekte edhe inflacionin bazë.

Gjatë vitit 2025, BQE ndërmoi hapa për të lehtësuar politikën monetare. Në qershor 2025, normat kryesore të interesit, përfshirë normën e depozitave, të rifinancimit dhe të kreditimit, u caktuan në 2.0 përqind, 2.15 përqind dhe 2.4 përqind, respektivisht, dhe mbetën të pandryshuara deri në fund të vitit.

Sipas Anketave të Kreditimit Bankar të BQE-së, përgjatë vitit 2025, standardet e kreditimit vazhduan të shtrëngohen përgjithësisht, me disa tendenca lehtësuese në sektorë specifikë. Standardet e kreditimit për ndërmarrjet dhe kreditë konsumuese u shtrënguan, për shkak të rritjes së perceptimit të rrezikut nga bankat. Kurse, standardet e kreditimit për kredi hipotekare

u lehtësuan, si rezultat i rritjes së konkurrencës në sektorin bankar. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet ishte e dobët në gjysmën e parë të vitit, por u përmirësua nga TM3 e tutje. Në anën tjetër, kërkesa e ekonomive familjare qëndroi e lartë përgjatë vitit, duke reflektuar normën e ulët të papunësisë dhe normat relativisht të moderuara të interesit për këtë sektor.

1.2. Ballkani Perëndimor

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, rritja ekonomike në vitin 2025 vlerësohet të ketë qenë mesatarisht rreth 2.9 përqind, duke shënuar ngadalësim krahasuar me 3.7 përqind në vitin 2024, sipas vlerësimit të FMN-së. Megjithatë zhvillimet brenda rajonit nuk ishin të njëtrajtshme. Në Kosovë, rritja më e ngadalësuar e konsumit privat si dhe përkeqësimi i eksporteve neto ndikuan në ritmin e rritjes. Në Shqipëri, dobësimi i kërkesës së jashtme, kryesisht si pasojë e rimëkëmbjes më të ngadaltë në vendet


partnere tregtare, veçanërisht në Itali, si dhe vlerësimi i lekut që ka rritur kostot e prodhimit duke ulur konkurrueshmërinë e eksporteve, së bashku me ngadalësimin e konsumit familjar, ndikuan në ritëm më të ngadalësuar të rritjes ekonomike. Në Serbi, rënia e aktivitetit në ndërtim, performanca më e dobët në bujqësi dhe flukset më të ulëta të IHD-ve ndikuan negativisht në rritje. Në anën tjetër, në Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, aktiviteti ekonomik u mbështet nga kërkesa e brendshme, sektori i shërbimeve dhe investimet publike. Në veçanti, turizmi dhe ndërtimi vazhduan të japin kontribut të rëndësishëm në rritjen ekonomike të vendeve të rajonit.

Projeksionet e FMN-së për vitin 2026 tregojnë se rritja ekonomike në rajon pritet të mbetet kryesisht e pandryshuar krahasuar me vitin paraprak, duke u stabilizuar rreth nivelit 2.9 përqind. Megjithatë, kjo perspektivë mbetet e ndjeshme ndaj rreziqeve të jashtme dhe të brendshme. Pasiguritë politike, si në nivel vendor ashtu edhe rajonal, mund të ndikojnë negativisht në besimin e investitorëve dhe në ritmin e reformave strukturore. Po ashtu, dobësimi i mundshëm i kërkesës nga vendet e BE-së mund të reduktojë eksportet, remitencat dhe flukset e IHD-ve. Rreziqe shtesë lidhen me luhatjet e çmimeve ndërkombëtare të naftës dhe mallrave bazë sidomos për shkak të konfliktit në Lindjen e Mesme, shtrëngimit të kushteve financiare globale dhe varësisë relativisht të lartë të disa ekonomive nga sektorë specifikë, si turizmi apo ndërtimi.

Norma mesatare e inflacionit në vendet e rajonit në vitin 2025 u përshpejtua në 3.8 përqind, nga 3.1 përqind në vitin 2024. Norma më e lartë e inflacionit ishte në Maqedoninë e Veriut (4.3 përqind), ndërsa Shqipëria kishte normën më të ulët prej 2.3 përqind (shih tabelën 2). Konsumi i brendshëm, rritja e çmimeve të ushqimeve dhe sfidat strukturore të vazhdueshme, si mungesa e fuqisë punëtore dhe kostot e larta të energjisë, ushtruan presione shtesë mbi çmimet.

Aktiviteti kredi dhënës ka shënuar rritje të përshpejtuar në shumicën e vendeve të rajonit. Rritja më e lartë e kreditimit u shënuar në Maqedoninë e Veriut (16.6 përqind), ndjekur nga Serbia (15.3 përqind) dhe Kosova (14.7 përqind) (shih tabelën 2). Kreditë jo-performuese vazhduan të ruajnë nivelin e ulët në të gjitha vendet e rajonit. Megjithatë, Shqipëria vazhdon të ketë nivelin më të lartë të tyre, ndjekur nga Mali i Zi, ndërkohë që Maqedonia e Veriut ka shënuar shkallën më të ulët të kredive jo-performuese (shih tabelën 2).

Grafik 2. Rritja vjetore e BPV-së në Ballkanin Perëndimor



Burimi: Eurostat, dhe Agjencitë Statistike të vendeve të Ballkanit Perëndimor (2026).

*Projeksionet e FMN-së (WEO Prill 2026).

Tabela 2. Indikatorët bazë makroekonomik në BP

Përshkrimi	Inflacioni (%)				Bilanci i llogarisë rrjedhëse (% e BPV)				Rritja e kreditimit (%)				Kreditë jo-performuese (%)				Papunësia (%)			
	2022	2023	2024	2025	2022	2023	2024	2025	2022	2023	2024	2025	2022	2023	2024	2025	2022	2023	2024	2025
Kosova	11.6	4.9	1.6	3.9	(9.4)	(7.2)	(8.7)	(9.2)	16.0	13.0	18.3	14.7	1.9	1.9	1.9	2.1	12.6	10.9	10.8	n/a
Maqedonia e Veriut	14.0	9.0	4.2	4.3	(6.1)	0.3	(2.2)	(4.4)	10.0	4.8	10.8	16.6	2.8	2.7	2.6	1.9	14.4	13.1	12.4	11.5
Mali i Zi	11.9	8.7	3.6	4.1	(12.9)	(11.2)	(17.1)	(20.5)	8.9	11.9	13.3	14.2	6.3	5.8	4.1	3.0	n/a	n/a	n/a	n/a
Shqipëria	6.6	5.3	2.6	2.3	(5.8)	(1.2)	(2.4)	(2.0)	6.4	2.8	12.8	12.9	4.8	4.6	4.0	3.8	10.8	9.5	8.8	8.7
Bosnja dhe Hercegovina	14.0	6.1	1.7	4.0	(4.4)	(2.1)	(3.5)	(3.2)	4.7	6.6	9.8	11.1	4.5	3.8	3.2	2.4	15.4	13.2	12.6	12.6
Serbia	11.7	12.1	4.8	4.1	(6.5)	(2.3)	(4.5)	(4.9)	7.1	1.1	8.8	15.3	3.0	3.2	2.5	2.1	9.5	9.4	8.6	8.7

Burimi: Eurostat, FMN, agjencitë statistikore dhe bankat qendrore të vendeve të BP (2026)

Në vitin 2025, tregu i këmbimit valutor kishte luhajtje. Euro u vlerësua kundrejt lirës turke, dollarit amerikan dhe sterlinës britanike. Në të njëjtën kohë, ajo është zhvlerësuar ndaj lekut shqiptar dhe frangut zviceran, ndërsa ka mbetur pothuajse e pandryshuar ndaj denarit maqedonas.

1.3. Sektori real

1.3.1 Bruto Prodhimi Vendor

Ekonomia e Kosovës ka vazhduar të rritet gjatë vitit 2025, por me një ritëm më të ngadalësuar krahasuar me periudhën paraprake. Sipas vlerësimeve tremujore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV reale shënoi rritje prej 3.6 përqind gjatë 2025 (shih grafikun 3). Ndonëse rritja ishte pozitive, ajo reflekton moderim të aktivitetit ekonomik, ndikuar nga zhvillimet në sektorin e jashtëm, përkatësisht nga kontributi negativ i importit të mallrave dhe shërbimeve. Në anën tjetër, konsumi, investimet dhe eksporti i shërbimeve vazhduan të mbështesin rritjen ekonomike.


Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, kontribuoi me 3.9 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së, krahasuar me 4.8 pikë përqindje në vitin 2024. Rritja e konsumit rezultoi në jetë mbështetur nga rritja e burimeve kryesore të financimit si dhe ngadalësimi i rritjes së çmimeve. Investimet kontribuan me 2.9 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së, krahasuar me 2.1 pikë përqindje në vitin 2024, kryesisht si rezultat i rritjes së investimeve publike.

Sa i përket sektorit të jashtëm, eksportet neto ndikuan negativisht në rritjen

ekonomike me -3.1 pikë përqindje. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve kontribuoi pozitivisht me 3.2 pikë përqindje, ndërsa importi pati ndikim negativ prej 6.4 pikë përqindje. Rritja e deficitit tregtar ishte rezultat i rritjes së importit të mallrave dhe shërbimeve për 8.8 përqind. Importi i mallrave shënoi rritje reale për 10.4 përqind, ndërsa importi i shërbimeve shënoi rritje të ngadalësuar për 3.0 përqind, krahasuar me 15.9 përqind në vitin 2024. Në anën tjetër, rritja e vizitave të diasporës në Kosovë rezultoi në rritje reale të eksportit të shërbimeve për 11.5 përqind. Ndërkohë, eksporti i mallrave shënoi rënie reale prej 5.5 përqind.

Për vitin 2026, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të shënoj rritje prej 3.5 përqind. Rritja pritet të mbështetet kryesisht nga kërkesa e brendshme, përkatësisht nga konsumi dhe eksportet, ndërsa sfidat në tregtinë ndërkombëtare dhe pasiguritë globale mund të kenë ndikim të vazhdueshëm negativ në ritmin e rritjes ekonomike. Faktorët që pritet të ndikojnë në

Grafik 3. Norma e rritjes së BPV-së reale



Burimi: ASK (2026)


këtë rritje janë të ardhurat nga diaspora dhe stabilizimi i çmimeve në tregjet ndërkombëtare, që mund të ndikojnë në rritjen e besimit të konsumatorëve dhe investitorëve. Kërkesa e brendshme pritët të kontribuoj me 3.0 pikë përqindje në rritjen e BPV-së. Konsumi privat pritët të kontribuoj me 3.3 pikë përqindje, i mbështetur nga rritja e remitencave, kompensimi i punëtorëve dhe kredive personale. Investimet pritët të kontribuojnë negativisht me 1.0 pikë përqindje. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve pritët të ndikojë pozitivisht me 2.9 pikë përqindje, veçanërisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve të diasporës, ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve pritët të kontribuoj negativisht me 1.5 pikë përqindje, duke bërë që eksportet neto të kenë kontribut pozitiv prej 1.4 pikë përqindje në rritjen ekonomike.

Megjithatë, perspektiva ekonomike mbetet e ekspozuar ndaj rreziqeve dhe pasigurive që mund të ndikojnë negativisht në aktivitetin ekonomik. Tensionet gjeopolitike mund të ndikojnë në çmimet e energjisë dhe zinxhirët e furnizimit, me efekte të mundshme negative në tregti dhe investime. Po ashtu, një ngadalësim i mundshëm i aktivitetit ekonomik në BE paraqet një faktor pasigurie për rritjen ekonomike të Kosovës, duke marrë parasysh lidhjet e ngushta tregtare dhe financiare.

1.3.2 Çmimet

Gjatë vitit 2025, dinamika e çmimeve në Kosovë u karakterizua me rikthim të presioneve inflacioniste, pas shkallës relativisht të ulët të inflacionit në vitin 2024 (1.6 përqind). Inflacioni vjetor ndoqi një trajektore rritëse përgjatë vitit, duke arritur në 3.9 përqind mesatarisht, sipas ASK-së (shih grafikun 4). Përsheptimi i inflacionit u nxit kryesisht nga rritja e çmimeve të ushqimit dhe pijeve joalkoolike, të cilat shënuan rritje mesatare prej 7.6 përqind (1.4 përqind në vitin 2024). Presione inflacioniste shtesë u gjeneruan nga rritja e çmimeve të energjisë elektrike dhe shërbimeve, si dhe nga rënia më e ngadalshme e çmimeve të naftës krahasuar me vitin paraprak. Ndërkohë, çmimet e mallrave të tjera mbetën relativisht të qëndrueshme.

Grafik 4. Inflacioni në Kosovë sipas kategorive kryesore



Burimi: ASK (2026) dhe kalkulimet e BQK-së.

Çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike ishin kontribuuesi kryesor në inflacionin e vitit 2025, me 2.5 pikë përqindje (0.8 p.p. në vitin paraprak). Rritje e përsheptuar u evidentua pothuajse në të gjitha kategoritë e ushqimit, përveç atyre të peshkut dhe bulmetit, ku rritja ishte më e moderuar. Rritja më e lartë vjetore u evidentua në çmimet e frutave (11.5 përqind) dhe mishit (11.0 përqind), ndërsa sa u përket pijeve joalkoolike, çmimet e kafesë shënuan rritje vjetore prej 15.2 përqind. Zhvillimet në tregun vendor të ushqimit pasqyruan si luhatjet në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht për çmimet e mishit dhe kafesë, ashtu edhe rritjen e presioneve të brendshme inflacioniste. Konkretisht, kostoja e inputeve bujqësore u rrit për 1.7 përqind, ndërsa çmimet e prodhimeve bujqësore shënuan rritje prej 5.3 përqind në vitin 2025, duke intensifikuar presionet inflacioniste në segmentin e ushqimit.

Rritja e çmimeve të energjisë elektrike kontribuoi pozitivisht me 0.1 p.p. në inflacion në vitin 2025, krahasuar me një kontribut negativ prej -0.1 p.p. në vitin paraprak. Çmimet e energjisë elektrike shënuan rritje prej 11.5 përqind si rrjedhojë e rritjes së tarifave për konsumatorët në tregun e rregulluar. Në anën tjetër, çmimet e naftës shënuan rënie prej 4.6 përqind (-4.9 përqind në vitin paraprak), duke kontribuar negativisht në inflacion. Presione inflacioniste u evidentuan edhe në çmimet e shërbimeve, kontributi i të cilave në inflacion u rrit në 0.7 p.p. (+0.3 p.p. nga viti paraprak), kryesisht si rrjedhojë e rritjes së çmimeve të shërbimeve të restoranteve dhe atyre klinike. Ndërkohë, kontributi i mallrave të tjera mbeti në 0.6 p.p., pasi luhatjet e lehta në çmimet e mallrave të ndryshme neutralizuan efektin e përgjithshëm në inflacion.


Përshpejtimi i inflacionit të përgjithshëm nuk u reflektua në inflacionin bazë, i cili u ngadalësua në 1.9 përqind në vitin 2025, kundrejt 2.6 përqind në vitin 2024 (shih grafikun 5). Ky zhvillim pasqyron strukturën e indeksit të çmimeve, pasi inflacioni i përgjithshëm u diktua kryesisht nga çmimet e ushqimit dhe energjisë, ndërsa çmimet e mallrave dhe shërbimeve të tjera shënuan rritje më të kufizuara, duke kontribuar në ngadalësimin e inflacionit bazë.

Varësia e ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave ushqimore dhe energjetike, si dhe pesha e lartë e këtyre mallrave në shportën e konsumit, ndikojnë që norma e inflacionit në Kosovë të përcaktohet në masë të madhe nga çmimet e mallrave të importuara (shih grafikun 6). Në vitin 2025, rreth 3.0 p.p. e inflacionit të përgjithshëm ishte nga çmimet e importit, ndërsa 0.9 p.p. u gjenerua brenda vendit.

Sipas indeksit të çmimeve të importit (IÇIMP) të ASK-së, çmimet e mallrave të importuara shënuan rënie të lehtë prej 0.5 përqind deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2025. Kjo rënie u mbështet nga rënia e çmimeve të produkteve minerale (-3.6 përqind), metaleve bazë (-4.0 përqind), si dhe produkteve të plastikës, letrës, e të tjera. Në anën tjetër, u evidentua rritje e çmimit të produkteve shtazore (5.4 përqind), produkteve bimore (3.5 përqind) dhe artikujve ushqimor të përpunuar (1.4 përqind).


Në anën tjetër, në vitin 2025 u evidentua përshpejtim i rritjes së indekseve që sinjalizojnë për koston e prodhimit të brendshëm, si indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) dhe indeksi i kostonë së ndërtimit (IKN). IÇP rezultoi me rritje prej 7.7 përqind, kundrejt rritjes prej 4.5 përqind në vitin 2024. Faktor kryesor ishte rritja e çmimeve në sektorin e furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (26.1 përqind), pavarësisht rritjes më të ngadalshme ose rënies në disa sektorë të përpunimit dhe xehetarisë. Po ashtu, IKN shënoi rritje prej 4.4 përqind (3.4 përqind në vitin paraprak), kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore prej 3.2 përqind, pagave prej 8.9 përqind, energjisë prej 17.1 përqind dhe, në shkallë më të ulët, nga rritja

Grafik 5. Inflacioni bazë dhe i përgjithshëm



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2026)

Grafik 6. Inflacioni i brendshëm dhe i importuar



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2026)

e çmimeve të transportit, makinerive, dhe kostove tjera. Edhe indeksi i çmimeve të pronave banesore sipas ASK-së shënoi rritje vjetore prej 4.8 përqind deri në tremujorin e tretë të vitit 2025 (3.6 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).

Sipas projeksioneve të BQK-së, inflacioni gjatë vitit 2026, pritet të arrijë një mesatare vjetore prej rreth 6.7 përqind, përpara se të ngadalësohet gradualisht në 4.5 përqind në vitin 2027, si rezultat i lehtësimit të presioneve të jashtme. Një moderim i pjesshëm i inflacionit mund të materializohet në gjysmën e dytë të vitit 2026, i mbështetur nga ngadalësimi i inflacionit të ushqimit dhe efektet bazë të favorshme nga tarifat e energjisë elektrike. Megjithatë, perspektiva mbetet e shoqëruar me pasiguri të konsiderueshme, të lidhura me zhvillimet në tregjet globale të energjisë, tensionet gjeopolitike dhe mundësinë e shpërndarjes së presioneve inflacioniste mbi çmimet e mallrave dhe shërbimeve tjera.


1.3.3 Ndërmarrjet

Qarkullimi i ndërmarrjeve, sipas të dhënave të ATK-së, ka shënuar rritje prej 6.9 përqind në vitin 2025. Dy sektorët me peshën më të madhe në qarkullimin e ndërmarrjeve mbeten tregtia dhe industria përpunuese, të cilët përfaqësojnë 42.2 përkatësisht 10.5 përqind të qarkullimit të përgjithshëm. Gjatë vitit 2025, qarkullimi në këta dy sektorë ka shënuar rritje. Në sektorin e tregtisë, rritja mesatare ishte 5.9 përqind, ndërsa në sektorin e industrisë përpunuese rritja ishte 9.1 përqind.

Sa i përket regjistrimit të ndërmarrjeve, në vitin 2025 u regjistruan më shumë ndërmarrje të reja dhe u mbyllën më pak ndërmarrje krahasuar me vitin 2024, duke treguar një përmirësim të klimës së biznesit dhe stabilitet të sektorit privat. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte 13,123 sosh, që paraqet një rritje prej 8.9 përqind krahasuar me vitin 2024, ndërsa u mbyllën 1,350 ndërmarrje, apo 17.5 përqind më pak sesa në vitin 2024 (shih grafikun 7).


Sektorin e tregtisë vazhdon të kryesoj për nga numri i ndërmarrjeve të reja, duke përfaqësuar 23.8 përqind të gjithë ndërmarrjeve të reja të regjistruara, ndjekur nga sektori i prodhimit me 11.0 përqind, sektori i ndërtimitarisë 10.7 përqind, aktiviteteve profesionale 10.4 përqind, hotelerisë 9.4 përqind, etj. (shih grafikun 8). Krahasuar me vitin 2024, në sektorin e hotelerisë u regjistruan 211 ndërmarrje më shumë, në sektorin e aktiviteteve profesionale 167 dhe në sektorin e informacionit dhe komunikimit 166 ndërmarrje më shumë. Në anën tjetër, sektori i vetëm me numrin më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara në krahasim me vitin 2024 ishte sektori i bujqësisë me 38 ndërmarrje më pak.

Grafik 7. Regjistri i bizneseve



Burimi: ASK (2026)

Grafik 8. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2026)

1.3.4. Tregu i punës¹

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në vitin 2024 ishte 43.2 përqind, duke shënuar rritje prej 2.5 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, ky nivel vlerësohet si relativisht i ulët, për shkak të një pjese të konsiderueshme të popullsisë në moshë relativisht të re (nxënës, studentë), si dhe punonjësve të dekurajuar dhe personave që nuk janë aktiv në kërkim të punës.

Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore të ASK-së, shkalla mesatare e punësimit në vitin 2024 ishte 38.6 përqind, që paraqet një rritje vjetore prej 2.3 pikë përqindje. Shkalla e punësimit ishte më e lartë se meshkujt, me 55.9 përqind, që tregon një rritje vjetore prej 2.5 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak. Ndërkohë, përqindja e femrave të punësuarra ishte 21.2 përqind, duke shënuar rritje vjetore prej 1.4 pikë përqindje krahasuar me vitin 2023.

Gjithashtu, sipas të dhënave nga anketa e lartpërmendur, popullsia e moshës 35-44 vjeç ka normën më të lartë të punësimit (51.1 përqind), ndërsa grup-mosha 15-24 vjeç (sipas kategorizimit të ASK-së) ka normën më të ulët të punësimit (19.4 përqind). Sipas nivelit arsimor, shkalla më e lartë e punësimit rezulton të jetë në mesin e fuqisë punëtore me arsim të lartë, pasuar nga ata me arsim të mesëm.

Diktuar edhe nga struktura e ekonomisë, shkalla e punësimit ishte më e lartë në sektorin e tregtisë (19.5 përqind e të punësuarve), pasuar nga sektori i ndërtimtarisë (12.6 përqind), sektori i prodhimit (10.6 përqind), sektori i arsimit (8.8 përqind), etj. Krahasuar me vitin 2023, të dhënat tregojnë për një rritje në pjesëmarrjen e të punësuarve në sektorët e ndërtimtarisë dhe prodhimit ndërsa pjesëmarrja e të punësuarëve në sektorin e tregtisë ishte më e ulët.

Statistikat zyrtare të tregut të punës tregojnë se shkalla mesatare e papunësisë në vitin 2024 ishte 10.8 përqind, një nivel pak më i ulët sesa në vitin paraprak (10.9 përqind). Në baza gjinore, tregu i punës në Kosovë karakterizohet nga një shkallë më e lartë e papunësisë tek femrat (18.0 përqind) sesa tek meshkujt (7.7 përqind). Sidoqoftë, edukimi ka përmirësuar perspektivat në tregun e punës në Kosovë, ku shkalla e papunësisë më e lartë është për personat pa shkollim (rreth 55.9 përqind), ndërsa më e ulëta për ata me arsimim terciar (6.5 përqind).

Paga mesatare bruto në Kosovë për vitin 2024, ishte 639 euro, nga 570 sa ishte vitin paraprak. Në sektorin publik, paga mesatare ishte 755 euro, ndërsa ajo në sektorin privat ishte 598 euro. Sipas aktivitetit ekonomik, sektorët me pagat më të larta janë Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (1105 euro) dhe Informimi dhe komunikimi (1090 euro). Në anën tjetër, paga më e ulët mesatare u raportua në sektorin e Akomodimit dhe aktivitetëve të shërbimeve me ushqim (389 euro).

1.4. Sektori fiskal

Gjatë vitit 2025, sektori fiskal u karakterizua me rritje të konsiderueshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Të hyrat buxhetore² arritën në 3.3 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.6 përqind. Kjo rritje u mbështet nga përmirësimi i procesit të mbledhjes së të hyrave dhe forcimi i luftës kundër evazionit tatimor. Si rezultat, deficiti primar buxhetor arriti në 0.3 përqind të BPV-së.

Të hyrat tatimore shënuan rritje pothuajse në të gjithë komponentët. Rritja më e lartë është shënuar tek të hyrat tatimore indirekte, të cilat arritën në 2.5 miliardë euro, që përbën rritje prej 8.4 përqind krahasuar me vitin 2024. Të hyrat tatimore direkte shënuan rritje prej 8.1 përqind,

¹ Të dhënat e fundit të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për tregun e punës janë për vitin 2024.

² Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen pranimet nga huazimet shtetërore.

duke arritur në 559.3 milionë euro. Ndërkohë, të hyrat jo-tatimore shënuan rritje të lehtë prej 0.5 përqind, duke arritur në 339.6 milionë euro.

Shpenzimet buxhetore³ shënuan rritje prej 9.9 përqind, duke arritur vlerën prej 3.4 miliardë euro. Shpenzimet rrjedhëse shënuan rritjen më të lartë, prej 9.5 përqind, duke arritur në 2.7 miliardë euro. Brenda kësaj kategorie, shpenzimet për paga shënuan rritje për 7.9 përqind, duke arritur vlerën prej 910.6 milionë euro, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime (përfshirë ato komunale) shënuan rritje për 8.8 përqind, duke arritur vlerën prej 502.4 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje prej 10.6 përqind, duke arritur në 1.2 miliardë euro. Në anën tjetër, shpenzimet kapitale arritën në 729.4 milionë euro, duke shënuar rritje prej 11.4 përqind krahasuar me vitin 2024.

Borxhi publik për vitin 2025 arriti vlerën prej 1.82 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 4.5 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Megjithatë, raporti i borxhit publik ndaj BPV-së u ul në 16.4 përqind, nga 16.8 përqind që ishte në fund të vitit 2024. Si rezultat i rritjes së likuiditetit të Qeverisë, borxhi i brendshëm publik shënoi rënie të lehtë prej 0.1 përqind, duke arritur në 961.1 milionë euro, ndërsa borxhi i jashtëm publik shënoi rritje prej 10.3 përqind, duke arritur në 854.6 milionë euro, apo 47.1 përqind e gjithsej borxhit publik.

Shuma e shpallur në ankande gjatë vitit 2025 arriti vlerën prej 275 milionë euro, apo 1.8 përqind më shumë krahasuar me vitin 2024. Ndërkohë, shuma e pranuar ishte 243.7 milionë euro, ose 13.3 përqind më pak se në vitin 2024. Kërkesa për investime në bono dhe obligacione qeveritare gjithashtu ishte më e lartë për 6.2 përqind krahasuar me vitin 2024. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës shënoi rënie, duke arritur në 2.77 përqind, krahasuar me 3.86 përqind në vitin 2024. Ngjashëm me vitin paraprak, struktura e letrave me vlerë në vitin 2025 dominohej nga letrat me vlerë me afat maturimi pesëvjeçar, të cilat përbënin 35.7 përqind të gjithsej letrave me vlerë.

1.5. Sektori i jashtëm

Në vitin 2025, bilanci i pagesave u karakterizua nga thellimi i deficitit në llogarinë rrjedhëse, ndërkohë që llogaria financiare vijoi të reflektojë hyrje neto të kapitalit, duke mundësuar financimin e deficitit të jashtëm. Llogaria kapitale mbeti pozitive dhe shënoi rritje të lehtë krahasuar me vitin paraprak. Deficiti i llogarisë rrjedhëse arriti në 908.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 4.1 përqind. Zgjerimi i deficitit u përcaktua kryesisht nga thellimi i deficitit të bilancit tregtar të mallrave dhe pjesërisht nga rënia e bilancit pozitiv e të ardhurave parësore. Në të njëjtën kohë, përmirësimi i bilancit të shërbimeve, si dhe i bilancit të të ardhurave dytësore, kontribuan në zbutjen e pjeshme të këtij thellimi.

Grafik 9. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar i mallrave



Burimi: ASK (2026)


³ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim.

Deficiti tregtar i mallrave shënoi rritje prej 12.5 përqind, duke arritur vlerën prej 6.1 miliardë euro (shih grafikun 9). Eksporti i mallrave arriti në 942.1 milionë euro, duke shënuar rënie të lehtë prej 0.2 përqind kundrejt vitit paraprak (shih grafikun 10). Rënia u ndikua kryesisht nga metalet bazë, të cilat shënuan rënie prej 7.9 përqind dhe kontribuan me -1.8 pikë përqindje në gjithsej eksportin, si rezultat i dobësimit të kërkesës së jashtme dhe sfidave në prodhim. Po ashtu, artikujt tjerë të prodhuar shënuan rënie prej 6.1 përqind, me kontribut negativ prej -0.7 pikë përqindje. Në anën tjetër, artikujt ushqimorë, makineritë (përfshirë pajisjet elektrike) dhe produktet bimore kontribuan pozitivisht, duke zbutur pjesërisht rënien e përgjithshme të eksportit. Nga këndvështrimi gjeografik, Ballkani Perëndimor mbetet destinacioni kryesor i eksporteve (me 45.8 përqind), ku Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut përfaqësojnë tregjet kryesore. Vendet e BE-së përbëjnë 33.6 përqind të eksportit të përgjithshëm, me Gjermaninë si partnerin kryesor tregtar.

Importi i mallrave arriti në 7.0 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 10.6 përqind. Rritja u mbështet nga kërkesa e brendshme, e reflektuar në rritjen e sasisë dhe peshës së mallrave të importuara, të cilat shënuan rritje për 13.1 respektivisht 8.2 përqind. Struktura e importeve mbeti kryesisht e pandryshuar, e dominuar nga produktet minerale, mjetet e transportit, makineritë dhe artikujt ushqimorë (shih Grafikun 11). Mallrat e ndërmjetme përbënin 43.8 përqind të gjithsej importeve, mallrat konsumuese 34.6 përqind, ndërsa mallrat kapitale 11.2 përqind, megjithëse këto të fundit shënuan rritje vjetore prej 9.7 përqind. Sa i përket strukturës gjeografike, 43.1 përqind e importeve u realizuan nga vendet e BE-së, 13.7 përqind nga vendet e rajonit, 13.3 përqind nga Turqia dhe 13.1 përqind nga Kina.


Bilanci i shërbimeve arriti në 2.4 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 32.2 përqind. Eksporti i shërbimeve shënoi rritje prej 27.9 përqind, duke arritur vlerën prej 4.3 miliardë euro, me kontributin kryesor nga shërbimet e udhëtimit, të cilat arritën në 3.2 miliardë euro (rritje prej 32.9 përqind), duke reflektuar shpenzimet e diasporës dhe rritjen e numrit të udhëtarëve dhe të fluturimeve krahasuar me vitin paraprak. Po ashtu, shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit shënuan rritje për 14.3 përqind, duke arritur vlerën 398.2 milionë euro. Importi i shërbimeve shënoi rritje prej 22.9 përqind, me kontributin kryesor nga shërbimet e udhëtimit dhe transportit.

Grafik 10. Eksporti i mallrave sipas kategorive



Burimi: BQK (2026)

Grafik 11. Importi i mallrave sipas kategorive



Burimi: BQK (2026)

Bilanci i të ardhurave parësore arriti vlerën prej 222.9 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 9.4 përqind. Kompensimi i punëtorëve arriti vlerën prej 470.4 milionë euro, me rritje vjetore prej 13.0 përqind. Nga ana tjetër, bilanci i të ardhurave nga investimet mbeti negativ në 250.6 milionë euro, kryesisht si rezultat i fitimit të riinvestuar nga investimet direkte.


Të ardhurat dytësore vijuan të mbështeten kryesisht nga remitencat, të cilat arritën në 1.4 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 4.3 përqind (shih Grafikon 12). Gjermania dhe Zvicra vazhdojnë të jenë burimet

kryesore, të cilat përbëjnë 56.4 përqind të gjithëj remitencave, ndjekur nga SHBA-të dhe vendet tjera të BE-së. Remitencat përmes kanaleve formale, si bankat dhe agjencitë për transferim të parave, shënuan rritje vjetore prej 3.3 përqind, ndërsa ato përmes kanaleve joformale shënuan rritje prej 7.0 përqind, të mbështetura nga vizitat më të shpeshta të diasporës.

IHD-të arritën në 1.1 miliardë euro, duke shënuar rritje të përshpejtuar prej 38.0 përqind, kundrejt rënies prej 5.5 përqind në vitin 2024 (shih grafikun 13). Sektori i patundshmërisë vazhdon të dominojë, me 70.4 përqind të gjithëj IHD-ve (771.3 milionë euro), duke shënuar rritje prej 18.9 përqind, i ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe kërkesës së qëndrueshme për patundshmëri. Shtetet kryesore prej nga vijnë IHD-të janë Gjermania me 25.9 përqind të gjithëj IHD-ve, Zvicra me 23.0 përqind dhe Shqipëria me 9.3 përqind. Në


anën tjetër, investimet direkte të rezidentëve nga Kosova jashtë vendit arritën në 365.8 milionë euro (rritje vjetore prej 63.1 përqind), të orientuara kryesisht në patundshmëri, tregti dhe ndërtim në vendet e rajonit, duke reflektuar diversifikim të kapitalit dhe kërkesën në rritje për investime jashtë Kosovës.

Grafik 12. Remitencat



Burimi: BQK (2026)

Grafik 13. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK (2026)


II. Aktiviteti i BQK-së në vitin 2025

1. Stabiliteti Financiar

1.1. Sektori financiar

Gjatë vitit 2025, sistemi financiar në vend u karakterizua nga një rritje e qëndrueshme e aktivitetit dhe zgjerim i bazës së asetëve (shih grafikun 14)⁴. Në fund të dhjetorit 2025, asetet e sistemit financiar arritën në 14.60 miliardë euro, duke shënuar normë të ngjashme të rritjes vjetore sikurse ajo e vitit paraprak, përkatësisht 14.8 përqind nga 14.7 përqind në vitin paraprak. Zgjerimi i sistemit financiar u mbështet kryesisht nga sektori bankar, i cili vazhdoi të jetë segmenti me peshën më të madhe, duke përbërë 66.5 përqind të totalit të asetëve në dhjetor 2025. Fondet pensionale si dhe institucionet mikrofinanciare dhe financiare jo-bankare u karakterizuan me rritje vjetore të përshpejtuar. Sektori i sigurimeve vijoi të rritet, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa, sektori i ndihmësve financiar shënoi rënie gjatë kësaj periudhe, por për shkak të peshës së ulët në sistemin financiar, kontributi i këtij sektori në rënien e përgjithshme ishte minimal.

Grafik 14. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës



⁴ Disa nga të dhënat për sektorin financiar të paraqitura në këtë raport përfshijnë të dhëna të paaudituar të cilat mund të ndryshohen pas korrjimeve eventuale dhe do të reflektohen në publikimet periodike të BQK-së.

2. Mbikëqyrja Financiare

2.1. Aktivitetet Mbikëqyrëse të sektorit bankar

Gjatë vitit 2025, aktiviteti mbikëqyrës i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës është fokusuar në ruajtjen e stabilitetit financiar, forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit bankar dhe avancimin e mëtejshëm të kornizës mbikëqyrëse në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Aktivitetet mbikëqyrëse janë zhvilluar në kuadër të mandatit ligjor të BQK-së, duke përfshirë mbikëqyrjen e bankave, përcaktimin dhe zbatimin e politikave për ruajtjen e stabilitetit financiar, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave financiare, si dhe zhvillimin e qasjes rregullative dhe mbikëqyrëse të bazuar në rrezik.

Në një mjedis të karakterizuar nga rritja e aktivitetit kreditues, konkurrenca në tregun e depozitave, nevoja për harmonizim të mëtejshëm me standardet evropiane dhe kërkesat në rritje për mbikëqyrje më të bazuar në të dhëna, BQK ka vazhduar të zbatojë një qasje proaktive, analitike dhe të orientuar drejt rreziqeve kryesore. Ndërhyrja në kohë, komunikimi i vazhdueshëm me bankat, monitorimi i rregullt dhe zbatimi efektiv i masave mbikëqyrëse kanë mbetur elemente thelbësore për ruajtjen e stabilitetit dhe besueshmërisë së sektorit bankar.

Avancimi i qasjes mbikëqyrëse të bazuar në rrezik

Gjatë vitit 2025, Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare ka vazhduar zbatimin e qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, në përputhje me Manualin e Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për Banka. Kjo qasje mundëson identifikimin, vlerësimin dhe adresimin më efektiv të rreziqeve më të rëndësishme që mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë financiare të bankave individuale dhe të sistemit bankar në tërësi.

Manuali përcakton metodologjinë për planifikimin, realizimin dhe dokumentimin e ekzaminimeve, si dhe për përcaktimin e masave të nevojshme mbikëqyrëse. Në këtë kuadër, prioritetet mbikëqyrëse janë përcaktuar duke u bazuar në profilin e rrezikut të bankave, rëndësinë sistematike, dinamikën e rritjes së aktivitetit kreditues, cilësinë e portofolit kreditor, strukturën e financimit dhe kapacitetin e bankave për të menaxhuar rreziqet në mënyrë të qëndrueshme.

Përveç ekzaminimeve në vend, gjatë gjithë vitit është realizuar monitorim i rregullt dhe sistematik i performancës financiare të bankave, përmes analizës së raporteve të rregullta të dorëzuara në BQK. Ky proces ka shërbyer si instrument kyç për identifikimin e hershëm të zhvillimeve që mund të ndikojnë në profilin e rrezikut, për përcaktimin e prioriteteve mbikëqyrëse dhe për hartimin e planeve vjetore të ekzaminimeve.

Ekzaminimet në vend dhe vlerësimi i profilit të rrezikut

Gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej tri ekzaminime në banka: një ekzaminim i plotë dhe dy ekzaminime të fokusuar. Ekzaminimi i plotë ka përfshirë vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të bankës, duke përfshirë qeverisjen korporative, rrezikun kreditor, rrezikun e likuiditetit dhe rreziqe të tjera relevante. Ndërsa dy ekzaminimet e fokusuar janë përqendruar kryesisht në qeverisjen korporative dhe rrezikun kreditor.

Tabela 3. Numri i ekzaminimeve në banka gjatë vitit 2025

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Banka	1 ekzaminim i plotë
Banka	2 ekzaminime të fokusuar

Burimi: BQK (2026)

Gjatë ekzaminimit të plotë në vend është analizuar dhe vlerësuar profili i përgjithshëm i rrezikut të bankës, duke përfshirë strukturën dhe efektivitetin e qeverisjes së brendshme, kulturën organizative, apetitin për marrjen e rrezikut, si dhe efektivitetin e politikave, procedurave dhe mekanizmave për identifikimin, matjen, monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve. Njëkohësisht, është vlerësuar edhe përmbushja e rekomandimeve dhe masave korrigjuese të dala nga ekzaminimet e mëparshme të BQK-së, me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë financiare dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Fokusi mbikëqyrës në rrezikun kreditor dhe cilësinë e portofolit

Rreziku kreditor ka mbetur një nga prioritetet kryesore të mbikëqyrjes gjatë vitit 2025, duke pasur parasysh se kreditë përfaqësojnë pjesën dominuese të aseteve të bankave dhe burimin kryesor të ekspozimit ndaj rrezikut në sektorin bankar. Në këtë drejtim, BQK ka vlerësuar në mënyrë sistematike kornizën e menaxhimit të rrezikut kreditor, duke përfshirë praktikën e bankave për identifikimin, matjen, monitorimin dhe menaxhimin e rrezikut kreditor, si dhe efektivitetin e proceseve të brendshme për kontrollin e këtij rreziku.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar politikave kreditore të bankave, cilësisë së proceseve të aprovimit, analizës së aftësisë paguese të klientëve, vlerësimit dhe menaxhimit të kolateralit, mbikëqyrjes së vazhdueshme të portofolit kreditor, si dhe adekuatshmërisë së niveleve të provizionimit për humbjet e pritshme kreditore. Gjithashtu është analizuar përputhshmëria me kërkesat rregullative dhe efektiviteti i kontrolleve të brendshme, me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë financiare në nivel institucional dhe zbutjen e rreziqeve potenciale sistematike.

Analiza e detajuar e profilit të portofolit kreditor, përfshirë vlerësimin e strukturës sektoriale dhe ekspozimet ndaj individëve dhe bizneseve, ka qenë pjesë e vazhdueshme e ekzaminimeve dhe monitorimit mbikëqyrës. Kjo analizë ka synuar identifikimin e sektorëve më të ndjeshëm, vlerësimin e cilësisë së kredive dhe matjen e gatishmërisë së bankave për t'u përballur me ndryshime të mundshme në mjedisin ekonomik.

Gjatë pjesës së parë të vitit 2025 është evidentuar një rritje e përshpejtuar e kreditimit, e cila në disa raste ka tejkaluar projeksionet e vetë bankave. Përmes komunikimit të vazhdueshëm, analizave mbikëqyrëse dhe angazhimit të drejtpërdrejtë me bankat, kjo dinamikë e rritjes është stabilizuar, duke kontribuar në ruajtjen e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së sektorit bankar.

Monitorimi i rrezikut të likuiditetit dhe strukturës së financimit

Në vijim të rritjes së përshpejtuar të portofolit kreditor gjatë pjesës së parë të vitit 2025, rreziku i likuiditetit ka marrë vëmendje më të shtuar në kuadër të aktivitetit mbikëqyrës. Zgjerimi më i shpejtë i kredidhënies krahasuar me ritmin e rritjes së depozitave ka krijuar presion shtesë mbi burimet e financimit të bankave dhe ka ndikuar në intensifikimin e konkurrencës për sigurimin e depozitave të reja.

Kjo konkurrencë është reflektuar kryesisht përmes ofrimit të normave më të larta të interesit, veçanërisht për depozitat me afat, duke ndikuar në koston e financimit. Në këtë kontekst, BQK ka monitoruar me kujdes ndikimin e këtyre zhvillimeve në strukturën e financimit, koston e fondeve dhe qëndrueshmërinë afatmesme të likuiditetit në sektorin bankar.

Në këtë drejtim, janë vlerësuar pozicionet afatshkurtra dhe afatgjata të likuiditetit të bankave, përmes treguesve kyç si LCR (Liquidity Coverage Ratio) dhe NSFR (Net Stable Funding Ratio). Po ashtu, janë analizuar skenarë të mundshëm të stresit në treg për të vlerësuar aftësinë e bankave për t'u përballur me tronditje të papritura në burimet e financimit. Rezultatet e këtyre analizave kanë treguar se bankat kanë mbetur stabile dhe të qëndrueshme edhe në kushte të stresit.

Transformimi i kornizës mbikëqyrëse drejt modelit SREP

Një nga zhvillimet më të rëndësishme reformuese gjatë vitit 2025 ka qenë vazhdimi i transformimit të qasjes mbikëqyrëse nga metodologjia tradicionale CAMELS drejt zbatimit të modelit evropian SREP (Procesi i Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës). Ky proces është zhvilluar me asistencë teknike nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe përfaqëson një reformë të rëndësishme strukturore në mënyrën e vlerësimit mbikëqyrës të bankave.

Tranzicioni drejt SREP synon ndërtimin e një kornize më gjithëpërfshirëse, më të strukturuar dhe më të orientuar drejt rrezikut, duke përfshirë vlerësimin e modeleve të biznesit, qeverisjes së brendshme, rreziqeve kryesore, si rreziku kreditor, operacional, i tregut dhe i likuiditetit, si dhe adekuatshmërisë së kapitalit dhe likuiditetit të secilës bankë në raport me profilin e saj të rrezikut.

Gjatë vitit 2025 është përpiluar manuali me udhëzime dhe procedura, në pajtueshmëri me planin e veprimit të aprovuar në BQK, me qëllim sigurimin e zbatimit të plotë dhe të harmonizuar të këtij modeli. Korniza e re mbikëqyrëse synon të jetë në përputhje me standardet e Autoritetit Bankar Evropian dhe të Komitetit të Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare, duke fuqizuar analizën e faktorëve kyç të rrezikut, vlerësimin e qëndrueshmërisë së kapitalit dhe likuiditetit, si dhe integrimin sistematik të elementeve cilësore dhe sasore në vendimmarrjen mbikëqyrëse.

Zgjerimi i kornizës raportuese FINREP dhe COREP

Në funksion të harmonizimit të mëtejshëm me standardet e Bashkimit Evropian, gjatë vitit 2025 BQK ka avancuar procesin për zgjerimin dhe avancimin e kornizës raportuese përmes zbatimit të FINREP (Financial Reporting) dhe COREP (Common Reporting). Ky proces është zhvilluar në bashkëpunim me FINSAC, Qendrën Këshilluese të Sektorit Financiar, pjesë e Bankës Botërore.

Gjatë vitit 2025 janë finalizuar format dhe kërkesat raportuese në kuadër të FINREP, duke krijuar një bazë të qëndrueshme bazën për përmirësimin e cilësisë, përmbajtjes dhe krahasueshmërisë së të dhënave financiare. Ndërkohë, ka vazhduar puna për zhvillimin dhe zbatimin e kornizës COREP. Të dyja setet e raportimit parashihen të hyjnë në fuqi në janar 2027.

Zbatimi i FINREP dhe COREP pritet të përforcojë ndjeshëm kapacitetet mbikëqyrëse të BQK-së, duke mundësuar analiza më të avancuara të rreziqeve, përmirësim të mekanizmave të paralajmërit të hershëm, krahasueshmëri më të madhe të të dhënave dhe rritje të efikasitetit të mbikëqyrjes. Gjatë procesit janë zhvilluar diskutime të rregullta me bankat, me qëllim sqarimin e kërkesave të reja, adresimin e sfidave teknike dhe sigurimin e një tranzicioni të strukturuar dhe të koordinuar drejt standardeve të reja raportuese.

Integrimi i rreziqeve klimatike dhe mjedisore në mbikëqyrje

Gjatë vitit 2025, BQK ka miratuar Udhërrëfyesin Strategjik 2025–2027 për Menaxhimin e Rreziqeve Klimatike dhe Mjedisore në sektorin financiar. Ky dokument është në përputhje me Planin Strategjik të BQK-së dhe me zotimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë Deklaratën e Sofjes dhe Marrëveshjen për Qëndrueshmëri me FMN-në.

Udhërrëfyesi synon të forcojë identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe kontrollin e rreziqeve klimatike dhe mjedisore nga institucionet financiare, përfshirë bankat. Në këtë kuadër, bankat do të dorëzojnë vlerësime të vetë-përputhshmërisë dhe do të hartojnë plane për adresimin e boshllëqeve të identifikuar. Rreziqet klimatike do të integrohen gjithashtu gradualisht në metodologjinë e vlerësimit SREP.

BQK do të vazhdojë të realizojë pyetësorë periodikë dhe të zhvillojë metodologji për adresimin e ndikimeve të rreziqeve klimatike në modelet e biznesit, qeverisjen, rrezikun kreditor, rrezikun

operacional dhe rrezikun e tregut. Kjo qasje përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse dhe integritetit të rreziqeve të reja strukturore në kornizën mbikëqyrëse që lidhen me tranzicionin klimatik dhe mjedisor, në linjë me zhvillimet dhe praktikatat ndërkombëtare.

Gjendja e sektorit bankar dhe rezultatet e mbikëqyrjes

Si rezultat i mbikëqyrjes së vazhdueshme, avancimit të kërkesave rregullative, përshtatjes me standardet ndërkombëtare, si dhe angazhimit të bankave për menaxhim më të mirë të rreziqeve, sektori bankar në Kosovë ka vazhduar të mbetet mirë i kapitalizuar, me cilësi të lartë të aseteve dhe me nivel të mjaftueshëm të likuiditetit.

Aktivitetet mbikëqyrëse gjatë vitit 2025 kanë kontribuar në identifikimin dhe adresimin në kohë të zhvillimeve me rëndësi për stabilitetin financiar, veçanërisht në fushën e rrezikut kreditor, rrezikut të likuiditetit, qeverisjes korporative, strukturës së financimit dhe qëndrueshmërisë së modeleve të biznesit. Komunikimi i vazhdueshëm me bankat dhe dialogu mbikëqyrës kanë ndihmuar dhe mbështetur orientimin e institucioneve drejt praktikave më të kujdesshme dhe më të qëndrueshme.

Reformat e ndërmarra gjatë vitit 2025, përfshirë avancimin drejt SREP, zgjerimin e kornizës raportuese FINREP dhe COREP, si dhe integrimin e rreziqeve klimatike në mbikëqyrje, përfaqësojnë shtylla kyçe të transformimit të kornizës mbikëqyrëse të BQK-së. Përmes këtyre reformave, BQK po konsolidon një sistem mbikëqyrës më të fuqishëm dhe më të avancuar, më reagues, më të bazuar në të dhëna dhe më të harmonizuar me kërkesat moderne të mbikëqyrjes bankare dhe me praktikatat evropiane.

Prioritetet mbikëqyrëse për periudhën në vijim

Në vijim, BQK do të vazhdojë avancimin e mëtejshëm të kornizës rregullative dhe forcimin e mbikëqyrjes së vazhdueshme, me theks të veçantë në mbikëqyrjen e bazuar në rrezik dhe në analizën e hershme të zhvillimeve që mund të ndikojnë në stabilitetin financiar.

Gjatë vitit 2026, fokusi mbikëqyrës i BQK-së do të intensifikohet në vlerësimin e rrezikut kreditor dhe rrezikut të likuiditetit, me fokus të veçantë në bankat me rëndësi sistematike, në institucionet që karakterizohen nga ritme të shpejta të rritjes, si dhe në ato që shfaqin sinjale të përkeqësimit të profilit të rrezikut, qoftë në cilësinë e portofolit kreditor apo në strukturën e burimeve të financimit.

Vëmendje e shtuar do t'i kushtohet forcimit të qeverisjes korporative, realizmit të projeksioneve financiare dhe qëndrueshmërisë së modeleve të biznesit, me qëllim që rritja e sektorit bankar të mbetet e bazuar në parime të shëndosha dhe të qëndrueshme. Në këtë kuadër, BQK do të avancojë më tej qasjen e mbikëqyrjes së bazuar në të dhëna, duke shfrytëzuar analiza më të thelluara, indikatorë të hershëm paralajmërues dhe zhvillim të dialogut të strukturuar me institucionet financiare.

Përmes këtyre prioritetëve dhe veprimeve, BQK synon të forcojë më tej stabilitetin financiar, të rrisë cilësinë dhe efektivitetin e mbikëqyrjes, si dhe të sigurojë që sektori bankar të vazhdojë të mbështesë zhvillimin ekonomik të vendit në mënyrë të qëndrueshme dhe të përgjegjshme.

2.1.1 Përmbyllja e Bankave

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) sipas Ligjit Nr. 08/L-304 për Bankat do të jetë autoritet i përmbylljes për bankat dhe degët e bankave të huaja që ushtrojnë veprimtari financiare dhe bankare në Republikën e Kosovës.

BQK si autoritet i përmbylljes ushtron kompetencat e përmbylljes kur konsideron se një bankë është duke dështuar ose ka mundësi të dështojë dhe se një veprim i përmbylljes është i nevojshëm në interes të publikut.

BQK si autoritet i përmbylljes në rastet e zbatimit të instrumenteve të përmbylljes dhe ushtrimit të kompetencave të përmbylljes merr parasysh objektivat e përmbylljes si në vijim:

- Sigurimin e vazhdimësisë së funksioneve kritike të bankës;
- Mënjanimin e efektit negativ të konsiderueshëm në sistemin financiar, në veçanti duke parandaluar përhapjen e rreziqeve, përfshirë edhe infrastrukturën e tregut dhe duke e ruajtur disiplinën e tregut;
- Mbrojtjen e fondeve publike duke minimizuar ndihmën e mbështetjes së jashtëzakonshme publike financiare;
- Mbrojtjen e depozitorëve sipas ligjit përkatës për sistemin e sigurimit të depozitave në Kosovë; dhe
- Mbrojtjen e fondeve dhe pasurive të klientit.

Kur aplikon instrumentet e përmbylljes BQK-ja merr masat e duhura për t'u siguruar se me veprimet e përmbylljes të parët që i bartin kostot për një dështim të mundshëm të bankës të jenë aksionarët dhe se kreditorët e bankës në procesin e përmbylljes i bartin humbjet pas aksionarëve, në përputhje me rendin e prioritetit të kërkesave të tyre sipas procedurave të rregullta të falimentimit.

Departamenti i Rimëkëmbjes dhe Përmbylljes i BQK-së është themeluar brenda strukturës organizative të BQK-së, dhe është funksionalisht i pavarur dhe i ndarë nga funksionet e tjera brenda BQK-së.

Gjatë vitit 2025 fokusi kryesor i Departamentit për Rimëkëmbje dhe Përmbyllje ishte operacionalizimi i tij përmes vendosjes së bazës rregullative dhe organizative të Departamentit, hartimit të akteve nënligjore për përmbyllje, ndërtimit të kapaciteteve profesionale, si dhe vendosjes së bashkëpunimit me institucione relevante vendore dhe ndërkombëtare.

Në funksion të operacionalizimit të Departamentit të Përmbylljes, gjatë vitit 2025 janë zhvilluar aktivitetet kryesore si në vijim:

I. Hartimi i akteve të brendshme rregullative:

- *Rregullorja e Brendshme e Departamentit* - e cila përcakton përgjegjësitë dhe detyrat e Departamentit, strukturën e tij organizative, ndarjen e funksioneve si dhe përgjegjësitë e stafit;
- *Rregulla e Brendshme për Bashkëpunim dhe Shkëmbim të Informacionit* – e cila përcakton kornizën për bashkëpunim dhe shkëmbim të informatave ndërmjet Departamentit për Rimëkëmbje dhe Përmbyllje dhe njësisve tjera organizative të BQK-së, në kuadër të funksionit të BQK-së si autoritet për përmbylljen e bankave, në përputhje me Ligjin për Bankat.

Këto akte rregullative janë në proces të miratimit.

II. Hartimi i rregullatives për zbatimin e dispozitave të Ligjit për Bankat që ndërlidhen me përmbylljen e bankave.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Bankat kjo rregullative (rregulloret) do të procedohen për miratim sipas afateve të përcaktuara me planin vjetor rregullativ.

III. Identifikimi i formave raportimit të nevojshme për përgatitjen e planeve të përmbyllje.

Janë identifikuar format e raportimit për qëllime të përmbylljes. Raportimi sipas këtyre formave do të zbatohet gradualisht, në përputhje me kapacitetet ekzistuese dhe zhvillimin e mëtejshëm të kornizës rregullative për përmbyllje.

IV. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore brenda Departamentit- Në këtë drejtim stafi ka marrë pjesë në trajnime dhe konferenca ndërkombëtare që lidhen me procesin e përmbylljes së bankave, përfshirë pjesëmarrjen në konferencën për 10 vjetorin e SRM (Single Resolution Mechanism) dhe konferencën vjetore të FinSAC.

V. Bashkëpunim ndërkombëtar – gjatë vitit 2025 ka filluar bashkëpunimi me autoritetet homologe të vendeve tjera. Në këtë drejtim është realizuar një vizitë studimore pranë Bankës së Shqipërisë – Departamenti për ndërhyrje të jashtëzakonshme. Qëllimi i vizitës ishte njohja me përvojat e tyre në krijimin dhe funksionalizimin e funksionit të përmbylljes. Gjithashtu janë vendosur kontaktet fillestare me Bankën Qendrore të Malit të Zi - njësinë përgjegjëse për përmbyllje (autoritetet e përmbylljes).

Në këtë kuadër, të bashkëpunimit ndërkombëtar, ka pasur komunikim të rregullt me FinSAC, ku janë diskutuar çështje që lidhen me funksionalizimin e Departamentit. Si rezultat, ka nisur puna për krijimin e një udhërrëfyesi operacional, i cili do të përfshijë hapat e nevojshëm për t'u ndërmarrë, si dhe afatet kohore për zbatimin e tyre.

Viti 2025 shënon fazën fillestare në drejtim të funksionalizimit të Departamentit të Përmbylljes në kuadër të BQK-së, përmes vendosjes së kornizës së brendshme rregullative, fillimin e hartimit të akteve nënligjore që rregullojnë procesin e përmbylljes, vendosjen e bashkëpunimit me institucione homologe të vendeve fqinje dhe institucione ndërkombëtare dhe vendore si dhe avancimin e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale.

BQK mbetet e përkushtuar në avancimin e mëtejshëm të këtij funksioni, me qëllim forcimin e stabilitetit financiar dhe mbrojtjen e interesit publik.

2.1.2 Sektori Bankar

Asetet

Në fund të vitit 2025, asetet e sektorit bankar arritën në 9.71 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 13.5 përqind, e njëjtë me nivelin e vitit paraprak. Aktiviteti kreditues vazhdon të ketë kontributin kryesor në rritjen e asetëve të sektorit bankar, megjithëse ritmi i rritjes së tij është ngadalësuar (tabela 4). Po ashtu, me rritje dukshëm më të ngadalësuar u karakterizua paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në, duke shënuar rritje prej vetëm 3.9 përqind, krahasuar me 13.5 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, kategoria e letrave me vlerë dhe bilanci me bankat komerciale shënuan rritje vjetore të përsheptuar gjatë këtij viti, pas një periudhe të rritjes së ngadalësuar, përkatësisht tkurrjes në vitin paraprak. Koncretisht, investimet në letra me vlerë u rritën me 21.2 përqind nga 10.8 përqind në vitin 2024, ndërsa bilanci me bankat komerciale shënoi rritje prej 9.1 përqind, pas rënies prej 18.0 përqind në vitin paraprak (shih grafikun 15).


Shkalla e koncentrimin në tregun bankar gjatë vitit 2025 shënoi rritje të lehtë në treguesit kryesor të koncentrimin. Asetet e pesë bankave më të mëdha rritën peshën e tyre në 79.9 përqind të gjithëj asetëve të sektorit, krahasuar me 79.5 përqind në vitin paraprak. Po ashtu, tri bankat më të mëdha shënuan rritje të pjesëmarrjes së tyre në treg, duke arritur në 53.7 përqind nga 52.7 përqind në vitin 2024. Përvetësimi i një banke me kapital të huaj nga një bankë vendore ka ndikuar në rënie të pjesëmarrjes së bankave të huaja për 0.8 pikë përqindje, duke shënuar rënie në 82.7 përqind në fund të vitit 2025. Indeksi Herfindal-Hirschman (HHI)⁵ për asetet e sektorit bankar u rrit në 1,455 pikë nga 1,413 pikë në vitin e kaluar, duke reflektuar një rritje të lehtë të përqendrimit në treg.

Tabela 4. Struktura e asetëve të sektorit bankar

Përshkrimi	2021		2022		2023		2024		2025	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në	839.9	14.1%	877.4	13.0%	911.8	12.1%	1,035.2	12.1%	1,075.2	11.1%
Bilanci me bankat komerciale	496.1	8.3%	575.2	8.5%	600.0	8.0%	492.2	5.8%	536.9	5.5%
Letrat me vlerë	685.0	11.5%	752.1	11.1%	895.0	11.9%	991.8	11.6%	1,201.7	12.4%
Kreditë bruto	3,748.6	62.9%	4,348.5	64.3%	4,913.8	65.2%	5,813.8	67.9%	6,666.2	68.7%
Asetet fikse	127.4	2.1%	136.1	2.0%	149.5	2.0%	161.0	1.9%	164.1	1.7%
Asetet Tjera	62.7	1.1%	71.4	1.1%	71.0	0.9%	62.4	0.7%	66.0	0.7%
Gjithsej	5,959.6	100%	6,760.6	100%	7,541.1	100%	8,556.4	100%	9,710.3	100%

Burimi: BQK (2026)

Grafik 15. Zërat kryesorë të asetëve të sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2026)

⁵ Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) është një numër që tregon sa i përqendruar është një treg: sa më i lartë numri, aq më pak kompani e kontrollojnë atë treg, dhe aq më pak konkurrencë ka.


Kreditë

Në fund të vitit 2025, gjithsej stoku i kredive arriti në 6.67 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të ngadalësuar prej 14.7 përqind nga 18.3 përqind në vitin paraprak. Ky zhvillim reflekton ngadalësim të kreditimit, si në segmentin e ekonomive familjare, ashtu edhe të korporatave jo financiare (shih grafikun 16). Rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar (AKBK), tregojnë se dinamikat e kreditimit gjatë vitit 2025 u ndikuan ndër të tjera nga një ofertë kreditore më e shtrënguar, si në terma të standardeve kreditore, ashtu edhe të kushteve dhe rregullave të aplikuara. Megjithatë, kërkesa për kredi mbeti e lartë, duke reflektuar nevojën e vazhdueshme të huamarrësve për financim.

Kontributin kryesor në zgjerimin e kreditimit gjatë vitit 2025 e kishte segmenti i ekonomive familjare. Për shkak të ritmit më të shpejtë të rritjes së këtij segmenti në vitet e fundit, pjesëmarrja e tij në totalin e portofolios kredituese u rrit në 41.9 përqind, nga 36.3 përqind pesë vite më parë, rritje kjo e cila po shoqërohet gjithashtu me zgjerim gradual të stokut të kredive me maturitet afatgjatë. Megjithatë, segmenti i korporatave jo-financiare vazhdon të dominojë strukturën e gjithsej kredive, me pjesëmarrje prej 56.9 përqind në gjithsej portfolion kreditore. Krahas rritjes së vlerës së kredive, numri i kredimarrësve ka vazhduar rritjen e përsheptuar vjetore, çka sinjalizon thellim të mëtejshëm të ndërmjetësimit financiar. Sipas Regjistrisë të Kredive të Kosovës (RKK), numri i kredimarrësve të rinj në sektorin bankar për periudhën janar - dhjetor 2025 arriti në 25,806 individë, duke shënuar rritje prej 12.1 përqind nga 6.8 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.


Kreditë ndaj korporatave jo-financiare shënuan rritje vjetore prej 11.2 përqind, të ngadalësuar për 4.1 pikë përqindje nga viti paraprak, dhe arritën vlerën prej 3.79 miliardë euro. Ky zhvillim reflekton rritjen më të ngadalësuar të kredive të reja, të cilat shënuan rritje vjetore prej 3.4 përqind nga 18.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke arritur vlerën prej 1.48 miliardë euro (shih grafikun 19). Në kuadër të kredive të reja, ato investuese u rritën me 9.1 përqind nga 42.2 përqind një vit më parë. Ndërsa, kreditë e reja jo-investuese shënuan rënie prej 6.2 përqind nga 10.5 përqind rënie në vitin

Grafik 16. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare




Burimi: BQK (2026)

Grafik 17. Pjesëmarrja e kredive sipas sektorëve ekonomikë, 2025



Burimi: BQK (2026)

Grafik 18. Stoku i kredive sipas sektorëve ekonomikë




Burimi: BQK (2026)

paraparak. Kreditë e reja investuese u karakterizuan me ngadalësim për sektorin e shërbimeve dhe të industrisë, duke shënuar rritje prej 26.8 përqind dhe 5.1 përqind, nga 51.4 përqind dhe 50.5 përqind, përkatësisht. Nga ana tjetër, kreditë jo-investuese për sektorin e shërbimeve shënuan rënie prej 11.1 përqind për dallim nga rritja prej 11.1 përqind një vit më parë, ndërsa kreditë jo-investuese për sektorin e industrisë shënuan rritje prej 9.9 përqind, pas rënies prej 31.4 përqind në vitin paraparak.

Sipas sektorëve ekonomikë, dinamika e kreditimit tregoi zhvillime të ndryshme. Më konkretisht, sektori i tregtisë me shumicë shënoi rritje vjetore të ngadalësuar prej 11.2 përqind nga 16.0 përqind, mirëpo vazhdon të mbetet kategoria me kontributin më të madh në dinamikën e kredive ndaj ndërmarrjeve, për shkak të peshës dominuese prej 42.1 përqind (shih grafikun 17). Sektori i ndërtimitarisë shënoi rritje të ngadalësuar prej 4.8 përqind nga 10.6 përqind në vitin paraparak, ndërsa sektori i energjetikës vazhdoi me rënie prej 8.0 përqind nga rënia prej 9.2 përqind në vitin paraparak. Në anën tjetër, kreditimi për sektorin e prodhimitarisë dhe bujqësisë përshpejtoi rritjen në 16.6 përqind nga 11.9 përqind, dhe 7.1 përqind nga rënia prej 9.2 përqind, përkatësisht (shih grafikun 18).

Stoku i kredive për ekonomitë familjare shënoi rritje vjetore të ngadalësuar prej 19.7 përqind nga 22.0 përqind në vitin e kaluar. Kjo dinamikë e rritjes u ndikua kryesisht nga kreditë e reja konsumuese, të cilat shënuan rënie prej 0.6 përqind nga rritja prej 27.1 përqind një vit më parë. Po ashtu ndikim kishin kreditë e reja hipotekare të cilat ngadalësuan rritjen në 26.9 përqind nga 37.9 përqind një vit më parë. Si rezultat i zgjerimit të kredive hipotekare për ekonomitë familjare, struktura e maturimit të gjithsej portfolios kreditore të ekonomive familjare ka pësuar ndryshim gradual, duke u orientuar gjithnjë më shumë drejt kredive me afat më të gjatë maturimi si dhe shuma më të larta. Konkretisht, kategoria ‘mbi 10 vite’ ka zgjeruar pjesëmarrjen në 38.0 përqind, për 1.3 pikë përqindje më e lartë se një vit më parë, dhe krahasuar me pesë vite më parë është rritur për 15.6 pikë përqindje. Gjithsesi, kategoria dominuese vazhdoi të jetë ajo e maturitetit ‘5 deri në 10 vite’, me pjesëmarrje prej 42.7 përqind.

Grafik 19. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor



Detyrimet dhe burimet vetanake

Financimi i aktivitetit të sektorit bankar vazhdon të mbështetet kryesisht nga depozitat e klientëve dhe kapitali vetanak. Në dhjetor 2025, depozitat kishin pjesëmarrje prej 80.6 përqind në gjithsej strukturën e detyrimeve dhe kapitalit vetanak të sektorit, për 0.4 pikë përqindje më ulët se në vitin paraparak (tabela 5). Në anën tjetër, mjetet vetanake, si komponenta tjetër kryesore e financimit, shënoi rritje të lehtë të pjesëmarrjes në 11.8 përqind apo 0.2 pikë përqindje më e lartë se në vitin paraparak, kryesisht si rezultat i rritjes së fitimit të mbajtur.

Tabela 5. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar

Përshkrimi	2021		2022		2023		2024		2025	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	113.2	1.9%	199.9	3.0%	183.8	2.4%	273.6	3.2%	357.5	3.7%
Depozitat	4,901.8	82.2%	5,553.3	82.1%	6,129.0	81.3%	6,923.5	80.9%	7,822.5	80.6%
Huatë tjera	39.1	0.7%	31.6	0.5%	33.3	0.4%	42.3	0.5%	25.8	0.3%
Detyrimet tjera	220.1	3.7%	252.0	3.7%	287.5	3.8%	270.5	3.2%	287.5	3.0%
Borxhi i ndërvarur	42.3	0.7%	23.0	0.3%	45.0	0.6%	59.1	0.7%	75.8	0.8%
Mjetet vetanake	643.1	10.8%	701.3	10.4%	862.4	11.4%	987.4	11.5%	1,141.2	11.8%
Gjithsej detyrimet dhe burimeve vetanake	5,959.6	100.0%	6,760.6	100.0%	7,541.1	100.0%	8,556.4	100.0%	9,710.2	100.0%

Burimi: BQK (2026)

Depozitat

Në dhjetor 2025, vlera e gjithsej depozitave arriti në 7.82 miliardë euro, duke ruajtur ritmin e rritjes vjetore të vitit paraprak, apo rritje prej 13.0 përqind. Kontributin kryesor në rritjen e gjithsej depozitave e kishin depozitat e ekonomive familjare të cilat dominojnë strukturën e gjithsej depozitave, me pjesëmarrje prej 64.5 përqind në dhjetor 2025 (shih grafikun 20). Këto depozita përshpejtuan ritmin e rritjes nga viti i kaluar, duke shënuar rritje prej 12.0 përqind nga 11.1 përqind në vitin paraprak. Po ashtu, me rritje të përshpejtuar u karakterizuan edhe depozitat e korporatave jo-financiare dhe të korporatave tjera financiare, apo rritje prej 15.5 përqind dhe 38.5 përqind, nga 12.3 përqind dhe 34.2 përqind, respektivisht. Ndërsa, depozitat e korporatave publike ndërruan kahun e zhvillimit, duke shënuar rënie prej 11.4 përqind nga rritja prej 20.6 përqind në vitin paraprak.


Sa i përket strukturës së depozitave sipas maturitetit, rritja e normave të interesit gjatë viteve të fundit ka ndikuar që depozitat e afatizuara të rrisin pjesëmarrjen në kuadër të gjithsej depozitave. Më konkretisht, në fund të dhjetorit 2025, pjesëmarrja e depozitave të afatizuara arriti në 31.3 përqind nga 28.9 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, depozitat e transferueshme dhe ato të kursimit, kishin pjesëmarrje prej 60.7 përqind dhe 8.0 përqind, respektivisht. Vlera e gjithsej depozitave të reja arriti në 1.55 miliardë euro në fund të dhjetorit 2025, duke shënuar rritje vjetore lehtësisht të ngadalësuar prej 32.8 përqind, krahasuar me 34.8 përqind një vit më parë, si rezultat i bazës së lartë nga periudha paraprake. Ky zhvillim u ndikua kryesisht nga segmenti i ekonomive familjare, të cilat shënuan rritje vjetore të ngadalësuar prej 33.3 përqind nga 42.0 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, depozitat e reja të korporatave jo-financiare përshpejtuan rritjen në 31.6 përqind nga 20.7 përqind në vitin e kaluar.

Normat e interesit

Gjatë vitit 2025, normat e interesit në kreditë e sektorit bankar shënuan rritje graduale, me nivelin më të lartë në shtator 2025. Konkurrenca e shtuar për financim nga depozitat ndikoi gjithashtu në rritje të lehtë të normave të interesit në depozitat e reja.

Më konkretisht, në dhjetor të vitit 2025, norma e interesit në kredi arriti në 6.8 përqind nga 5.9 përqind sa ishte një vit më parë. Ndërkohë, norma e interesit në depozita arriti në 3.5 përqind nga 3.4 përqind në vitin paraprak. Si rezultat i rritjes dukshëm më të lartë të normës së interesit në kredi në raport me rritjen e normës së interesit në depozita, margjina e interesit kredi-depozitë ka

Grafik 20. Struktura e depozitave, në përqindje




Burimi: BQK (2026)

shënuar rritje, duke arritur në 3.3 pikë përqindje në dhjetor 2025 nga 2.5 pikë përqindje në dhjetorin e vitit paraprak (shih grafikun 21).


Norma mesatare e interesit në kredi ka shënuar rritje si për korporatat jo-financiare, ashtu edhe për ekonomitë familjare. Konkretisht, në dhjetor 2025, norma e interesit në kredi për korporatat jo-financiare arriti në 7.1 përqind, apo rritje për 1.1 pikë përqindje nga viti paraprak. Ndërsa, norma e interesit për ekonomitë familjare arriti në 6.4 përqind, apo rritje për 0.7 pikë përqindje nga dhjetori i vitit të kaluar (shih grafikun 22).

Grafik 21. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK (2026)

Grafik 22. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2026)


Grafik 23. Norma mesatare e interesit në depozita



Burimi: BQK (2026)


Në kuadër të KJF-ve, normat e interesit për sektorin e shërbimeve dhe industrisë shënuan rritje për 1.0 pikë përqindje, duke arritur në një mesatare prej 6.9 përqind dhe 7.0 përqind, respektivisht. Ndërkaq, për ekonomitë familjare, normat më të favorshme të interesit u aplikuan për kreditë hipotekare me një mesatare prej 5.9 përqind, ndërsa për kreditë konsumuese u aplikua një normë mesatare interesi prej 6.6 përqind.

Grafik 24. Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve, sipas kategorive



Burimi: BQK (2026)

Grafik 25. Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2026)

Normat e interesit në depozita arritën në 3.5 përqind, duke shënuar rritje për 0.1 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Në dhjetor 2025, norma mesatare e interesit në depozita për ekonomitë familjare ka shënuar rritje vjetore për 0.2 pikë përqindje, duke arritur në 3.1 përqind. Ndërsa, për korporatat jofinanciare norma mesatare e interesit ka shënuar rënie vjetore për 0.3 pikë përqindje, duke zbritur në 3.8 përqind (shih grafikët 24 dhe 25).

Struktura e kredive sipas llojit të normave të interesit ka shënuar trend të rritjes së kredive me normë fikse të interesit gjatë vitit 2025. Më konkretisht, në dhjetor 2025, pjesëmarrja e kredive me normë fikse të interesit arriti në 72.6 përqind nga 70.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (shih grafikun 26).

Performanca e sektorit bankar


Në fund të vitit 2025, profiti neto i gjithsej sektorit arriti në 184.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore të ngadalësuar prej 3.0 përqind nga 15.4 përqind në vitin paraprak (shih grafikun 27). Ky zhvillim reflekton rritjen më të ngadalësuar të të hyrave në raport me rritjen e shpenzimeve (shih grafikun 28).

Të hyrat e sektorit arritën në 552.8 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore të ngadalësuar prej 10.5 përqind nga 15.1 përqind në vitin paraprak. Ky ngadalësim u ndikua nga ecuria e të hyrave nga interesi, të cilat u rritën me 10.6 përqind nga 17.2 përqind në vitin paraprak dhe njëherësh përfaqësojnë 76.0 përqind të gjithsej të hyrave të sektorit.

Ritmi më i ngadalësuar i kreditimit, si aktivitet primar i gjenerimit të të hyrave nga bankat, u reflektua në rritje vjetore më të ulët të të hyrave nga interesi nga kreditë, apo rritje prej 13.7 përqind nga 18.1 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, të hyrat nga interesi në letrat me vlerë shënuan rënie prej 9.0 përqind krahasuar me rritjen prej 29.6 përqind një vit më parë.


Të hyrat nga jo-interesi, të cilat përbëhen kryesisht nga tarifatat dhe komisionet, shënuan rritje të përshpejtuar prej 14.2 përqind, krahasuar me 8.4 përqind në vitin paraprak, duke arritur në 118.4 milionë euro në fund

Grafik 26. Stoku i kredive, sipas normave të interesit fikse apo variable (në përqindje)




Burimi: BQK (2026)

Grafik 27. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2026)

Grafik 28. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar




Burimi: BQK (2026)

të dhjetorit 2025. Si rrjedhojë, pjesëmarrja e tyre në gjithsej të hyrat e sektorit u rrit në 21.4 përqind, nga 20.7 përqind një vit më parë.

Shpenzimet e sektorit bankar arritën vlerën 368.3 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.7 përqind, ngjashëm me 14.9 përqind një vit më parë (shih grafikun 28). Kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej shpenzimeve gjatë vitit 2025, e kishin shpenzimet e interesit, të cilat megjithatë shënuan rritje më të ngadalësuar prej 36.9 përqind, krahasuar me 42.2 përqind një vit më parë, si rezultat i bazës së lartë krahasuese. Në të njëjtën kohë, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, shënuan ngadalësim të dukshëm të rritjes, në 7.0 përqind nga 16.9 përqind në vitin paraprak. Megjithatë, kjo kategori e shpenzimeve vazhdon të ketë pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të shpenzimeve, me 53.2 përqind. Rritja më e ulët e gjithsej të hyrave krahasuar me rritjen e gjithsej shpenzimeve ndikoi që raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit të jetë më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (shih grafikun 28). Po ashtu, treguesit e profitabilitetit shënuan rënie krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i zgjerimit më të shpejtë të aseteve dhe kapitalit në raport me fitimin. Më konkretisht, treguesi i kthimit në kapital zbriti në 17.4 përqind nga 19.6 përqind një vit më parë, ndërsa kthimi në asete ka shënuar rënie vjetore për 0.3 pikë përqindje, duke zbritur në 2.3 përqind (shih grafikun 29).

Grafik 29. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK (2026)

Treguesit e shëndetit financiar

Gjatë periudhës raportuese, sektori bankar në vend ka demonstruar stabilitet dhe qëndrueshmëri. Treguesit kryesorë të shëndetit financiar qëndruan mbi nivelet minimale rregulatore, duke reflektuar kapacitete të mjaftueshme për përballimin e goditjeve të mundshme makroekonomike dhe financiare.

Në kuadër të treguesve të shëndetit financiar, raporti i kredive jo-performuese rezultoi me 2.1 përqind, duke shënuar rritje për 0.2 pikë përqindje nga viti paraprak (shih grafikun 30). Rritja e këtij treguesi reflekton ritmin më të lartë të rritjes së kredive jo-performuese në raport me rritjen e ngadalësuar të gjithsej kredive. Po ashtu, mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë shënoi rënie në 111.1 përqind nga 124.4 përqind një vit më parë, si rezultat i rritjes më të ulët të vlerës së provizioneve të ndara për mbulimin e kredive krahasuar me rritjen më të shpejtë të vlerës së kredive jo-performuese.

Grafik 30. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve



Burimi: BQK (2026)

Norma e kredive jo-performuese për segmentin e korporatave jo-financiare shënoi rritje për 0.3 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak, ndërsa për segmentin e ekonomive familjare mbeti në nivel të njëjtë. Më konkretisht, raporti i kredive jo-performuese për korporatat jo-financiare arriti në 2.5 përqind, ndërsa për ekonomitë familjare mbeti në 1.5 përqind. Ekonomitë familjare

ngadalësuan ritmin e rritjes së ekspozimeve jo-performuese në 17.5 përqind nga 34.4 përqind një vit më parë. Ndërsa, segmenti i korporatave jo-financiare ka përsheptuar ritmin e rritjes së ekspozimeve jo-performuese, duke shënuar rritje vjetore prej 26.6 përqind nga 6.5 përqind në vitin e kaluar. Kontributin kryesor në rritjen e ekspozimeve jo-performuese për segmentin e korporatave jo-financiare e kishte sektori i tregtisë, i cili ka shënuar rritje të nivelit të KJP-ve për 0.8 pikë përqindje, duke rezultuar në normë prej 2.3 përqind. Megjithatë, kjo rritje kryesisht u ndikua nga zhvillime të veçanta në një institucion dhe nuk paraqet dinamikë të përgjithshme të sektorit. Rritje të raportit të KJP-ve shënuan gjithashtu sektori i ndërtimtarisë dhe patundshmërive, si dhe ai i komunikimit, duke arritur përkatësisht në 2.7 përqind nga 2.6 përqind dhe 2.8 përqind nga 1.7 përqind. Në anën tjetër, për sektorin e bujqësisë dhe prodhimtarisë, raporti i KJP-ve shënoi rënie si rezultat i rritjes më të shpejtë të kreditimit në raport me rritjen e kredive jo-performuese. Përkatësisht, raporti u ul në 6.4 përqind nga 6.6 përqind për sektorin e bujqësisë dhe në 2.6 përqind nga 2.9 përqind për sektorin e prodhimtarisë.

Pozicioni i kapitalit në fund të vitit 2025 ka qëndruar në 17.2 përqind, duke shënuar rënie të lehtë prej 0.2 pikë përqindje nga viti paraprak. Ky zhvillim në normën e kapitalizimit u ndikua nga rritja më e ngadalësuar e kapitalit rregullativ në raport me atë të mjeteve të peshuara me rrezik. Konkretisht, kapitali rregullativ i sektorit shënoi rritje vjetore prej 8.7 përqind nga 15.1 përqind një vit më parë. Ndërsa, mjetet e peshuara me rrezik kanë shënuar rritje vjetore prej 9.7 përqind nga 15.6 përqind në vitin paraprak.

Forcimi i raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR), i mbështetur nga shtesat makroprudenciale, ka kontribuar ndjeshëm në rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit bankar, duke përmirësuar kapacitetin e tij për të përballuar goditje të mundshme ekonomike dhe financiare. Paralelisht, avancimi i sistemit të sigurimit të depozitave përmes rishikimit të lartësisë së premieeve, që variojnë nga 0.75% deri në 1.5%, synon rritjen e mbulueshmërisë së depozituesve dhe forcimin e disiplinës së tregut. Ky zhvillim plotësohet nga kapitalizimi i fondit të sigurimit të depozitave, i mbështetur nga Banka Botërore përmes Ministrisë së Financave, duke krijuar një shtresë shtesë sigurie dhe duke kontribuar drejtpërdrejt në stabilitetin dhe besueshmërinë afatgjatë të sistemit financiar.

Treguesit e likuiditetit dhe financimit shënuan rritje krahasuar me vitin e kaluar. Treguesi i mbulimit me likuiditet (LCR) qëndroi lartë mbi minimumin prej 100 përqind të kërkuar me rregullore, përkatësisht në 292.0 përqind në dhjetor 2025, duke shënuar rritje për 81.1 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak. Niveli i lartë i LCR dëshmon se bankat mbajnë mjaftueshëm mjete likuide për të plotësuar nevojat dalëse (rrjedhjes së parasë) për një periudhë 30 ditore. Po ashtu, edhe treguesi i Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR) shënoi rritje në 140.8 përqind nga 136.0 përqind në dhjetor 2024, dhe mbetet mbi minimumin rregullativ prej 100 përqind, duke sugjeruar se bankat disponojnë financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për të mbuluar kërkesat më afatgjata të financimit. Tutje, raporti i likuiditetit - i shprehur si raport i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra - shënoi rritje vjetore për 1.3 pikë përqindje, duke arritur në 34.1 përqind. Kjo si rezultat i rritjes vjetore më të lartë të gjithsej mjeteve likuide me 18.9 përqind në raport me rritjen e detyrimeve afatshkurtra me 14.2 përqind. Ndërsa, rritja më e lartë e kreditimit në raport me depozitat ka ndikuar në rritjen tutje të raportit kredi-depozitë, duke arritur në 85.2 përqind nga 84.0 përqind në vitin paraprak.

2.2. Aktivitetet mbikëqyrëse të sektorit të sigurimeve

Për vitin 2025, BQK ka vazhduar aktivitetin në realizimin e detyrave dhe përgjegjësisive në funksion të mbikëqyrjes prudente për sektorin e sigurimeve. Aktiviteti i mbikëqyrjes është realizuar përmes mbikëqyrjes në vend – ekzaminimeve dhe mbikëqyrjes nga jashtë, respektivisht sistemit të monitorimit dhe analizimit të raporteve financiare. BQK është angazhuar me kapacitet të plotë në

realizimin e ekzaminimeve të plota dhe të fokusuara. Qëllimi i ekzaminimeve në vend ka qenë vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të institucioneve siguruese në raport me pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e BQK-së, profilin e rrezikut, gjithnjë në funksion të mbrojtjes së policë mbajtësve dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të institucioneve.

Klasifikimi i siguruesve për të qenë subjekt i ekzaminimeve është bazuar në disa faktorë, duke filluar nga analizat e pasqyrave dhe treguesve financiarë, profilin e rrezikut të siguruesve duke marr parasysh edhe ekzaminimet paraprake të realizuara, numrin e gjetjeve dhe rekomandimeve, ankesat e policëmbajtësve në BQK, opinionin e pasqyrave financiare nga auditori i jashtëm, si dhe faktorëve tjerë relevant. Këta faktorë kanë ndikuar në prioritizimin e institucioneve më me rrezik për të qenë subjekt i ekzaminimeve të radhës nga BQK dhe si rrjedhojë, në ngritjen e nivelit të mbikëqyrjes së vazhdueshme efektive.

Tabela 6. Numri i ekzaminimeve të sektorit të sigurimeve për vitin 2025

Institucioni	Lloji i ekzaminimit
Sigurues	3 ekzaminime të plota 2 të fokusuara
Ndërmjetësues	2 ekzaminime të plota 1 i fokusuar

Burimi: BQK (2026)

Gjatë vitit 2025, BQK ka vazhduar me implementimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Manualit të Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për Siguruesit, implementimin e udhëzuesve për vlerësimin e rreziqeve dhe funksioneve të kontrollit, së bashku me Shkallët e Ndërhyrjes bazuar në vlerësimin e rrezikut, duke plotësuar dhe forcuar tutje mbikëqyrjen e bazuar në rrezik. Ky progres drejt qasjes së bazuar në rrezik është në funksion të harmonizimit me parimet bashkëkohore të mbikëqyrjes së sigurimeve, të zgjerimit dhe nxitjes së identifikimit të hershëm të rreziqeve ndaj të cilave siguruesit ekspozohen, si dhe hartimin e rekomandimeve mbikëqyrëse prudente në funksion të ruajtjes së sigurisë dhe stabilitetit financiar të siguruesve.

Me qëllim të avancimit të mëtejshëm të mbikëqyrjes në vend, gjatë vitit 2025 është përgatitur Udhëzimi i brendshëm për përcaktimin e metodologjisë së mostrimit të ekzaminimeve në vend të siguruesve i cili do të kontribuoj tutje në standardizimin e procesit të mostrimit, transparencës dhe objektivitetit, si dhe rritjen e efikasitetit gjatë procesit të mbikëqyrjes në vend.

Gjatë periudhës raportuese, janë ndërmarrë një sërë veprimesh mbikëqyrëse të cilat kanë pasur për qëllim forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit të sigurimeve dhe përmirësimin e mekanizmave të menaxhimit të rrezikut. Këto aktivitete janë realizuar përmes analizës së rregullt të treguesve financiarë, vizitave mbikëqyrëse në vend, vlerësimit të funksioneve kyçe dhe shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës nga kompanitë e sigurimeve.

Nga ky proces, janë identifikuar fushat të cilat kanë nevojë për përmirësim në lidhje me qeverisjen korporatave, funksionimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe avancim të praktikave të menaxhimit të rrezikut. Në këtë kontekst, veprimet mbikëqyrëse janë fokusuar në ofrimin e rekomandimeve praktike dhe të zbatueshme, me qëllim rritjen e efektivitetit në fushat kyçe të cilat synojnë jo vetëm të adresojnë sfidat aktuale, por edhe të krijojnë një mjedis të qëndrueshëm për rritje të shëndetshme dhe afatgjatë të sektorit.


BQK me përkrahjen e Asistencës Teknike nga Banka Botërore, gjatë vitit 2025 ka punuar intensivisht në përgatitjen rreth procesit të implementimit të IFRS 17, proces i cili do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2026. Zbatimi i këtij standardi nuk konsiderohet vetëm si një kërkesë për përputhje me standardet ndërkombëtare, por shihet si një element kyç për rritjen e transparencës, qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë në raportimin financiar të sektorit të sigurimeve.

Po ashtu, është hartuar plani gjithëpërfshirës 2025-2030 i aktiviteteve për zbatimin e Solvencës II, bazuar në Udhërrëfyesin e Bankës Botërore. Është rishikuar Rregullorja për Qeverisje Korporative, me qëllim të përafrimit të mëtejme me kërkesat e Solvencës II (Shtylla II). Rrjedhimisht komponenti ORSA (Vlerësimi i Vetë-Rrezikut dhe Qëndrueshmërisë) është përfshirë në mënyrë tranzitore dhe ushtrimore, për të mundësuar integrimin e saj të hershëm në sistemin e menaxhimit të riskut dhe për t'i përgatitur siguruesit për zbatim të plotë në të ardhmen.

2.2.1. Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve vazhdoi rritjen edhe gjatë vitit 2025, megjithatë me ritëm më të ngadalësuar për të dytin vit me radhë. Vlera e përgjithshme e primeve të shkruara shënoi rritje vjetore më të ulët krahasuar me një vit më parë, kryesisht si rezultat i zhvillimeve në segmentin e sigurimeve jo-jetë. Kurse, shkalla e ndërmjetësimit financiar të sektorit e vlerësuar përmes raportit të primeve të shkruara bruto ndaj BPV-së mbeti e ngjashme me të vitit të kaluar, prej 1.6 përqind. Në anën tjetër, niveli i densitetit të sigurimeve - i matur përmes primeve të shkruara për kokë banori - është rritur në 112.9 euro nga 106.0 euro në vitin 2024.

Grafik 31. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK (2026)

Tregu i sigurimeve në Kosovë karakterizohet me një shkallë më të ulët të koncentrimin krahasuar me atë bankar dhe mikrofinanciar. Krahasuar me një vit më parë, Indeksi Herfindahl⁶ për primet e shkruara bruto (PShB) në vitin 2025 shënoi rritje në 1014 pikë nga 1000 pikë sa ishin një vit më parë. Po i njëjti indeks, i llogaritur duke marrë për bazë asetet e tregut të sigurimeve, shënoi rënie në 945 pikë nga 957 pikë në fund të vitit 2024. Në të njëjtën kohë, indeksi CR5⁷ për vitin 2025, i llogaritur në raport me PShB për sektorin e sigurimeve, rezulton 60.8 përqind nga 59.1 përqind në vitin 2024, ndërsa, i llogaritur në raport me asetet, rezulton 55.7 përqind nga 56.1 përqind në vitin 2024.

Asetet e sektorit të sigurimeve përfaqësuan 2.4 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar në fund të vitit 2025, krahasuar me 2.6 përqind në vitin paraprak. Vlera e tyre arriti në 356.9 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 6.8 përqind, për 3.3 pikë përqindje më ulët se shkalla e rritjes vjetore një vit më parë (shih grafikun 31). Sigurimet “jo-jetë” shënuan rritje vjetore prej 6.8 përqind dhe përfaqësuan 91.7 përqind të gjithsej asetëve të sektorit në fund të vitit 2025. Ndërsa sigurimet “jetë”, që përbëjnë pjesën e mbetur të asetëve, shënuan rritje vjetore prej 5.7 përqind.

Në strukturën e gjithsej asetëve të sektorit të sigurimeve, depozitat e mbajtura në bankat komerciale, si kategoria me peshën më të madhe (50.2%) shënuan rritje vjetore dukshëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak, përkatësisht 9.7 përqind në vitin 2025 nga 16.0 përqind rritje në vitin 2024, duke reflektuar ngadalësimin e rritjes së primeve të shkruara. Kategoria e dytë për nga pesha, investimet në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës me pjesëmarrje 14.3

⁶ Indeksi Herfindahl është llogaritur me formulën në vijim: $HI = \sum_{i=1}^n (s_i)^2$, ku S paraqet pjesëmarrjen e kompanisë në gjithsej mjetet (primet e shkruara bruto) e tregut të sigurimeve, n është gjithsej numri i institucioneve në sektorin përkatës. Në qoftë se indeksi shtrihet ndërmjet intervaleve 1,000 – 1,800 njësi, niveli i koncentrimin në sektorin e sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

⁷ Indeksi CR5 (Concentration Ratio of the top 5 firms (Shqip: Raporti i koncentrimin të top 5 kompanive) kombinon pjesëmarrjen në treg të 5 siguruesve me vlerat më të larta të asetëve në raport me gjithsej asetet e sektorit dhe PSHB ndaj gjithsej PSHB të sektorit.

përqind, shënoi rënie vjetore prej 3.6 përqind nga 4.2 përqind rritje në vitin e kaluar. Kategoria Hua dhe të Arkëtueshmet gjatë kësaj periudhe shënuan rritje vjetore të theksuar krahasuar me një vit më parë, zhvillim që i atribuohet kryesisht rritjes së nënkategorisë së të hyrave të papaguara nga policëmbajtësit (shih tabelën 7).

Sa i përket strukturës së detyrimeve të sektorit, provizionet teknike dhe matematike përbëjnë pjesën dominuese me gjithsej 65.3 përqind, pasuar nga ekuiteti me 25.4 përqind dhe zërat tjerë bilancor me peshë më të ulët (shih tabelën 8). Vlera e kapitalit të sigurimeve shënoi rritje dukshëm më të lartë krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i fitimit të realizuar gjatë vitit 2025 dhe shtimit të kapitalit aksionar. Për më tepër, operimi me fitim për të gjashtin vit me radhë ka kontribuar në zvogëlim gradual të humbjeve të trashëguara nga vitet e kaluara. Si rrjedhojë, vlera e humbjeve të akumuluar ndër vite u zvogëlua në 29.1 milionë euro nga 36.2 milionë euro sa ishin në vitin e kaluar, duke përmirësuar ndjeshëm pozicionin financiar të sektorit.

Tabela 7. Asetet e sektorit të sigurimeve (në milionë euro)

Përshkrimi	2024	2025	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja 2024	Pjesëmarrja 2025
Paraja dhe depozitat në BQK	4.7	5.1	8.9%	1.4%	1.4%
Depozitat në bankat komerciale	163.4	179.1	9.7%	48.8%	50.2%
Letrat me vlerë	53.0	51.1	-3.6%	15.8%	14.3%
Huatë dhe të arkëtueshmet	20.8	24.8	19.6%	6.2%	7.0%
Pjesa e risiguruesit për rezerva teknike	49.8	48.5	-2.8%	14.9%	13.6%
Investimet në prona	4.8	5.2	8.7%	1.4%	1.5%
Asetet tjera	38.0	43.0	13.1%	11.4%	12.0%
Gjithsej tregu	334.5	356.9	6.7%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2026)

Vlera e përgjithshme e primeve të shkruara shënoi rritje vjetore prej 6.5 përqind, e cila është dukshëm më e ngadalësuar krahasuar me 14.7 përqindje rritje një vit më parë, dhe arriti në 179.0 milionë euro. Struktura e primeve të shkruara vazhdon të dominohet nga primet e sigurimit “jo-jetë” të cilat përfaqësuan 95.3 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Vlera e tyre arriti në 170.5 milionë euro, që paraqet rritje vjetore dukshëm më të ngadalësuar, prej 6.3 përqind nga 14.7 përqind rritje një vit më parë. Në ngadalësim të vlerës së primeve të shkruara për vitin 2025 ka ndikuar edhe rënia e volumit të policave të shitura krahasuar me një vit më parë, nga 2.0 milionë sa ishin në vitin 2024 në 1.9 milionë ,rënie vjetore prej 4.8 përqind.

Tabela 8. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve (në milionë euro)

Përshkrimi	2024	2025	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja 2024	Pjesëmarrja 2025
Rezervat teknike	223.2	233.0	4.4%	66.7%	65.3%
Llogarite tjera të pagueshme	23.6	26.3	11.5%	7.0%	7.4%
Detyrimet tjera	5.1	7.1	37.9%	1.5%	2.0%
Gjithsej kapitali i aksionarit	82.5	90.5	9.6%	24.7%	25.4%
Gjithsej tregu	334.5	356.9	6.7%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2026)

Bruto primet e shkruara në segmentin “jo-jetë” vazhdojnë të dominohen nga sigurimet e detyrueshme, të cilat përbëjnë 56.4 përqind të gjithsej primeve në këtë segment, ndërsa pjesa tjetër përfaqëson sigurimet vullnetare. Produktet e sigurimeve të detyrueshme shënuan rritje vjetore prej 8.1 përqind, ndikuar kryesisht nga produktet “MTPL” (tabela 9). Kurse, në kuadër të sigurimit vullnetar, kategoria “Aksident dhe shëndet”, me pjesëmarrje më të madhe në treg prej 21.5 përqind, shënoi rënie vjetore prej 0.3 përqind kundrejt rritjes së theksuar një vit më parë prej 27.6

përqind, që ndikoi edhe në ulje të peshës në gjithsej primet e shkruara. Ky zhvillim ishte rezultat i rënies së theksuar të numrit të policave të shitura krahasuar me një vit më parë, me një tkurrje prej 24.8 përqind, përkatësisht rreth 166.6 mijë polica më pak gjatë vitit 2025. Rënia u përqendrua kryesisht në nënkategorinë e “Sigurimit të shëndetit”, e ndikuar edhe nga efekti i bazës krahasuese, përkatësisht niveli i lartë i policave të shitura gjatë vitit 2024.

Vlera e primeve të shkruara nga siguruesit “jetë” në vitin 2025 arriti në 8.4 milionë euro, që paraqet vlerë më të lartë për 10.5 përqind krahasuar me vitin 2024. Megjithatë, ky segment vazhdon të ketë peshë relativisht të ulët në treg, duke përfaqësuar 4.7 përqind të gjithsej primeve bruto të shkruara.

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e siguruesve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rritje vjetore prej 12.4 përqind nga 7.8 përqind rritje një vit më parë, duke arritur në 86.5 milionë euro në fund të vitit 2025. Nga kjo shumë, 79.7 milionë euro ishin dëme të paguara nga siguruesit, ndërsa 6.8 milionë euro dëme të paguara nga Byroja Kosovare e Sigurimit.

Tabela 9. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit (në milionë euro)

Aktiviteti	2024	2025	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja: 2024	Pjesëmarrja: 2025
Gjithsejtë Jo-jetë	160.4	170.6	6.4%	95.5%	95.3%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTPL	75.6	82.0	8.4%	45.0%	45.8%
TPL+	4.7	4.9	3.4%	2.8%	2.7%
Sigurime kufitare	8.6	9.2	7.7%	5.1%	5.2%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	38.7	38.6	-0.3%	23.0%	21.5%
Kasko	11.4	12.1	5.8%	6.8%	6.8%
Kredi dhe garancione	11.0	11.1	0.6%	6.6%	6.2%
Zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë	8.3	10.6	27.3%	5.0%	5.9%
Përgjegjësi civile të përgjithshme	1.9	2.1	10.2%	1.1%	1.2%
<i>Gjithsej jetë</i>	<i>7.6</i>	<i>8.4</i>	<i>10.5%</i>	<i>4.5%</i>	<i>4.7%</i>
Gjithsej tregu	168.1	179.0	6.5%	100.0%	100.0%


Burimi: BQK (2026)

Dëmet e paguara nga risiguruesit arritën në 13.6 milionë euro, duke përfaqësuar 15.7 përqind të gjithsej shumës së dëmeve të paguara nga siguruesit. Kjo tregon nivel relativisht të qëndrueshëm të transferimit të rrezikut drejt tregjeve të risigurimit.

Dëmet për sigurimet jo-jetë mbeten dominante, por me një rënie të lehtë të pjesëmarrjes nga 98.2 përqind sa ishin në vitin e kaluar në 97.8 përqind në vitin 2025. Sigurimi i detyrueshëm “MTPL” vazhdon të ketë peshën më të madhe në treg, me pjesëmarrje prej 46.5 përqind. Kategoria “Aksident dhe shëndet” mbetet kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pjesëmarrja me 25.0 përqind, pasuar nga sigurimi “Kasko” dhe “Sigurimi i pronës” (tabela 10).

Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit “jetë” në vitin 2025 është rritur në 1.9 milionë euro nga 1.4 milionë euro një vit më parë, duke shënuar rritje vjetore prej 37.0 përqind. Kjo rritje i atribuohet rritjes së dëmeve të paguara për

Grafik 32. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK (2026)

nënkategoritë “Jeta e debitorit” (shlyerje të detyrimeve në rast të vdekjes së policëmbajtësit, që aplikohet kryesisht nga bankat për sigurim të kredive), “Sigurimi i mbijetesës” (që paguhet vetëm nëse i siguruari është gjallë deri në fund të periudhës së kontratës së policës) dhe “Jeta e kombinuar” (kombinim i sigurimit ‘jetë’ për periudhë të caktuar kohore me mundësi vazhdimi).

Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara në vitin 2025 u rrit për 2.5 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 48.4 përqind (shih grafikun 32). Kjo erdhi si rezultat i rritjes më të lartë të dëmeve të paguara krahasuar me rritjen e primeve të shkruara (tabelat 10 dhe 11).

Tabela 10. Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit (në milionë euro)

Aktiviteti	2024	2025	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja: 2024	Pjesëmarrja: 2025
Gjithsejtë Jojetë	75.6	84.6	11.9%	98.2%	97.8%
Sigurimi i detyruar					
MTPL	37.2	40.2	8.0%	48.3%	46.5%
TPL+	0.3	0.4	27.9%	0.4%	0.5%
Sigurime kufitare, FG, MoU	7.6	6.8	-10.9%	9.9%	7.9%
Sigurimi vullnetar					
Aksident dhe shëndet	19.7	21.7	9.9%	25.6%	25.0%
Kasko	6.9	7.4	8.2%	8.9%	8.6%
Kredi dhe garancione	1.4	1.1	-26.6%	1.9%	1.2%
Sigurime në pronë	2.3	6.7	185.7%	3.0%	7.7%
Përgjegjësi e përgjithshme	0.0	0.3	1549.6%	0.0%	0.4%
Gjithsej jetë	1.4	1.9	37.0%	1.8%	2.2%
Gjithsej tregu	77.0	86.5	12.4%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2026)

2.2.2 Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve në vitin 2025 realizoi fitim neto në vlerë prej 14.3 milionë euro, për 3.4 përqind më i ulët se një vit më parë (tabela 11).

Tabela 11. Rezultati financiar (në milionë euro)

Përshkrimi	2021	2022	2023	2024	2025
Sigurimet Jojetë	5.8	2.5	10.0	13.5	13.1
Sigurimet Jetë	0.5	-0.4	1.0	1.2	1.2
Gjithsej tregu	6.3	2.1	11.0	14.7	14.3

Burimi: BQK (2026)

Fitimi më i ulët i realizuar i atribuohet kryesisht ngadalësimit të të hyrave nga primet e shkruara, si dhe rritjes më të theksuar të dëmeve të paguara. Shpenzimet operacionale (që përfshijnë shpenzimet për personelin dhe ato administrative) nuk shënuan ndryshime të theksuara krahasuar me një vit më parë, duke mos ushtruar presion mbi profitabilitetin e sektorit.

2.2.3 Ndihmësit financiar

Sektori i ndihmësve financiar përfaqëson vetëm 0.1 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar, megjithatë ai karakterizohet me numrin më të lartë të institucioneve financiare që operojnë në vend. Në dhjetor 2025, sektori u përfaqësua nga gjithsej 64 subjekte të licencuara, përkatësisht zyre të këmbimeve valutore dhe agjencioneve për transferim të parave, krahasuar me 65 sosh në vitin paraprak.

Vlera e aseteve të ndihmësve financiar në fund të vitit 2025 zbriti në 15.0 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 5.7 përqind. Struktura e aseteve dominohet nga asetet fikse dhe të tjera, me pjesëmarrje prej 62.0 përqind. Ndërsa 34.0 përqind e mjeteve të sektorit janë të mbajtura në bankat komerciale dhe pjesa e mbetur përfshinë paratë e gatshme. Sektori ka nivel të ulët të borxhit, me vetëm 21.8 përqind të detyrimeve dhe ekuitetit të financuar nga produkte të ndryshme të borxhit si kredi, llogari të pagueshme dhe detyrime tjera. Ndërsa, kapitali vetanak përbën 78.2 përqind të gjithëj detyrimeve dhe ekuitetit të sektorit.

Sektori i ndihmësve financiar në vitin 2025 realizoi fitim neto në vlerë prej 1.0 milionë euro nga 0.3 milionë euro një vit më parë. Performanca dukshëm më e mirë financiare e këtij sektori erdhi kryesisht si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve prej 6.9 përqind, kurse të hyrat u rritën për vetëm 1.9 përqind vit-më-vit. Të hyrat pothuajse tërësisht burojnë nga të ardhurat prej shërbimeve (99.8 përqind) përderisa shpenzimet janë të shpërndara në shpenzimet për personelin (51.7 përqind) dhe shpenzimet tjera operative (47.8 përqind). Shpenzimet për personelin ishin ato të cilat ndikuan në rënie të tërësishme të shpenzimeve, pasi që u zvogëluan për 19.2 përqind nga 48.0 përqind rritje një vit më parë.

2.3. Aktivitetet Mbikëqyrëse të Sektorit të Pensioneve

Në funksion të ruajtjes së stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së sektorit pensional në vend, gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë aktivitete në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi mbikëqyrëse ndaj fondeve pensionale. Aktiviteti mbikëqyrës është realizuar përmes mbikëqyrjes në vend, duke përfshirë ekzaminime të plota dhe të fokusuara, si përmes mbikëqyrjes nga jashtë, nëpërmjet monitorimit dhe analizimit të rregullt të raporteve financiare periodike të fondeve pensionale. Mbikëqyrja e fondeve pensionale ka zbatuar qasjen e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, me fokus të veçantë në rrezikun investues, menaxhimin e fondeve, strategjitë e investimit, ruajtjen e një niveli adekuat të likuiditetit, rrezikun operacional, si dhe rreziqe të tjera relevante për funksionimin e qëndrueshëm të sektorit.

Sa i përket aktivitetit mbikëqyrës të fondeve pensionale, gjatë vitit 2025 janë realizuar ekzaminime në fonde pensionale dhe banka komerciale në përputhje me planin vjetor të mbikëqyrjes. Gjithëj janë realizuar 3 ekzaminime, prej të cilave një ekzaminim i plotë në një fond pensional dhe dy ekzaminime të fokusuara në banka komerciale, lidhur me ofrimin e shërbimeve bankare për tërheqjen në faza të pensioneve të administruara nga bankat.

Gjatë ekzaminimeve është vlerësuar niveli i pajtueshmërisë së fondeve pensionale me kërkesat ligjore dhe rregullative të BQK-së, duke përfshirë praktikën e menaxhimit të aseteve, kornizën e menaxhimit të rreziqeve, funksionimin dhe efektivitetin e organeve drejtuese, si dhe funksionalitetin e sistemit të kontrollave të brendshme. Vëmendje e veçantë i është kushtuar vlerësimit të profilit të rrezikut të fondeve pensionale, me fokus në rrezikun investues, rrezikun operacional dhe atë të qeverisjes.

Në kuadër të ekzaminimeve është rishikuar edhe zbatimi i rekomandimeve të ngritura në raportet e mëparshme të ekzaminimit të BQK-së, me qëllim të forcimit të mbrojtjes së mjeteve pensionale të kursyera nga kontribuesit dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të fondeve. Për më tepër, tek ekzaminimet e fokusuara fushëveprimi është përqendruar në vlerësimin e zbatimit të procesit të tërheqjes në faza të kursimeve pensionale të kontribuuesve, i cili realizohet përmes bankave që ofrojnë këtë shërbim dhe me të cilat fondet pensionale kanë marrëdhënie kontraktuale.

Tabela 12. Numri i ekzaminimeve të sektorit të pensioneve

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Fondet Pensionale	1 ekzaminim i plotë
Banka	2 ekzaminime të fokusuar

Burimi: BQK (2026)

Nga vlerësimi i rreziqeve në sektorin e fondeve pensionale është konstatuar se sfidat kryesore lidhen me rrezikun investues, i cili ndikon drejtpërdrejt në performancën e kthimit të mjeteve të kontribuara dhe të investuara dhe që mund të ndikohet nga luhatjet e mundshme në tregjet financiare.

Në kuadër të mandatit mbikëqyrës, BQK në vazhdimësi adreson rekomandime të qarta dhe të strukturuar me afate të përcaktuara për zbatim, me qëllim të forcimit të praktikave të qeverisjes, përmirësimit të kornizës së menaxhimit të rreziqeve, si dhe ruajtjes së integritetit e transparencës në sistemin pensional.

Këto veprime pasqyrojnë një qasje proaktive të BQK-së në sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm të fondeve pensionale, në përputhje me interesat afatgjata të kontribuuesve. Përmes kësaj qasjeje synohet që fondet pensionale të operojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe transparente, në përputhje me objektivat e tyre për ruajtjen dhe rritjen e vlerës së mjeteve pensionale të investuara.


2.3.1. Sektori pensional

Sektori pensional vazhdoi të rritet me ritëm të lartë për të tretin vit me radhë. Asetet pensionale shënuan rritje vjetore prej 18.1 përqind dhe arritën vlerën prej 3.8 miliard euro në fund të vitit 2025 (shih grafikun 33). Gjatë vitit 2025, sektori realizoi kthim bruto nga investimet në vlerë prej 308.9 milionë euro, krahasuar me 247.2 milionë euro një vit më parë. Po ashtu, arkëtimet nga kontributet u rritën ndjeshëm, duke arritur në 364.3 milionë euro nga 315.8 milionë euro një vit më parë.

Sektori pensional i Kosovës u dominua pothuajse tërësisht nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), që përfaqësoi 99.7 përqind të gjithsej aseteve pensionale në vitin 2025. Vlera e aseteve të FKPK-së arriti në 3.8 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 18.1 përqind, të përafërt me rritjen e realizuar në vitin paraprak (17.8 përqind).


Kthimi bruto nga investimet arriti në 308.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 24.9 përqind (shih grafikun 34.)

Grafik 33. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro



Burimi: BQK (2026)

Grafik 34. Performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK (2026)

Performanca e lartë financiare i atribuohet zhvillimeve pozitive në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, aksioneve dhe veçanërisht në sektorin e teknologjisë, kryesisht në tregun amerikan. Për më tepër, edhe politikatat monetare më lehtësuese gjatë vitit 2025 kontribuan gjithashtu në rritjen e çmimeve të aseteve financiare në bursat kryesore botërore.


Arkëtimet nga kontribut-dhënësit u rritën me ritëm më të lartë krahasuar me vitin paraprak, përkatësisht rritje vjetore prej 15.3 përqind nga 10.4 përqind një vit më parë. Ky zhvillim ishte rezultat i rritjes së pagave të sektorit publik përgjatë vitit 2025 në dy faza, Janar 2025 dhe Korrik 2025. Si rrjedhojë, vlera e kontributeve të arkëtuara nga FKPK-ja arriti në 364.3 milionë euro në vitin 2025 nga 315.8 milionë euro një vit më parë.

Çmimi i aksioneve të FKPK-së u rrit në 1.99 euro nga 1.82 euro për njësi, rezultat i kthimit të lartë prej plasmanëve në tregjet e jashtme dhe financimit prej kontributeve të arkëtuara prej kontribut-dhënësit (shih grafikun 34).

Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP) përfaqëson 0.3 përqind të gjithë asetëve pensionale, vlera e të cilave në fund të vitit 2025 arriti në 11.4 milionë euro. Për dallim nga FKPK-ja, FSKP shënoi ngadalësim të rritjes së asetëve në 5.8 përqind, nga 13.6 përqind në vitin paraprak. Kthimi në investime ishte dukshëm më i ulët, prej 0.7 milionë euro në vitin 2025 nga 1.2 milionë euro një vit më parë. Shuma e kontributeve të arkëtuara në vitin 2025 arriti në 1.1 milionë euro, për 0.4 milionë më shumë se një vit më parë. Çmimi i njësishë së aksionit të FSKP-së u rrit në 2.26 euro në fund të dhjetorit 2025 nga 2.15 euro në periudhën e njëjtë të një viti më parë.


Struktura e investimeve të dy fondeve dominohet nga investimet në tregjet e jashtëm, të cilat vazhduan të zgjerohen tutje (shih grafikun 35). Vlera e investimeve në tregun e jashtëm arriti në 3.0 miliardë euro, duke përfaqësuar 80.1 përqind të portofolit (79.2 përqind një vit më parë). Investimet jashtë vendit janë të koncentruar kryesisht në fondet e përbashkëta me pjesëmarrje prej 99.97 përqind, ndërsa pjesa e mbetur prej 0.03 përqind është e mbajtur në formën e parasë së gatshme (shih grafikun 36). Në kuadër të investimeve në tregun e brendshëm, vlera e të cilave arriti në 748.6 milionë euro, investimet në

Grafik 35. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale




Burimi: FKPK, FSKP (2026)

Grafik 36. Investimet e FKPK-së



Burimi: FKPK (2026)

Grafik 37. Investimet e FSKP-së



Burimi: FSKP (2026)

letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës shënuan rënie vjetore prej 1.9 përqind në vitin 2025 nga rritja prej 11.4 përqind një vit më parë. Kjo kategori përbënë 65.3 përqind të gjithsej portofolit investuese brenda vendit. Ndërkohë, investimet në certifikatat e depozitave në bankat vendore vazhduan të rriten konsiderueshëm për të dytin vit me radhë, për 30.9 përqind në vitin 2025 nga 23.0 përqind rritje një vit më parë. Pjesa e mbetur prej 3.8 përqind përbëhet nga paraaja e gatshme dhe ajo e mbajtur në BQK, në vlerë totale prej 28.5 milionë euro.

Struktura e portofolit investues të FSKP-së është ngjashëm e diversifikuar me atë të FKPK-së, duke qenë kryesisht e orientuar në tregun e jashtëm (8.9 milionë euro), më konkretisht në aksione që përbën 99.4 përqind të portofolit investues jashtë vendit dhe pjesa tjetër në para të gatshme, që përbën 0.6 përqind (shih grafikun 37). Kurse, investimet brenda vendit (2.4 milionë euro), janë kryesisht të fokusuara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës që përfaqësojnë 76.8 përqind të gjithsej portofolit investues brenda vendit. Pjesa tjetër e mjeteve të mbajtura në vend, që përbëhet nga paraaja e gatshme dhe depozitat e mbajtura në bankat komerciale, përbën 23.2 përqind të vlerës investuese.

2.4. Aktivitetet Mbikëqyrëse të Sektorit të Tregjeve, IMF, IFJB, IP dhe IPE

Institucionet mikrofinanciare (IMF) dhe institucionet jo-bankare (IFJB) kredidhënëse, gjatë vitit 2025 kanë vazhduar të luajnë rol të rëndësishëm në thellimin e ndërmjetësimit financiar dhe rritjen e përfshirjes financiare në vend. Aktiviteti i tyre mbetet i fokusuar në financimin e ekonomive familjare, bizneseve mikro dhe ndërmarrësve individualë, duke adresuar nevojat e segmenteve që jo lehtësisht gjejnë qasje në burime të financimit. Gjithsej kreditë në fund të vitit 2025 arritën shumën prej 629.6 milionë euro, duke marrë pjesë mbi 9.4% në gjithsej kreditë e sektorit financiar. Po ashtu, edhe institucionet financiare jobankare me aktivitet të këmbimit të valutave, por edhe të faktoringut realizuan rritje të ofrimit të produkteve të tyre në ekonomi.

Vëmendje e veçantë gjatë vitit 2025 i është kushtuar institucioneve të pagesave (IP) dhe institucioneve të parasë elektronike (IPE), të cilat janë karakterizuar nga zhvillime të qëndrueshme dhe dinamike. Zgjerimi i rrjetit të pikave të shërbimit të pagesave dhe i modeleve digjitale, i shoqëruar me ofrimin e shërbimeve me kosto të pranueshme dhe konkurruese, ka mbështetur rritjen e aktivitetit dhe diversifikimin e produkteve dhe shërbimeve.

Në këtë kontekst, IP dhe IPE kanë kontribuar ndjeshëm në zhvillimin e tregut përmes zgjerimit të gamës së shërbimeve dhe rritjes së përdorimit të instrumenteve digjitale. Këto zhvillime pasqyrojnë rritjen e kërkesës për shërbime më efikase, më të shpejta dhe me kosto konkurruese, duke konsoliduar rolin e këtij segmenti në thellimin e ndërmjetësimit financiar dhe avancimin e digjitalizimit të shërbimeve financiare.

Në funksion të forcimit të mbikëqyrjes prudenciale, rritjes së specializimit dhe avancimit të efektivitetit mbikëqyrës, gjatë vitit 2025 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka funksionalizuar Departamentin e Mbikëqyrjes së Tregjeve (DMT). Ky departament integron mbikëqyrjen e institucioneve mikrofinanciare (IMF), institucioneve financiare jobankare (IFJB), institucioneve të pagesave (IP), institucioneve të parasë elektronike (IPE), si dhe të sektorit të krypto-aseteve, duke zbatuar një qasje mbikëqyrëse më të strukturuar dhe të orientuar drejt rrezikut. Ky zhvillim institucional përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt harmonizimit me praktikën bashkëkohore evropiane të mbikëqyrjes financiare dhe reflekton fokus të shtuar në zhvillimet në fushën e fintech-ut dhe inovacionit financiar, në forcimin e mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregut të krypto-aseteve, si dhe në avancimin e analizës prudenciale përmes ngritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse të bazuara në të dhëna.

DMT, gjatë gjithë vitit 2025, ka përcjellë në mënyrë të vazhdueshme performancën financiare të institucioneve mikrofinanciare, institucioneve financiare jobankare, institucioneve të pagesave

dhe institucioneve të parasë elektronike. Aktiviteti mbikëqyrës është zhvilluar mbi bazën e qasjeje të orientuar drejt rrezikut, duke kombinuar monitorimin e vazhdueshëm jashtë vendit me ekzaminimet në vend, me fokus të veçantë në institucionet me profil më të lartë rreziku, me qëllim identifikimin në kohë dhe adresimin efektiv të dobësive potenciale. Në varësi të gjetjeve dhe profilit të rrezikut, janë ndërmarrë masa të nevojshme mbikëqyrëse, të shoqëruara me rekomandime konkrete për përmirësim.

Bazuar në raportimet, analiza mbikëqyrëse dhe proceset e ekzaminimeve, sektori gjatë vitit 2025 paraqitet përgjithësisht funksional dhe i kapitalizuar, megjithatë me rritje të ekspozimit ndaj rrezikut të kapitalit në segmente të caktuara. Lulatjet rreth nivelit minimal rregullativ në disa institucione kanë evidentuar nevojën për forcimin e menaxhimit të kapitalit dhe përmirësimin e planifikimit financiar. Në këtë kuadër, institucionet kanë ndërmarrë hapa drejt forcimit të bazës kapitale dhe rritjes së përputhshmërisë me kërkesat rregullative, duke reflektuar një përshtatje ndaj pritjeve dhe kërkesave mbikëqyrëse.

Në kuadër të planit mbikëqyrës për vitin 2025, marrë parasysh profilin e rreziqeve dhe vlerësimet mbikëqyrëse, janë realizuar gjashtë ekzaminime të plota. Ekzaminimet kanë përfshirë dy në institucione financiare jobankare me aktivitet të kredithënies, dy institucione mikrofinanciare, një të pagesave elektronike dhe një institucion të pagesave.

Tabela 13. Numri i ekzaminimeve të sektorit të IMF, IFJB, IP dhe IPE

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
FJB me aktivitet të kredithënies dhe lizingut	2 ekzaminime të plota
IMF	2 ekzaminime të plota
IPE	1 ekzaminim i plotë
IP	1 ekzaminim i plotë

Burimi: BQK (2026)


Gjatë ekzaminimeve në vend, fokusi i BQK-së ka qenë vlerësimi gjithëpërfshirës i profileve të rrezikut të institucioneve, me theks në praktikat e kreditimit, klasifikimit dhe provizionimit të kredive, për të vlerësuar cilësinë e portofolit dhe menaxhimin e rrezikut kreditor në tërësi. Po ashtu, është vlerësuar struktura dhe përbërja e asetëve dhe detyrimeve, menaxhimi i rrezikut të likuiditetit dhe aspektet e qeverisjes korporative, përfshirë rolin mbikëqyrës të bordit, auditimin dhe kontrollat e brendshme. Pjesë kyçe ka qenë edhe analiza e strukturës dhe cilësisë së kapitalit, si dhe planifikimi i tij në raport me kërkesat rregullative. Gjendja dhe performanca financiare janë shqyrtuar në funksion të qëndrueshmërisë së institucionit, ndërsa është vlerësuar edhe përputhshmëria me standardet e mbrojtjes së konsumatorit dhe transparencës ndaj klientëve.

Rrjedhimisht, zhvillimet pozitive në këtë sektor reflektojnë edhe efektet e qasjes së përshtatshme dhe efektive të mbikëqyrjes nga ana e BQK-së, ku nëpërmjet procesve mbikëqyrëse – dialogut mbikëqyrës, mbikëqyrjes nga jashtë, ekzaminimeve në vend dhe rekomandimeve dhe masave korrektuese, është arritur të reflektohet avancim në menaxhimin e riskut, kontrollave të brendshme, rritjen dhe forcimin e cilësisë së kapitalit, si dhe përmirësimin e infrastrukturës së rregullimit dhe raportimit të sektorit mikrofinanciar, sektorit financiar jobankar, sektorit të institucioneve të pagesave dhe sektorit të pagesave elektronike, përfshirë punën në rregullimin e tregut të krypto-asetëve.

2.4.1 Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar

Sektori mikrofinanciar dhe ai financiar jo-bankar vazhdoi rritjen dyshifrore për të katërtin vit me radhë. Vlera e aseteve arriti në 747.0 milionë euro në fund të vitit 2025, duke shënuar rritje vjetore prej 20.7 përqind, e cila është për 1.7 përqind më e lartë se në vitin paraprak (shih grafikun 38). Kreditë vazhdojnë të dominojnë strukturën e aseteve të këtij sektori me pjesëmarrje prej 73.9 përqind, pasuar nga lizingjet me 10.4 përqind. Mjetet e mbajtura në sektorin bankar përbënin 9.1 përqind të aseteve dhe zërat e tjerë bilancor përbënin pjesën e mbetur prej 6.6 përqind.


Grafik 38. Asetet e sektorit mikrofinanciar dhe jobankar



Burimi: BQK (2026)


Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar dhe atij financiar jo-bankar vazhdoi të rritet, ndonëse me ritëm më të ngadalësuar për vitin e dytë me radhë, duke arritur në 551.9 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 23.3 përqind (shih grafikun 39).

Grafik 39. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive



Burimi: BQK (2026)

Grafik 40. Rritja e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë




Burimi: BQK (2026)

Të dy segmentet e sektorit privat, korporatat jofinanciare dhe ekonomitë familjare shënuan rritje dyshifrore. Kreditë ndaj ekonomive familjare u rritën për 22.7 përqind nga 19.9 përqind në vitin 2024, duke arritur vlerën në 324.1 milionë euro. Kreditë ndaj korporatave jofinanciare u rritën për 24.3 përqind nga 30.8 përqind në vitin 2024, duke arritur vlerën në 227.8 milionë euro në fund të periudhës.

Kreditimi ndaj korporatave jofinanciare ka vazhduar të rritet me ritëm të lartë për të katërtin vit me radhë, por me trend ngadalësues në dy vitet e fundit në të gjithë sektorët ekonomikë, në veçanti sektori i tregtisë (shih grafikun 40). Kreditë bujqësore kanë peshë më të madhe (24.2 përqind), duke dhënë kështu kontributin më të lartë në rritjen e kreditimit ndaj korporatave jofinanciare. Vlera e kredive ndaj

Grafik 41. Lizingjet




Burimi: BQK (2026)

sektorit të bujqësisë arriti në 55.0 milionë euro, që përkon me rritje vjetore prej 23.3 përqind. Rritja e theksuar e kredive për sektorin e bujqësisë prej vitesh vazhdon të mbështetet nga garancionet kreditore nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK).


Lizingjet janë kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha në strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar dhe jo-bankar. Për dallim nga ecuria e aktivitetit kreditues që është duke u rritur me ritëm të shpejtë, aktiviteti i lizingjeve, veçanërisht në tri vitet e fundit është ngadalësuar theksueshëm, me vitin e kaluar që u karakterizua me rënie vjetore. Lizingjet në vitin 2025 arritën vlerën prej 77.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.0 përqind (shih grafikun 41). Në rritjen, kontributin kryesor e kishte segmenti i ekonomive familjare, të cilat përbëjnë 40.8 përqind të gjithëj lizingjeve. Ky segment shënoi rritje vjetore prej 14.2 përqind dhe arriti vlerën në 31.7 milionë euro në fund të vitit 2025. Kurse, lizingu për korporatat jofinanciare, të cilat kanë dhe peshën më të madhe prej 59.2 përqind në gjithëj lizingjet, u karakterizua me rënie vjetore prej 2.0 përqind dhe zbriti në 46.0 milionë euro në fund të vitit 2025.

Grafik 42. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar



Burimi: BQK (2026)

Grafik 43. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomikë




Burimi: BQK (2026)

Në dhjetor 2025, norma mesatare e interesit në kreditë nga institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo-bankare ishte 18.3 përqind, duke u zvogëluar për 0.5 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (shih grafikun 42). Norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare shënoi poashtu rënie për 0.5 pikë përqindje duke zbritur në 21.2 përqind. Norma mesatare e interesit në kreditë konsumuese po ashtu është zvogëluar, për 1.0 pikë përqindje, dhe ajo e kredive hipotekare për 2.9 pikë përqindje.

Për korporatat jofinanciare, norma mesatare e interesit në kredi zbriti për 0.4 pikë përqindje, në 15.2 përqind në fund të vitit 2025. Norma e interesit në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve u zvogëlua për 0.7 pikë përqindje, në 14.5 përqind, përderisa për sektorin e industrisë dhe bujqësisë u rritën për 1.4 dhe 0.3 pikë përqindje respektivisht, duke rezultuar në 17.4 dhe 16.6 përqind në dhjetor 2025 (shih grafikun 43).

Grafik 44. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar dhe jobankar



Burimi: BQK (2026)

Vlera e fitimit neto të sektorit arriti në 24.2 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 23.7 përqind nga 8.3 përqind rritje një vit më parë, ndikuar nga rritja më e lartë në të hyra krahasuar me rritjen e shpenzimeve (shih grafikët 44 dhe 45). Të hyrat e sektorit janë rritur për 17.7 milionë euro apo për 19.9 përqind, kurse shpenzimet për 13.1 milionë euro apo për 18.4 përqind.


Në kuadër të të hyrave, kategoria e të hyrave nga interesi dominojnë me 84.3 përqind pjesëmarrje. Këto të hyra shënuan rritje vjetore prej 19.9 përqind në vitin 2025 nga 23.8 përqind në vitin e kaluar, kryesisht si rezultat i rritjes së të hyrave nga interesi në kredi. Kategoria e të hyrave nga jointerеси, që përbën 15.7 përqind të gjithë të hyrave, shënoi rritje vjetore prej 17.7 përqind nga 58.3 përqind rritej një vit më parë. Rritja e theksuar në vitin e kaluar e kësaj kategorie ishte si rezultat i rritjes së të hyrave tjera operative në 8.8 milionë euro nga 3.9 milionë euro në vitin 2023, kurse në vitin 2025 kjo nënkategori arriti vlerën prej 10.5 milionë euro. Ky zhvillim me efekt të lartë në vitin e kaluar ishte rezultat i riklasifikimit si IMF/IFJB të një institucioni financiar, i cili në të kaluarën operonte si ndihmës financiar.

Në kuadër të shpenzimeve, pagesat e interesit, të cilat përbëjnë 34.2 përqind të gjithë shpenzimeve, shënuan rritje vjetore prej 22.9 përqind dhe arritën në 28.8 milionë euro. Shpenzimet e jointerесit, që përfaqësojnë peshën më të madhe me 48.5 përqind, u rritën për 17.7 përqind në baza vjetore, duke arritur në 40.9 milionë euro. Kjo rritje u ndikua kryesisht nga shtimi i shpenzimeve për personelin dhe provizionet.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave është zvogëluar me 0.8 pikë përqindje dhe zbriti në 77.7 përqind në dhjetor 2025, duke reflektuar rritjen relative më të lartë të hyrave kundrejt rritjes së shpenzimeve. Indikatorët kryesorë të profitabilitetit shënuan përmirësim në dhjetor 2025, me kthimin në mesataren e aseteve me rritje për 0.1 pikë përqindje dhe kthimin në mesataren e kapitalit për 1.0 pikë përqindje.


Raporti i kredive joperformuese ndaj gjithë kredive të sektorit në fund të vitit 2025 mbeti i ngjashëm me vitin e kaluar, në 1.6 përqind, kurse mbulueshmëria e KJP-ve me provizione vazhdon të jetë e qëndrueshme, ndonëse zbriti lehtësisht në 147.6 përqind nga 148.4 përqind një vit më parë (shih grafikun 46).

Grafik 45. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar



Burimi: BQK (2026)

Grafik 46. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



*Përfshihen kreditë dhe lizingjet

Burimi: BQK (2026)

2.5. Aktivitetet në fushën e Stabilitetit Financiar, Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike

Në funksion të objektivit të saj parësor, ruajtjes së stabilitetit financiar, BQK ka avancuar më tej kornizën e saj për ruajtjen e stabilitetit financiar, duke thelluar qasjen analitike ndaj rreziqeve sistemike, forcuar kapacitetet institucionale dhe intensifikuar bashkëpunimin teknik me partnerë ndërkombëtarë. Aktivitetet janë orientuar drejt forcimit të qëndrueshmërisë së sistemit financiar, përmirësimit të kornizave për identifikimin e hershëm të rreziqeve dhe harmonizimit gradual me praktikatat më të mira të bankave qendrore të rajonit dhe vendeve të zhvilluara.

Gjatë vitit 2025, BQK ka avancuar kapacitetet e saj analitike dhe modeluese në funksion të mbështetjes së politikëbërjes, ruajtjes së stabilitetit financiar dhe përmirësimit të parashikimeve makroekonomike. Aktivitetet janë përqendruar në përmirësimin e kornizave për identifikimin e hershëm të rreziqeve sistemike, ndërtimin e një modeli të ri makroekonometrik, rishikimin e kornizës së parashikimeve afatshkurtra (nowcasting), si dhe në intensifikimin e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë për modernizimin e arkitekturës analitike.

Në këtë kontekst, asistenca teknike e FMN-së ka realizuar një vlerësim të plotë të modeleve ekzistuese dhe procesit të projeksioneve, dhe bashkërisht me BQK-në, është vendosur që në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare të procedohet me një projekt trevjeçar në zhvillimin e një modeli të ri për gjenerim të projeksioneve makroekonomike tremujore QPM (angl: Quarterly Projection Model) dhe rishikimin e mëtejshëm të kornizës “nowcasting”, me qëllim përmirësimin e konsistencës ndërmjet analizës, projeksioneve dhe komunikimit të politikave.

Në fushën e stabilitetit financiar, BQK ka avancuar kornizën analitike për vlerësimin e rreziqeve sistemike, duke përmirësuar instrumentet për analizën e ngarkesës me borxh të huamarrësve, rrezikut të likuiditetit dhe rreziqeve nga tregu i pasurive të paluajtshme, si dhe duke zhvilluar ‘Panelin e Gjelbër’ për monitorimin e rreziqeve klimatike dhe mjedisore.

Gjatë vitit janë realizuar për herë të parë stres-testime makroprudenciale për kapitalin dhe likuiditetin, si dhe analiza të sensitivitetit mbi ndryshimet e parametrave kryesorë makroekonomik dhe financiarë. Përmes këtyre aktiviteteve janë intensifikuar përpjekjet për mbylljen e hendekut të të dhënave dhe janë avancuar kapacitetet për parashikimin dhe menaxhimin e rreziqeve ciklike dhe strukturore.

Po ashtu, gjatë vitit 2025, BQK ka realizuar për herë të parë një anketë gjithëpërfshirëse të ekonomive familjare, në bashkëpunim me Bankën e Austrisë. Ky aktivitet ka forcuar bazën empirike për analizat makroekonomike dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë financiare të sektorit familjar. Cilësia metodologjike dhe realizimi profesional i anketës janë vlerësuar pozitivisht nga partneri austriak.

Në tërësi, këto zhvillime kanë kontribuar dhe pritet të kontribuojnë në konsolidimin e kapaciteteve institucionale dhe teknike të BQK-së, duke harmonizuar praktikatat e saj me standardet më të mira ndërkombëtare në fushën e stabilitetit financiar, parashikimit makroekonomik dhe analizës së rreziqeve sistemike, duke e pozicionuar institucionin në një nivel më të avancuar analitik dhe modelues.

Forcimi i kornizës analitike për vlerësimin e rreziqeve sistemike

BQK ka avancuar kornizën e vlerësimit të rreziqeve, duke zhvilluar kornizën ‘Paneli i Rreziqeve dhe Qëndrueshmërisë’ (angl: Risk and Resilience Dashboard), e ndërtuar përmes bashkëpunimit teknik me Bankën e Sllovenisë. Kjo kornizë konsolidon indikatorët kryesorë ciklikë makro-financiarë dhe strukturorë në një platformë të integruar monitorimi, duke mundësuar vlerësim më të strukturuar dhe sistematik të dimensioneve kryesore të rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet sistemi financiar, si dhe të aftësisë së tij për të përballuar rreziqet potenciale.

Njëkohësisht, në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), është punuar në avancimin e tri kornizave kyçe: kornizës për vlerësimin e ngarkesës me borxh të huamarrësve (angl: Debt-at-Risk); kornizës për vlerësimin e rrezikut sistemik të likuiditetit dhe kornizës për vlerësimin e rreziqeve nga tregu i pasurive të paluajtshme.

Në kuadër të analizës së ngarkesës me borxh, është punuar në identifikimin e pjesës së borxhit që mund të bëhet i cenueshëm në skenarë makroekonomikë të pafavorshëm, duke forcuar qasjen me perspektivë/parashikuese të analizës makroprudenciale dhe duke mbështetur vendimmarrjen makroprudenciale. Konkretisht, është zhvilluar një kornizë analitike e bazuar në të dhënat e Regjistrimit të Kredive, e cila vlerëson shpërndarjen e portofolit të kredive sipas treguesve të Servisimit-të-Borxhit-ndaj-të-ardhurave (angl:DSTI) si dhe Borxhit-ndaj-të-ardhurave (angl:DTI), dhe klasifikon këto ekspozim sipas cilësive kryesore të kredisë (llojit të kredisë, qëllimit, maturitetit, kolateralit). Gjithashtu, korniza identifikon segmentet më të ndjeshme përmes indikatorëve të kombinuar të rrezikut. Gjatë vitit janë hedhur bazat për përfshirjen e parametrave shtesë, si Kredi-ndaj-vlerës së kolateralit (angl:LTV), si dhe për zgjerimin gradual të analizës në segmentin e korporatave.

Sa i përket projektit për tregun e pasurive të paluajtshme, BQK ka mbështetur në mënyrë aktive zhvillimin e tij përmes koordinimit të brendshëm dhe harmonizimit të kërkesave për të dhëna, duke siguruar konsistencë dhe përputhje me objektivat analitike të projektit. Është zhvilluar infrastruktura teknike për analizim të ekspozimeve kreditore ndaj tregut të patundshmërive, duke përfshirë indikatorë të përqendrimit të ekspozimeve, raportet Kredi-ndaj-vlerës së kolateralit (angl:LTV) dhe Servisimit-të-Borxhit-ndaj-të-ardhurave (angl:DSTI), si dhe shpërndarjen e ekspozimeve sipas karakteristikave të ndryshme të kredive. Ky hap shënon progres të theksuar drejt ndërtimit të kornizës së plotë të vlerësimit të rrezikut nga tregu i pasurive të paluajtshme, në një periudhë kur ekspozimi ndaj këtij tregu është në rritje.

Në periudhën gusht–dhjetor 2025 është avancuar gjithashtu projekti për Kornizën e Rrezikut Sistemik të Likuiditetit, në bashkëpunim me FMN-në. BQK ka koordinuar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave relevante brenda dhe jashtë institucionit, ka harmonizuar të dhënat në nivel banke dhe ka kontribuar në vlerësimin metodologjik të modelit. Është përgatitur një draft-ushtim i stres-testimit të likuiditetit në nivel sistemi, ndërsa modeli aktualisht po kalibrohet për nevojat e BQK-së me synim integrimin gradual në kornizat e rregullta të monitorimit.

Përfundimisht, në funksion të adresimit të rreziqeve të ndërlidhura me ndryshimet klimatike dhe tranzicionin drejt ekonomisë së gjelbër, gjatë vitit 2025 është përpiluar ‘Paneli i Gjelbër’ (eng. “Green Dashboard”, me asistencë teknike nga FinSAC. Kjo kornizë synon identifikimin dhe monitorimin e ekspozimeve të sektorit financiar ndaj rreziqeve klimatike dhe mjedisore, duke përfshirë indikatorë të lidhur me financimin e aktiviteteve të gjelbra dhe ekspozimet ndaj sektorëve potencialisht të cenueshëm nga tranzicioni. Përmes këtij instrumenti, BQK ka hedhur bazat për integrimin gradual të dimensionit klimatik në analizën makroprudenciale.

Stres-testi i kapitalit dhe likuiditetit dhe analizat e sensitivitetit

Gjatë vitit 2025, BQK ka realizuar për herë të parë një ushtim të stres-testimit makroprudencial, i cili është ndërtuar mbi një qasje të avancuar analitike (avancim nga analizë sensitiviteti në stres-testim makroprudencial) që përbëhet nga dy blloqe kryesore: blloku i ekuacioneve satelitore, i cili modelon marrëdhëniet ndërmjet faktorëve makroekonomikë dhe treguesve të sektorit financiar. Kjo strukturë synon të kapë lidhjet dinamike mes variablave makroekonomikë (BPV, inflacioni, normat e interesit) dhe probabilitetit të dështimit të ekspozimeve kreditore; si dhe blloku i efektit të tronditjeve në pozicionin e kapitalit, i cili përpunon pasojat e ndryshimeve të variablave makroekonomike të parashikuara nga ekuacionet satelitore në pozicionin e kapitalit të bankave. Ky stres-test makroprudencial është konceptuar për të reflektuar ndikimet e një shoku të jashtëm ekonomik që prek tregun global dhe kanalizohet përmes variablave makroekonomikë në Kosovë.

Tutje, BQK ka vazhduar realizimin e stres-testit të pozicionit të likuiditetit, përkatësisht aplikimit të skenarëve të rënduar në treguesin e mbulimit të likuiditetit.

Gjatë vitit është ngritur gjithashtu kapaciteti për realizim të analizave të sensitivitetit duke aplikuar infrastrukturën e kornizave të reja analitike. Korniza e vlerësimit të borxhit përfshinë edhe modul sensitiviteti për simulimin e goditjeve në të ardhura dhe rritjes së normave të interesit, me qëllim vlerësimin e migrimit të ekspozimeve drejt kategorive më të larta të rrezikut, përkatësisht vlerësimin e qëndrueshmërisë së borxhit. Gjithashtu korniza për rrezikun sistematik të likuiditetit përfshinë modulën e analizës së ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve në parametrat kryesorë të likuiditetit.

Mbyllja e hendekut të të dhënave për vlerësim të rreziqeve sistemike

BQK ka intensifikuar përpjekjet për mbylljen e hendekut të të dhënave në funksion të vlerësimit të rreziqeve sistemike. Kjo ka përfshirë evidentimin e nevojave për përmirësim të strukturës së raportimeve rregullative, zgjerimin e granularitetit të të dhënave mbi ekspozimet kreditore dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional për shkëmbimin e të dhënave relevante. Këto iniciativa synojnë rritjen e cilësisë së analizës dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare për monitorimin makroprudencial.

Transparenca, publikimet dhe komunikimi

Në funksion të transparencës dhe informimit të shpejtë të publikut, BQK ka vazhduar publikimin e raporteve të saj të rregullta, duke shkurtuar kohën e publikimit dhe duke përmirësuar qartësinë analitike të tyre.

Raporti i Stabilitetit Financiar mbetet publikimi kyç, me frekuencë vjetore, që pasqyron qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe analizën e zhvillimeve makroekonomike dhe financiare në vend. Vlerësimet Tremujore të Ekonomisë ofrojnë një pasqyrë të zhvillimeve kryesore tremujore makroekonomike dhe të sektorit financiar, ndërsa Raporti i Informatave Mujore të Sistemit Financiar përmbledh indikatorët kyç të sektorit financiar dhe publikohet çdo muaj.

BQK ka vazhduar realizimin e Anketës së Kreditimit Bankar të Kosovës (AKBK) në baza tremujore, e cila ndihmon në kuptimin e zhvillimeve në sektorin bankar dhe shërben si një input i rëndësishëm për parashikimin e rritjes ekonomike dhe indikatorëve makroekonomikë e financiarë. Në përputhje me objektivin e saj mandator, AKBK përfshin edhe seksionin mbi pritjet e bankave për çmimet në vend, ndërsa të dhënat mbi pritjet për inflacionin publikohen në faqen zyrtare të BQK-së, së bashku me Serinë Kohore të Inflacionit Bazë.

2.6. Aktivitetet Mbikëqyrëse për Parandalimin e pastrimit të parave dhe LFT

BQK-ja bazuar në paragrafin 4 të nenit 34 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (PPP/FT), zbaton kompetencat mbikëqyrëse në institucionet financiare për sa i përket pajtueshmërisë me këtë ligj dhe me rregulloret përkatëse.

BQK-ja ka vazhduar me realizimin e funksionit mbikëqyrës në institucionet financiare sa i përket sigurimit të pajtueshmërisë për PPP/FT. Fushëveprimi i mbikëqyrjes ka mbuluar institucionet financiare të licencuara, duke përfshirë bankat, kompanitë e sigurimeve, shërbimet e transferimit të vlerës monetare, institucionet financiare jobankare si dhe zyret e këmbimit të valutave.

Gjatë vitit 2025, BQK ka realizuar 10 ekzaminime në vend, duke reflektuar një qasje mbikëqyrëse të bazuar në rrezik e cila i jep përparësi institucioneve dhe sektorëve me rrezik më të lartë të PP/FT. Qëllimi i ekzaminimeve të realizuara ishte vlerësimi i pajtueshmërisë së programit me legjisclacionin në fuqi si dhe vlerësimi i efektivitetit të sistemeve dhe kontroleve të brendshme të fushës. Tabela në vazhdim paraqet numrin e ekzaminimeve të realizuara për vitin 2025.

Fushat e ekzaminuara përfshijnë komponentët kryesorë të programit duke përfshirë qeverisjen dhe kulturën e pajtueshmërisë, funksionin e pajtueshmërisë për PPP/LFT, zbatimin e masave të kujdesit të duhur ndaj klientit dhe kujdesit të duhur të shtuar ndaj klientëve me rrezik të lartë, efektivitetin e vlerësimeve të rrezikut të PP/FT, monitorimi dhe raportimi si dhe trajnimi dhe ndërgjegjësimi i punonjësve.

Tabela 14. Numri i ekzaminimeve për pastrimin e parasë

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Banka	3 ekzaminime të plota
Shërbimet e transferimit të vlerës monetare	2 ekzaminime të plota
Sigurues	1 ekzaminim i plote
Zyrë të këmbimit të valutave	4 ekzaminime të fokusuara

Burimi: BQK (2026)

Me qëllim të forcimit të mëtejshëm të qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, dhe në zbatim të metodologjisë për vlerësimin e rrezikut të PP/FT, të miratuar me Manualin e Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për PPP/LFT, gjatë vitit 2025, në kuadër të mbikëqyrjes nga zyra, është kryer vlerësimi periodik i rrezikut të PP/FT, si dhe është realizuar përditësimi i profileve të rrezikut për institucionet bankare dhe institucionet e shërbimeve të transfereve të mjeteve monetare.

Kjo metodologji mbështetet në pyetësorët për vlerësimin e faktorëve të rrezikut inherent, të cilët përfshijnë të dhëna mbi bazën e klientëve, produktet dhe shërbimet e ofruara, si dhe vëllimin dhe natyrën e transaksioneve të kryera. Gjithashtu, pyetësori për vlerësimin e masave zbutëse përfshin të dhëna mbi kontrollet e brendshme dhe programin e institucionit në fushën e PPP/LFT. Nëpërmjet matricës së rrezikut përcaktohet dhe paraqitet niveli i rrezikut të mbetur (rezidual).

Gjatë vitit 2025, BQK gjithashtu ka miratuar “Rregullën për përcaktimin e afateve kohore të rekomandimeve në raportet e ekzaminimit”. Qëllimi i kësaj Rregulle është të përcaktoj procedurat e përcaktimit të afateve kohore si dhe sigurimin e zbatimit në kohë të rekomandimeve të dala nga raportet e ekzaminimeve të institucioneve financiare mbi pajtueshmërinë me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kjo rregull është e zbatueshme për të gjitha ekzaminimet në institucionet financiare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Pjesë e rëndësishme e kësaj rregulle është edhe monitorimi dhe përcjellja e rekomandimeve. Divizioni për PPP/FT duhet të sigurojë monitorimin dhe përcjellje në kohë efektive të zbatimit të rekomandimeve të dala nga raportet e ekzaminimit në institucionet financiare.

Në aspekt të përgatitjes për aplikimin në SEPA, me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare të FATF dhe Direktivat e BE-së, është miratuar plotësim ndryshimi i Rregullores aktuale të BQK-së për PPP/LFT si dhe është miratuar Rregullorja mbi informacionet që duhet të shoqërojë transferet e fondeve dhe krypto asetëve e cila transponon Rregulloren e BE-së 2023/1113 si dhe implementon në plotësi kërkesat e Rekomandimit 16 të FATF për transferet elektronike.

Në aspektin e fuqizimit të bashkëpunimit dhe rritjes së kujdesit për sektorin financiar janë zhvilluar takime me Komitetin për Pajtueshmëri brenda Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe me bankat komerciale, në të cilat takime janë shqyrtuar kërkesat lidhur me kornizën ligjore dhe operacionale të fushës. Ndërsa, në kuadër të projektit të përbashkët të BE-së dhe Këshillit të Evropës kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK III), BQK ka vazhduar me pjesëmarrje aktive në takimet e Këshillit Drejtues dhe aktivitetet tjera të projektit.

2.7. Aktivitetet Mbikëqyrëse të Sistemeve të TI të Institucioneve Financiare

Gjatë vitit 2025, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka vazhduar të forcojë ndjeshëm kornizën mbikëqyrëse për sistemet e informacionit dhe rrezikun kibernetik, duke kontribuar në rritjen e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe vazhdimësisë operacionale të sektorit financiar. Aktivitetet mbikëqyrëse gjatë kësaj periudhe janë fokusuar në avancimin e kornizës rregullative, forcimin e praktikave mbikëqyrëse, ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe harmonizimin e mëtejme me standardet dhe praktikat ndërkombëtare mbikëqyrëse.

Një nga arritjet kryesore gjatë vitit raportues ishte zbatimi me sukses dhe avancimi i mëtejme i kornizës rregullative për menaxhimin e sistemeve të informacionit dhe rrezikut kibernetik. Kjo kornizë ka forcuar ndjeshëm kërkesat ndaj institucioneve financiare në aspektin e qeverisjes së teknologjisë, menaxhimit të rrezikut, reagimit ndaj incidenteve, menaxhimit të rrezikut nga palët e treta, si dhe sigurimit të vazhdimësisë operacionale dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve kritike. Për më tepër, kjo rregullore për herë të parë ka vendosur edhe kërkesa dhe kritere specifike që ndërlidhen me përdorimin e sistemeve të bazuara në Inteligjencën Artificiale, duke adresuar aspektet e qeverisjes, menaxhimit të rrezikut, transparencës, mbikëqyrjes dhe kontrollit të këtyre sistemeve. Përfshirja e këtyre dispozitave përfaqëson një hap të rëndësishëm dhe inovativ në kuadrin rregullativ, duke e bërë këtë akt ligjor ndër të parët që trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë përdorimin e Inteligjencës Artificiale. Kjo ka pozicionuar Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës ndër autoritetet e para rregullative në rajon që kanë adresuar në mënyrë të strukturuar dhe proaktive rregullimin dhe mbikëqyrjen e përdorimit të Inteligjencës Artificiale në sektorin financiar.

Në funksion të zbatimit efektiv të kësaj rregulloreje dhe për të siguruar një kuptim të plotë dhe të njëtrajshëm të kërkesave rregullative, gjatë periudhës raportuese janë organizuar dhe realizuar një sërë takimesh informuese dhe ndërgjegjësuese me përfaqësues të industrisë financiare, përfshirë bankat, institucionet mikrofinanciare, institucionet financiare jo-bankare, kompanitë e sigurimeve, Byronë Kosovare të Sigurimeve, si dhe fondet e kursimeve pensionale. Këto takime kanë kontribuar në rritjen e transparencës, forcimin e dialogut ndërmjet autoritetit mbikëqyrës dhe industrisë, si dhe në lehtësimin e zbatimit të kërkesave rregullative në praktikë.

Si rezultat i zbatimit të suksesshëm të kësaj rregulloreje dhe progresit të arritur në forcimin e mbikëqyrjes së rrezikut kibernetik dhe teknologjik, Banka Qendrore është ftuar të prezantojë këtë kornizë rregullative dhe qasjen e saj mbikëqyrëse në Konferencën Vjetore për Siguri Kibernetike të organizuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në Washington, D.C., duke reflektuar njohjen ndërkombëtare të progresit të arritur dhe rolin aktiv të Bankës Qendrore në avancimin e praktikave moderne të mbikëqyrjes së teknologjisë dhe inovacionit në sektorin financiar.

Gjatë vitit raportues, aktivitetet mbikëqyrëse janë realizuar përmes një kombinimi të ekzaminimeve në vend (On-Site) dhe monitorimit të vazhdueshëm jashtë vendit (Off-Site), duke mundësuar identifikimin dhe vlerësimin në kohë të rreziqeve që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe sigurinë kibernetike në institucionet financiare. Nga aspekti operativ, janë realizuar katër (4) ekzaminime të institucioneve financiare, në përputhje me Planin Vjetor të Ekzaminimeve, me fokus në vlerësimin e kornizave të qeverisjes së teknologjisë, kontrolleve të sigurisë, menaxhimit të rrezikut kibernetik dhe qëndrueshmërisë operacionale të institucioneve të mbikëqyrura. Paralelisht, monitorimi jashtë vendit (Off-Site) është zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme bazuar në raportimet e institucioneve financiare, përfshirë raportimet për incidente, ndërprerje të shërbimeve, aktivitete apo ngjarje të papritura që kanë kërkuar vlerësim dhe reagim nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, duke siguruar mbikëqyrje të vazhdueshme dhe ndërhyrje në kohë kur është konsideruar e nevojshme.

Në të njëjtën kohë, janë realizuar takime të rregullta me institucionet financiare me qëllim të qartësimit të kërkesave të tyre dhe adresimit të çështjeve që ndërlidhen me sigurinë kibernetike, menaxhimin e rrezikut kibernetik, si dhe zbatimin e kërkesave rregullative përkatëse. Këto angazhime kanë kontribuar në forcimin e dialogut ndërmjet autoritetit mbikëqyrës dhe industrisë, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e nivelit të përgatitjes së institucioneve financiare për menaxhimin efektiv të rreziqeve teknologjike dhe kibernetike. Në tërësi, këto aktivitete kanë kontribuar në forcimin e praktikave të menaxhimit të rrezikut dhe rritjen e qëndrueshmërisë së përgjithshme të sektorit financiar. Një zhvillim i rëndësishëm gjatë kësaj periudhe ishte forcimi i kapaciteteve të brendshme mbikëqyrëse përmes rekrutimit të dy zyrtarëve të rinj, me qëllim mbështetjen e zgjerimit të fushës dhe kompleksitetit të mbikëqyrjes së sistemeve të informacionit dhe rrezikut kibernetik. Pas rekrutimit, është ofruar mentorim i strukturuar dhe udhëzim profesional për të mbështetur zhvillimin e tyre teknik, integrimin në proceset mbikëqyrëse dhe ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme institucionale. Ky proces ka kontribuar në forcimin e efektivitetit operacional të Divizionit dhe në sigurimin e vazhdimësisë së kapaciteteve mbikëqyrëse.

Gjatë vitit raportues, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka vazhduar të forcoj bashkëpunimin ndërkombëtar dhe pjesëmarrjen në iniciativa dhe forume profesionale ndërkombëtare. Pjesëmarrja në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare, përfshirë Konferencën për Siguri Kibernetike të organizuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në Washington, D.C., Forumin për Inteligjencën Artificiale të organizuar nga BIS në Bazel, si dhe aktivitetet profesionale të organizuara nga Deutsche Bundesbank lidhur me rreziqet e bankimit digjital dhe metodologjitë mbikëqyrëse, ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe harmonizimin me praktikat më të mira ndërkombëtare. Gjithashtu, është realizuar pjesëmarrja nga përfaqësuesit e BQK-së në Konferencën Rajonale për Rregullimin dhe Mbikëqyrjen Bankare të organizuar nga Center of Excellence in Finance në Lubjanë, në Digital Innovation Summit në Bukuresht, në Kosovo Finance Forum, si dhe në Konferenca për Siguri Kibernetike, ku pjesëmarrja në ngjarjet e sipërpërmendura përfshinte edhe kontribut si panelist apo folës.

Në të njëjtën kohë, është vazhduar kontributi aktiv në grupe punuese dhe iniciativa strategjike në nivel kombëtar dhe institucional, përfshirë pjesëmarrjen në Këshillin Kombëtar të Pagesave, iniciativat për bankimin e hapur (Open Banking), si dhe grupet e brendshme të punës për sigurinë fizike dhe kibernetike dhe vlerësimin e brendshëm të qëndrueshmërisë institucionale. Këto angazhime kanë kontribuar në forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe zhvillimin e mëtejme të kornizës mbikëqyrëse dhe rregullative.

Bashkëpunimi me partnerë dhe institucione ndërkombëtare është forcuar më tej përmes takimeve dhe angazhimeve profesionale me organizata ndërkombëtare, përfshirë Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, si dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë, duke kontribuar në shkëmbimin e përvojave, avancimin e metodologjive mbikëqyrëse dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.

Në përgjithësi, aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 kanë kontribuar ndjeshëm në forcimin e kornizës mbikëqyrëse, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së sektorit financiar ndaj rreziqeve që lidhen me teknologjinë dhe sigurinë kibernetike. Zbatimi i suksesshëm i kornizës rregullative, zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, avancimi i metodologjive mbikëqyrëse dhe forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar kanë konsoliduar më tej aftësinë e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për të përmbushur në mënyrë efektive mandatin e saj mbikëqyrës.

Në vazhdim, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të vazhdojë të avancojë kornizën rregullative dhe mbikëqyrëse, të forcojë kapacitetet institucionale dhe të thellojë bashkëpunimin

ndërkombëtar, me qëllim sigurimin e një sistemi financiar të qëndrueshëm, të sigurtë dhe të përgatitur për sfidat e një mjedisi gjithnjë e më digjital dhe kompleks.

2.8. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare

Gjatë vitit 2025, procesi i shqyrtimit të kërkesave për rishqyrtim u zhvillua në përputhje me kornizën ligjore dhe procedurale të BQK-së, duke siguruar një trajtim të plotë dhe të drejtë të materies në shqyrtim. Në këtë proces, u mbajt komunikim i vazhdueshëm me institucionet financiare, si dhe me departamentet përkatëse të BQK-së, për të siguruar që dokumentacioni dhe sqarimet e nevojshme të ishin të disponueshme dhe të verifikuara në mënyrë të plotë.

Divizioni i Rishqyrtimit koordinon aktivitetet e tij me departamentet e mbikëqyrjes financiare për të siguruar përgatitjen e plotë të rasteve dhe për të trajtuar në mënyrë të duhur çdo kërkesë të mundshme për rishqyrtim nga institucionet financiare para vendimmarrjes nga Bordi Ekzekutiv. Ky bashkëpunim garanton një shqyrtim të kujdesshëm dhe të drejtë, si dhe mbështet hartimin e raporteve me rekomandime të detajuara për Bordin Ekzekutiv.

Në ushtrimin e kompetencave të saj mbikëqyrëse, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vepron në përputhje me nenin 67, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-209 për BQK-në, gjatë zbatimit të procedurave për shqiptimin e ndëshkimeve administrative ndaj subjekteve/personave të mbikëqyrur. Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, para se të merret vendimi për shqiptimin e ndëshkimeve administrative, Bordi Ekzekutiv i BQK-së i adreson subjektit/personit një deklaratë të arsyetuar dhe të detajuar, në të cilën pasqyrohen faktet përkatëse si dhe baza ligjore mbi të cilën mbështetet konstatimi i shkeljes. Njëkohësisht, subjektit (institucionit financiar) i garantohet e drejta për t'u deklaruar, duke paraqitur fakte, prova dhe argumente relevante në mbështetje të kërkesës për mosndëshkim.

Rrjedhimisht, në Njoftimin paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative, të dërguar nga BQK-ja, përfshihet këshilla juridike përkatëse, përmes së cilës subjekti (institucioni financiar) njoftohet për të drejtën e tij që, brenda afatit prej 15 ditësh kalendarike nga data e pranimit të deklaratës, mund të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim në Divizionin e Rishqyrtimit të BQK-së. Në rast se subjekti i mbikëqyrur vendos ta ushtrojë këtë të drejtë, kërkesa për rishqyrtim i përcillet Divizionit të Rishqyrtimit për shqyrtim të mëtejshëm.

2.9. Regjistri Kreditor

Bazuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, BQK-ja mund të operojë, të rregullojë, të licencojë, të regjistrojë dhe të mbikëqyrë sistemet e informacionit të kredive me qëllim të mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit të kredive mes institucioneve kredidhënëse si dhe mund të nxjerrë rregullore për zbatimin përkatës.

Bazuar në këtë objektiv, që nga viti 2006, BQK-ja ka nën menaxhim të saj sistemin e Regjistrit të Kredive (RKK), i cili funksionon si një aplikacion i bazuar në internet dhe ka për qëllim mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave pozitive dhe negative të personave fizikë dhe juridikë, me qëllim të përmirësimit të procesit vlerësues të klientëve kreditorë si dhe realizimin e funksionit mbikëqyrës të BQK-së.

Nga një perspektivë e përgjithshme ekonomike, Regjistri i Kredive lehtëson procesin e kredidhënies, si në aspektin e vëllimit ashtu edhe të kostos, duke kontribuar njëkohësisht në forcimin e stabilitetit financiar në përgjithësi. Përmes funksionit të tij, Regjistri mbështet kredidhënësit në marrjen e vendimeve më të shpejta, më të sakta dhe më objektive, duke përmirësuar cilësinë e vlerësimit të rrezikut kreditor.

Në bazë të rregullores së Regjistrit të Kredive, anëtar në sistemin e RKK-së janë të gjitha institucionet financiare të përcaktuara nga BQK për të qenë ofrues të kredive, duke përfshirë të

gjitha bankat komerciale dhe institucionet mikro-financiare të licencuara si dhe ato institucione financiare jo-bankare dhe kompani të sigurimeve të licencuara për ushtrimin e aktiviteteve të caktuara kreditore.

Me miratimin e Udhëzimit të ri Metodologjik për raportimin e të dhënave në Regjistrin e Kredive, është përmirësuar cilësia e të dhënave të raportuara nga Institucionet kredidhënëse, është zgjeruar spektri i informatave të mbledhura për huamarrësit. Ky udhëzim mundëson raportimin e të dhënave më të detajuara, përfshirë aftësinë paguese, qëllimin e kredisë, vlerësimin e kolateralit si dhe të dhëna të ndara sipas gjinisë së huamarrësve, si element i rëndësishëm për analizimin e qasjes së grave në financa. Udhëzimi kontribuon në realizimin e analizave më efektive për formulimin e politikave më të sakta nga BQK, si dhe mbështet institucionet financiare në vlerësimin më të saktë të rrezikut kreditor.

Pas nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit me Agjencinë e Shoqërisë Informativë (ASHI) dhe integritit të shërbimit të Regjistrin të Kredive në platformën shtetërore eKosova, qytetarëve u është mundësuar marrja e raportit individual kreditor në mënyrë elektronike, pa qenë nevoja ta kërkojnë fizikisht në BQK. Ky zhvillim ka ndikuar drejtpërdrejt në uljen e numrit të kërkesave fizike pranë BQK-së, duke rritur njëkohësisht efikasitetin dhe lehtësinë e qasjes në raportin individual kreditor.


Bazuar në të dhënat e sistemit të RKK-së aktualisht janë të regjistruar 2,678 përdorues aktiv të institucioneve kredidhënëse, ku dominon numri i përdoruesve nga institucionet bankare me 1,803 përdorues aktiv, institucionet mikro-financiare dhe ato jo bankare vijnë me 845 përdorues dhe në fund kompanitë e sigurimeve me 30 përdorues aktiv të sistemit të RKK-së. Gjatë vitit 2025, Regjistri i Kredive ka regjistruar 346 përdorues të rinj.

Sistemi i Regjistrin të Kredive është i dizajnuar që të sigurojë një infrastrukturë të avancuar e cila mbështet funksionimin efikas dhe të qëndrueshëm të tregut të kredive. Ky sistem shërben si një mjet kyç për institucionet kredidhënëse, duke u mundësuar atyre të kryejnë vlerësime më të sakta të rrezikut kreditor.

Ky sistem është një aplikacion i bazuar në internet dhe mund të qaset drejtpërdrejt dhe në kohë reale nga stafi i institucioneve kredidhënëse i cili hulumton mbi historitë kreditore të aplikantëve kreditor. Gjatë vitit 2025, numri i hulumtimeve ka arritur në 2,182,644 (grafiku 47)


Të gjithë ofruesit e kredive janë të obliguar të raportojnë në RKK, të gjitha aplikacionet për kredi dhe kreditë e lëshuara për klientët e tyre në përputhje me kushtet e udhëzimit përkatës të lëshuar nga BQK.

Grafik 47. Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së



Burimi: BQK (2026)

Grafik 48. Numri i kredive të aprovuara në sistemin e RKK-së




Burimi: BQK (2026)

Gjatë vitit 2025, në RKK janë raportuar 347,699 kredi ku përfshihen huat, kredit kartelat, mbitërheqjet, kreditë hipotekare rezidenciale, linjat kreditore, garancionet, lizingu, faktoringu dhe asetet tjera kreditore. Në raportimin për kredi të aprovuara për vitin 2025 prijnë bankat me 192,331 kredi, ndjekur nga institucionet mikrofinanciare dhe ato jobankare me 141,597 dhe kompanitë e sigurimeve me 13,771 kredi të aprovuara (grafiku 48).

Në vitin 2025 është vërejtur një rënie e numrit të kërkesave për raportin kreditor të kredimarrësve në BQK, si për personat fizikë ashtu edhe për ata juridikë (grafiku 49). Kjo tendencë lidhet me mundësinë e qasjes dhe shkarkimit të raportit kreditor elektronik përmes platformës eKosova, e cila e ka lehtësuar ofrimin e këtij shërbimi duke u mundësuar kredimarrësve ta sigurojnë atë mënyrë të drejtpërdrejt nga distanca.

Grafik 49. Numri i kërkesave për raporte kreditore



Burimi: BQK (2026)

3. Licencimi dhe rregullimi i Institucioneve Financiare

Bazuar në Ligjin për BQK-në, objektivi parësor i saj është nxitja dhe mbajtja e një sistemi financiar stabil. BQK-ja angazhohet në arritjen e këtij objektivi përmes përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi si autoritet përgjegjës për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare që operojnë në Republikën e Kosovës.

BQK-ja, në zbatim të përgjegjësi ligjore si autoritet licencues, rregullues, dhe mbikëqyrës i institucioneve financiare në vend, angazhohet në:

Rregullimin e hyrjes në treg të investitorëve potencialë, duke përcaktuar kritere për licencimin e institucioneve financiare dhe të atyre institucioneve, që posedojnë kapital të mjaftueshëm për mbështetjen e aktiviteteve të parapara, që prezantojnë përgatitjet e duhura për vlerësimin dhe monitorimin e rrezikut, plane biznesore të qëndrueshme me synim ndikimin dhe konkurrencën në sektor, politika dhe procedura adekuate për kontrollin e tij, si dhe administratorë me nivel të lartë kualifikimi, profesionalizmi dhe etike, qasje të lehtë dhe të mirëbesimit dhe komunikimit me institucionet përkatëse shtetërore të vendit të investitorit;

Hartimin dhe mirëmbajtjen e kornizës rregullatore të përbërë nga një tërësi kriteresh minimale dhe kërkesash rregullative të zbatueshme ndaj institucioneve financiare, në përputhje me legjislacionin primar, Direktivat përkatëse Evropiane, si dhe standardet ndërkombëtare;

Zhvillimin e një procesi mbikëqyrës efektiv, duke zbatuar parimet e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, nëpërmjet ekzaminimeve në vend, si dhe analizimin, vlerësimin dhe interpretimin e të dhënave të institucioneve financiare, vlerësimin e trendëve të ardhshëm financiar, si dhe mundësinë e ndërmarrjes së masave përmirësuese për zgjidhjen e problemeve të ndryshme;

Bashkëpunimin me institucionet financiare të licencuara dhe mbikëqyrura nga BQK-ja, si dhe me autoritetet e huaja mbikëqyrëse për bankat ose autoritetet rregullatorë përkatëse për institucionet jo-bankare që operojnë në territorin e Republikës së Kosovës.


Me qëllim të kryerjes së funksioneve të saj mbikëqyrëse, BQK-ja synon nivelet më të larta të integritetit, profesionalizmit, efikasitetit, transparencës dhe zhvillimit të përhershëm të kapaciteteve të saj mbikëqyrëse.

3.1. Licencimi

Sipas Ligjit për BQK-në, autoriteti i vetëm përgjegjës për rregullimin, licencimin/regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në Republikën e Kosovës është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

BQK-ja ka për qëllim që të sigurojë një proces meritore, transparent dhe gjithëpërfshirës të licencimit, i cili ndihmon për të siguruar një mjedis të sigurtë, të qëndrueshëm dhe konkurrues financiar të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Kushtet dhe kriteret e licencimit janë të karakterit mbikëqyrës dhe nuk kanë për qëllim vendosjen e barrierave ndaj investitorëve qofshin ata të brendshëm apo të jashtëm; megjithatë, ato shërbejnë për të siguruar që vetëm institucionet që plotësojnë kërkesat ligjore në nivelin e kërkuar, nuk ekspozojnë vendin ndaj rreziqeve dhe sjellin vlerë të shtuar, të mund të hyjnë në treg. Hyrja e investitorëve të huaj në tregun kosovar, veçanërisht në sektorin financiar, dëshmon politikën e hapur të BQK-së ndaj investimeve të huaja, pa i cenuar kërkesat ligjore, ndërsa praktika në disa raste, ka dëshmuar nevojën për rishikimin dhe avancimin e tyre, konform praktikave të kaluara dhe sfidave aktuale.

Figura 1. Struktura e Institucioneve Financiare që operojnë në tregun financiar në Kosovë



Burimi: BQK (2026)

Tabela 15. Numri i institucioneve financiare


Përshkrimi	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Bankat komerciale	11	11	12	12	11	10
Siguruesit	13	12	12	12	12	12
Fondet pensionale	2	2	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	57	53	59	61	64	64
Ndërmjetësuesit në sigurime	18	19	16	16	17	16
Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jobankare	29	30	30	32	32	34

Burimi: BQK (2026)

Struktura e sistemit financiar në fund të vitit 2025, sipas llojit të institucioneve financiare të licencuara dhe regjistruara që ofrojnë shërbime financiare në Kosovë, bazuar në legjislacionin e aplikuar në Republikën e Kosovës dhe në kuadrin rregullator në fuqi të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, të renditura sipas peshës së tyre në sistem është paraqitur në figurën 1.

Në tregun financiar të Kosovës operojnë 140 institucione financiare të licencuara dhe regjistruara, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vend bazuar në legjislacionin e aplikuar në Republikën e Kosovës dhe kornizën rregullatore në fuqi të BQK-së.

Grafik 50. Rrjeti bankar sipas numrit të degëve/zyrave



Burimi: BQK (2026)

Sa i përket qasjes në financa në komunat veriore të Kosovës, edhe gjatë vitit 2025 ka vazhduar zgjerimi i pranisë së institucioneve financiare të licencuara në këtë pjesë të vendit. Pas hyrjes në fuqi të Rregullores për Operacione me Para të Gatshme më 1 shkurt 2024, BQK ka vazhduar të mbështesë përfshirjen financiare përmes masave rregullative, bashkëpunimit me sektorin financiar dhe aktiviteteve të edukimit financiar. Këto përpjekje kanë kontribuar në rritjen e qasjes së qytetarëve dhe bizneseve në shërbime financiare formale.

Prania e shtuar e bankave, institucioneve mikrofinanciare, institucioneve financiare jobankare dhe kompanive të sigurimit ka kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e disponueshmërisë dhe qasjes në shërbime financiare në këtë rajon.

Numri i institucioneve financiare që operojnë në komunat veriore deri më 31 dhjetor 2025 paraqitet në tabelën vijuese.

Tabela 1. Numri i institucioneve financiare të hapura në pjesën Veriore të Kosovës deri më 31 dhjetor 2025

Numri i institucioneve financiare të hapura në pjesën Veriore të Kosovës	Krahasimi gusht 2023 - 31 dhjetor 2024				Krahasimi gusht 2023 - 31 dhjetor 2025			
	Deri më Gusht 2023	Deri më dhjetor 2024	Ndryshimi ne (numer)	Ndryshimi ne (%), rritje prej	Deri në Gusht 2023	Deri ne dhjetor 2025	Ndryshimi (numer)	Ndryshimi ne (%), rritje prej
Banka	4	9	5	125%	4	12	8	200%
Mikrofinanciare	2	4	2	100%	2	3	1	50%
Zyra dhe agjent në IFJB	3	5	2	67%	3	9	6	200%
Zyra të IFJB	7	16	9	129%	7	22	15	214%
Sigurues	1	4	3	300%	1	4	3	300%
Gjithsejt	17	38	21	124%	17	50	33	194%

Banka: Numri i degëve bankare në komunat veriore është rritur nga 4 në 12 deri në fund të vitit 2025, që përfaqëson një rritje prej 200%. Kjo reflekton zgjerimin dhe konsolidimin e pranisë së sektorit bankar në rajon, si dhe forcimin e ofrimit të shërbimeve bankare për qytetarët dhe bizneset.

Institucione Mikrofinanciare: Institucionet mikrofinanciare kanë shënuar një rritje më të moderuar, nga 2 në 3 institucione (50%). Kjo rritje pasqyron një zgjerim të moderuar të këtij segmenti në rajon. Po ashtu, tregon një stabilizim relativ të këtij segmenti, duke vazhduar megjithatë të luajnë rol të rëndësishëm në financimin e individëve dhe ndërmarrjeve të vogla, si dhe tregon një rritje të kërkesës për shërbime financiare alternative nga qytetarët.

Zyra dhe Agjentë në IFJB: Numri i zyrave dhe agjentëve të institucioneve financiare jobankare është rritur nga 3 në 9, përkatësisht një rritje prej 200%. Ky zhvillim tregon zgjerimin e konsiderueshëm të rrjetit të ofrimit të shërbimeve alternative financiare në terren.

Zyra të IFJB-së: Zyrat e institucioneve financiare jobankare kanë shënuar rritjen më të madhe absolute, nga 7 në 22 (214%). Kjo pasqyron një zgjerim të theksuar të pranisë së këtyre institucioneve dhe përmirësim të qasjes fizike të qytetarëve në shërbime financiare.

Sigurues: Numri i kompanive të sigurimit është rritur nga 1 në 4 (300%), duke reflektuar një zgjerim të hershëm të këtij segmenti dhe më pas një stabilizim të pranisë së tyre në treg.

Gjithsejt: Numri total i institucioneve financiare është rritur nga 17 në 50, me një shtim prej 33 njësisish ose 194%. Ky zhvillim dëshmon për një dinamizëm edhe më të theksuar në zgjerimin e sektorit financiar në veri të Kosovës, duke reflektuar forcimin e vazhdueshëm të pranisë së institucioneve financiare dhe përmirësimin e qasjes në shërbime financiare në këtë rajon.

Në përgjithësi, zhvillimet e arritura deri në fund të vitit 2025 tregojnë se masat e ndërmarra nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me industrinë financiare, kanë ndikuar

dukshëm në zgjerimin e rrjetit të institucioneve financiare dhe në përmirësimin e përfshirjes financiare në komunat veriore.

Rritja e numrit të institucioneve financiare ka kontribuar në rritjen e qasjes së qytetarëve dhe bizneseve në shërbime financiare të licencuara dhe të mbikëqyrura, duke forcuar kështu edhe stabilitetin dhe funksionalitetin e sistemit financiar në këtë pjesë të vendit.

Gjatë vitit 2025, BQK miratoi përvetësimin e aktivës dhe pasivës së degës së “Turkiye Is Bankasi A.S.” Dega në Kosovë nga “Banka Ekonomike” SH.A., në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi. Ky transaksion pritet të kontribuojë në konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit bankar, duke mbështetur rritjen e portofolit të kredive dhe depozitave, si dhe duke ruajtur stabilitetin financiar dhe konkurrencën në treg.


Gjithashtu, gjatë vitit 2025 është miratuar shndërrimi i degës së bankës Ziraat Dega në Kosovë në banke të themeluar, përkatësisht subjekt të varur, me qëllim të avancimit të procesit të mbikëqyrjes efektive si dhe konsolidimit të sektorit financiar, në pajtim me ligjin për bankat dhe ligjin e BQK-se. Ky proces është në vijim dhe pritet të përmbyllet sipas ligjit të ri për bankat.

3.1.2 Rrjeti i sistemit financiar

Në fund të vitit 2025, bankat e ushtruan veprimtarinë e tyre në gjithsej 58 degë dhe 176 zyra brenda territorit të vendit (shih grafikun 48). Gjatë këtij viti, me miratim të BQK-së është rritur numri i zyrave të bankave për dhjetë, ndërsa, numri i degëve të bankave ka mbetur i njëjtë me vitin paraprak.

Shpërndarja gjeografike e rrjetit bankar përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit dhe ishte pothuajse e njëjtë me vitin paraprak në raport me numrin e degëve dhe zyrave (shih tabelën 16). Megjithatë, vazhdon të evidentohet përqendrim më i madh i degëve dhe zyrave në rajonin e Prishtinës me 34.0 përqind, ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i madh 27.8 përqind (shih grafikun 49). Trendi pesëvjeçar tregon një strategji të qëndrueshme të bankave sa i përket fokusimit gjeografik. Gjatë kësaj periudhe nuk vërehen ndryshime të theksuara ndërmjet rajoneve për sa i përket përqindjes së degëve dhe zyrave bankare; shpërndarja ka mbetur pothuajse proporcionale në të gjitha rajonet. Një trend rritës vërehet në rajonin e Mitrovicës, si rezultat i zgjerimit më të madh të pranisë së bankave edhe në pjesën veriore të vendit gjatë dy viteve të fundit. Megjithatë, objektivat për përfshirje financiare mund të kërkojnë rishikimin e mëtejshëm të kësaj shtrirjeje.

Grafik 51. Shpërndarja e popullsisë në Kosovë sipas regjioneve



Burimi: ASK (të dhënat e Regjistrimit 2024)


Tabela 16. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të bankave

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	95	36%	38	15%	42	16%	52	20%	35	13%	262
2017	83	35%	37	16%	39	16%	47	20%	32	13%	238
2018	74	33%	35	16%	38	17%	44	20%	31	14%	222
2019	71	33%	35	16%	37	17%	44	20%	30	14%	217
2020	70	33%	34	16%	32	15%	41	19%	34	16%	211
2021	67	33%	34	17%	28	14%	38	19%	34	17%	201
2022	67	33%	35	17%	29	14%	39	19%	33	16%	203
2023	73	33%	37	17%	33	15%	41	19%	35	16%	219
2024	79	34%	39	17%	35	15%	41	17%	41	17%	235
2025	83	34%	40	16%	35	14%	42	17%	45	18%	245

Burimi: BQK (2026)

Siguruesit, gjatë vitit 2025 veprimtarinë e tyre e ushtruan përmes 58 degëve, 323 zyrave dhe 72 agjentëve dhe brokerëve brenda territorit të vendit (shih grafikun 52), ku vërehet një zgjerim i lehtë i rrjetit të përgjithshëm të zyrave të siguruesve në vend.

Shpërndarja gjeografike e rrjetit të siguruesve përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit, por, nuk përputhet me shpërndarjen gjeografike të popullsisë si në rastin e bankave. Përqendrimi i rrjetit të siguruesve, me theks ai i degëve të siguruesve, në vitin 2025 ka përfaqësuar më të lartë në rajonin e Pejës me 25.4%, i pasuar nga rajoni i Gjilanit, që si rajone nuk reflektojnë shpërndarjen gjeografike të popullsisë dhe kjo strukturë është konsistente gjatë gjashtë viteve të fundit (shih tabelën 17).

Grafik 52. Rrjeti i siguruesve

Burimi: BQK (2026)

Tabela 17. Shpërndarja gjeografike e filialeve të siguruesve

Vitet	Rajoni i Prishtinës		Rajoni i Prizrenit		Rajoni i Pejës		Rajoni i Gjilanit		Rajoni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	11	15.3%	11	15.3%	21	29.2%	18	25.0%	11	15.3%	72
2017	13	17.8%	11	15.1%	20	27.4%	19	26.0%	10	13.7%	73
2018	14	18.9%	11	14.9%	20	27.0%	19	25.7%	10	13.5%	74
2019	13	19.4%	10	14.9%	18	26.9%	17	25.4%	9	13.4%	67
2020	13	19.4%	10	14.9%	18	26.9%	17	25.4%	9	13.4%	67
2021	12	20.0%	9	15.0%	16	26.7%	15	25.0%	8	13.3%	60
2022	12	20.0%	9	15.0%	16	26.7%	15	25.0%	8	13.3%	60
2023	12	20.0%	9	15.0%	16	26.7%	15	25.0%	8	13.3%	60
2024	12	20.0%	9	15.0%	16	26.7%	15	25.0%	8	13.3%	60
2025	13	20.6%	11	17.5%	16	25.4%	15	23.8%	8	12.7%	63

Burimi: BQK (2026)

Fondet pensionale aktivitetin e tyre e zhvillojnë vetëm përmes zyrave qendrore me lokacion në Prishtinë.

Institucionet mikrofinanciare në fund të vitit 2025, aktivitetin e tyre e ushtruan përmes 152 zyrave të shpërndara brenda territorit të vendit. Gjatë vitit 2025 është aprovuar zhvendosje e njëmbëdhjetë (11) zyrave, si dhe hapja e katër (4) zyrave të tjera të IMF-ve. Shpërndarja

gjeografike e zyrave të institucioneve mikrofinanciare vazhdon të jetë e përqendruar kryesisht në dy rajone të territorit të vendit, në rajonin e Prishtinës dhe atë të Prizrenit (shih tabelën 18).

Tabela 18. Rrjeti i IMF-ve sipas shpërndarjes gjeografike

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	27	26%	24	23%	23	22%	19	18%	12	11%	105
2017	29	26%	26	23%	24	21%	20	18%	14	12%	113
2018	32	27%	28	23%	24	20%	22	18%	14	12%	120
2019	37	29%	30	23%	24	19%	23	18%	14	11%	128
2020	38	29%	30	23%	25	19%	23	18%	14	11%	130
2021	12	14%	30	36%	5	6%	23	27%	14	17%	84
2022	40	29%	33	24%	27	20%	24	17%	14	10%	138
2023	42	30%	32	23%	28	20%	24	17%	14	10%	140
2024	45	30%	33	22%	29	20%	26	18%	15	10%	148
2025	45	30%	33	22%	30	20%	28	18%	16	11%	152

Burimi: BQK (2026)

Institucionet financiare jobankare në fund të vitit 2025, aktivitetin e tyre e ushtruan në gjithsej 1026 zyra dhe agjentë të shpërndarë brenda territorit të vendit. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të rrjetit të institucioneve financiare jobankare është i përqendruar pothuajse në gjithë territorin e vendit, ku prinë rajoni i Prishtinës me 37 përqind, pasuar nga rajoni i Gjilanit me 22 përqind, dhe me rajonin e Mitrovicës që ka pjesëmarrjen më të ultë në vend (shih tabelën 19). Këtij trendi të rritjes së zyrave dhe agjentëve të rinj i ka kontribuar hyrja në treg dhe regjistrimi i institucioneve të reja financiare që merren me shërbimin e pagesave, emetimit të parasë elektronike dhe këmbimit valutor.

Tabela 19. Rrjeti i IFJB-ve (zyra dhe agjent) sipas shpërndarjes gjeografike

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	132	29%	85	18%	101	22%	103	22%	41	9%	462
2017	154	29%	96	18%	109	21%	115	22%	52	10%	526
2018	177	30%	111	19%	122	21%	130	22%	53	9%	593
2019	219	31%	126	18%	139	20%	160	23%	65	9%	709
2020	286	33%	150	17%	165	19%	192	22%	82	9%	875
2021	340	36%	163	17%	170	18%	197	21%	80	8%	950
2022	360	36%	177	18%	174	17%	212	21%	81	8%	1004
2023	384	37%	174	17%	177	17%	228	22%	75	7%	1038
2024	369	37%	168	17%	172	17%	223	22%	66	7%	998
2025	383	37%	173	17%	174	17%	226	22%	70	7%	1026

Burimi: BQK (2026)

3.1.3 Aktiviteti i licencimit

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të licencimit dhe sigurimit të funksionimit të rregullt të veprimtarive financiare, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka vazhduar të jetë aktive në shqyrtimin dhe trajtimin e kërkesave për licencim gjatë vitit 2025. Në këtë periudhë, BQK-ja ka shqyrtuar gjithsej 524 kërkesa, detajet e të cilave janë pasqyruar në tabelën 20 të raportit. Vlen të theksohet se në këtë numër nuk përfshihen: (i) Shprehjet e interesimit për licencim apo regjistrim që janë paraqitur pranë BQK-së, por nuk kanë kaluar në fazën formale të shqyrtimit, (ii) Kërkesat që janë trajtuar nga BQK-ja, por nuk kërkojnë miratim formal sipas kuadrit rregullativ në fuqi, (iii) Pyetjet, njoftimet dhe vlerësimet e tjera që kanë qenë objekt i trajtimit gjatë periudhës raportuese.

Gjatë vitit 2025, BQK-ja ka pranuar kryesisht kërkesa për regjistrimin e Institucioneve Financiare Jobankare (IFJB), një trend i ngjashëm me atë të vitit të kaluar. Po ashtu, është vërejtur një rritje e kërkesave të paraqitura nga sektori bankar, duke reflektuar zhvillimet dhe dinamikën e këtij sektori në tregun financiar të Kosovës. Në tërësi, struktura e kërkesave për licencim ka mbetur e qëndrueshme, ndonëse me një rënie të lehtë në numrin e përgjithshëm të aplikimeve krahasuar me vitet paraprake.

Kjo analizë ofron një pasqyrë të qartë të trendeve dhe dinamikës në procesin e licencimit, duke nënvizuar përkushtimin e BQK-së për të mbështetur një sistem financiar të qëndrueshëm dhe të mbrojtur nga rreziqet operacionale.

Tabela 20. Struktura e kërkesave të sistemit financiar të miratuara/refuzuara nga BQK

Transaksionet	2025					
	Bankë	Fonde pensionale	IMF & IFJB	Sigurues	Ndërmjet. në sigurime/ tjetër	Gjithsej
Aplikacionet	0	0	1	0	0	1
Aksionarët kryesor dhe ndryshime në kapital	0	0	4	2	0	6
Drejtorë dhe menaxherë të lartë dhe delegim funksioneve	30	0	61	30	3	124
Auditori i jashtëm	9	2	31	16	4	62
Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutit/ emrit	9	0	21	5	0	35
Përvetësimet e interesit të kapitalit dhe transferimi i portofolit	1	0	1	0	0	2
Zgjerim i veprimtarive financiare	0	0	4	0	0	4
Hapja, zhvendosja dhe mbyllja e degëve dhe zyrave brenda dhe jashtë vendit	17	0	41	21	0	79
Licencimi dhe regjistrimi i agjentëve/brokerëve	49	0	78	4	2	133
Tërheqja e licencimit/regjistrimit	10	0	67	1	0	78
Tjetër	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	125	2	309	79	9	524

Burimi: BQK (2026)

Në procesin licencues, përveç kërkesave ligjore dhe rregullatore, BQK-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë vlerësimit të planit të biznesit dhe vlerës së shtuar, si dhe zbatimit të parimeve dhe rregullave bazë për qeverisje të përgjegjshme dhe efektive duke vlerësuar strukturat e tyre organizative, menaxhimin, si dhe ndarjen e përgjegjëseve.

Gjatë vitit 2025 janë marrë vendime dhe proceduar kërkesat për miratim/refuzim paraprak, Ku gjithsej ka pasur 524 kërkesa. Natyra e kërkesave të miratuara/refuzuara në vitin 2025 ishte si në vijim:

Aplikacioni për licencim ka përfshirë një kërkesë për licencimin e një Institucioni Financiar Jobankar për dhënien e kredive, i cili, sipas legjislacionit në fuqi, kërkon miratim paraprak nga BQK-ja;

Miratimi i 6 kërkesave për ndryshim në aksionarin kryesor dhe në kapital është kryer në përputhje me rregulloret në fuqi dhe procedurat standarde të licencimit, duke përfshirë vlerësimin e përmbushjes së kriterëve ligjore dhe rregullative. Procesi ka përfshirë shqyrtimin e dokumentacionit të plotë dhe të saktë të dorëzuar nga aplikantët, analizën e ndikimit në strukturën e kapitalit dhe qëndrueshmërinë financiare të institucioneve. Në këtë kategori janë shqyrtuar dy kërkesa për sigurues, tri për IFJB dhe një për IMF;

Miratimi i 124 kërkesave për ndryshime në drejtorë dhe menaxherë të lartë, si dhe delegim të funksioneve, është realizuar në përputhje me rregulloret në fuqi, duke siguruar që të gjitha aplikimet përmbushin kriteret ligjore dhe standardet profesionale të kërkuara. Ky proces përfshiu: tridhjetë kërkesa për banka, dyzet e nëntë kërkesa për IFJB, dymbëdhjetë kërkesa për IMF&IFJB, tridhjetë kërkesa për sigurues përfshirë edhe BKS, tri kërkesa për ndërmjetësues;

Miratimi i 35 kërkesave për ndryshime në aktet themeluese dhe statutin e institucioneve financiare është kryer në përputhje me rregulloret në fuqi, duke siguruar përputhshmërinë me kornizën ligjore të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Procesi përfshiu shqyrtimin

e dokumentacionit, vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, verifikimin e ndikimit në funksionimin e institucioneve dhe garantimin që strukturat dhe qëllimet e tyre të reflektojnë qeverisjen e mirë. Kjo kategori përfshiu: nëntë banka, shtatëmbëdhjetë IFJB, katër IMF, si dhe pesë sigurues;

Miratimi i një kërkesë për zgjerimin e veprimtarisë financiare përfshin vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar, analizën e përshtatshmërisë së planit të propozuar dhe sigurinë që aktivitetet e reja janë në përputhje me kornizën rregullative dhe ligjore në fuqi;

Miratimi i një kërkesë për përvetësimet e interesit të kapitalit të një degë të bankës së huaj dhe një transferimi i portofolit të një IFJB-je (tani në likuidim të detyrueshëm) tek një IFJB;

Miratimi i 133 kërkesave për licencim dhe regjistrim të agjentëve dhe brokerëve përfshinë shqyrtimin e dokumentacionit të nevojshëm, verifikimin e plotësisë të kriterëve ligjore dhe rregullatore, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale dhe integritetit të aplikantëve për të siguruar përmbushjen e standardeve të përcaktuara. Në këtë kategori janë shqyrtuar dyzet e nëntë kërkesa për banka, shtatëdhjetë e tetë kërkesa për IFJB, katër për sigurues dhe dy për ndërmjetësues në sigurime;

Miratimi i 79 kërkesave për hapjen, zhvendosjen dhe mbylljen e degëve është kryer pas një procesi të detajuar vlerësimi dhe verifikimi të plotë të dokumentacionit. Nga ky numër, për banka janë miratuar shtatëmbëdhjetë kërkesa, dyzet e një për IMF&IFJB, dhe njëzet e një për sigurues;

Miratimi i 78 kërkesave për tërheqjen e licencimit/regjistrimit të agjentëve është kryer pas një procesi të detajuar vlerësimi dhe verifikimi të plotë të dokumentacionit. Nga ky numër, për banka janë miratuar dhjetë kërkesa, gjashtëdhjetë e shtatë për IMF&IFJB dhe një për sigurues;

Gjatë vitit 2025 janë shqyrtuar dhe mbajtur edhe takime informuese me palë të interesuara për licencim/regjistrim si institucione financiare nga Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit.

3.2. Rregullimi i Institucioneve Financiare

Hartimi i akteve të reja nënligjore dhe rishikimi i kornizës rregullative në fuqi synon plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij, në funksion të realizimit të një mbikëqyrjeje më efektive dhe në zbatim të kërkesave ligjore për institucionet financiare të licencuara/regjistruara dhe të mbikëqyrura nga BQK, nëpërmjet përafrimit me aktet rregullative të Bashkimit Evropian dhe me parimet bazë për mbikëqyrjen efektive të institucioneve tjera relevante ndërkombëtare.

Deri më tani, BQK-ja ka ndërtuar një kornizë rregullative për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare të bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare, e mbështetur në vazhdimësi nga institucione të njohura ndërkombëtare, si Grupi i Bankës Botërore (BB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), USAID, FED, Thesari Amerikan, BQE, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), KfW, GIZ dhe institucione të tjera ndërkombëtare. Korniza rregullative është hartuar në pajtueshmëri me direktivat evropiane që adresojnë rregullimin e institucioneve financiare, si standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare. Gjithashtu, BQK-ja ka vazhduar me procesin gradual drejt përafrimit me parimet bazë për mbikëqyrjen e bankave, të nxjerra nga Bank for International Settlements (BIS), si dhe parimet bazë për mbikëqyrjen e siguruesve të nxjerra nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (International Association for Insurance Supervision - IAIS). Meqenëse direktivat e BE, standardet ndërkombëtare, dhe parimet e lartëcekura lidhur me rregullimin e institucioneve financiare dhe fushën e veprimtarisë së tyre janë të natyrës dinamike, kjo ndikon që hartimi i kornizës rregullative të jetë një proces i vazhdueshëm dhe kompleks pasi që kërkon plotësimin dhe ndryshimin e kornizës ekzistuese ligjore dhe rregullative, si dhe kërkon një qasje adekuate në mënyrë që të studiohen me kujdes rrethanat specifike të Kosovës, për një adaptim adekuat të

këtyre instrumenteve juridike ndërkombëtare në funksion të nevojave të sektorit financiar në Kosovë.

Në shtesë të kësaj, BQK ka vazhduar aktivitetin për ligjin për institucionet mikrofinanciare (jo bankare). Gjithashtu, është në proces të shqyrtimit të ndryshimeve ligjore në fushën e sigurimeve - ligjin për autopërgjegjesinë.

3.2.1 Korniza ligjore e zbatueshme për institucionet financiare

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës ligjore të institucioneve financiare, gjatë vitit 2025 janë hartuar aktet ligjore dhe nënligjore, si më poshtë:

3.2.1.1. Draft Ligji për Institucionet Financiare Jobankare

Draft-ligji për Institucionet Financiare Jobankare (IFJB) synon të krijojë një kornizë të re rregullative për licencimin, mbikëqyrjen, qeverisjen dhe funksionimin e IFJB-ve në Kosovë, me fokus në mbrojtjen e konsumatorëve dhe ruajtjen e stabilitetit financiar. Ai do të përcaktoj veprimtaritë e lejuara, kërkesat për qeverisje të brendshme, transparencë, raportim financiar, kontroll të rrezikut dhe standarde kapitale sipas profilit të institucionit.

Me miratimin e këtij Draftligji, do të shfuqizohet Kreu II i Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.

3.2.1.2. Draft-Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm në Komunikacion

Draft-ligji për Sigurimin e Detyrueshëm në Komunikacion rregullon mbrojtjen e palëve të treta nga dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjeteve motorike, sigurimin e pasagjerëve në transportin publik dhe funksionimin e sistemit të sigurimit të detyrueshëm, duke përafuar legjislacionin e Kosovës me Direktivën 2009/103/KE të BE-së.

Po ashtu, draftligji rregullon funksionimin e Byrosë Kosovare të Sigurimit, fondet e kompensimit dhe garantimit, si dhe vendos masa ndëshkuese për mosrespektimin e detyrimeve ligjore, duke synuar krijimin e një sistemi më transparent dhe efikas të sigurimeve të detyrueshme. Me hyrjen në fuqi të tij, shfuqizohet Ligji Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjesisë.

3.2.2 Korniza rregullative për mbikëqyrjen e bankave

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për rregullimin e bankave, gjatë vitit 2025 janë realizuar aktivitetet si në vijim:

3.2.2.1. Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për kontrollin e brendshme dhe auditimin e brendshëm

Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kontrollin e brendshëm dhe auditimin e brendshëm, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 28 shkurt 2025, forcon kërkesat profesionale për udhëheqësin e funksionit të auditimit të brendshëm. Ndryshimet kërkojnë që ky funksion të ushtrohet nga persona që plotësojnë kriteret e përcaktuara në Rregulloren për Drejtorë dhe Menaxherë të Lartë, posedojnë certifikim profesional në auditim dhe dëshmojnë integritet, përvojë dhe kompetencë të mjaftueshme në sektorin bankar.

Rregullorja parashikon një periudhë tranzitore njëvjeçare për zbatimin e kërkesave të reja dhe ka hyrë në fuqi më 1 mars 2025, duke plotësuar Rregulloren për Kontrollin e Brendshëm dhe Auditimin e Brendshëm në Banka të vitit 2012 dhe duke kontribuar në forcimin e qeverisjes dhe mbikëqyrjes së brendshme bankare.

3.2.2.2. Rregullore për shtesat makroprudenciale të kapitalit

Rregullorja për shtesat makroprudenciale të kapitalit, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 29 prill 2025, përcakton kërkesat shtesë të kapitalit për bankat me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë së sistemit financiar. Rregullorja zbatohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK dhe përfshin shtesën kundërciklike të kapitalit, shtesën për bankat me rëndësi sistemike (O-SII), shtesën për rrezikun sistematik dhe kërkesën e shtesës së kombinuar të kapitalit, në përputhje me standardet e Basel Committee on Banking Supervision (BCBS) dhe European Systemic Risk Board (ESRB).

Rregullorja përcakton gjithashtu kufizime për shpërndarjen e kapitalit dhe obligon bankat që nuk i përmbushin kërkesat të hartojnë plan për ruajtjen e kapitalit për miratim nga BQK. Rregullorja ka hyrë në fuqi më 1 maj 2025. Rregullorja për Shtesat Makroprudenciale të Kapitalit, e miratuar nga BQK më 29 prill 2025, synon të përcaktojë mekanizmat makroprudencialë të kapitalit që bankat duhet të mbajnë për të forcuar qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Ajo zbatohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK dhe përfshin pesë lloje shtesash: shtesën kundërciklike, shtesën kundërciklike specifike për bankën, shtesën për bankat me rëndësi sistemike (O-SII), shtesën për rrezikun sistematik dhe kërkesën e shtesës së kombinuar të kapitalit.

Shtesa kundërciklike e kapitalit vendoset për të adresuar rritjen e tepërt të kreditimit dhe përcaktohet në intervalin 0%–2.5%, me mundësi rritjeje mbi këtë nivel në rrethana të jashtëzakonshme. BQK vlerëson periodikisht normën e saj duke u mbështetur në treguesit e ciklit kreditor, raportin kredi–BPV dhe udhëzimet e BCBS dhe ESRB. Për ekspozimet jashtë vendit përdoren normat e juridiksioneve përkatëse, përveç rasteve kur BQK përcakton ndryshe. Bankat që nuk e përmbushin kërkesën i nënshtrohen kufizimeve të dividendëve.

Shtesa O-SII aplikohet për bankat me rëndësi sistemike, të identifikuar çdo vit nga BQK sipas një metodologjie të harmonizuar me standardet e Autoritetit Bankar Evropian. Normat O-SII mund të arrijnë deri në 3.5% të ekspozimeve të peshuara me rrezik dhe duhet të mbulohen me kapital bazë CET1. Gjithashtu, BQK mund të vendosë një shtesë për rrezikun sistematik nga 1% deri në 3%, me mundësi tejkalimi kur kërkohet për të adresuar rreziqe të gjera makroprudenciale që nuk mbulohen nga instrumentet tjera.

Rregullorja parashikon gjithashtu kufizime të detajuara mbi shpërndarjet e kapitalit për bankat që nuk plotësojnë kërkesën për shtesën e kombinuar, duke përfshirë llogaritjen e Shumës Maksimale të Shpërndarjes (SHMSH) sipas nivelit të kapitalit të lirë dhe fitimeve të pashpërndara. Bankat që nuk përmbushin kërkesat duhet të përgatisin një plan të ruajtjes së kapitalit për miratim nga BQK. Rregullorja ka hyrë në fuqi më 1 maj 2025.

3.2.2.3. Rregullore për platformën për krahasimin e produkteve dhe shërbimeve financiare

Rregullorja për platformën për krahasimin e produkteve dhe shërbimeve financiare, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 29 gusht 2025, përcakton kërkesat për raportimin, shpalosjen, përditësimin dhe krahasimin e informatave mbi normat dhe tarifat e produkteve dhe shërbimeve financiare për konsumatorët individualë. Qëllimi i saj është rritja e transparencës, krahasueshmërisë së ofertave dhe mbrojtjes së konsumatorit financiar përmes Platformës për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare të BQK-së.

Rregullorja zbatohet për të gjitha institucionet financiare të licencuara, regjistruara ose autorizuara nga BQK për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve financiare, duke siguruar qasje të barabartë në informim dhe zbatim të standardeve të përcaktuara në këtë rregullore dhe udhëzuesit përkatës të BQK-së.

Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 29 gusht 2025, ka miratuar këtë rregullore. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë rregullat dhe kërkesat për raportim, shpalosje, përditësim dhe krahasim të informatave mbi normat dhe tarifatat e produkteve dhe shërbimeve financiare për konsumator individual për qëllim të informimit dhe krahasueshmërisë së tarifave që ofrohen nga institucionet financiare, duke siguruar transparencë, qasje të barabartë në informim dhe mbrojtje të konsumatorit financiar në Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare (në tekstin e mëtejshëm “Platforma”) të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës-(BQK).

Kjo Rregullore zbatohet nga institucionet financiare të licencuara, regjistruara ose autorizuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve financiare në pajtim me këtë rregullore dhe udhëzuesit përkatës që lëshohen në zbatim të saj.

3.2.2.4. Rregullore për sistemet e informacionit dhe menaxhimin e rrezikut kibernetik

Rregullorja për sistemet e informacionit dhe menaxhimin e rrezikut kibernetik, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 29 gusht 2025, vendos një kornizë gjithëpërfshirëse për qeverisjen e TIK, sigurinë kibernetike, menaxhimin e rrezikut dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në institucionet financiare të licencuara nga BQK, duke përcaktuar edhe përgjegjësitë e Bordit dhe menaxhmentit të lartë për mbikëqyrjen e këtyre rreziqeve.

Ajo përcakton kërkesa për raportimin e incidenteve, testimet e sigurisë dhe menaxhimin e palëve të jashtme, si dhe afate për përputhshmëri deri më 1 qershor 2026. Rregullorja ka hyrë në fuqi më 15 shtator 2025 dhe zbatohet për institucionet financiare të licencuara nga BQK, me përjashtimet përkatëse të përcaktuara.

3.2.2.5. Aktet nënligjore në proces të draftimit për bankat

Është hartuar letra këshilluese për menaxhimin e rreziqeve klimatike dhe mjedisore në kuadër të projektit me Bankën Botërore (FinSAC), gjatë vitit 2025, ka vazhduar aktiviteti i draftimit të rregulloreve në fushën e bankave lidhur me licencimin, likuiditetin, qeverisjen korporative, dhe legjislacion tjetër i nevojshëm për avancimin e sektorit.

3.2.3 Korniza rregullative për siguresit

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative të siguresve dhe ndërmjetësuesve në sigurime, gjatë vitit 2025 janë hartuar aktet ligjore dhe nënligjore, si më poshtë:

3.2.3.1. Rregullore për menaxhimin e rrezikut operacional të siguresve

Rregullorja për menaxhimin e rrezikut operacional të siguresve, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 30 janar 2025, përcakton parimet dhe kërkesat për identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e rrezikut operacional nga siguresit e licencuar nga BQK, duke kërkuar ngritjen e një sistemi gjithëpërfshirës të menaxhimit të rrezikut në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e aktivitetit të tyre, si dhe përcaktimin e qartë të përgjegjësisë të organeve drejtuese dhe funksioneve të kontrollit.

Rregullorja obligon siguresit për raportim të rregullt dhe të menjëhershëm të ngjarjeve materiale, përfshirë humbjet mbi 10,000 euro, krimet financiare, humbjen e të dhënave, ndërprerjet operacionale dhe ngjarje të tjera të rëndësishme, si dhe kërkon funksionim të kontrolleve të brendshme, auditim të vazhdueshëm dhe plane të vazhdimësisë së biznesit, me afat përputhshmërie deri më 30 prill 2025.

3.2.3.2. Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për zbatimin e sistemit bonus-malus

Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për zbatimin e sistemit Bonus-Malus, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 25 qershor 2025, përditëson kornizën ekzistuese të vitit 2020, duke ndërhyrë në nenin 4 përmes shfuqizimit të paragrafëve 6–10, me qëllim thjeshtimin dhe harmonizimin e sistemit me praktikatat aktuale mbikëqyrëse të BQK-së në sektorin e sigurimeve.

Rregullorja nuk ndryshon dispozitat tjera të rregullores bazë, të cilat mbeten në fuqi, dhe konsiderohet pjesë përbërëse e saj duke zëvendësuar vetëm dispozitat e shfuqizuara. Ajo ka hyrë në fuqi më 4 gusht 2025 dhe synon përshtatjen graduale të industrisë së sigurimeve me ndryshimet e reja.

Rregullorja e re për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për zbatimin e sistemit Bonus-Malus synon të përditësojë dhe harmonizojë kornizën ekzistuese të vendosur në vitin 2020, duke bërë ndërhyrje të drejtpërdrejta në nenin 4 të rregullores bazë.

Rregullorja e re nuk prek dispozitat tjera të rregullores bazë, të cilat mbeten në fuqi në formën e tyre të plotë, duke ruajtur strukturën dhe parimet themelore të sistemit Bonus-Malus. Ajo lexohet dhe interpretohet si pjesë përbërëse e rregullores së vitit 2020, duke zëvendësuar vetëm pjesët e shfuqizuara. Rregullorja ka hyrë në fuqi më 4 gusht 2025, duke i dhënë industrisë së sigurimeve një periudhë të mjaftueshme tranzitore për të përshtatur proceset e brendshme dhe sistemet teknike me ndryshimet e miratuara.

3.2.3.2. Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për llogaritjen e kufirit minimal të aftësisë paguese, adekuatshmërisë së kapitalit dhe fondit garantues për siguresit jo-jetë

Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për llogaritjen e kufirit minimal të aftësisë paguese, adekuatshmërisë së kapitalit dhe fondit garantues për siguresit jo-jetë, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 27 mars 2025, përditëson kornizën e vitit 2019 duke saktësuar trajtimin rregullator të asetëve dhe përkufizimin e “pasurive të riposeduara”, si dhe kushtet për zbritjen e tyre nga kapitali rregullator.

Rregullorja përcakton zbritje graduale të pasurive të riposeduara (25% pas 3 muajsh deri në 100% pas 12 muajsh për pasuri të paluajtshme dhe deri në 100% pas 6 muajsh për pasuri të luajtshme), si dhe kufizim për “pronat investuese” kur tejkalojnë 15% të kapitalit bazë ose pa miratim të BQK-së. Ajo ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2025 dhe parasheh periudhë përshtatjeje deri më 31 mars 2026.

3.2.3.3. Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm të Siguruesve

Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm të siguruesve, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 28 shkurt 2025, përditëson dhe forcon kornizën e vitit 2016, duke rritur kërkesat profesionale dhe teknike për funksionin e auditimit të brendshëm dhe duke përcaktuar kritere më të qarta për kualifikimet, kompetencën dhe integritetin e personelit, veçanërisht të udhëheqësit të auditimit të brendshëm.

Rregullorja ruan dispozitat e tjera të rregullores bazë, përveç ndryshimeve të përcaktuara, dhe parasheh periudhë tranzitore njëvjeçare për përshtatje. Ajo ka hyrë në fuqi më 1 mars 2025 dhe konsiderohet pjesë integrale e rregullores bazë për kontrollin dhe auditimin e brendshëm të siguruesve.

3.2.3.4. Aktet nënligjore në proces të draftimit për siguruesit

Gjatë vitit 2025, ka vazhduar aktiviteti i draftimit të rregulloreve në fushën e sigurimeve lidhur me qeverisjen korporative të siguruesve, licencimin e siguruesëve dhe degëve të siguruesve të jashtëm dhe akte tjera të nevojshme për sektorin.

3.2.4 Korniza Rregullative për Fondet Pensionale

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës ligjore dhe rregullative të fondeve pensionale gjatë vitit 2025 janë hartuar aktet nënligjore, si në vijim:

3.2.4.1. Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm për Fondet Pensionale

Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm për fondet pensionale, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 28 shkurt 2025, përditëson kornizën e vitit 2017, duke rritur kërkesat profesionale për udhëheqësin e auditimit të brendshëm, përfshirë kualifikimet, certifikimin dhe integritetin etik në nivel të menaxherëve të lartë.

Rregullorja ruan dispozitat e tjera të rregullores bazë, me periudhë tranzitore njëvjeçare për përshtatje. Ajo ka hyrë në fuqi më 1 mars 2025 dhe forcon cilësinë e auditimit të brendshëm në fondet pensionale.

3.2.4.2 Aktet nënligjore në proces të draftimit

Gjatë vitit 2025, ka vazhduar aktiviteti i draftimit të rregulloreve në fushën e pensioneve lidhur me Qeverisjen Korporative të Fondeve Pensionale dhe akte tjera të nevojshme.

3.2.5 Korniza rregullative për Institucionet mikrofinanciare dhe jobankare

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për rregullimin e institucioneve mikrofinanciare dhe jo bankare, gjatë vitit 2025 janë hartuar draft aktet ligjore dhe nënligjore si më poshtë.

3.2.5.1. Rregullore për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për kontrollet e brendshme dhe funksionimin e auditimit të brendshëm të institucioneve mikrofinanciare (IMF)

Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm të institucioneve mikrofinanciare, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore nga Bordi i Bankës Qendrore më 28 shkurt 2025, përditëson kornizën e vitit 2013 duke rritur kërkesat profesionale për udhëheqësin e auditimit të brendshëm, përfshirë certifikimin, përvojën dhe integritetin etik në përputhje me rregulloren për regjistrimin e IMF-ve.

Rregullorja ruan dispozitat e tjera të rregullores bazë dhe parasheh periudhë tranzitore dyvjeçare për përputhje të plotë. Ajo ka hyrë në fuqi më 1 mars 2025 dhe synon forcimin e pavarësisë, cilësisë dhe mbikëqyrjes së funksionit të auditimit të brendshëm në IMF.

3.2.5.2. Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Kontrollet e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm të Institucioneve Financiare Jobankare

Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm të institucioneve financiare jobankare, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore nga Bordi i Bankës Qendrore më 28 shkurt 2025, përditëson kornizën e vitit 2018 duke forcuar

kërkesat e pavarësisë dhe standardet profesionale për udhëheqësin e auditimit të brendshëm, përfshirë certifikimin, përvojën dhe reputacionin etik në përputhje me rregulloren për regjistrimin e IFJB-ve.

Rregullorja ruan dispozitat e tjera të rregullores bazë dhe parasheh periudhë tranzitore dyvjeçare për përputhje të plotë. Ajo ka hyrë në fuqi më 1 mars 2025 dhe synon rritjen e profesionalizmit, cilësisë dhe pavarësisë së funksionit të auditimit të brendshëm në IFJB.

3.2.5.3. Aktet nënligjore në proces të draftimit për Institucionet mikrofinanciare dhe jobankare

Gjatë vitit 2025, ka vazhduar aktiviteti i draftimit të rregulloreve në fushën e institucioneve mikrofinanciare dhe jobankare që lidhen me qeverisjen korporative, menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, dhe rregulloreve tjera relevante për sektorin e institucioneve mikrofinanciare dhe jobankare.

3.2.6 Korniza Rregullative për Kripto-Asete

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-295 për Kripto-Asete, BQK, në zbatim të këtij ligji ka miratuar Rregulloren për Licencimin e Operatorëve të Shërbimeve të Kripto-Aseteve që ofrojnë shërbimin e Këmbimit të Kripto-Aseteve, dhe ka vazhduar aktivitetet për hartimin e akteve tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji.

3.2.6.1. Rregullore për Licencimin e Operatorëve të Shërbimeve të Kripto-Aseteve që ofrojnë shërbimin e Këmbimit të Kripto-Aseteve

Rregullorja për Licencimin e Operatorëve të Shërbimeve të Kripto-Aseteve, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 29 gusht 2025, përcakton kushtet, procedurat dhe afatet për licencimin e operatorëve që ofrojnë shërbime të këmbimit të kripto-aseteve për para fiat (përfshirë ATM/bankomatë) dhe anasjelltas, si dhe këmbimin kripto-aset me kripto-aset, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-295 për Kripto-Asetet.

Rregullorja rregullon gjithashtu kërkesat për aplikim dhe informacion, miratimet paraprake të BQK-së, obligimet e raportimit dhe organizimin e brendshëm të operatorëve, duke u zbatuar për subjektet që aplikojnë ose janë të licencuara për këto veprimtari në Republikën e Kosovës. Ajo ka hyrë në fuqi 90 ditë pas miratimit nga BQK.

Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 gusht 2025, miratoi këtë rregullore, e cila ka për qëllim të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet kohore që duhen zbatuar për licencimin e operatorëve të shërbimeve të kripto-aseteve që ushtrojnë veprimtarinë si në vijim:

- këmbimit të kripto-aseteve për para fiat (përfshirë kripto ATM apo bankomatëve të kripto-valutave;) dhe anasjelltas, me bazë fizike (zyrë), ashtu siç është përcaktuar në nenin 5, paragrafin 1, nënparagrafët 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 08/L-295 për Kripto-Asetet; autorizimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike;
- këmbimit të kripto-aseteve për kripto-asete të tjera, ashtu siç është përcaktuar në nenin 5, paragrafin 1, nënparagrafët 1.2 të Ligjit Nr. 08/L-295 për Kripto-Asetet;
- informacionet që duhet t'i ofrohen Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës me rastin e aplikimit për licencim;
- dhënien e miratimeve paraprake për transaksionet që kërkojnë miratim paraprak nga BQK;
- obligimet e operatorëve të shërbimeve të kripto-aseteve për të njoftuar BQK-në gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre;
- organizimin, menaxhimin dhe funksionimin e operatorëve të shërbimeve të kripto-aseteve.

Kjo Rregullore ka hyrë në fuqi 90 (nëntëdhjetë) ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, dhe e njëjta zbatohet nga për personat juridikë të përcaktuar në Ligjin për Kripto Asete që aplikojnë për licencim, si dhe personat e licencuar sipas kësaj rregullore për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit të krypto-aseteve për para fiat (përfshirë ATM/bankomatët) dhe anasjelltas si dhe/ose me krypto-asete tjera në Republikën e Kosovës.

3.2.7 Aktivitete tjera rregullative

Aktivitete tjera që mund të veçohen gjatë vitit 2025 janë:

Aktivitetet rreth raporteve, pyetësorëve dhe dokumenteve tjera të ndryshme, të pranuar nga Komisioni European, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe organizatat tjera ndërkombëtare;

Analizimi dhe përgatitja e përgjigjeve lidhur me kërkesat për opinione të institucioneve financiare dhe njësisive organizative brenda Mbikëqyrjes Financiare në BQK, sa i përket pajtueshmërisë së veprimeve të institucioneve financiare me kërkesat rregullative; etj.

3.3. Aktiviteti i BQK-së në fushën ligjore dhe të pajtueshmërisë

Gjatë vitit 2025, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka vijuar të ushtrojë mandatin e saj kushtetues dhe ligjor për ruajtjen e stabilitetit financiar, si dhe për rregullimin dhe mbikëqyrjen efektive të institucioneve financiare në vend. Në këtë kuadër, aktiviteti në fushën ligjore dhe të pajtueshmërisë është përqendruar në forcimin dhe konsolidimin e kornizës rregullative, duke siguruar përputhshmëri të plotë me legjislacionin në fuqi dhe me standardet ndërkombëtare relevante.

Në këtë drejtim, BQK ka vijuar me avancimin e kornizës ligjore në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare, duke miratuar dhe zbatuar legjislacionin kyç për zhvillimin e sektorit financiar. Në këtë kontekst, janë hartuar dhe miratuar akte rregullatore sekondare të nevojshme për rregullimin e institucioneve financiare dhe ofrimin e shërbimeve të pagesave, duke siguruar harmonizimin me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe përgatitjen për integrimin e sektorit financiar të Kosovës në tregun financiar të BE-së.

BQK ka miratuar Rregulloren për Licencimin e Operatorëve të Shërbimeve të Kripto-Aseteve që Ofrojnë Shërbimin e Këmbimit të Kripto-Aseteve, si akt nënligjor i nxjerrë në zbatim të Ligjit Nr. 08/L-295 për Kripto-Asetet, duke vendosur kornizën e detajuar rregullative për licencimin, autorizimin dhe mbikëqyrjen e subjekteve që operojnë në këtë fushë dhe ka vazhduar me akte tjera nënligjore në zbatim të ligjit për Kripto-Asete. Gjithashtu, janë miratuar një sërë rregulloresh në funksion të harmonizimit me kornizën ligjore për shërbimet e pagesave, sistemin bankar dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, gjithashtu janë realizuar ndryshime dhe plotësime edhe në disa rregullore ekzistuese.

Përveç kësaj, janë miratuar një sërë rregulloresh që rregullojnë veprimtarinë e sektorit të sigurimeve, fondeve pensionale, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare, me synimin e forcimit të mbikëqyrjes dhe rritjes së qëndrueshmërisë së këtyre segmenteve të tregut financiar.

Së fundmi, ka hyrë në fuqi edhe Ligji Nr. 08/L-304 për Bankat, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në forcimin dhe avancimin e kornizës ligjore të zbatueshme për BQK-në dhe sektorin bankar në vend. Ky ligj përcakton rregullat për themelimin, licencimin, organizimin, qeverisjen dhe mbikëqyrjen e bankave, duke vendosur kërkesa të avancuara prudenciale dhe standarde të qarta për menaxhimin e rreziqeve. Po ashtu, ligji definon kompetencat mbikëqyrëse dhe ndërhyrëse të BQK-së, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar dhe mbrojtjen e depozitorëve.

Në bazë të këtij ligji, BQK është autoriteti përgjegjës për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave, si dhe për nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e tij. Për realizimin e plotë dhe efektiv të dispozitave të ligjit, BQK ka ndërmarrë hapa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve përkatëse, si dhe për përshtatjen e praktikave mbikëqyrëse në përputhje me kërkesat e reja ligjore.

Në kuadër të realizimit të detyrave ligjore, BQK ka ndërmarrë gjithashtu hapa për arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim forcimin e bashkëpunimit rregullator dhe shkëmbimin e përvojave.

Një aspekt tjetër kyç i aktivitetit ligjor ka qenë sigurimi i mbrojtjes efektive të interesave institucionale të BQK-së, përfshirë përfaqësimin në çështje administrative dhe të tjera që kërkojnë mbështetje ligjore. Po ashtu, janë ndërmarrë masa për menaxhimin e riskut ligjor dhe forcimin e mekanizmave të pajtueshmërisë, me synim garantimin e sigurisë juridike dhe integritetit institucional të Bankës.

Ambienti ligjor që lidhet me mandatin dhe objektivat e BQK-së ka pësuar ndryshime të caktuara, të cilat kanë ndikuar ose mund të ndikojnë në fushëveprimin e veprimtarisë së saj. Përkundër mbrojtjes ligjore të paraparë me Ligjin për BQK-në (neni 73), këto zhvillime kanë shtuar kompleksitetin e zbatimit të mandatit të saj, përfshirë ato për Kripto-Asetet dhe ndryshimet në aspekte të përshtatshmërisë së procedurës së përgjithshme administrative. Lidhur me zbatimin e këtyre zhvillimeve ligjore, BQK-ja i ka adresuar si çështje përmes komunikimeve zyrtare ndaj institucioneve kompetente dhe pret të reflektohen në kuadër të proceseve përkatëse institucionale. Në vazhdimësi, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për sigurimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së saj me legjislacionin në fuqi dhe Ligjin për BQK-në. Në përputhje me objektivat e saj strategjike, BQK do të vijojë të avancojë një kornizë rregullative efektive për mbikëqyrjen e sistemit financiar, duke kontribuar në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e tij, si dhe në funksionimin e sigurt të sistemit të pagesave në Kosovë.

4. Sistemi i Pagesave

Operimi me një sistem të pagesave të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase, është një ndër objektivat kryesore të BQK-së. Sistemi i pagesave ndërbankare -KIPS, i zhvilluar, i mbikëqyrur dhe nën administrimin e BQK-së, gjatë vitit 2025 ka siguruar disponueshmëri maksimale, duke garantuar procesimin dhe shlyerjen e pagesave për të gjithë pjesëmarrësit ekonomikë në vend.

Në përmbushje të këtij objekti, BQK ka prioritet funksionin rregullativ, operacional, mbikëqyrës dhe katalizator për ruajtjen e sigurisë të infrastrukturës së pagesave dhe zhvillimit të mëtejshëm të tregut për shërbime të pagesave. Për këtë qëllim, BQK është duke punuar në implementimin e Planit Strategjik 2024-2028, në të cilin një ndër qëllimet kryesore është modernizimi i infrastrukturës së tregut financiar. Përveç kësaj, BQK ka vazhduar punën e saj në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlera të Vogla 2021-2026.

Në kuadër të zhvillimeve në Këshillin Kombëtar të Pagesave (KKP), me 17 qershor 2025, është mbajtur takimi mbi reformat për modernizimin e sistemit kombëtar të pagesave dhe integrimin në SEPA, të cilat pritet të sjellin përfitime të rëndësishme për ekonominë dhe qytetarët. Në këtë takim janë vendosur disa rekomandime kyçe, përfshirë vazhdimin e punës së grupeve teknike për implementimin e sistemit të pagesave të shpejta “TIPS clone”, si dhe avancimin e funksioneve të sistemit ndërbankare të pagesave KIPS, përgatitjen ligjore dhe teknike për aplikimet në SEPA, si dhe formimin e Grupit Punues ndërinstitucional për implementimin e Bankimit të Hapur.

Në rrjedhën e përgatitjeve për aderim në Zonën e Pagesave “SEPA”, pas shqyrtimit dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur Ligjin për Shërbimet e Pagesave (LSHP) dhe Ligjit për Amandamentimin e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit (LAML) me miratuar nga Kuvendi i Kosovës të datës 5 dhjetor 2024, është ri-proceduar Ligji për Shërbimet e Pagesave (LSHP) dhe janë adaptuar ndryshimet e nevojshme në Ligjin për Amandamentimin e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit (LAML), bazuar në komentet e pranuar gjatë procesit të para-aplikimit. Të dy këto ligje janë proceduar tutje, duke i kthyer në ri-procedim. Ligji për Shërbimet e Pagesave veç është miratuar në kuvend the ka hyrë në fuqi, përderisa Ligji për amandamentimin e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ka hyrë në procedurë të shqyrtimit final për miratim. Të dy këto ligje së bashku me aktet nënligjore që rrjedhin nga të njëjtat, synojnë përmbushjen e kriterëve të nevojshme për aplikim dhe anëtarësim në SEPA, si dhe krijimin e bazës ligjore dhe teknike për ndër lidhjen e infrastrukturës kombëtare me atë të Bashkimit Evropian. Kjo nismë zhvillohet në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së, duke shërbyer si parakusht për transpozimin e direktivave dhe rregulloreve përkatëse të BE-së që lidhen me lëvizjen e lirë të kapitalit dhe ofrimin e shërbimeve financiare.


4.1. Operimi i Sistemit të Pagesave Ndërbankare

Sistemi i Pagesave Ndërbankare të Kosovës-KIPS, sistem i rëndësisë sistemike, i cili mundëson procesimin e një sërë instrumentesh të pagesave, kliringun ndërbankar, si dhe shlyerjen e letrave me vlerë, ka vazhduar funksionimin normal dhe pa pengesa. Grafikët në vijim, paraqesin numrin dhe vlerën e transaksioneve të kryera përmes këtij sistemi për periudhat përkatëse.

Treguesit statistikor të aktiviteteve në KIPS gjatë vitit 2025, kanë shënuar rritje të theksuar të transaksioneve në vëllim për 5.1 përqind, si dhe në vlerë për 7.0 përqind, në krahasim me vitin paraprak, ku janë procesuar mbi 21.9 milionë transaksione me vlerë totale mbi 27.1 miliardë euro (shih grafikët 53 dhe 54).


Përmes sistemit KIPS, realizohen pagesat e dy komponentëve RTGS (Real-Time Gross Settlement) dhe ACH (Automated Clearing House). Në komponentën RTGS realizohen në kohë reale të gjitha pagesat me vlerë mbi 10 mijë euro, si dhe pagesat të urdhëruara me prioritet nga ana e klientëve. Ndërsa, në komponentin ACH realizohen të gjitha pagesat me vlerë nën 10 mijë euro ku përfshihen pagesat e rregullta-normale, pagesat masive, pagat dhe pensionet, pagesat Kos-Giro, dhe Debitimi

Grafik 53. Numri i transaksioneve në KIPS



Burimi: BQK (2026)


Grafik 54. Vlera e transaksioneve në KIPS (në mijëra)



Burimi: BQK (2026)


Direkt. Krahasimi i trendëve rritës të vëllimit dhe vlerës së këtyre kategorive të pagesave për vitet e caktuara, është paraqitur në grafikët në vijim.

Grafik 55. Vëllimi vjetor i transaksioneve të KIPS-it sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2026)

Grafik 56. Vlera vjetore e transaksioneve të KIPS-it sipas llojeve të tyre (në mijëra)




Burimi: BQK (2026)

Gjatë vitit 2025, pagesat e rregullta (normale dhe masive) përbënin rreth 48.3 përqind të vëllimit dhe 19.6 përqind të vlerës së transaksioneve të KIPS (shih grafikun 55). Transaksionet RTGS procedohen dhe shlyhen gjatë orarit të punës në kohë reale dhe në baza bruto. Gjatë vitit 2025, numri i tyre përbënte rreth 3.6 përqind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve në KIPS (shih grafikun 55), ndërsa, vlera e tyre rreth 43.1 përqind të vlerës së transaksioneve përmes KIPS (shih grafikun 56).


Në kategorinë e pagesave për paga/pensione është shënuar rritje, si në numër ashtu edhe në vlerë të transaksioneve. Në krahasim me vitin paraprak rritja në numër është 3.1 përqind, ndërsa në vlerë të transaksioneve 16.1 përqind. Krahas rritjes në vëllim dhe në vlerë të transaksioneve në krahasim me vitin paraprak, vërehet gjithashtu një rritje e mesatares ditore të transaksioneve të procesuara, si në vëllim ashtu edhe në vlerë, prej 5.5 përqind respektivisht 7.4 përqind (shih grafikët 57 dhe 58).

Grafik 57. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në KIPS



Burimi: BQK (2026)


Grafik 58. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në KIPS



Burimi: BQK (2026)

Gjatë vitit 2025, pasqyrimi i pagesave të procesuara përmes komponentës ACH, sipas sesioneve, tregon një përqendrim më të theksuar në sesionin e parë dhe të dytë të kliringut, krahasuar me sesionin e fundit. Shmangia e mbingarkesave në flukset e pagesave përgjatë sesionit të fundit të kliringut minimizon rreziqet shtesë në kuadër të funksionimit të sistemit të pagesave, prandaj, aplikohen tarifa më të ulëta për transaksionet e procesuara në dy sesionet e para (shih grafikët 59 dhe 60).


Grafik 59. Numri i transaksioneve sipas sesioneve në KIPS



■ Sesioni i I-rë ■ Sesioni i II-të ■ Sesioni i III-të ■ Sesion shtesë

Burimi: BQK (2026)

Grafik 60. Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në KIPS



■ Sesioni i I-rë ■ Sesioni i II-të ■ Sesioni i III-të ■ Sesion shtesë

Burimi: BQK (2026)

Vlera e përgjithshme e transaksioneve të shlyera në KIPS gjatë vitit 2025 ka qenë afër 27.1 miliardë euro, ku janë përfshirë transaksionet e të gjithë pjesëmarrësve në KIPS, Bankat dhe Thesari.

Nga vëllimi dhe vlera e transaksioneve të iniciuara nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse në sistem, tre pjesëmarrësit me numrin më të madh të transfereve të iniciuara zënë 58.97 përqind të vëllimit të përgjithshëm, ndërsa të gjithë pjesëmarrësit tjerë zënë 41.03 përqind. Ndërsa, sa i përket vlerës të transfereve të iniciuara nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse, nga vlera e përgjithshme e tyre prej 27.1 miliard transaksione, tri institucionet e para pjesëmarrëse në sistem me vlerën më të madhe të transfereve të iniciuara zënë 41.5 përqind të vlerës të përgjithshëm, ndërsa, të gjitha institucionet tjera zënë 58.5 përqind (shih tabelën 21).

Tabela 21. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në KIPS

Sistemi KIPS	Vëllimi	Vlera
3 pjesëmarrës në sistem	59.00%	41.50%
pjesëmarrës të tjerë	41.00%	58.50%
Gjithsejt	21,989,756	27,154,104,781

Burimi: BQK (2026)


Raporti i vlerës së Huasë brenda-ditore për likuiditet ndaj vlerës totale të aktivitetit të sistemit RTGS për vitin 2025 rezulton rreth 5.1 përqind (shih grafikun 61), duke reflektuar një peshë të ulët të nevojës së financimit të aktivitetit të këtij sistemi me likuiditet nga BQK, rrjedhimisht, të ekspozimit të sistemit ndaj rrezikut të likuiditetit.

4.2. Regjistri i Llogarive Bankare

Në kuadër të funksioneve operacionale të BQK-së, rol të rëndësishëm zë edhe Regjistri i Llogarive Bankare. Ky regjistër përfaqëson një infrastrukturë të bazës së të dhënave, e cila mundëson raportimin e të dhënave për llogaritë bankare nga ofruesit e të dhënave të llogarive (bankat komerciale), si dhe shfrytëzimin e këtyre të dhënave në funksion të zbatimit të vendimeve përmbarimore nga organet e përmbarimit dhe institucionet tjera kompetente sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Ky regjistër ka pasur ndikim të rëndësishëm në rritjen e efikasitetit në procedimin e lëndëve përmbarimore nga organet e procedurës përmbarimore, sidomos pas zgjerimit të funksioneve për mundësimin e procedimit elektronik të vendimeve përmbarimore.

Në regjistër gjatë vitit raportues 2025, kanë pasur qasje 50 përmbarues privatë, 124 zyrtarë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si dhe 18 zyrtarë nga Administrata Tatimore e Kosovës, përmes të cilit kanë shkëmbyer me bankat komerciale 24,244 raste të procedurës përmbarimore, prej të cilave 18,713 janë mbyllur (shih tabelën 22).

Grafik 61. Raporti i kredisë brenda ditore ndaj totalit së vlerës së shlyer ne RTGS



Burimi: BQK (2026)

Tabela 22. Rastet e procesuara në Regjistrin e Llogarive Bankare

Statusi i rasteve	2024	2025	Në ngritje/Në rënje (%)
Të hapura	24,598	24,244	-1.44%
Të mbyllura	20,719	18,713	-9.68%

Burimi: BQK (2026)

Përveç tjerave, gjatë vitit 2025, në Regjistrin e Llogarive janë shtuar edhe funksione shtesë të cilat kanë mundësuar pjesëmarrjen dhe raportimin në këtë regjistër edhe të ofruesve të shërbimeve të pagesave jo-banka, si dhe funksioneve për ndërlidhjen e regjistrit me institucionet tjera kërkuese.

4.3. Mbikëqyrja dhe analizat e sistemeve të pagesave

Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave dhe shlyerjeve është një funksion i rëndësishëm i BQK-së, ku objektivat e sigurisë dhe efikasitetit promovohen duke monitoruar sistemet ekzistuese dhe të planifikuara, duke i vlerësuar ato kundrejt objektivave dhe sipas nevojës duke nxitur ndryshime.

Në funksion të mbikëqyrjes dhe zhvillimit të analizave të sistemeve të pagesave, gjatë vitit 2025 BQK ka vazhduar monitorimin e sistemit të pagesave përmes raporteve nga metodologjia e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave, por gjithashtu ka grumbulluar dhe publikuar raporte dhe analiza të rëndësishme mbi përdorimin e instrumenteve të shërbimeve të pagesave.

Në kuadër të përbushjes së objektivave strategjike të BQK-së për forcimin e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit financiar, ndër prioritetet kryesore mbetet avancimi i kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse, me qëllim identifikimin dhe adresimin në kohë të rreziqeve që përballen institucionet financiare, në funksion të ruajtjes të stabilitetit të sistemit financiar. Për këtë qëllim në funksion të përbushjes së kërkesave dhe këtyre zhvillimeve, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, në koordinim me departamentet tjera të ndërlidhura dhe në mbështetje teknike nga Banka Botërore, ka rishikuar Politikën për Mbikëqyrje të Sistemit Kombëtar të Pagesave, me që rast janë adaptuar praktikat më të mira ndërkombëtare lidhur me monitorimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave.


Në kuadër të analizave mbi përdorimin e instrumenteve të shërbimeve të pagesave, këtë vit është rishikuar analiza vjetore për përdorimin e kartelave në Kosovë. Kjo analizë, nxjerr të dhëna mbi shpërndarjen socio-demografike të kartelave të përdorura nga qytetarët e Kosovës dhe faktorët përkatës që kanë ndikuar në shpërndarjen e tillë. Gjithashtu, analiza pasqyron informacione për llojet e kartelave dhe përdorimin e kartelave në terminale të ndryshme, përfshirë ato online. Analiza vjetore publikohet në baza të rregullta vjetore në faqen zyrtare të BQK-së.

Në kuadër të përgatitjes së analizave dhe raporteve periodike për statistikën e pagesave janë përgatitur dhe publikuar edhe raportet e rregullta vjetore dhe mujore lidhur me numrin dhe vlerën e pagesave ndërbankare, depozitat e bankave komerciale dhe rezervat, instrumentet me para të gatshme dhe jo me para të gatshme, si dhe raporti krahasues mbi instrumentet e pagesave elektronike (Kosova në krahasim me vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore) të cilat publikohen në baza të rregullta në faqen zyrtare të internetit në BQK.

4.4. Instrumentet e pagesave dhe infrastruktura bankare për shërbime të pagesave


Raportimet e institucioneve financiare për instrumente të pagesave, tregojnë se deri në fund të dhjetorit të vitit 2025 numri i kartelave të debitit arriti afër 1.9 milionë, ndërsa, numri i kartelave të kreditit arriti në rreth 218 mijë. Krahasuar me një vit më parë, numri i kartelave të debitit është rritur për 33.7 përqind, ndërsa, numri i kartelave të kreditit është rritur për 12.1 përqind (shih grafikët 62 dhe 63).

Grafik 62. Numri i kartelave të debitit sipas llojit



Burimi: BQK (2026)


Grafik 63. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit



Burimi: BQK (2026)


Infrastruktura e terminaleve ka vazhduar të zgjerohet, ku evidentohet rritje e lehtë e numrit të bankomatëve/ATM gjatë këtij viti në krahasim me vitin paraprak (shih grafikun 64), si dhe një rritje e theksuar e numrit të terminaleve në pikat e shitjes/POS (shih grafikun 65).

Grafik 64. Numri i terminaleve ATM



Burimi: BQK (2026)

Grafik 65. Numri i terminaleve POS




Burimi: BQK (2026)

Rritja e pagesave elektronike përgjatë viteve reflektohet edhe në mënyrën e realizimit të transfereve të kreditit. Transferet në formë letre vazhdimisht janë në rënie kundrejt atyre në formë elektronike. Gjatë vitit 2025, transferet e iniciuara në formë letre përbënin 11.7 përqind, ndërsa ato në formë elektronike përbënin 88.3 përqind të gjithsej transfereve të iniciuara nëpërmjet bankave (shih Grafikun 66).

Krahas rritjes së numrit të terminaleve dhe instrumenteve të pagesave, në vitin 2025, nga të dhënat statistikore vërehet se ka pasur rritje të përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike. Numri i pagesave të kryera përmes shërbimit të internetit/e-banking arriti në mbi 13.4 milionë transaksione, që krahasuar me vitin paraprak paraqet rritje për 18.7 përqind, me një vlerë që arriti në mbi 27.7 miliardë euro apo një rritje vjetore prej 11.28 përqind (shih grafikët 67 dhe 68).

Grafik 66. Numri i transfereve të kreditit në formë elektronike në raport me transferet formë letër




Burimi: BQK (2026)

Viti 2025 u karakterizua me një trend në rritje të përdorimit të pagesave me kartelë. Numri i pagesave në pikat e shitjeve/POS është rritur për 33.4 përqind, ndërsa në vlerë është evidentuar rritje krahasuar me vitin paraprak për 29.8 përqind. Tërheqjet në bankomate/ATM gjithashtu


tregojnë rritje në numër dhe vlerë krahasuar me vitin paraprak, megjithëse në nivele më të ulëta në krahasim me pagesat me kartelë, ku numri i tërheqjeve në bankomate/ATM është rritur për 6.6 përqind, ndërsa në vlerë për 7.8 përqind (shih Grafikët 67 dhe 68).

Grafik 67. Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2026)

Grafik 68. Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2026)

Nga raportimet e institucioneve financiare rezulton se në fund të vitit 2025, numri i përgjithshëm i llogarive bankare të klientëve arriti rreth 2.72 milionë, që paraqet një rritje prej 7.5 përqind krahasuar me fundin e vitit 2024. Rreth 98.1 përqind e llogarive janë të rezidentëve, ndërsa rreth 1.9 përqind të jorezidentëve (shih tabelën 23).

Tabela 23. Numri i llogarive

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive të klientëve			Të aksesueshme nga interneti		
	2022	2023	2025	2022	2023	2025
Llogaritë e Klientëve (1+2)	2,512,575	2,539,345	2,729,820	851,645	1,030,357	1,225,962
1-Llogari të rezidentëve (a+b)(%)	98.53%	98.34%	98.11%	98.21%	97.93%	97.68%
a-Indivuale (%)	91.10%	92.34%	92.06%	90.31%	90.83%	90.84%
b-afariste (%)	7.43%	7.66%	7.94%	9.69%	9.17%	9.16%
2-Llogari të jorezidentëve (c+d) (%)	1.45%	1.66%	1.89%	1.79%	2.07%	2.32%
c-Indivuale (%)	99.20%	99.35%	99.48%	84.80%	81.27%	80.92%
d-afariste (%)	0.80%	0.65%	0.52%	15.20%	18.73%	19.08%


Burimi: BQK (2026) Shënim: BQK, Raportimet e bankave sipas "Rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve.

Nga totali i llogarive, në fund të vitit 2025, mbi 1 milion llogari kishin qasje "online" nga interneti, që është një rritje prej 19 përqind e qasjes në llogari nga distanca.

Grafiku 69 tregon pjesëmarrjen e llogarive me qasje në internet, në numrin e përgjithshëm të llogarive rrjedhëse gjatë viteve të fundit. Bazuar në të dhënat statistikore, zhvillimi i infrastrukturës ka vazhduar trendin rritës dhe inkurajues mbetet edhe trendi i shpejtë i rritjes së përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike.

IFJB-të të regjistruara për emetimin e parasë elektronike, në fund të vitit 2025 kanë raportuar 122,546 llogari të parasë elektronike, duke shënuar një rritje të shpejtë bazuar në faktin se ky është vetëm viti i pestë i operimit të tyre në treg (shih tabelën 24). Këto institucione së bashku kanë kryer një volum prej 2.4 milion pagesa me para elektronike, me një vlerë prej rreth 1.1 miliard euro (tabela 24).

Grafik 69. Numri i llogarive me qasje në internet në raport me numrin e përgjithshëm të llogarive



Burimi: BQK (2026)

Tabela 24. Numri i llogarive të parasë elektronike

Përshkrimi i llogarisë	2023	2024	2025
Llogaritë e parave elektronike (E-money accounts)	45,310	79,706	122,546

Burimi: BQK (2026)

Nxitja e përdorimit të instrumenteve të parasë elektronike vlerësohet me ndikim edhe në zgjerimin e përfshirjes financiare të qytetarëve duke mundësuar qasjen në shërbimet e pagesave (hapjen e një llogarie paraje elektronike/llogarie pagese, dhe zotërimin e një karteje me parapagim) nga kategori të popullsisë pa qasje në shërbime bankare, si për kategoritë që nuk janë të punësuar. Realizimi i transaksioneve elektronike konsiderohet edhe si dritarja kryesore që mund t'u lehtësojë edhe qasjen në kursime, kredi, sigurime dhe shërbime tjera financiare.

Tabela 25. Numri dhe vlera pagesave të parave elektronike

Përshkrimi	2023	2024	2025
Numri	1,620,139	2,188,448	2,458,548
Vlera	617,969,808	860,437,319	1,110,451,750

Burimi: BQK (2026)

Rritja e pagesave elektronike reflekton një ndryshim të dukshëm në sjelljen e konsumatorëve, të cilët po orientohen drejt metodave më të shpejta, më të sigurta dhe më praktike të pagesës. Lansimi edhe i Apple Pay gjatë vitit 2025, pas përfshirjes së Kosovës në Google Pay në vitin paraprak, për realizimin e të cilave u angazhuan BQK, së bashku me bankat dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar, ka forcuar më tej infrastrukturën digjitale në vend dhe ka përshpejtuar tranzicionin drejt një ekonomie më moderne dhe më pak të varur nga paraja e gatshme. Numri i pagesave të realizuara përmes kuletës digjitale ka arritur në 1.8 milion ndërsa vlera totale e tyre ka shënuar 34.3 milion, duke dëshmuar rritjen e konsiderueshme të përdorimit dhe besimit të qytetarëve në këto forma moderne të pagesës.

4.5. Roli i BQK-së si katalizator i sistemit të pagesave

BQK-ja, si një aktor kyç në sistemin e pagesave, ka demonstruar përkushtim të palëkundur për modernizimin dhe zgjerimin e tregut të pagesave. Ky angazhim dëshmohet nga zbatimi i iniciativave të shumta që synojnë përmirësimin dhe reformimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të pagesave.

Gjatë vitit 2025, BQK organizoi takimin e Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP), ku u vlerësua progresi në modernizimin e sistemit të pagesave në Republikën e Kosovës. Takimi i 17 qershorit evidentoi avancime të rëndësishme në digjitalizimin e pagesave, përmirësimin e infrastrukturës kombëtare, harmonizimin me standardet e BE-së dhe përgatitjet për integrim në SEPA. Këto zhvillime konfirmuan rritjen e përfshirjes financiare dhe forcimin e konkurrencës në treg, duke reflektuar rezultate të prekshme të reformave institucionale.

Një ndër momentet kryesore të takimit ishte themelimi i Grupit Punues për Bankimin e Hapur, hap që shënon fillimin e zhvillimit të ekosistemit të Open Banking në Kosovë. Po ashtu, u riafirmua angazhimi për reduktimin e përdorimit të parasë së gatshme dhe promovimin e pagesave elektronike, në koordinim me të gjitha institucionet relevante, përfshirë sektorin publik dhe atë privat, si dhe me partnerët ndërkombëtarë. Angazhimi për modernizimin e infrastrukturës së pagesave është duke vazhduar me projektet për implementimin e sistemit të pagesave të shpejta (TIPS Clone), ngritjen e funksioneve të sistemit KIPS, si dhe iniciativave për zhvillimin e mekanizmave dhe shërbimeve mbështetëse (overlay and value added services), të njohura si; QR Code, Request to Pay, Proxy ID, Fraud Management dhe Verification of Payee.

Zbatimi i Ligjit për Shërbimet e Pagesave dhe përgatitjet për anëtarësim në SEPA përbënin një tjetër shtyllë të diskutimeve. U theksua rëndësia e përsheptimit të akteve nënligjore, përzgjedhjes së operatorëve për procesimin e pagesave dhe rishikimit të tarifave në zonën e pagesave në SEPA. U paralajmërua gjithashtu përgatitja e akteve të reja për qasjen e IFJB-ve në sistemin e pagesave dhe përmirësimi i proceseve për njohjen e klientit “KYC”.

Gjatë takimit, rezultatet strategjike të deritanishme u vlerësuan pozitive, me tejkalimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël 2021–2026. Përfshirja financiare arriti në 73%, ndërsa numri i pagesave jo-cash për banor u rrit në 49, duke dëshmuar progres të qëndrueshëm drejt formalizimit të ekonomisë dhe zgjerimit të përdorimit të instrumenteve digjitale. Këto arritje konfirmuan se reformat janë duke dhënë rezultate konkrete dhe të matshme në nivel kombëtar.

Për periudhën 2025–2026, KKP rekomandoi intensifikimin e koordinimit institucional për implementimin e sistemit të pagesave të shpejta TIPS Clone dhe procesin e integritimit në SEPA, si dhe rritjen e investimeve në infrastrukturën teknike dhe cilësinë e të dhënave. U theksua nevoja për forcimin e edukimit financiar dhe ndërgjegjësimin publik, si dhe vazhdimin e harmonizimit me rregullativat e BE-së. Si përfundim, takimi konfirmoi se sistemi i pagesave në Kosovë po hyn në një fazë vendimtare të reformimit, ku vitet 2026–2027 do të jenë kyçe për finalizimin e projekteve strategjike dhe konsolidimin e ekosistemit të pagesave digjitale në përputhje me standardet evropiane.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në Bashkimin Evropian është vendimi i Bankës Qendrore Evropiane, i cili u mundëson ofruesve të shërbimeve të pagesave qasje të drejtpërdrejtë në sistemet e pagesave dhe në llogaritë e bankës qendrore. Ky vendim synon rritjen e konkurrencës, nxitjen e inovacionit dhe modernizimin e hapësirës evropiane të pagesave. Me këtë rast, në kuadër të përgatitjeve për aplikim në skemat SEPA, rekomandohet plotësimi i kuadrit ligjor vendor me dispozitat përkatëse të Rregullores (BE) 2024/886, e cila plotëson direktivën PSD2 dhe mundëson qasjen e ofruesve të shërbimeve të pagesa jobanka në sistemet e pagesave përmes përcaktimit të kriterëve ligjore dhe teknike për këto institucione.

Në funksion të këtyre zhvillimeve, Departamenti i Sistemit të Pagesave, në bashkëpunim me departamentet relevante dhe me mbështetjen teknike të Bankës Botërore, ka hartuar një kornizë rregullative që synon zgjerimin e qasjes së institucioneve financiare jobankare në sistemin kombëtar të pagesave. Kjo reformë për qasjen e drejtpërdrejtë të ofruesve të shërbimeve të pagesave përbën një hap strategjik drejt modernizimit të tregut të pagesave në Kosovë.

Reforma mbështetet në analizat e Bankës Botërore, zhvillimet e fundit rregullative në BE, si dhe objektivat kombëtare për përfshirje financiare dhe integrim evropian, duke u bazuar në një qasje të kujdesshme dhe të orientuar drejt menaxhimit të rrezikut.

Një zhvillim tjetër me rëndësi të veçantë është rishikimi i Politikës për Mbikëqyrjen e Sistemit Kombëtar të Pagesave (SKP). SKP përbën infrastrukturën bazë për funksionimin e ekonomisë dhe ruajtjen e stabilitetit financiar. Evoluimi i tregut – përfshirë inovacionet teknologjike, rritjen e rolit të ofruesve jo-bankë dhe digjitalizimin e përsheptuar të pagesave – ka krijuar një mjedis më dinamik, por edhe më kompleks, me rreziqe të reja operative, teknologjike dhe sistemike. Në këtë kontekst, është bërë e domosdoshme një politikë e qartë, e strukturuar dhe e harmonizuar e mbikëqyrjes, me qëllim që të garantojë sigurinë, efikasitetin dhe gjithë përfshirjen e SKP-së; të sigurojë një mbikëqyrje proporcionale dhe të bazuar në rrezik nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK); si dhe të harmonizohet me standardet ndërkombëtare, veçanërisht me Parimet për Infrastrukturat e Tregjeve Financiare (PFMI) të Banka për Rregullime Ndërkombëtare (BIS) dhe IOSCO.

Në funksion të përmbushjes së kriterëve për aplikim në SEPA, përfshirë obligimet raportuese që rrjedhin nga direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (PPP/LFT), Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka rishikuar Rregulloren për Regjistrin e Llogarive, e cila do të ofroj mundësinë që në këtë regjistër të raportohen edhe të dhënat mbi kasafortat, si dhe të dhënat mbi persona e autorizuar dhe personat përfitues të llogarive të pagesave që ofrohen nga bankat dhe OSHP-të jo-banka.

4.6. Bashkëpunimi me institucione tjera vendore dhe ndërkombëtare

Në kuadër të projektit për modernizim të sistemeve të pagesave të Ballkanit Perëndimor, nën udhëheqjen e Komisionit Evropian, dhe mbështetje teknike nga ekipi i Bankës Botërore, është ofruar një mbështetje shumë e rëndësishme për finalizimin e Ligjit për Shërbimet e Pagesave, rishikimit të kornizës ligjore për AML/CFT, përgatitjen e akteve nën-ligjore përfshirë këtu rishikimin e Politikës së Mbikqyrjes së Sistemit kombëtar të pagesave, rregulloren për qasjen e ofruesve të shërbimeve të pagesave jo-banka në sistemet e pagesave dhe përgatitjen e dokumenteve të nevojshme për plotësim të kriterëve për aplikim në SEPA, si dhe përzgjedhjen e opcionit për implementim të sistemit të pagesave të shpejta.

Në funksion të përgatitjeve teknike për operacionalizim të pagesave në SEPA, gjatë vitit 2025 BQK ka nënshkruar marrëveshjen me Këshillin Evropian për Pagesa (EPC) për përdorimin e standardeve dhe rregullave teknike të skemave të pagesave në SEPA, si skema për kredit transfere (SCT), skema për Direkt Debit (SDD), si dhe skema për pagesat e shpejta (SCT Inst).

Përveç kësaj, nga Banka Botërore është ofruar edhe mbështetja mbi analizën për pranimin e pagesave elektronike (EPA) në vend, nga ku është në proces zhvillimi i një studimi gjithëpërfshirës për të fituar njohuri më të thella se si individët, bizneset dhe palët e tjera kryesore të interesit në Kosovë po përdorin instrumentet e pagesave elektronike. Ky hulumtim synon të vlerësojë gjendjen aktuale të transaksioneve digjitale, duke shqyrtuar tendencat në adaptim, modelet e përdorimit dhe depërtimin e përgjithshëm të zgjidhjeve të pagesave elektronike brenda ekonomisë. Më konkretisht, studimi synon të identifikojë dhe analizojë faktorët kryesorë që ndikojnë në pranimin e pagesave elektronike, si dhe barrierat që mund të kufizojnë përdorimin e gjerë të tyre. Kjo përfshin eksplorimin e faktorëve të tillë si preferencat e konsumatorëve, gatishmërinë e biznesit, edukimin financiar dhe dixhital, kornizat rregullatore dhe disponueshmërinë e infrastrukturës që mbështet transaksionet elektronike.

Për më tepër, studimi do të vlerësojë sfidat më të gjera me të cilat përballen pjesëmarrës të ndryshëm të tregut, duke përfshirë institucionet financiare, ofruesit e shërbimeve të pagesave, tregtarët dhe konsumatorët. Këto sfida mund të përfshijnë çështje që lidhen me kostot e transaksionit, shqetësimet e sigurisë, ndërveprueshmërinë ndërmjet sistemeve të pagesave dhe aksesin e shërbimeve financiare digjitale, veçanërisht për popullsinë e pashërbyer.

Gjatë këtij viti, përveç komunikimit dhe bashkëpunimit me shtete individuale për çështjet mbi fushat e pagesave, BQK ka marrë pjesë në forumin e Shoqatës Evropiane të Shtëpive të Kliringut të Pagesave-EACHA, të mbajtur në Varshavë të Polonisë.

Pjesëmarrja në këtë forum paraqet një hap të rëndësishëm, duke marrë parasysh projektet dhe reformat në proces lidhur me digjitalizimin e shërbimeve të pagesave. BQK është anëtare në EACHA nga viti 2024 dhe anëtarësimi në këtë mekanizëm ndërkombëtar ofron një mundësi për të mësuar nga përvojat dhe njohuritë e vendeve të tjera mbi infrastrukturën e sistemeve të pagesave në BE dhe zhvillimin e shërbimeve të reja në fushën e pagesave.

Në nivel vendor, përveç tjerave një hapësirë e veçantë iu kushtua gjithashtu edhe rolit të edukimit financiar, në nxitjen e përfshirjes financiare si dhe bashkëpunimit të grupeve punuese në kuadër të funksioneve dhe përgjegjësisë të Këshillit Kombëtar të Pagesave.

5. Edukimi Financiar dhe Mbrojtja e Konsumatorit

5.1. Promovimi i Edukimit Financiar dhe Përfshirjes Financiare

Gjatë vitit 2025, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), përmes Departamentit për Marrëdhënie me Publikun dhe Edukim Financiar (DMPEF), ka zhvilluar një sërë aktivitete me qëllim të kontribuimit në rritjen e nivelit të edukimit financiar në vend dhe avancimin e përfshirjes financiare për kategori të ndryshme të qytetarëve.

Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025, janë fokusuar në:

- informimin dhe rritjen e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e financave personale
- promovimin e kulturës së kursimit dhe planifikimit financiar;
- rritjen e ndërgjegjësimit për përdorimin e produkteve dhe shërbimeve financiare;
- promovimin e sigurisë financiare dhe mbrojtjes nga rreziqet digjitale;
- fuqizimin e përfshirjes financiare për grupet e marginalizuara.

Këto aktivitete janë realizuar përmes formateve të ndryshme edukative si: ligjërata, debate, vizita edukative, publikim dhe shpërndarje të materialeve edukative, konkurse, fushata sensibilizuese dhe projekte ndërinstytucionale.

Ndër aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit përfshihen:

Java Ndërkombëtare e Parasë 2025, (17-21 mars 2025), me temën *“Mendo para se të klikosh, për një siguri financiare nesër”*, u realizuan aktivitetet:

- Hapja e JNP me ceremoninë e ndarjes së shpërblimeve për nxënësit e shkollës fillore - fituesit e konkurseve (5 çmime për videon edukative mbi kursimet) dhe nxënësit e shkollave të mesme (20 punime artistike më të mira në fushën e edukimit financiar), me gjithsej 119 aplikime nga nxënës të shkollave të ndryshme nga gjithë Kosova;
- Fushatë sensibilizuese kundër mashtrimeve online, në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave të Kosovës, dhe të gjitha bankat që operojnë në Kosovë;
- Ligjëratë në Kolegjin UBT mbi rolin e BQK-së në ekonominë e Kosovës, dhe sistemin financiar;
- Aktivitet edukativ dhe informues me nxënësit e Shkollës fillore Model, Prishtinë - ku u njohën me konceptet bazë ekonomike dhe financiare, përfshirë vlerën e parasë, financat personale, ndërtimin e buxhetit, krijimin e shprehisë së kursimit dhe funksionimin e sektorit financiar.
- Debat interaktiv me nxënësit e shkollës së mesme ekonomike “Hoxhë Kadri Prishtina” me temën mbi digjitalizimin e shërbimeve bankare dhe të ardhmen e parasë së gatshme, ku morën pjesë rreth 100 nxënës;
- Java u përmyll me konferencën për lansimin e projektit “WE Finance Code”, një nismë e BQK-së me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Shkollës së Frankfurtit për Financa dhe Menaxhim, e cila synon të mbështesë qasjen në financa për gratë ndërmarrëse. Konferenca mbledhi mbi 110 pjesëmarrës, ndërsa ngjarja u nderua me pjesëmarrjen e Presidentes së Republikës.

- Lansimi i versionit zyrtar të Platformës për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare

Me qëllim rritjen e transparencës, fuqizimin e konsumatorëve dhe promovimin e përfshirjes financiare, BQK lansoj zyrtarisht Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare.

Kjo platformë u mundëson qytetarëve të informohen e krahasojnë në mënyrë të thjeshtë dhe transparente produktet dhe shërbimet financiare të ofruara nga **bankat, institucionet mikrofinanciare, institucionet financiare jobankare dhe kompanitë e sigurimeve** në Kosovë, duke i ndihmuar ata të marrin vendime më të informuara financiare.

Platforma është e qasshme në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze përmes faqes zyrtare të BQK-së dhe ofron një mjet praktik për informim dhe krahasim të produkteve financiare. Për funksionimin e saj, BQK ka zhvilluar edhe kornizën përkatëse rregullative, duke miratuar rregulloren dhe udhëzimin që përcaktojnë mënyrën e raportimit të të dhënave nga institucionet financiare.

- Java e Vetëdijesimit për Qasje në Financa për personat me aftësi të kufizuara –BQK në kuadër të aktiviteteve të edukimit financiar, në bashkëpunim me Forumin Kosovar të Aftësisë së Kufizuar (FKAK), Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe me përkrahje të Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE), ka organizuar fushatën **“Ekonomia për të gjithë”**, e cila shënoi Javën e Vetëdijesimit për Qasje në Financa për personat me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj fushate ishte të promovojë përfshirjen financiare dhe barazinë e qasjes në financa, si dhe të nxisë bashkëpunimin ndërmjet sektorit financiar dhe organizatave që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara, për ndërtimin e një sistemi financiar më gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë qytetarët.

- Aktivitetet përfshinë ligjërata informuese, diskutime mbi përfshirjen financiare dhe shpërndarjen e materialeve edukative, përfshirë libra në alfabetin Braille. Aktivitetet u organizuan në Prishtinë, Gjilan, Gjakovë, Prizren dhe Pejë ku morën pjesë rreth 200 qytetarë.

- Lansimi i Garës SML - gjatë vitit 2025 u lansua gjithashtu gara edukative “Stock Market Learning Competition”, e organizuar nga BQK në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar – Sparkassenstiftung. Kjo iniciativë ka për qëllim avancimin e edukimit financiar dhe thellimin e njohurive mbi tregjet e kapitalit, veçanërisht tek studentët, duke ndërlidhur teorinë me praktikën në fushën e financave dhe investimeve. Përmes simulimit në bursën virtuale të Stuttgart-it, studentët e të gjitha universiteteve dhe kolegjeve të Kosovës do të kenë mundësinë të aplikojnë koncepte teorike në një mjedis praktik dhe konkurrues që pasqyron dinamikat reale të tregjeve financiare. Gara filloi në tetor 2025 dhe zhvillohet për një periudhë katër mujore.

Aktivitete edukative dhe vizita me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme gjatë 2025

Gjatë vitit 2025, BQK ka zhvilluar aktivitete edukative dhe vizita me nxënës dhe studentë nga institucione të ndryshme arsimore, përfshirë Shkollën Finlandeze në Kosovë, SHFMU “Gjergj Fishta” dhe SHFMU “Faik Konica” në Prishtinë, si dhe me studentë të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë dhe të Kolegjit UBT. Përmes këtyre aktiviteteve, nxënësit dhe studentët u njohën me funksionet dhe rolin e BQK-së në ekonominë e vendit dhe funksionimin e sektorit financiar, ndërsa u trajtuan tema të rëndësishme si planifikimi financiar, menaxhimi i buxhetit, rëndësia e kursimeve, zhvillimet në pagesat digjitale, si dhe funksionet rregullatore dhe mbikëqyrëse të BQK-së.

Konkurse dhe Iniciativa për nxitjen e kreativitetit dhe Hulumtimit

Me qëllim të nxitjes së nxënësve dhe studentëve për t'u informuar dhe për të thelluar njohuritë e tyre në fushën e ekonomisë dhe financave, si dhe për të zhvilluar mendimin kritik dhe aftësitë analitike, BQK gjatë vitit 2025 ka shpallur konkurse të ndryshme për nivele të ndryshme arsimore, duke përfshirë nxënës të shkollave fillore, të mesme dhe studentë të universiteteve.

- Konkursi për Punime Artistike
U shpall konkurs për nxënësit e shkollave fillore (klasa VI–IX), me fokus në paraqitjen kreative të koncepteve të kursimit dhe menaxhimit të zgjuar të parasë.
- Konkursi për Videon më të mirë në Fushën e Financave
Nxënësit e shkollave të mesme u inkurajuan të krijojnë video edukative mbi planifikimin financiar, kursimet dhe sigurinë financiare digjitale.
- Çmimi për Ekonomistin e Ri – ku BQK shpall konkurs për studentët e nivelit Bachelor, Master dhe Doktoratë, me qëllim nxitjen dhe promovimin e hulumtimeve shkencore në fushën e ekonomisë dhe financave.
- Çmimi i BQK-së për shkrimin dhe raportimin në gazetari për sektorin financiar 2025 - me qëllim të nxitjes së raportimit korrekt për sistemin financiar, BQK shpallë konkurs për shkrimin dhe raportimin më të mirë për sektorin financiar, të botuar në shtypin e shkruar ose online, si dhe në mediet radio e televizive.

Materiale informuese e edukative - Gjatë vitit 2025, BQK ka publikuar dhe shpërndarë një sërë materialesh edukative me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive financiare të qytetarëve. Këto materiale përfshijnë fletëpalosje informuese si “Chargeback – Si të veproni në rast të një pagese të paautorizuar përmes kartelës suaj”, “Secili cent ka vlerë – rëndësia e menaxhimit të financave personale”, “Pse duhet të kemi kujdes kur i këmbejmë paratë tona” dhe “Të drejtat dhe përgjegjësitë e konsumatorit financiar”, si dhe broshurën informuese “Krahasoni me lehtësi produktet dhe shërbimet financiare”. Gjithashtu, janë publikuar edhe materiale audiovizuale, përfshirë videon për Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare dhe videon edukative “Çka është Bruto Produkti Vendor”.

Gjatë vitit 2025, BQK ka vazhduar të avancojë rolin e saj në promovimin e edukimit dhe përfshirjes financiare në Kosovë. Përmes bashkëpunimeve institucionale, projekteve inovative dhe angazhimit të drejtpërdrejtë me nxënës, studentë dhe kategori të ndryshme të qytetarëve, BQK ka kontribuar në rritjen e kulturës financiare dhe në ndërtimin e një sistemi financiar më të qëndrueshëm, transparent dhe gjithëpërfshirës.

5.2. Mbrojtja e konsumatorit

Në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorit si përgjegjësi e rëndësishme për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), realizohet mbikëqyrja e praktikave të tregut dhe trajtim i ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare.

Në kuadër të mbikëqyrjes së praktikave të tregut gjatë vitit 2025 është avancuar korniza rregullative, ku janë hartuar katër rregullore, përkatësisht dy për sektorin bankar dhe dy për sektorin e sigurimeve. Këto rregullore janë përgatitur në përputhje me kornizën ligjore vendore, direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian dhe 12 Parimet e OECD-së për Mbrojtjen e Konsumatorëve të Shërbimeve Financiare.

Rregulloret e hartuara janë:

1. Rregullore për zhvillimin, shpërndarjen dhe reklamimin e produkteve dhe shërbimeve bankare;

2. Rregullore për Normën Efektive të Interesit për Bankat, e cila është rishikuar duke bërë plotësim/ndryshimet e nevojshme;
3. Rregullore për Zhvillimin, Shpërndarjen dhe Qeverisjen e Produkteve të Sigurimit;
4. Rregullore për Informimin, Reklamimin Kostot dhe Transparencën ndaj Klientëve në Sigurime.

Mbikëqyrja e praktikave të tregut luan një rol të rëndësishëm në promovimin e transparencës, integritetit dhe sjelljes së drejtë të institucioneve financiare ndaj konsumatorëve, duke kontribuar në forcimin e besimit në sistemin financiar dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Kjo kërkon monitorim të vazhdueshëm të zhvillimeve në treg dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet BQK-së dhe institucioneve financiare.

Në funksion të mbikëqyrjes së praktikave të tregut gjatë vitit 2025, përmes monitorimit të reklamave dhe ndryshimeve të çmimoreve të aplikuara nga institucionet financiare, është verifikuar pajtueshmëria e institucioneve financiare me kërkesat rregullative, siç janë Rregullorja për Normën Efektive të Interesit dhe Kërkesat për Shpalosje dhe Rregullorja për Reklamimin e Shërbimeve Financiare.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i mbrojtjes së konsumatorit është edhe trajtimi i ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare, të cilat janë bërë ndaj institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja.

Llojet e ankesave gjatë vitit

Gjatë vitit 2025, në BQK janë pranuar dhe trajtuar gjithsej 1,188 ankesa të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare (persona fizik e juridik). Përkatësisht, ankesat sipas kategorive të institucioneve financiare janë listuar si më poshtë:

- Bankat: Numri i ankesave të trajtuara ndaj bankave ka qenë 632 ankesa, ndërsa ankesat më të shpeshta kanë qenë lidhur me produktet kreditore (kredi), menaxhimin e llogarisë bankare dhe produktin e kartelave debitore dhe kreditore.
- Institucione Mikrofinanciare (IMF): Numri i ankesave të trajtuara ndaj IMF-ve ka qenë 50 ankesa, ndërsa ankesat më të shpeshta kanë qenë lidhur me produktin e kredisë.
- Institucione Financiare Jo Bankare (IFJB): Numri i ankesave të trajtuara ndaj IFJB-ve ka qenë 58 ankesa, ndërsa ankesat më të shpeshta kanë qenë lidhur me produktin e kredisë dhe menaxhimin e shërbimeve digjitale përmes kartelave virtuale.
- Kompanitë e Sigurimeve/Ndërmjetësuesit e Sigurimeve: Numri i ankesave të trajtuara ndaj kompanive të sigurimeve ka qenë 446 ankesa, ndërsa ankesat më të shpeshta kanë qenë lidhur me sigurimin shëndetësor, sigurimin e autopërgjegjesisë (përfshirë sigurimin Kasko) dhe produktin e Letërkredisë/Garancionit.
- Fondet pensionale: Numri i ankesave të trajtuara ndaj fondeve pensione ka qenë vetëm dy ankesa lidhur me pagesën e fazave mujore.

Nga totali i ankesave të pranuar për vitin 2025, 1066 ankesa janë parashtruar nga persona fizikë, ndërsa 122 ankesa nga persona juridikë.

Tabela 26. Numri i ankesave ndër vite

Industria financiare	Numri i ankesave sipas viteve				
	2023	2024	% e ndryshimit	2025	% e ndryshimit
Bankat komerciale	448	537	20%	632	18%
Institucionet Mikrofinanciare	54	37	-31%	50	35%
Institucionet Financiare jo Bankare	27	31	15%	58	87%
Kompanitë e sigurimeve	246	321	30%	446	39%
Ndërmjetësuesit e Sigurimeve	0	1	0%	0	0%
Fondet pensionale	1	0	-100%	2	0%
Gjithsej	792	927	17%	1,188	28%

Burimi: BQK (2026)

Në tabelën e mësipërme vërehet se numri i ankesave të trajtuara në vitin 2025 është rritur në krahasim me dy vitet paraprake. Krahasuar me vitin paraprak, rritja e këtillë pasqyron një rritje të vetëdijesimit të konsumatorëve për të adresuar shqetësimet e tyre, duke shfrytëzuar mekanizma të ndryshëm të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve.

Ankesat sipas kanalit të pranimit

Sa i përket mënyrës së pranimit të ankesave, bazuar në kërkesat e Rregullës së Brendshme për Trajtimin e Ankesave, parashtrimi i ankesave në BQK bëhet kryesisht përmes platformës/sistemit për parashtrimin dhe menaxhimin e ankesave, linku i së cilës është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të BQK-së. Përveç kësaj, ankesat mund të dorëzohen edhe përmes:

- Postës Elektronike, duke e dërguar në adresën e postës elektronike zyrtare të BQK-së,
- Dorëzimi personal në zyrën e arkivit të BQK-së,
- Departamentit të Mbrojtjes e Konsumatorit, për ankesat e referuara sipas marrëveshjes mes BQK-së dhe Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT).

Tabela 27. Numri i ankesave sipas kanalit se pranimit

Kanali i pranimit te ankesave	Numri i ankesave	Pjesëmarrja në %
Sistemi online	998	84.0%
Personalisht në BQK	162	13.6%
MINT	18	1.5%
E-mail	10	0.8%
Gjithsej	1,188	100.0%

Burimi: BQK (2026)

Numri i ankesave sipas statusit

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të trajtuara të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare gjatë vitit 2025, rreth 34% e tyre janë cilësuar si “të bazuara” dhe të njëjtat janë zgjidhur në favor të palëve ankuese. Ndërsa pjesa tjetër e ankesave ka përfshirë ankesat e pabazuara ku përfshihen edhe ankesat e pambështetura me dëshmi shtesë se ankesa është trajtuar fillimisht nga institucioni financiar, për të cilat shfrytëzuesit e shërbimeve financiare janë udhëzuar që fillimisht të shfrytëzojnë të drejtën e ankesës në institucionin financiar, në përputhje me rregullën përkatëse për trajtimin e ankesave.

Tabela 28. Numri i ankesave sipas statusit

Institucionet financiare	Gjithsej ankesa	Të Bazuara	Të Pabazuara
Bankat komerciale	632	44	588
Institucionet Mikrofinanciare	50	2	48
Institucionet Financiare jo Bankare	58	0	58
Kompanitë e sigurimeve	446	111	335
Ndërmjetësuesit e Sigurimeve	0	0	0
Fondet pensionale	2	0	2
Gjithsej ankesa	1,188	157	1,031

Burimi: BQK (2026)

6. Aktivitetet në fushën e Statistikave

Në bazë të nenit 25 të Ligjit për BQK-në, BQK për përmbushjen e objektivave të saj mbledh, përpilon dhe publikon statistika dhe informacione tjera të nevojshme. BQK është prodhuese dhe përdoruese kryesore e statistikave financiare të Republikës së Kosovës dhe një nga burimet kryesore të statistikave në nivel kombëtar. Në kuadër të mandatit ligjor të saj, BQK përpilon dhe publikon statistikat e sektorit monetar, financiar, llogarive financiare dhe sektorit të jashtëm. Përpilimi i këtyre statistikave ndjekë metodologjinë e rekomanduar nga FMN, BQE, BB, Eurostat, dhe praktikat më të mira të vendeve tjera.

Për qëllime të përpilimit të statistikave, subjektet raportuese në BQK, janë personat fizik dhe juridik, përfshirë institucionet financiare (bankat komerciale, fondet pensionale, siguruesit, ndërmjetësit tjerë financiar, dhe ndihmësit financiar), ndërmarrjet në pronësi të huaj, Dogana e Kosovës, institucionet qeveritare, korporatat jofinanciare, ekonomitë familjare dhe organizatat jofitimprurëse. Në pajtim me legjislacionin në fuqi, BQK respekton konfidencialitetin në lidhje me të dhënat individuale që i siguron nga subjektet e ndryshme raportuese, të cilat i përdorë vetëm për qëllime të përpilimit të statistikave. Informatat e siguruar nga raportuesit janë të nevojshme për të përpiluar statistikat monetare dhe financiare, statistikat e sektorit të jashtëm dhe llogarive financiare në kuadër të përgjegjësive ligjore të BQK-së që burojnë nga Ligji nr. 03/L209 për BQK-në dhe Ligji nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Publikimi i statistikave bëhet sipas afatit të publikuar paraprakisht në faqen e internetit të BQK-së, dhe në formate të ndryshme, si: seritë kohore, Buletini Mujor Statistikor, Raporti Vjetor, Faqja Përmbledhëse e të Dhënave Kombëtare, FMN, Eurostat, BB, CEFTA, etj. Statistikat në përgjegjësinë e BQK-së sipas kërkesës, përgatiten dhe shpërndahen për nevoja të njësive organizative brenda BQK-së, si dhe për përdoruesit e jashtëm, si: institucionet qeveritare, mediat, organizata ndërkombëtare, universitetet dhe publiku i gjerë.

Gjatë vitit 2025, BQK ka vijuar përpilimin dhe publikimin e rregullt të statistikave brenda fushëveprimit të saj, në përputhje me kalendarin zyrtar të publikimeve. Statistikat monetare dhe financiare, që mbulojnë nënsektorët e bankës qendrore, bankave komerciale, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, ndërmjetësve dhe ndihmësve financiarë, si dhe statistikat e sektorit të jashtëm, përfshirë bilancin e pagesave, pozicionin e investimeve ndërkombëtare dhe borxhin e jashtëm, janë publikuar rregullisht në faqen e internetit të BQK së dhe në platformat e organizatave ndërkombëtare.

Moduli i statistikave të llogarive financiare ka vazhduar të publikohet në baza tremujore, në seri kohore, për sektorin financiar dhe sektorin e jashtëm. Ndërkohë, tre sektorë të tjerë të ekonomisë mbeten ende të pambuluar, për të cilët siguri i burimeve të të dhënave kërkon bashkëpunim të

mëtejshëm me institucionet relevante në vend. Gjatë vitit 2025 janë realizuar përparime të rëndësishme në zhvillimin e sektorit të qeverisjes së përgjithshme në përputhje me metodologjitë ESA 2010 dhe GFSM 2014, ndërkohë që sektori i ndërmarrjeve jo financiare mbetet një fushë e rëndësishme e fokusit. Për këtë sektor është zhvilluar intensivisht baza e të dhënave për periudhën 2013–2024 për kompanitë më të mëdha.

Në cilësinë e koordinatorit kombëtar, BQK ka vazhduar angazhimet për procesin e abonimit të Kosovës në Special Data Dissemination Standard (SDDS), në bashkëpunim me institucionet vendore përgjegjëse për prodhimin e statistikave ekonomike dhe financiare. Aktualisht Kosova është anëtare e sistemit të GDDS, ndërsa kalimi në SDDS përbën një ngritje të rëndësishme cilësore, pasi kërkon rritje të standardeve të publikimit të të dhënave, zgjerim të mbulimit statistikor, krijimin e Faqes Kombëtare të Përmbledhjes së të Dhënave (NSDP), si dhe forcim të transparencës, besueshmërisë dhe potencialit për investime në vend.

Për të nxitur progresin, gjatë vitit 2025 BQK organizoi një takim online me institucionet vendore dhe FMN në, me qëllim koordinimin e detyrimeve sipas kërkesave të SDDS. BQK ka përbushur të gjitha kërkesat teknike dhe metodologjike të parashikuara, përfshirë përditësimin e praktikave të publikimit, konsolidimin e raportimit të rezervave ndërkombëtare dhe përshpejtimin e afateve të shpërndarjes së të dhënave. Kalimi nga e GDDS në SDDS kërkon angazhim të koordinuar ndërinstytucional, por përfitimet afatgjata, si rritja e transparencës, përmirësimi i cilësisë së statistikave, forcimi i besimit të tregjeve dhe rritja e mundësive të integritimit ekonomik ndërkombëtar, e bëjnë këtë proces një nga prioritetet strategjike të Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2025, kemi vazhduar përafrimin e statistikave me standardet e Bashkimit Evropian, të përcaktuara në ESA 2010. Në baza mujore janë raportuar statistikave të interesit në depozita në Bankën Qendrore Evropiane (BQE), ndërsa në Eurostat janë raportuar rregullisht statistikave tremujore të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, si dhe statistikave vjetore për investimet direkte dhe tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve.

BQK mbetet plotësisht e përkushtuar ndaj Kodit Evropian të Praktikës Statistikore. Gjatë vitit 2025 ka marrë pjesë në procesin e rëndësishëm të Peer Review, të udhëhequr nga Eurostat, në kuadër të vlerësimit të përputhshmërisë me ES CoP. Pyetësi i Vetëvlerësimit (SAQ) u dorëzua në maj 2025, ndërsa në nëntor 2025 u zhvilluan takimet zyrtare me ekipin vlerësues të Eurostatit i cili vlerësoi lart profesionalizmin e stafit të BQK-së, pavarësinë institucionale, zbatimin e metodologjive ndërkombëtare, mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe respektimin e parimeve të statistikave zyrtare. U theksua gjithashtu roli potencial i BQK-së në mbështetjen e institucioneve të tjera për ngritjen dhe forcimin e njësive të statistikave zyrtare. Procesi Peer Review vlerësohet lartë për avancimin e transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare të BQK-së, veçanërisht në një kohë kur vendimmarrja globale mbështetet në të dhëna të besueshme dhe të standardizuara.

BQK ka vazhduar me sukses zbatimin e projektit “IPA 2022 – 1.9 Investimet e Huaja Direkte”, i nisur në shtator 2024 dhe që do të zgjasë deri në shtator 2026. Projekti synon zgjerimin e gamës së publikimeve të BQK-së për FDI-në me katër sete të reja të dhënash dhe përmirësimin e cilësisë së statistikave në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2025 janë shënuar arritje të rëndësishme: në mars 2025 janë publikuar për herë të parë të dhënat e stokut të FDI-së sipas shteteve dhe aktiviteteve ekonomike, ndërsa në shtator 2025 janë transmetuar me sukses në Eurostat të gjitha tabelat e detyrueshme për sektorin e jashtëm dhe të pesë tabelat kaluan me sukses kontrollet e validimit/konzistencës STRUVAL/CONVAL të Eurostatit që në përpyekjen e parë. BQK-ja ka zhvilluar dhe implementuar një program të ri IT për transformimin e “flat file” të statistikave të sektorit të jashtëm në strukturat e tabelave sipas vademekumit, të kërkuara për transmetim në Eurostat. Gjithashtu është zhvilluar një sistem i ri IT për automatizimin e transmetimit të statistikave duke rritur efikasitetin, saktësinë dhe

qëndrueshmërinë operacionale. Përveç kësaj, gjatë vitit 2025 është organizuar anketa e rregullt me jo-rezidentët që vizitojnë Kosovën, e realizuar në sezonin veror dhe atë dimëror. Anketa është kryer përmes një sistemi të avancuar të huazuar nga Banka Botërore, duke siguruar mbledhje më efikase dhe të dhëna më cilësore. Rezultatet janë përdorur për vlerësimin e shpenzimeve të emigrantëve dhe kanë ndikim të rëndësishëm në statistikën e udhëtimit, remitencave dhe investimeve direkte.

BQK ka qenë po ashtu e angazhuar në ngritjen e cilësisë dhe konsistencës së të dhënave të prodhuara, përditësimin e metodikës së publikuar, publikimin e tabelave të reja, shkurtimin e frekuencës së publikimit të treguesve, avancimin e metodave të procesimit dhe validimit të të dhënave, mirëmbajtjen e faqes “Ekonomia e Kosovës në një shikim”, përpilimin e kamatëvonesës në transaksionet tregtare dhe instrumentet kreditore, raportimin e treguesve të shëndetit financiar, si dhe publikimin e shpjegimeve përmbledhëse mbi zhvillimet ekonomike dhe financiare për transparencë dhe informim më të saktë të publikut.

7. Menaxhimi i Rezervave dhe Operacionet Bankare

7.1. Menaxhimi i Mjeteve dhe Rezervave

Banka Qendrore e Kosovës menaxhon asetet dhe rezervat e saj dhe është përgjegjëse për administrimin e Sistemit Qendror Depozitar, duke mundësuar realizimin e ankandeve dhe tregtimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Detyrat e menaxhimit të rezervave janë specifikuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, respektivisht në Nenin 15 të Ligjit Nr. 03/L-209.

7.1.1. Menaxhimi i Investimeve


Banka Qendrore menaxhon rezervat e saj për të arritur objektivat e Politikës së Investimeve të miratuar nga Bordi Ekzekutiv, ku prioritet kanë siguria dhe likuiditeti i mjeteve, para kthimit nga investimet. Gjatë vitit 2025, janë finalizuar marrëveshjet e bashkëpunimit për menaxhimin e rezervave ndërkombëtare me katër banka partnere: Bankën e Anglisë, Bankën e Francës, Bankën e Austrisë dhe Landesbank Baden-Wuerttemberg. Këto marrëveshje përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt zgjerimit të rrjetit të partnerëve strategjikë dhe diversifikimit të mëtejshëm të portofolit të investimeve.

Në të njëjtën kohë, ka vazhduar bashkëpunimi i ngushtë me Departamentin e Thesarit të Bankës Botërore, me fokus në avancimin e mëtejshëm të politikave për investime ku gjatë këtij viti është finalizuar dhe miratuar Politika e Investimeve për Menaxhimin e Rezervave Ndërkombëtare. Ky bashkëpunim synon rritjen e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e rezervave në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe zhvillimin e mëtejshëm të kornizës së politikave dhe praktikave operacionale të investimeve.

7.1.2 Instrumentet

Rezervat në portfolion e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës përbëhen nga instrumentet e portfolios të cilat klasifikohen si likuide dhe me gradë investuese. Kategoria e rezervave likuide përbëhet prej instrumenteve që mirëmbahen për të siguruar mjete të mjaftueshme për realizimin e pagesave dhe transfereve sipas nevojave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe depozitorëve të saj. Ndërsa kategoria e mjeteve investuese përbëhet nga instrumentet financiare të sigurta, me vlerësim kreditor investiv që gjithashtu janë lehtësisht të tregtueshme.

Grafik 70. Portfolio e rezervave (EUR) të BQK-së, sipas gjendjes 31 dhjetor 2025



Burimi: BQK (2026)

Për të siguruar mjaftueshmëri të fondeve likuide për realizimin e transfereve ndërkombëtare të depozitarëve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, mjetet në llogarinë rrjedhëse mirëmbahen për të realizuar obligimet afatshkurtëra të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës të cilat për periudhën raportuese përbëjnë nivelin prej 2.88 përqind të portfolios.

Portfolio e rezervave në euro të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës sipas instrumenteve është pasqyruar në grafikun 70, bazuar në gjendjen e datës 31 dhjetor 2025. Sipas këtij grafiku, 39.26 përqind e portofolit është i investuar në Letra me Vlerë Ndërkombëtare, 3.82 përqind në

Letra me Vlerë të gjelbra dhe të qëndrueshmërisë, si dhe 13.83 përqind në Letra me Vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Plasimi në depozita bankare në mënyrë që të sigurohet shpërndarje adekuate sipas instrumenteve afatshkurtra është prej 40.21 përqind.

Portfolion investuese të rezervës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në të gjitha valutat e përbëjnë këto instrumente financiare:

- Depozitat bankare me afat të plasura në bankat Evropiane me rangim adekuat investues, marrëveshjet afatshkurtra të riblerjes të plasura me bankat vendore dhe Rezervën Federale të SHBA-së;
- Letrat me Vlerë Ndërkombëtare, respektivisht obligacione qeveritare, komunale, supranacionale, agjensive shtetërore apo institucioneve kreditore në euro dhe dollarë me afat maturimi deri në shtatë vite;
- Obligacionet shtetërore të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës të tregtuara në tregun sekondar të Letrave me Vlerë me afat maturimi deri në shtatë vite.

Marrëveshjet afatshkurtra të riblerjes (Repo) me bankat vendore të Republikës së Kosovës kanë vazhduar të plasohen përgjatë vitit 2025 dhe përbëjnë një instrument të rëndësishëm të tregut vendor të parasë. Përmes këtij instrumenti Banka Qendrore të Republikës së Kosovës u ofron likuiditet të shpejtë bankave vendore në rast nevojë për periudhë prej një deri në dhjetë ditë kundrejt kolateralit, respektivisht Letrave me Vlerë të Republikës së Kosovës. Po ashtu, ky instrument u ndihmon obligacioneve qeveritare të trajtohen si instrumente më likuide duke u ofruar mbajtësve të tyre qasje të lehtë në financim përmes kolateralit.

Gjatë vitit 2025, Banka Qendrore të Republikës së Kosovës ka vazhduar të jetë pjesë e linjës kreditore të ofruar nga Euro sistemi përmes Deutsche Bundesbank. Përmes kësaj linje kreditore, Banka Qendrore Evropiane i ka ofruar mundësinë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës të marrë hua nga pakoja e likuiditetit të Euro sistemit kundrejt kolateralit adekuat në euro të përbërë nga Letra me Vlerë të tregtueshme të borxhit të emetuara nga qeveritë qendrore të Eurozonës dhe institucionet supranacionale. Kjo linjë kreditore adreson nevojat e mundshme të likuiditetit në euro të BQK-së në rast të kërkesave eventuale, duke i mundësuar hua deri në 100 milion euro nga Banka Qendrore Evropiane. Linja kreditore do të qëndrojë në fuqi deri në datën 31 janar 2027, me mundësi të zgjatjes së afatit.


7.1.3 Valutat

Gjatë vitit 2025, si rezultat i bashkëpunimit me Bankën e Anglisë, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka realizuar vendosjen e depozitave me afat në valutën paund britanik. Përbërja valutore e portfolios së rezervave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës konsiston në euro, dollar amerikan dhe paund britanik.

Siç shihet në grafikun 71, rezervat në euro në dispozicion në portfolion e Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës kanë shënuar rritje marginale në 1,362 milionë euro në vitin 2025 nga 1,326 milionë euro në vitin paraprak, për shkak të lëvizjeve të

fondeve të depozitarëve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Grafik 71. Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara në EUR (mil) sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve përkatëse



Burimi: BQK (2026)


Prej rreth 4.7 përqind e portfolios së rezervave mbahet në dollar amerikan, të investuara në plasmane një-ditore me normën e interesit të kuotuar nga marrëveshjet e riblerjes me Bankën e Rezervës Federale të ShBA-ve, depozita të afatizuara dhe letra me vlerë afatshkurtra të emetuara dhe paguara nga thesari Amerikan me afat maturimi deri në një vit në kuadër të programit automatik të investimeve me Bankën e Rezervës Federale (Automatic Investment Programme). Në vitin 2025, rezervat në dollar amerikan kanë shënuar një rritje të konsiderueshme, kryesisht si rezultat i rritjes së ekspozimit ndaj dollarit amerikan përmes blerjes shtesë të bonove të thesarit. Si rrjedhojë, grafiku 72 pasqyron një rritje nga 10.98 milionë dollar amerikan në vitin 2023 në 61.66 milionë dollar amerikan në vitin 2024 dhe në 64.09 milionë dollar amerikan në vitin 2025. Shpërndarja e aseteve në dy valutat përkatëse bëhet në bazë të përmbajtjes së rezervave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës nga depozitarët e saj, të cilat kryesisht mbahen në valutën euro.

7.1.4 Shpërndarja

Në përputhje me objektivat e Politikës së Investimeve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, plasmani i investimeve të rezervave është përqendruar në instrumentet financiare të sigurta dhe likuide, respektivisht në instrumente borxhi apo obligacione me maturitet maksimal deri në shtatë vite dhe rangim kreditor adekuat.

Gjatë vitit 2025 shpërndarja e portfolios është realizuar me fokus në kategorinë e aseteve likuide, lehtësisht të konvertueshme dhe me treg të zhvilluar siç janë letrat me vlerë sikurse bonot e thesarit dhe obligacionet. Rrjedhimisht, 34.9 përqind e portfoliut është e investuar në letra me vlerë ndërkombëtare, të cilat përfaqësojnë instrumentet kryesore likuide me pjesëmarrjen më të lartë në portfolin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Letrat me Vlerë Kombëtare përbëjnë prej 13.8 përqind të portfolios, ndërsa depozitat bankare përbëjnë 40.2 përqind dhe mjetet e mbajtura në llogari rrjedhëse prej 2.9 përqind, siç pasqyrohet në grafikun 73.


Grafik 72. Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara në USD (mil) sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve përkatëse



Burimi: BQK (2026)


Në vitin 2025, rezervat në dollar amerikan kanë shënuar një rritje të konsiderueshme, kryesisht si rezultat i rritjes së ekspozimit ndaj dollarit amerikan përmes blerjes shtesë të bonove të thesarit. Si rrjedhojë, grafiku 72 pasqyron një rritje nga 10.98 milionë dollar amerikan në vitin 2023 në 61.66 milionë dollar amerikan në vitin 2024 dhe në 64.09 milionë dollar amerikan në vitin 2025. Shpërndarja e aseteve në dy valutat përkatëse bëhet në bazë të përmbajtjes së rezervave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës nga depozitarët e saj, të cilat kryesisht mbahen në valutën euro.

Grafik 73. Raporti i shpërndarjes së portfolios investuese në EUR të BQK-së (në përqindje)



Burimi: BQK (2026)

Grafik 74. Raporti i shpërndarjes së portfolios investuese në EUR të BQK-së (në përqindje)



Burimi: BQK (2026)

Gjatë vitit 2025 shpërndarja e portfolios është realizuar me fokus në kategorinë e aseteve likuide, lehtësisht të konvertueshme dhe me treg të zhvilluar siç janë letrat me vlerë sikurse bonot e thesarit dhe obligacionet. Rrjedhimisht, 34.9 përqind e portfoliut është e investuar në letra me vlerë ndërkombëtare, të cilat përfaqësojnë instrumentet kryesore likuide me pjesëmarrjen më të lartë në portfolin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Letrat me Vlerë Kombëtare përbëjnë prej 13.8 përqind të portfolios, ndërsa depozitat bankare përbëjnë 40.2 përqind dhe mjetet e mbajtura në llogari rrjedhëse prej 2.9 përqind, siç pasqyrohet në grafikun 73.

Në portfolion e letrave me vlerë rëndësi të veçantë i kushtohet shpërndarjes gjeografike, shpërndarjes sipas emetuesve dhe kushtit që këto letra të njihen si kolateral i pranueshëm nga Banka Qendrore Evropiane.

Ndryshimet e fundit në normat e interesit nga Banka Qendrore Evropiane dhe Rezerva Federale e ShBA-së kanë ndikuar në normat e tregut ndërbankar dhe tregut të borxheve. Këto zhvillime kanë mundësuar pozicionimin e portfolios në instrumente me kthime sipas normave të tregut të Eurosistemit dhe Bankës së Rezervës Federale në ShBA.

Sikurse në vitin paraprak, shpërndarja e portfolios së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në Letra me Vlerë është realizuar nga kushtet e tregut dhe çmimet për obligacionet qeveritare, supranacionale, agjensive dhe institucioneve kreditore të emetuara dhe paguara në euro.

Norma depozitare në tregun ndërbankar në euro bazohet në normën e vendosur nga Banka Qendrore Evropiane për depozita e cila gjatë vitit 2025 ka variuar nga 2.75 përqind në janar deri në uljen e fundit në 2 përqind në qershor 2025.⁸


Në vitin 2025 shpërndarja në Letra me Vlerë Ndërkombëtare ka shënuar ngritje krahasuar me vitin paraprak, siç shihet në grafikun 75. Ndryshimin kryesor në strukturën e shpërndarjes së portfolios e shohim tek depozitat bankare ku kjo kategori asetesh në fillim të vitit ka

shënuar ngritje të konsiderueshme, si rezultat i ngritjes së normës depozitare nga Banka Qendrore Evropiane dhe mundësive për plasmane në tregun ndërbankar të bankave Qendrore dhe Komerciale të Eurosistemit. Kjo shpërndarje i mundëson BQK-së që të mbajë likuiditet të mjaftueshëm në portfolion e saj të rezervave, njëkohësisht duke kontribuar në ruajtjen e sigurisë së portfolios dhe realizimit të kthimit nga investimi nga kjo kategori e asetëve.

7.1.5. Performanca e portfolios

Instrumentet në portfolion e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës kanë treguar performancë të lartë duke realizuar 23.37 milionë euro të hyra neto nga të gjitha kategoritë e investimeve, përfshirë diferencën në mes të hyrave dhe shpenzimeve nga normat e aplikuar ndaj llogarive depozitare.

Grafik 75. Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundvit (në milionë euro)



Burimi: BQK (2026)

⁸ https://www.ecb.europa.eu/stats/policy_and_exchange_rates/key_ecb_interest_rates/html/index.en.html

7.1.6 Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës


Në pajtim me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, Banka Qendrore e Kosovës vepron si agjent fiskal për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në procesin e emetimit të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke realizuar ankandet sipas kalendarit për emetime.

Sipas kalendarit vjetor të emetimeve të Letrave me Vlerë të publikuar nga Thesari i Kosovës në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej 14 ankande për emetimin e Letrave me Vlerë me afat maturimi nga 2 deri në 10 vite.


Grafiku 76 paraqet strukturën sipas maturimit të Letrave me Vlerë të emetuara gjatë vitit 2025 në tregun primar, shprehur në përqindje, ku dominojnë emetimet me afat maturimi 5 dhe 3 vjeçar. Grafiku 77 paraqet fondet e investuara në tregun primar sipas kategorisë së investitorit.⁹

Në grafikun 78 shihen normat mesatare vjetore të kthimit në investim sipas maturitetit, nga ku shihet rënie krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa, në grafikun 79 janë paraqitur ankandet e realizuara me sukses, ku shihet se kërkesa më e madhe nga tregu ishte për Letra me Vlerë me afat maturimi nga 3 deri 7 vite.


Grafik 76. Struktura e letrave me vlerë sipas afatit të maturimit




Grafik 77. Struktura e investitorëve në ankandet e letrave me vlerë



Grafik 78. Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2024 dhe 2025, në përqindje



Grafik 79. Ankandet e Letrave me Vlerë gjatë vitit 2025



⁹ Pjesëmarrës në tregun primar të Letrave me Vlerë të Qeverisë janë bankat komerciale, fondet pensionale, siguruesit si dhe personat juridik dhe fizik duke vepruar përmes bankave komerciale.

Gjithsej vëllimi i shitblerjeve¹⁰ të Letrave me Vlerë ndërmjet pjesëmarrësve në tregun sekondar gjatë vitit 2025 ishte 84.6 milionë euro, i cili krahasuar me vëllimin e vitit paraprak prej 77.6 milionë euro, shënoi rritje prej 9.0 përqind.

Ndërsa, për qëllime të huadhënies afatshkurtër të mbështetur me kolateral Letra me Vlerë të Qeverisë, gjithsej vëllimi i transaksioneve të riblerjeve të Letrave me Vlerë gjatë vitit 2025 rezultoi me 80.4 milionë euro, krahasuar me vëllimin e vitit paraprak prej 64.0 milionë euro, duke shënuar rritje prej 25.6 përqind.

Me qëllim të menaxhimit sa më efikas të ofrimit të likuiditetit nga Banka Qendrore e Kosovës për sektorin bankar bazuar në huadhënien brenda-ditore të mbështetur me kolateral Letra me Vlerë, vëllimi i kërkesave nga sektori bankar gjatë vitit 2025 ishte gjithsej 879.2 milionë, duke shënuar rritje për 358.3 milionë euro apo 145.4 përqind.

7.2. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme

BQK në kuadër të operacioneve të menaxhimit të parave të gatshme siguron furnizimin e ekonomisë vendore me sasi dhe cilësi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave euro. Për realizimin e këtij funksioni BQK mban dhe administron rezervat valutore, rregullon dhe përcakton standardet për Institucionet Financiare në fushën e operacioneve me para të gatshme që kanë të bëjnë me kontrollin dhe riqarkullimin e kartëmonedhave dhe monedhave, si dhe obligimin për tërheqjen nga qarkullimi të parave të dyshuara si të falsifikuara dhe atyre të papërshtatshme për riqarkullim, duke përfshirë kriteret për këmbimin e parave të dëmtuara.

Gjatë vitit 2025 BQK-ja përmbushi në mënyrë të suksesshme funksionin e furnizimit të ekonomisë vendore me sasi dhe cilësi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave euro.

Tabela 29. Shuma dhe vëllimi i aktiviteteve të përgjithshme të operacioneve me para të gatshme

Llojet e operacioneve	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Rritja vjetore e shumës së operacioneve me kartëmonedha	-12.17%	29.31%	28.18%	12.59%	2.64%	11.79%
Shuma e operacioneve me kartëmonedha (në euro)	3,143,483,655	4,064,682,790	5,210,009,170	5,865,873,880	6,020,805,090	6,730,503,470
Pranimi i kartëmonedhave	1,449,545,855	2,087,439,200	2,499,965,400	2,735,521,340	2,988,237,500	3,350,532,500
Furnizimi me kartëmonedha	1,093,937,800	967,243,590	981,543,770	871,352,540	937,567,590	983,470,970
Eksport i kartëmonedhave	475,000,000	950,000,000	1,700,000,000	2,215,000,000	2,075,000,000	2,370,000,000
Import i kartëmonedhave	125,000,000	60,000,000	28,500,000	44,000,000	20,000,000	26,500,000
Rritja vjetore e vëllimit të operacioneve me kartëmonedha	5.17%	18.98%	21.51%	12.76%	5.08%	12.75%
Vëllimi i operacioneve me kartëmonedha (në copë)	68,618,553	81,643,508	99,201,043	111,862,413	117,541,912	132,533,861
Pranimi i kartëmonedhave	29,268,128	40,173,242	45,151,268	49,980,419	54,605,837	62,159,000
Furnizimi me kartëmonedha	25,258,425	19,627,266	19,016,775	19,159,994	20,669,075	22,234,861
Eksport i kartëmonedhave	9,672,000	18,128,000	32,333,000	38,072,000	38,267,000	44,040,000
Import i kartëmonedhave	4,420,000	3,715,000	2,700,000	4,650,000	4,000,000	4,100,000
Rritja vjetore e shumës së operacioneve me monedha	-33.87%	-5.80%	28.59%	385.59%	52.27%	-35.72%
Shuma e operacioneve me monedha (në euro)	2,408,470	2,268,716	2,917,422	14,166,836	21,572,088	13,867,614
Pranimi i monedhave	0	290,000	180,362	20,000	7,993,818	3,310,279
Furnizimi me monedha	1,045,470	1,367,716	1,616,060	2,414,836	4,578,270	3,476,335
Eksport i monedhave	0	0	0	0	9,000,000	2,940,000
Import i monedhave	1,363,000	611,000	1,121,000	11,732,000	0	4,141,000
Rritja vjetore e vëllimit të operacioneve me monedha	-46.71%	47.18%	58.47%	67.35%	-44.92%	78.75%
Vëllimi i operacioneve me monedha (në copë)	9,379,000	13,803,957	21,874,635	36,606,123	20,162,029	36,038,988
Pranimi i monedhave	0	160,500	180,185	20,000	5,129,209	2,807,191
Furnizimi me monedha	5,379,000	7,743,457	10,544,450	12,786,123	10,132,820	11,331,797
Eksport i monedhave	0	0	0	0	4,900,000	2,750,000
Import i monedhave	4,000,000	5,900,000	11,150,000	23,800,000	0	19,150,000


Burimi: BQK (2026)

¹⁰ Pjesëmarrës në tregun sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë ishin fondet pensionale, bankat komerciale, personat fizik duke vepruar përmes bankave komerciale dhe institucionet publike.

Krahasuar me vitin e kaluar, gjatë vitit 2025 aktivitetet e përgjithshme të operacioneve me kartëmonedha shënuan një rritje grupore prej 11.79 përqind (shprehur në vlerë) dhe një rritje grupore prej 12.75 përqind (shprehur në vëllim) ndërsa aktivitetet e përgjithshme të operacioneve me monedha shënuan një rënie grupore prej 35.72 përqind (shprehur në vlerë) dhe një rritje grupore prej 78.75 përqind (shprehur në vëllim).


Vlera e përgjithshme e furnizimit me para të gatshme në vitin 2025, shënoi një rritje prej 4.76 përqind krahasuar me vitin 2024.

Grafik 80. Furnizimi me para të gatshme, (vlera) në milionë euro



Burimi: BQK (2026)

Grafik 81. Furnizimi i parave të gatshme, (vëllimi) në milionë copë




Burimi: BQK (2026)

Gjatë vitit 2025, BQK-ja e furnizoi sektorin bankar me mbi 22.23 milionë copë kartëmonedha euro (në vlerë prej mbi 983.47 milionë euro) dhe me mbi 11.33 milionë copë monedha euro (në vlerë prej afër 3.48 milionë euro). Struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, nuk pati ndonjë ndryshim nga viti 2024 në vitin 2025. Te kartëmonedhat euro vëllimet e kërkesave për furnizim gjatë vitit 2025 shënuan një rritje prej 7.58 përqind krahasuar me vitin 2024 dhe vazhduan të dominojnë kërkesat për furnizime me denominimet me prerje prej 5, 20 dhe 100 euro te cilat përbenin rreth 85.94 përqind të kërkesës vëllimore për furnizim.


Gjatë vitit 2025 kërkesa për denominimet në vlerë prej 200, 100 dhe 50 euro shënoi një rritje grupore prej 3.94 përqind, përderisa kërkesa për denominimet në vlerë prej 20, 10 dhe 5 euro shënoi një rritje grupore prej 9.99 përqind krahasuar me vitin 2024.

Grafik 82. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2026)

Grafik 83. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)




Burimi: BQK (2026)

Vëllimet e kërkesave për furnizim me monedha gjatë vitit 2025 shënuan një rritje prej rreth 11.83 përqind krahasuar me vitin 2024. Kjo rritje e kërkesës gjatë vitit 2025 kryesisht ka ndodhur për shkak të furnizimeve të shtuara me vëllime të monedhave me vlerë të vogël prej 1, 2 dhe 5 euro

cent. Kërkesa për furnizim me monedha euro në vitin 2025 u dominua nga monedhat me vlerë të vogël prej 1, 2 dhe 5 euro cent të cilat përbënin rreth 60.03 përqind të kërkesës për furnizim.


Krahasuar me vitin paraprak kërkesat për denominimet prej 1, 2 dhe 5 euro cent kanë shënuar një rritje grupore prej 29.01 përqind, ndërsa kërkesat për furnizim me denominimet prej 2 dhe 1 euro kanë shënuar një rënie grupore prej 30.08 përqind në raport me vitin paraprak. Rënia e kërkesave për denominimet prej 2 dhe 1 euro erdhi kryesisht si rezultat i furnizimeve të shtuara me vëllime të monedhave në fund të dhjetorit 2023 dhe gjatë vitit 2024, si rezultat i masave kundër parave të falsifikuara dhe furnizimit të ekonomisë me monedha plotësisht të reja.

Grafik 84. Pranimi i parave të gatshme, (vlera) në milionë euro



Burimi: BQK (2026)

Grafik 85. Pranimi i parave të gatshme, (vëllimi) në milionë copë




Burimi: BQK (2026)

Vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuar si depozita shënoi një rritje prej 11.94 përqind në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak. Të shprehura në vlerë, depozitat e parave të gatshme arritën shumat prej mbi 3.35 miliardë kartëmonedha euro dhe mbi 3.31 milionë monedha euro përkatësisht. Për sa i përket vëllimit, BQK-ja pranoi nga sektori bankar afër 62.16 milionë copë kartëmonedha (mesatarisht rreth 250,000 copë kartëmonedha në ditë), ndërsa depozitat e monedhave ishin mbi 2.81 milionë copë. Vëllimet e kartëmonedhave të pranuar si depozita gjatë vitit 2025 shënuan një rritje prej rreth 13.83 përqind krahasuar me vitin 2024 ndërsa vëllimet e monedhave të pranuar si depozita gjatë vitit 2025 shënuan një rënie prej rreth 45.27 përqind krahasuar me vitin 2024 tregues ky i tërheqjes së monedhave 2 dhe 1 euro nga qarkullimi si rezultat i masave kundër parave të falsifikuara.


Struktura e kartëmonedhave euro të pranuar si depozita gjatë vitit 2025 nuk ka pasur ndonjë ndryshim të madh nga viti paraprak kurse siç shihet edhe në grafikun e mëposhtëm depozitat e monedhave (sidomos tek denominimet prej 2 euro) ishin në një nivel më të ultë se në vitin 2024 si rezultat i masave kundër parave të falsifikuara (tërheqja prej ekonomisë të monedhave 2 euro në qarkullim).

Grafik 86. Pranimi i kartëmonedhave euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2026)


Grafik 87. Pranimi i monedhave euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2026)


Ngjashëm me vitet e kaluara edhe gjatë vitit 2025 paratë e gatshme të pranuar si depozita ishin në një vlerë më të lartë se sa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, gjatë vitit 2025 paratë e gatshme neto¹¹ (tepricat) ishin rreth 2.37 miliardë euro, shumë kjo që ishte dukshëm më e lartë se sa në vitin e kaluar kur paratë e gatshme neto ishin rreth 2.05 miliardë euro. Kjo rritje e parave të gatshme neto ishte kryesisht si rezultat i rritjes domethënëse të vëllimit të depozitave të parave të gatshme nga sektori bankar në njërin anë dhe rritjes së moderuar të kërkesës për para të gatshme krahasuar me vitin paraprak në anën tjetër.

Grafik 88. Eksporti i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2026)


Grafik 89. Eksporti i parave të gatshme (vëllimi), në milionë copë



Burimi: BQK (2026)


BQK-ja mban vetëm nivelin optimal të nevojshëm të parave të gatshme për kryerjen e operacioneve, ndërsa tepricat dërgohen¹² në Eurozonë, ku më pastaj përdoren për kryerjen e pagesave ndërkombëtare, si dhe përmes investimeve kthehen në mjete interes-prurëse. Neto dërgesat¹³ jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2025 arritën shumën prej 2.34 miliardë euro duke qenë më e lartë për 13.48 përqind se sa një vit më parë kur ishin 2.06 miliardë euro. Rritja e parave e gatshme neto dhe rritja neto e dërgesave në vitin 2025, ishte rezultat i rritjes domethënëse të depozitave të parave të gatshme nga sektori bankar në njërin anë dhe rritjes së moderuar të kërkesës për para të gatshme krahasuar me vitin paraprak në anën tjetër.

Grafik 90. Importi i parave të gatshme, (vlera) në milionë euro



Burimi: BQK (2026)

Grafik 91. Importi i parave të gatshme (vëllimi), në milionë copë



Burimi: BQK (2026)

Gjatë vitit 2025 rreth 62.20 milionë copë kartëmonedha euro të pranuar si depozita nga sektori bankar, u procesuan duke u kontrolluar për autenticitet dhe duke u klasifikuar sipas shkallës së përshtatshmërisë. Kontrolli për autenticitet dhe klasifikimi sipas shkallës së përshtatshmërisë i

¹¹ Depozitat minus Tërheqjet e parave të gatshme


¹² Depozitohen në llogaritë e BQK-s të mbajtura në bankat korrespondente të Eurozonës

¹³ Importet minus Eksportet e parave të gatshme

një vëllimi kaq të madh të kartëmonedhave ka kontribuar dukshëm në mbrojtjen e integritetit të kartëmonedhave euro në qarkullim, si dhe mundësimin e detektimit të falsifikimit duke siguruar kështu që të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat euro të lëshuara në qarkullim të kishin një gjendje të mirë kualitative (të përshtatshme për riqarkullim) në mënyrë që të sigurohej se këto të fundit mundën lehtë të kontrollohen për vërtetësinë e tyre.


Rreth 20.65 milionë copë kartëmonedha euro (33.23 përqind e numrit të përgjithshëm kartëmonedhave euro të depozituara nga sektori bankar) gjatë vitit 2025 u klasifikuan si të papërshtatshme për riqarkullim (të vjetërsuara/dëmtuara/seria 1 e kartëmonedhave) dhe u tërhoqën nga qarkullimi duke u dërguar në bankat e eurozonës. Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi vazhdoi të kontribuoi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës si parakusht i mbrojtjes së integritetit të valutës zyrtare në qarkullim.

Grafik 92. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi (vëllimi), në milionë copë



Burimi: BQK (2026)


Grafik 93. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar, në përqindje



Burimi: BQK (2026)


Ngjashëm me vitet e kaluara, kartëmonedhat që më së shumti u klasifikuan si të papërshtatshme për riqarkullim, ishin ato të denominimeve 50, 20, 10 dhe 5 euro. Ato përbënin rreth 84.77 përqind të vëllimit të kartëmonedhave të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi për shkak të përdorimit më të shpeshtë nga qytetarët.

Grafik 94. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve)



Burimi: BQK (2026)


Grafik 95. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar (në përqindje)



Burimi: BQK (2026)


Cilësia e parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës u përmirësua gjithashtu edhe përmes furnizimit të sektorit bankar me kartëmonedha euro plotësisht të reja, të cilat u sollën nga eurozona. Gjatë vitit 2025, BQK-ja furnizoi sektorin bankar me më shumë se 4.48 milionë copë kartëmonedha të reja euro (20.16 përqind e të gjithë numrit të kartëmonedhave euro të furnizuara gjatë vitit).

Grafik 96. Kartëmonedha të reja te futura ne qarkullimi (vëllimi), në milionë copë



Burimi: BQK (2026)


Grafik 97. Kartëmonedha te reja te futura ne qarkullim (vëllimi) nga gjithsej të furnizuara, në përqindje



Burimi: BQK (2026)


Rreth 99.58 përqind e sasisë së kartëmonedhave të reja të furnizuara (futura në qarkullim) gjatë vitit 2025 ishin kartëmonedha të denominimeve me vlerë të ulët (20, 10 dhe 5 euro), me të cilat u furnizuan bankat komerciale me qëllim të furnizimit dhe shlyerjes së transaksioneve me para të gatshme në ekonomi. Për më tepër, edhe të gjitha kartëmonedhat e përshtatshme për riqarkullim euro me të cilat u furnizuan bankat komerciale ishin të një cilësie të lartë (të përshtatshme për riqarkullim).

Grafik 98. Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim (numri i copëve)



Burimi: BQK (2026)

Grafik 99. Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim në raport me gjithsej të furnizuara (në përqindje)



Burimi: BQK (2026)


7.2.1 Lufta kundër parave të falsifikuara dhe aktivitetet në zbatim të masave rregulative

Me qëllim të ruajtjes së integritetit të euros në qarkullim saj, ashtu sikurse në vitin paraprak lufta kundër parave të falsifikuara ka vazhduar gjatë gjithë vitit 2025.

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, gjatë vitit 2025 janë analizuar/raportuar ¹⁴ një numër prej 1,745 kartëmonedhash dhe 34,007 monedhash të falsifikuara. Pjesa më e madhe e këtyre kartëmonedhave dhe monedhave janë konfiskuar nga institucionet financiare gjatë aktivitetit të tyre të rregullt të masave kundër parave të falsifikuara.


¹⁴ Kartëmonedha dhe monedha të rezultuara si të falsifikuara pas analizave

Grafik 100. Kartëmonedhat euro të falsifikuara te konfiskuara në qarkullim (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2026)


Grafik 101. Kartëmonedhat euro të falsifikuara te konfiskuara në qarkullim, sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2026)


Për dallim me vitin paraprak, në vitin 2025 kartëmonedhat më të falsifikuara kanë qenë ato të prerjes prej 200, 100 dhe 50 euro të cilat përbënin rreth 76.22 përqind të të gjitha kartëmonedhave të falsifikuara të tërhequra nga qarkullimi. Ndërsa, sa i përket monedhave në vitin 2025 ashtu sikurse edhe në vitin e kaluar monedha më e falsifikuar ishte ajo në prerje prej 2€ e cila përbënte rreth 88.27 përqind të numrit të përgjithshëm të monedhave të falsifikuara të tërhequra nga qarkullimi.

Grafik 102. Monedhat euro të falsifikuara te konfiskuara në qarkullim (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2026)

Grafik 103. Monedhat euro të falsifikuara te konfiskuara në qarkullim, sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2026)

Ndërlidhur me situatën e krijuar gjatë vitit 2023 me dukurinë e qarkullimit të monedhave 2 euro të falsifikuara, BQK, në kuadër të kompetencave të saj, gjatë muajit nëntor dhe dhjetor 2023 pati zhvilluar disa takime me institucionet përgjegjëse në luftën kundër parave të falsifikuara me qëllim të koordinimit ndër-institucional për luftimin e kësaj dukurie. Nga takimet ndër-institucionale, institucionet përgjegjëse ishin dakorduar për masa specifike afatshkurtra të veprimit, masa këto që parashihnin ndërmarrjen e veprimeve parandaluese nga secili institucion sipas fushave të përgjegjësisë me qëllim të luftimit dukurisë së parave të falsifikuara. Përpjekjet e përbashkëta ndër-institucionale gjatë gjithë vitit 2024 rezultuan me një luftë të suksesshme ndaj parasë së falsifikuar në fushat e përgjegjësisë të secilit institucion pa përjashtim.

Më konkretisht, në zbatim të këtyre masave, gjithnjë në kuadër të kompetencave të saj, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me Bankat komerciale, në fillim të muajit dhjetor 2023 filloi me zbatimin e masave specifike të veprimit si:

1. Heqja e tarifës për depozitim të monedhave dhe stimulimit të depozitimit të monedhave
 - a. *Heqja e tarifës për depozitim të monedhave në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, efektive prej datës 11 dhjetor 2023;*
 - b. *Udhëzimi i bankave komerciale që të njejtën praktikë të aplikojnë kundrejt klientëve të tyre;*
 - c. *Heqja e tarifës për depozitim të monedhave nga Bankat komerciale, efektive prej fundit të muajit dhjetor 2023;*
2. Sigurimi i furnizimit të ekonomisë përmes Bankave komerciale me monedha plotësisht të reja të denominimeve prej 2 dhe 1 euro.

Në zbatim të masës së heqjes së tarifës për depozitim të monedhave në sektorin bankar, dhe stimulimit të depozitimit të monedhave, gjatë vitit 2025 janë tërhequr nga qarkullimi dhe deponuar në BQK rreth 1.91 milionë copë monedha të denominimeve prej 2€ dhe 1€, prej të cilave mbi 993 mijë copë monedha të denominimeve prej 2 euro dhe mbi 902 mijë copë monedha të denominimeve prej 1 euro, monedha këto të deponuara nga bizneset dhe qytetarët në bankat komerciale pa asnjë tarifë të aplikuar. Përmes kësaj mase, BQK-ja dhe bankat komerciale kanë detektuar dhe tërhequr nga qarkullimi mbi 84 mijë copë monedha të denominimeve prej 2 euro, të dyshuara si të falsifikuara të cilat janë dorëzuar tek autoritetet përgjegjëse për analizë të mëtutjeshme.

Në zbatim të masës së sigurimit të furnizimit të ekonomisë përmes Bankave komerciale me monedha plotësisht të reja, BQK-ja ka furnizuar ekonominë e Republikës së Kosovës përmes bankave komerciale me afër 11.33 milionë copë monedha euro plotësisht të reja të të gjitha denominimeve në shumë prej afër 3.48 milionë euro pa asnjë tarifë të aplikuar. Ky angazhim ka kontribuar në zvogëlimin e qarkullimit të monedhave false, ka lehtësuar identifikimin dhe ka ngritur ndërgjegjësimin e publikut për këtë çështje. Për më shumë, BQK-ja furnizoi ekonominë e Republikës së Kosovës përmes bankave komerciale me mbi 22.23 milionë copë kartëmonedha euro plotësisht të reja dhe të përshtatshme për ri-qarkullim. Shuma e kartëmonedhave të lëshuara në qarkullim ishte afër 983.47 milionë euro.

Ne aspektin rregullativ, me qëllim të parandalimit të parave të falsifikuara dhe luftës kundër informalitetit dhe dukurive të ndërlidhura, në fillim të vitit 2024 gjegjësisht prej 1 shkurt 2024, përmes Rregullores për Operacione me Para të Gatshme ndër të tjera filluan të zbatohen masat rregullative si:

1. Rregullimi i transportit ndërkufitar të monedhave - Përmes këtij rregullimi synohet që në vazhdimësi të bëhet parandalimi i futjes së monedhave të falsifikuara në Republikën e Kosovës, përmes të cilit rregullim personat fizikë dhe personat juridikë që nuk ushtrojnë veprimtari financiare, do të jenë të obliguar që të bëjnë deklarin e monedhave nëse bartin më shumë se 100 copë/njësi, pavarësisht që vlera e tyre është nën kufirin e deklaramit prej 10,000 (dhjetëmijë) euro.
2. Ndalimi i ri-qarkullimit të kartëmonedhës prej 500 euro - Përmes këtij rregullimi është dhënë kontribut dhe ndihmë në aspektin e strategjisë përkatëse kundër shpëlarjes së parave, informalitetit dhe dukurive të ndërlidhura. Përmes këtij rregullimi u ndalua ri-qarkullimi i kartëmonedhës prej 500 euro nga institucionet financiare edhe pse rregullimi nuk e ndalon qarkullimin e kartëmonedhës prej 500 euro ndërmjet palëve si mjet i ligjshëm i pagesës.

3. Rregullimi i transportit ndërkufitar të kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera - Përmes këtij rregullimi bëhet kontrolli i plotë i parave të gatshme që hyjnë dhe dalin nga Republika e Kosovës përmes institucioneve financiare për mundësimin e modelimit të vlerësimit të parasë në qarkullim. Përmes këtij rregullimi, importi dhe eksporti i kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera në Republikën e Kosovës mund të bëhet vetëm për dhe nga institucionet financiare bankare dhe jo-bankare të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ushtrimin e aktiviteteve financiare bankare.
4. Rregullimi i procedurave dhe detyrimet për ofruesit e shërbimeve të depozitimit apo tërheqjes së parave të gatshme përmes makinerive që përdoren nga klienti - Përmes këtij rregullimi Institucionet financiare jo-bankare që janë të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, të cilat ofrojnë llogari të pagesave dhe parave elektronike, duhet të marrin licencën dhe autorizimin shtesë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ofrimin e shërbimit të depozitimit apo tërheqjes së parave të gatshme, apo blerjen dhe rikthimin e parasë elektronike përmes makinave që përdoren nga klienti. Asnjë person fizik apo juridik nuk mund të ofrojë shërbime të depozitimit apo të tërheqjes së parave të gatshme përmes ndonjë lokacioni me shërbim fizik apo përmes ndonjë pajisje apo makine që përdoret nga klienti, në emër të ofrimit të shërbimeve financiare pa posedim të licencës dhe autorizimit nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
5. Rregullimi i importimit të pajisjeve ose makinave teknike-elektronike që ofrojnë shërbime të tërheqjes dhe depozitimit të parave të gatshme - Përmes këtij rregullimi synohet të rregullohet importimi i pajisjeve ose makinave teknike-elektronike për shërbime të tërheqjes dhe depozitimit të parave të gatshme ku ky aktivitet mund të bëhet vetëm nga institucionet e licencuara financiare për ofrim të aktiviteteve bankare apo institucionet financiare jo-bankare me shërbime të licencuara për para elektronike dhe shërbimet e pagesave. Asnjë person fizik apo juridik nuk mund të importojë dhe pajiset me makina teknike-elektronike për shërbime të tërheqjes dhe depozitimit të parave nëse nuk është i licencuar si institucion financiar për ofrim të aktiviteteve bankare, apo institucion financiar jo-bankar me shërbime të licencuara për para elektronike dhe shërbimet e pagesave.

Në zbatim të masës rregullative të ndalimit të ri-qarkullimit të kartëmonedhës prej 500 euro, gjatë vitit 2025 numri i kartëmonedhave të denominimit prej 500 euro të tërhequra nga qarkullimi dhe deponuara në BQK arriti në 169.5 mijë copë apo 84.75 milionë euro. Ky veprim, ka ndikuar, kontribuar dhe ndihmuar në strategjinë përkatëse kundër informalitetit dhe dukurive të ndërlihdhura.

Në zbatim të masës rregullative të rregullimit të transportit ndërkufitar të parave të gatshme, BQK-ja gjatë vitit 2024 dhe 2025 ka licencuar 5 institucione financiare për importin dhe eksportin e parave të gatshme dhe për të njëjtat gjatë periudhës së vitit 2025 ka lëshuar 266 autorizime për eksport (kryesisht të valutave jo-euro) në kundërvlerë të tërësishme prej 982.45 milionë euro. Valuta më e eksportuar nga institucionet financiare ishte Franka Zvicerane e cila përbënte rreth 86.26% të shumës së eksportuar në kundërvlerë euro, e përcjellur nga Funta Angleze me 7.47%, Dollari Amerikan me 6.14% dhe pjesa tjetër kishte të bënte me Krunen Suedeze, Dollarin Kanadez dhe Dollarin Australian dhe Euron që së bashku përbënin rreth 0.13% të shumës së eksportuar në kundërvlerë euro nga institucionet financiare gjatë vitit 2025. Në anën tjetër gjatë kësaj periudhe ka lëshuar 3 autorizime për import të parave të gatshme në kundërvlerë të tërësishme prej 1.7 milionë euro. Valuta që u importua më së shumti nga institucionet financiare ishte Dollari Amerikan i cili përbënte rreth 99.74% të shumës së importuar dhe u importua për kryerjen e operacioneve të aktiviteteve të këmbimit të bankave.

Në vazhden e masave strategjike dhe afatgjata të luftës dhe krijimit të sistemit për luftën kundër parave të falsifikuara, me qëllim të fuqizimit dhe përafrimit të kornizës ligjore për luftimin e parave të falsifikuara me atë të BE-s, me mbështetje nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë përmes programit TAIEX dhe me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve përgjegjëse është realizuar projekti 'Krijimi i sistemit për luftën kundër parave të falsifikuara në Republikën e Kosovës' përmes të cilit projekt është draftuar ligji për parandalimin dhe luftën kundër parave të falsifikuara.

Përmes draftimit të legjislacionit për parandalimin dhe luftën kundër parave të falsifikuara përmes programit TAIEX synohet:

1. Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësive të secilit institucion përgjegjës në procesin e parandalimit dhe luftës kundër parave të falsifikuara duke përfshirë aspektet e funksionimit të sistemit, shkëmbimit të të dhënave dhe monitorimit;
2. Krijimi dhe funksionalizimi i Qendrave Kombëtare, përfshirë Qendrën Kombëtare Kundër Falsifikimit (NCC) – Njesine ne BQK;
3. Krijimi dhe funksionalizimi i Sistemit të Monitorimit të Falsifikimeve (KCMS);

Gjithashtu, në shtator të vitit 2025 BQK-ja ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Bankën Qendrore Evropiane, përkatësisht ndërmjet Guvernatorit Ismaili dhe Presidentes se BQK, Znj. Lagarde, në fushën e luftimit të falsifikimit të kartëmonedhave euro dhe qasjes në sistemin CMS. Kjo marrëveshje shënon marrëveshjen e pare të këtij niveli ndërmjet BQK dhe BQE, e cila ka për qëllimin ruajtjen e integritetit të euros si valute në Kosovë, dhe merr për bazë rregullimin e mëparshëm të bërë përmes rregullores për operacione me para të gatshme.

7.2.3 Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive të klientëve të BQK-së

BQK-ja ofron shërbime bankare për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe institucione të tjera siç janë bankat dhe institucionet të tjera financiare, subjektet publike, bankat e huaja, bankat qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare (Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore), dhe organizatat ndërkombëtare, siç është specifikuar në nenin 9 të ligjit Nr. 03/L-209 të BQK-së.

BQK-ja ka mbështetur avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe akordimeve të Ministrisë së Financave. Edhe gjatë vitit 2025 sikurse në vitet paraprake, të gjitha pagesat ndërkombëtare u realizuan përmes rrjetit SWIFT kurse të gjitha pagesat vendore u realizuan përmes sistemit KIPS, duke shkurtuar kështu kohën dhe duke rritur efektivitetin e procesimit.


Tabela 30. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave (në mijëra euro)

Llojet e transaksioneve	2021	2022	2023	2024	2025
Transaksionet me para te gatshme	+1,119,117	+1,516,986	+1,861,774	+2,054,085	+2,366,895
Depozita ne para te gatshme	2,087,729	2,500,146	2,735,541	2,996,231	3,353,843
Terheqje te parave te gatshme	968,612	983,160	873,767	942,146	986,947
Transferet vendor	+30,021	+34,037	+5,532	+40,391	+39,836
Transferet vendor ardhesh	76,421	92,164	95,370	105,957	81,785
Transferet vendor dales	46,400	58,127	89,838	65,566	41,949
Transferet nderkombetar	-1,068,449	-1,444,209	-1,811,455	-2,094,613	-2,270,035
Transferet nderkombetar ardhesh	1,727,337	1,728,325	1,471,546	1,825,009	2,072,649
Transferet nderkombetar dales	2,795,786	3,172,534	3,283,000	3,919,622	4,342,683

Burimi: BQK (2026)


Përderisa pjesa më e madhe e operacioneve me para të gatshme të BQK-së në vitin 2025 u kryen në emër të/dhe për llogari të bankave komerciale, pjesa më e madhe e operacioneve të pagesave vendore të BQK-së janë kryer në emër të/dhe për llogari të AKP-së¹⁵.

Grafik 104. Vëllimi i transaksioneve vendore dalëse, numri



Burimi: BQK (2026)

Grafik 105. Vlera e transaksioneve vendore dalëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2026)

BQK-ja gjatë vitit 2025 ka procesuar në emër të klientëve të saj afër 9.72 mijë urdhërpagesa dalëse vendore (një rritje prej 7.84 përqind krahasuar me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 9.54 mijë urdhërpagesa hyrëse (një rënie prej 2.14 përqind krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat dalëse vendore arrinin shumën prej mbi 41.95 milionë euro (një rënie prej 36.02 përqind krahasuar me vitin paraprak) kurse urdhërpagesat hyrëse vendore arrinin shumën prej afër 81.79 milionë euro (një rënie prej 22.81 përqind krahasuar me vitin paraprak). Numri dhe shuma më e madhe e transaksioneve vendore u kryen nga BQK-ja me urdhër dhe për AKP-në.


¹⁵ AKP – Agjencia Kosovare e Privatizimit

Grafik 106. Vëllimi i transaksioneve vendore hyrëse, numri



Burimi: BQK (2026)

Grafik 107. Vlera e transaksioneve vendore hyrëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2026)

Sa i përket pagesave vendore dalëse, duhet theksuar se të gjitha bankat komerciale i gjenerojnë vetë ato, kurse kompanitë e sigurimit të gjitha pagesat e tyre i kryejnë nëpërmes bankave komerciale. Në të vërtetë, të gjithë llogari-mbajtësit e tjerë të BQK-së i shfrytëzojnë shërbimet e pagesave të ofruara nga BQK-ja në mënyrë të kufizuar, pasi që të gjithë ata kanë llogari në banka komerciale.


Sa u përket transaksioneve ndërkombëtare, numri më i madh i tyre u krye nga BQK-ja me urdhër dhe për llogari të Thesarit. Në anën tjetër, duke marrë për bazë vlerën e tyre, pjesa më e madhe e transaksioneve ndërkombëtare të kryera nga BQK-ja kishte të bënte me transferet e fondeve të bankave komerciale dhe Trustit Pensional të Kosovës.

Grafik 108. Vëllimi i transaksioneve nderkombëtare dalëse, numri



Burimi: BQK (2026)

Grafik 109. Vlera e transaksioneve nderkombëtare dalëse, shuma




Burimi: BQK (2026)

BQK-ja gjatë vitit 2025 ka procesuar për dhe në emër të klientëve të saj afër 3,276 urdhërpagesa dalëse ndërkombëtare (një rritje e moderuar prej 0.83 përqind krahasuar me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 1,417¹⁶ urdhërpagesa hyrëse ndërkombëtare (një rritje prej 6.70 përqind krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat dalëse ndërkombëtare arritën shumën prej mbi 4.34 miliardë euro (një rritje prej 10.79 përqind krahasuar me vitin paraprak) kurse urdhërpagesat hyrëse ndërkombëtare arritën shumën mbi 2.07 miliardë euro (një rritje prej 13.57 përqind krahasuar me vitin paraprak).


¹⁶ Shumica e pagesave ardhese kanë të bëjnë me transferet e fondeve të bankave komerciale

Grafik 110. Vëllimi i transaksioneve nderkombëtare hyrëse, numri



Burimi: BQK (2026)

Grafik 111. Vlera e transaksioneve nderkombëtare hyrëse, shuma



Burimi: BQK (2026)

Më 31 dhjetor 2025, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës arritën shumën prej rreth 419.09 milionë euro ndërsa ato të AKP-së arritën shumën prej rreth 194.10 milionë euro. Së bashku, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës dhe ato të AKP-së përbënin rreth 43.28 përqind të depozitave që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2025.

Tabela 31. Niveli i depozitave klientëve kryesor (në mijëra euro)

Gjendja e llogarive	2021	2022	2023	2023	2025
Gjithsej gjendja	1,275,801	1,288,150	1,343,340	1,336,308	1,416,813
Institucionet Qeveritare	423,322	419,664	345,232	395,422	419,095
Agjencia Kosovare e Privatizimit	184,737	165,854	166,373	179,143	194,103
Bankat Komeriale + Kompanitë e Sigurimeve	593,910	575,043	594,657	660,291	673,201
Të tjera	73,832	127,589	237,078	101,452	130,413

Burimi: BQK (2026)

Bankat komerciale dhe kompanitë e sigurimeve kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në nivelin e depozitave në BQK. Këto depozita kryesisht kanë të bëjnë me kërkesat dhe obligimet ligjore dhe rregullatore të Bankave komerciale dhe kompanive të sigurimeve. Ato përbënin rreth 47.52 përqind të depozitave që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2025. Më 31 dhjetor 2025, depozitat e bankave komerciale dhe kompanive të sigurimit ishin në shumën prej rreth 673.20 milionë euro.

III. Qeverisja dhe zhvillimet e brendshme të BQK-së

1. Bordi i Bankës Qendrore dhe komitetet e tij

Procesi i vendimmarrjes në Bordin e Bankës Qendrore udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, pavarësisë dhe transparencës.

Aktivitetet e Bordit të Bankës Qendrore kanë qenë të orientuara në përmbushjen e kompetencave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim, Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur takime të vazhdueshme në të cilat është informuar dhe është diskutuar lidhur me ecuritë e përgjithshme të sistemit financiar në Kosovë. Gjithashtu, Bordi i Bankës Qendrore, ka ushtruar mbikëqyrjen e zbatimit të politikave, si dhe mbikëqyrjen e administrimit dhe të aktiviteteve të Bankës Qendrore.

Gjatë vitit 2025, Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur 12 mbledhje në të cilat janë marrë gjithsejtë 31 vendime. Në këtë kuadër, Bordi ka arritur të realizoj në mënyrë të plotë Planin Vjetor të Punës për vitin 2025, të miratuar paraprakisht.

Bordi i Bankës Qendrore, si një nga organet vendimmarrëse të BQK-së, duke u bazuar në rekomandimet e Bordit Ekzekutiv ka shqyrtuar dhe ka aprovuar nxjerrjen dhe plotësimin e rregulloreve nga fusha e sistemit financiar, si në vijim:

1. Rregullore për Menaxhimin e Rrezikut Operacional të Siguruesve;
2. Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Kontrollat e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm;
3. Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Kontrollat e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm për Fondet Pensionale;
4. Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Kontrollat e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm të Institucioneve Financiare Jo bankare;
5. Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Kontrollat e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm të Institucioneve Mikrofinanciare;
6. Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Kontrollat e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm të Siguruesve;
7. Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Llogaritjen e Kufirit Minimal të Aftësisë Paguese Adekuatshëmërisë së Kapitalit dhe Fondit Garantues për Siguruesit Jo Jetë;
8. Rregullore për Shtesat Makroprudenciale të Kapitalit;
9. Rregulloren për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus;
10. Rregullore për Licencimin e Operatoreve të Shërbimeve të Kripto-Aseteve që Ofrojnë Shërbimin e Këmbimit të Kripto-Aseteve;
11. Rregullore për Sistemet e Informacionit dhe Menaxhimin e Rrezikut Kibernetik;
12. Rregullore për Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare;
13. Rregullore për Llogaritë dhe Shërbimet ndaj Klientëve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës;

14. Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Procesin e Trajtimit të Ankesave nga Institucionet Financiare;
15. Rregullore për Qasjen e Ofruesve të Shërbimeve të Pagesave Jo-banka në Sistemet e Pagesave;
16. Rregullore për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit;
17. Rregullore për Informacionet që duhet të Shoqerojnë Transferet e Fondeve dhe Kripto-Aseteve;
18. Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Licencimin e Bankave dhe Degëve të Bankave të Huaja;
19. Rregullore për Regjistrin e Llogarive.

Bordi i Bankës Qendrore, gjithashtu ka miratuar:

- Raportin vjetor të BQK-së për vitin 2024;
- Pasqyrat Financiare të BQK-së për vitin 2024 dhe Raportin e Auditorit të Pavarur;
- Buxhetin Vjetor të BQK-së për vitin 2026;
- Raportet dhe pasqyrat periodike të gjendjes financiare të BQK-së;
- Ka adoptuar Kornizën Buxhetore;
- Planin Vjetor (të punës) të Bordit të Bankës Qendrore për vitin 2026;
- Planin Vjetor (të punës) të Auditimit të Brendshëm për vitin 2026.

Me qëllim të përmbushjes së kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i Bankës Qendrore me kohë ka kryer të gjitha detyrat lidhur me:

- Zbatimin e procesit të nominimeve dhe emërimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Shqyrtimin e të gjitha raporteve dhe rekomandimeve të Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorit, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar;

Gjithashtu, Bordi ka ushtruar edhe detyra tjera të cilat kanë qenë në harmoni me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Më 31 dhjetor 2025, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

Bashkim Nurboja, Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore;

Nora Latifi Jashari, anëtare;

Nexhat Kryeziu, anëtar;

Arta Hoxha, anëtare; dhe

Ahmet Ismaili, Guvernator/anëtar.

1.1.Komiteti i Auditimit (KA)

Komiteti i Auditimit (KA) është organ këshillues i emëruar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) në përputhje me nenin 62 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Ai mbështet Bordin e Bankës Qendrore në ushtrimin e funksionit të tij mbikëqyrës, duke ofruar siguri dhe këshillim të pavarur në fushat e kontrollit të brendshëm, menaxhimit të rrezikut, qeverisjes institucionale dhe raportimit financiar.

Misioni i Komitetit është të forcojë integritetin dhe efektivitetin e sistemeve të qeverisjes përmes mbikëqyrjes dhe vlerësimit të:

- cilësisë dhe besueshmërisë së raportimit financiar;
- përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullative;
- efektivitetin të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut;
- pavarësisë dhe performancës së funksionit të Auditimit të Brendshëm;
- bashkëpunimit ndërmjet Auditimit të Brendshëm dhe atij të Jashtëm.

Përbërja, mandati dhe përgjegjësitë e Komitetit janë të përcaktuara në Statutin përkatës të miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore. Komiteti raporton në mënyrë të rregullt mbi aktivitetet dhe vlerësimet e tij.

Përbërja:

Më 31 dhjetor 2025, Komiteti i Auditimit përbëhej nga:

- Nora Latifi-Jashari, Kryetare;
- Nexhat Kryeziu, Anëtar;
- Edona Perjuci-Uka, Anëtare e Jashtme.

Aktivitetet gjatë vitit 2025:

Gjatë vitit 2025, Komiteti i Auditimit zhvilloi gjashtë (6) takime dhe ushtroi në mënyrë aktive rolin e tij mbikëqyrës, duke kontribuar në forcimin e qeverisjes dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit të rrezikut në BQK.

Në veçanti, Komiteti:

- shqyrtoi raportet e Auditimit të Brendshëm dhe mbikëqyri adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve, duke nxitur përmirësime në kontrollet kyçe;
- vlerësoi cilësinë e raportimit financiar dhe diskutoi çështjet kryesore të ngritura nga auditimi i jashtëm;
- analizoi rezultatet e vlerësimit të jashtëm të funksionit të Auditimit të Brendshëm dhe mbështeti zbatimin e rekomandimeve përkatëse;
- shqyrtoi dhe rekomandoi për miratim Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm 2026-2028 dhe Planin Vjetor 2026;
- vlerësoi pavarësinë objektivitetin dhe mjaftueshmërinë e burimeve të Auditimit të Brendshëm;
- mbikëqyri marrëdhëniet dhe koordinimin ndërmjet auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm;
- kontribuoi në forcimin e praktikave të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm në nivel institucional.

Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, Komiteti i Auditimit ka ofruar mbështetje të vazhdueshme për Bordin e Bankës Qendrore në sigurimin e një kuadri të qëndrueshëm dhe efektiv të qeverisjes së BQK-së.

1.2. Komiteti për qeverisje, etikë dhe burime njerëzore

Komiteti për Qeverisje, Etikë dhe Burime Njerëzore (KQEBNJ) është emëruar nga Bordi i Bankës Qendrore në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Rregullën për Procedurat e Punës së Bordit të Bankës Qendrore. Komiteti si organ këshillues ndihmon Bordin e Bankës Qendrore në mbikëqyrjen dhe implementimin e standardeve më të larta të qeverisjes, sjelljes etike dhe burimeve njerëzor brenda Bankës Qendrore.

KQEBNJ në rolin këshillëdhënës ndaj Bordit të BQK-së mbikëqyre:

- Zbatimin e strukturës së përgjithshme të qeverisjes së BQK-së për të vlerësuar nëse ajo është e përshtatshme, efikase dhe transparente dhe konform kërkesave ligjore dhe rregullative, si dhe në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare;
- Përputhshmërinë e politikave të qeverisjes, etikes dhe burimeve njerëzore me kornizën ligjore dhe rregullative, në fushat që i përkasin mandatit të Komitetit.
- Zbatimin e Kodit të Etikës dhe Mirësjelljes të Bankës Qendrore dhe vlerëson nevojën e rishikimit periodik të tij, i cili përfshinë vetëdijesimin e punonjësve mbi parimet etike;
- Politikatat dhe mekanizmat për raportimin dhe trajtimin e çështjeve etike dhe konflikteve të interesit;
- Përshtatshmërinë dhe zbatimin e politikave të rekrutimit, trajnimit, vlerësimit të performancës, kompensimit të punonjësve të BQK-së, si dhe parimin e vazhdimësisë;
- Përshtatshmërinë dhe zbatimin e politikave të BQK-së për tërheqjen, zhvillimin dhe mbajtjen e talentëve të nevojshëm për të përmbushur misionin e saj.

Përbërja, mandati dhe detyrat e Komitetit janë të përcaktuara në Statutin përkatës të miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore, ndërsa Komiteti raporton rregullisht mbi aktivitetet dhe vlerësimet e tij.

Përbërja:

Më 31 dhjetor 2025, Komiteti për Qeverisje, Etikë dhe Burime Njerëzore përbëhej nga:

- Arta Hoxha, Kryetare;
- Bashkim Nurboja, Anëtar.

Aktivitetet gjatë vitit 2025:

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, Komiteti për Qeverisje, Etikë dhe Burime Njerëzore zhvilloi gjithsej katër (4) takime. Përmes punës së tij, Komiteti ka kontribuar në forcimin e praktikave të qeverisjes, avancimin e standardeve etike dhe përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore në BQK, duke ofruar këshilla dhe rekomandime për Bordin dhe menaxhmentin e Bankës Qendrore.

Aktivitetet kryesore gjatë vitit 2025 përfshijnë:

- Hartimin e Planit Vjetor të Punës së KQEBNJ-së dhe inicimin e ndryshimeve në Statutin e Komitetit;
- Ofrimin e këshillave dhe rekomandimeve në fushën e qeverisjes korporative, si dhe përcjelljen e zbatimit të tyre;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të strukturës organizative dhe shqyrtimin e politikave dhe praktikave të qeverisjes së BQK-së;
- Rishikimin e politikave dhe mekanizmave që lidhen me etikën, konfliktin e interesit dhe sinjalizimin e rasteve;
- Shqyrtimin e politikave dhe praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, përfshirë rekrutimin, zhvillimin profesional dhe vlerësimin e performancës së personelit;
- Diskutimin dhe rekomandimin për avancimin e kornizës së vlerësimit të performancës dhe akteve të tjera të brendshme në fushën e burimeve njerëzore;
- Raportimin e rregullt në Bordin e BQK-së mbi aktivitetet dhe rekomandimet e Komitetit.

Hartimi i kornizës rregullative:

Komiteti ka draftuar Statutin e Komitetit i cili është miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore pas shqyrtimeve përkatëse.

2. Bordi Ekzekutiv

Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës përbëhet nga Guvernatori, në cilësinë e kryesuesit të Bordit Ekzekutiv, dhe Zëvendësguvernatorët. Më 31 dhjetor 2025, Bordi Ekzekutiv përbëhej nga Ahmet Ismaili, Guvernator; Dardan Fusha, Zëvendësguvernator për Operacione Bankare; Milot Cakaj, Zëvendësguvernator për Mbikëqyrje Financiare; dhe Nesrin Shileku Shala, Zëvendësguvernatorë për Funksione të Përgjithshme. Kompetencat e Bordit Ekzekutiv janë të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Në përputhje me këtë mandat, Bordi Ekzekutiv është përgjegjës për politikëbërjen, administrimin dhe ushtrimin e operacioneve të BQK-së, ndërsa veprimtaria e tij mbikëqyret nga Bordi i Bankës Qendrore.

Gjatë vitit 2025, Bordi Ekzekutiv zhvilloi aktivitetin e tij përmes 42 mbledhjeve, në të cilat u shqyrtuan 376 lëndë të veçanta për vendimmarrje dhe informim, në përputhje me kompetencat e përcaktuara ligjore dhe rregullative. Në të njëjtën periudhë, Bordi Ekzekutiv nxori 113 vendime të veçanta, që mbuluan fushat kryesore të përgjegjësive të tij institucionale.

Në fushën rregullatore dhe mbikëqyrëse, gjatë vitit 2025, Bordi Ekzekutiv miratoi dy instrumente rregullatore në formë udhëzimesh të aplikueshme për sistemin financiar të vendit. Në të njëjtën fushë të kompetencave, miratoi regjistrimin e një institucioni financiar jobankar. Gjithashtu, në mbështetje të objektivave parësore të BQK-së dhe bazuar në punën e njësive organizative përgjegjëse, në tetë raste u shqiptuan masa mbikëqyrëse të veçanta ndaj institucioneve financiare dhe palëve të lidhura, përfshirë revokimin e licencës së një ndërmjetësuesi të sigurimeve.

Në aspektin e administrimit të brendshëm dhe planifikimit institucional, Bordi Ekzekutiv miratoi planin vjetor të punës, si dhe planet e veçanta për realizimin e operacioneve dhe administrimin e BQK-së. Gjatë vitit 2025, Bordi Ekzekutiv miratoi gjithashtu nxjerrjen, ndryshimin dhe plotësimin e 33 akteve dhe dokumenteve të tjera të brendshme, si dhe mbikëqyri raportimet e komiteteve dhe organeve të tjera të brendshme relevante për ushtrimin e kompetencave të tij. Përveç këtyre, Bordi Ekzekutiv ushtroi edhe detyra të tjera në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Në kuadër të bashkëveprimit me Bordin e Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv shqyrtoi dhe përgatiti për procedim 19 rregullore të aplikueshme për sistemin financiar të vendit, raportin vjetor të BQK-së, si dhe raportet, pasqyrat dhe planet financiare të institucionit. Po ashtu, në funksion të raportimit dhe llogaridhënies institucionale, Bordi Ekzekutiv përgatiti dhe komunikoi raporte dhe informata të rregullta dhe ad hoc lidhur me ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të tij.

Brenda fushëveprimit të kompetencave ekzekutive funksionojnë edhe këto komitete:

- Komiteti Këshillëdhënës për Makroprudencë
- Komiteti i Investimeve
- Komiteti i Riskut

Gjatë vitit 2025, këto komitete zhvilluan aktivitetin e tyre në përputhje me përcaktimet përkatëse në termat e referencës, duke mbajtur gjithsej 11 takime: Komiteti Këshillëdhënës për Makroprudencë mbajti 4 takime, Komiteti i Investimeve 3 takime dhe Komiteti i Riskut 4 takime.

3. Auditimi i Brendshëm

Auditimi i Brendshëm (AB) është një funksion i pavarur dhe objektiv që ofron siguri të arsyeshme për Bordin e Bankës Qendrore, Komitetin e Auditimit dhe Bordin Ekzekutiv të BQK, lidhur me efektivitetin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit të brendshëm dhe qeverisjes.

Në përmbushje të mandatit të tij ligjor dhe institucional, AB operon me pavarësi të plotë funksionale dhe organizative, duke kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e mekanizmave të llogaridhënies, transparencës dhe integritetit institucional, në bashkëpunim dhe koordinim me Auditimin e Jashtëm.

Aktiviteti auditues dhe mbulimi i rrezikut

Gjatë vitit 2025, AB ka realizuar aktivitetin auditues në përputhje me Planin Vjetor të Auditimit të bazuar në rrezik, i hartuar sipas metodologjisë së vlerësimit të rrezikut të institucionit. Aktivitetet audituese kanë përfshirë auditime financiare, të pajtueshmërisë, operacionale dhe të teknologjisë së informacionit, duke adresuar fushat me rëndësi të lartë për arritjen e objektivave strategjike të Bankës Qendrore.

Rezultatet kryesore

Bazuar në auditimet e realizuara gjatë vitit 2025, Auditimi i Brendshëm vlerëson se:

- Sistemi i kontrollit të brendshëm në përgjithësi është efektiv, duke ofruar një nivel të arsyeshëm sigurie mbi arritjen e objektivave institucionale;
- Nuk janë identifikuar dobësi materiale që të komprometojnë në mënyrë thelbësore funksionimin e Bankës Qendrore;
- Megjithatë, janë identifikuar hapësira për përmirësim të mëtejshëm, të cilat kryesisht ndërlidhen me forcimin e kuadrit rregullativ, si dhe përmirësimin dhe konsolidimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në procese dhe funksione specifike.

Rekomandimet e Auditimit të Brendshëm janë fokusuar në:

- përditësimin dhe harmonizimin e politikave dhe procedurave të brendshme,
- rritjen e formalizimit dhe standardizimit të proceseve,
- forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes së brendshme.

Gjatë vitit raportues:

- është siguruar monitorim sistematik i zbatimit të rekomandimeve,
- është vërejtur progres i qëndrueshëm në adresimin e dobësive dhe përmirësimin e kontrollit të brendshëm.

Qeverisja dhe raportimi

Shefi i Auditimit të Brendshëm ka raportuar rregullisht tek Komiteti i Auditimit dhe Bordin e Bankës Qendrore, duke siguruar transparencë mbi:

- realizimin e planit të auditimit,
- çështjet kryesore të identikuara,
- nivelin e zbatimit të rekomandimeve.

Gjatë vitit 2025 janë mbajtur gjashtë (6) takime të Komitetit të Auditimit, ku janë trajtuar në mënyrë sistematike çështjet që lidhen me efektivitetin e kontrollit të brendshëm, menaxhimin e rrezikut dhe qeverisjen institucionale.

Përputhshmëria dhe cilësia

Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm është zhvilluar në përputhje me:

- Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (përfshirë nenin 61),
- Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm (2024/2025).

AB ka vijuar zbatimin e rekomandimeve të dala nga vlerësimet e jashtme, përfshirë ato nga:

- Banka e Holandës (De Nederlandsche Bank),
- Fondi Monetar Ndërkombëtar (Safeguards Assessment),
- Auditorët e Jashtëm.

Planifikimi strategjik dhe zhvillimi i funksionit

Në funksion të një qasjeje të strukturuar dhe afatgjatë, AB ka hartuar:

- Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2026–2028,
- Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2026,

të cilat janë diskutuar me Komitetin e Auditimit dhe miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore.

Zhvillimi profesional dhe bashkëpunimi

Stafi i Auditimit të Brendshëm ka vijuar zhvillimin profesional përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe aktivitete ndërkombëtare, me qëllim rritjen e kapaciteteve në fusha kyçe si auditimi i teknologjisë së informacionit, menaxhimi i rrezikut dhe qeverisja.

Bashkëpunimi me Auditorët e Jashtëm është zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme dhe të strukturuar, duke kontribuar në një qasje të koordinuar të sigurimit në nivel institucional.

4. Funkzioni i Menaxhimit të Rrezikut

Menaxhimi i rrezikut (MR) në BQK është i orientuar drejt arritjes së objektivave të përcaktuara me ligj dhe monitorohet e mbikëqyret me një qasje të strukturuar sistematike, e përcaktuar nga kuadri i përgjithshëm i MR-së. Ky kuadër përcakton llojet kryesore të rrezikut (rrezikun strategjik, operacional dhe financiar) me të cilët BQK përballlet dhe menaxhon. Pjesë e kuadrit janë proceset për identifikim, analizim dhe vlerësim të rrezikut që përcillen me përgjigje adekuate ndaj rrezikut dhe monitorimit të nivelit të rrezikut sipas kuadrit rregullues në fuqi.


Zhvillimi dhe përditësimi i kuadrit të MR në BQK mbështetet mbi parimet të cilat sigurojnë menaxhimin efektiv dhe efikas të rrezikut në funksion të arritjes së objektivave institucionale. Menaxhimi i rrezikut nuk trajtohet si proces i veçuar, por si pjesë integrale e qeverisjes institucionale dhe të gjitha proceseve të punës, përfshirë planifikimin strategjik dhe menaxhimin e projekteve.

BQK, në përputhje me praktikat më të mira, ka adoptuar modelin e tri linjave mbrojtëse për menaxhimin e rrezikut:

Figura 2. Njësitë organizative-bartësit e proceseve

Linja e parë mbrojtëse - Njësitë organizative/bartësit e proceseve kanë përgjegjësinë kryesore për menaxhimin e rrezikut, të cilët zbatojnë kontrole të brendshme për të parandaluar dhe menaxhuar rreziqet që lidhen me aktivitetet e tyre.

Linja e dytë mbrojtëse - Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut ka rol mbikëqyrës, duke siguruar që proceset e menaxhimit të rrezikut janë të përshtatshme dhe efektive, si dhe duke ofruar udhëzime dhe koordinim në zbatimin e politikave dhe strategjive të rrezikut, dhe



Linja e tretë mbrojtëse – Auditimi i brendshëm kryen vlerësime të pavarura për të siguruar që masat e menaxhimit të rrezikut dhe kontrollet e brendshme funksionojnë në mënyrë efektive dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator dhe objektivat strategjike të BQK-së.

Gjatë vitit 2025, Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut ka kontribuar në forcimin e mëtejshëm të qasjes së strukturuar ndaj menaxhimit të rrezikut në BQK. Komiteti ka mbështetur monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe strategjive të menaxhimit të rrezikut, si dhe ka shqyrtuar në mënyrë periodike profilin e përgjithshëm të rrezikut të BQK-së.

Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut (DMR) raporton tek Bordi Ekzekutiv i BQK-së lidhur me aktivitetet e ndërmarra për avancimin e proceseve të menaxhimit të rrezikut dhe mbi zhvillimet që ndikojnë në profilin e përgjithshëm të rrezikut. Po ashtu, DMR ka raportuar në baza tremujore edhe tek Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut dhe Komiteti i Auditimit, duke siguruar koordinim dhe mbikëqyrje efektive të rrezikut në nivel institucional.

BQ Kosovës ka një tolerancë të ulët ndaj rreziqeve të pranueshme, që mund të pengojnë aftësinë e saj për të siguruar ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar dhe arritjen e objektivave të saj.

Në arritjen e objektivave të saj, BQK-ja është e ekspozuar ndaj këtyre kategorive kryesore të rreziqeve:

Rreziku strategjik

Rreziku strategjik është rreziku që ngjarjet e papritura të brendshme dhe të jashtme mund ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave dhe qëllimeve strategjike të BQK-së .

Rreziku financiar

BQK është e ekspozuar ndaj llojeve të ndryshme të rreziqeve financiare duke përfshirë; rrezikun kreditor, rrezikun e tregut, rrezikun e valutës dhe rrezikun e likuiditetit.

Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes që rezulton nga procese, njerëz dhe sisteme të brendshme të pamjaftueshme ose të dështuara ose nga ngjarje të jashtme.

Rreziku i reputacionit

Rreziku i reputacionit i referohet mundësisë që një ngjarje apo veprim i caktuar të dëmtoj imazhin apo reputacionin publik të BQK-së. Si rrjedhojë të rrezikohet dhe të jetë e paaftë në arritjen e objektivave të politikës dhe përmbushjen e përgjegjësive të saj ndaj publikut, punonjësve, palëve të interesuara dhe mbarë ekonomisë.

Rreziku i jashtëm

Rreziku i jashtëm është rreziku që ngjarjet politike, gjeopolitike ose të akterëve të jashtëm të ndikojnë në arritjen e objektivave të BQK-së

Rreziku i mbikëqyrjes

Rreziku i mbikëqyrjes është rreziku që proceset mbikëqyrëse të BQK-së të mos identifikojnë dhe të zbusin rreziqe të rëndësishme për industrinë e shërbimeve financiare ose klientët dhe që kanë një efekt negativ në stabilitetin e tregut ose konkurrencën efektive.

DMR përbëhet nga dy divizione, për menaxhimin e rrezikut operacional dhe menaxhimin e rrezikut financiar.

4.1. Menaxhimi i Rrezikut Operacional

Divizioni i menaxhimit të rrezikut operacional në kuadër të Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut ka të zhvilluar Sistemin e Menaxhimit të Rrezikut, i cili mbështet proceset e identifikimit, vlerësimit, raportimit dhe monitorimit të rreziqeve brenda BQK-së. Ai siguron mbledhjen e të dhënave të nevojshme për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve dhe mundëson krijimin e raporteve të rregullta për monitorimin e tyre. Përmes këtij sistemi, BQK trajton në mënyrë efektive dhe të koordinuar çdo lloj rreziku, duke mundësuar që të merren masa proaktive dhe reaktive për të mbajtur nën kontroll ndikimet e mundshme të rreziqeve dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e operacioneve të saj.

Për secilin rrezik të identifikuar përcaktohet edhe burimi i rrezikut, i cili mund të ketë ndikim në arritjen e objektivave strategjike dhe operacionale të bankës. Rreziqet operative mund të vijnë nga procese të brendshme joefektive, dështime të sistemeve, ngjarje të jashtme ose gabime njerëzore. Figura e mësipërme tregon burimet e rreziqeve të identifikuara në fund të vitit 2025 dhe ndikimi potencial i tyre.

BQK-ja është anëtare e International Operational Risk Working Group (IORWG), një grup punues ndërkombëtar që bashkon banka qendrore dhe autoritete monetare e mbikëqyrëse me qëllim zhvillimin dhe avancimin e praktikave më të mira në menaxhimin e rrezikut operacional.

Anëtarësia në IORWG i mundëson BQK-së shkëmbim të vazhdueshëm të njohurive dhe përvojave, krijim dhe forcim të rrjeteve profesionale si dhe zhvillim të njohurive të specializuara për temat e

rrezikut operacional përmes pjesëmarrjes në grupe ekspertësh me fokus ndërkombëtar. Përmes angazhimit në këtë grup punues, BQK kontribuon dhe përfiton nga praktikatat e avancuara të menaxhimit të rrezikut operacional, duke forcuar më tej kornizën e saj institucionale dhe kapacitetet profesionale në këtë fushë.

Për të forcuar kulturën e rrezikut të BQK-së, në vitin 2025 janë zhvilluar programe vetëdijesimi lidhur me menaxhimin e rrezikut operacional të cilat programe janë ekzekutuar në mënyrë periodike. Për t'i kontribuar ngritjes së vetëdijesimit rreth raportimit të incidenteve, zhvillimit dhe raportimit të indikatorëve kyç të rrezikut dhe çështjeve tjera që kanë të bëjnë me menaxhimin e rrezikut, janë zhvilluar udhëzues dhe procedura lehtë të qasshme për stafin. Gjatë periudhave tremujore të

raportimit të vetëvlerësimeve dhe indikatorëve të rrezikut, janë mbajtur takime me të gjitha njësitë raportuese me qëllim të ofrimit të udhëzimeve për identifikim të rrezikut dhe vlerësim të kontrolleve për zbutje të rrezikut. Gjithashtu, pas çdo zhvillimi dhe avancimi të proceseve dhe instrumenteve mbështetëse, janë organizuar takime me njësitë organizative në mënyrë që të ofrohen informacionet e nevojshme për zbatim të kërkesave të reja të nxjerra përmes këtyre akteve.

Proceset për identifikim, analizim dhe vlerësim të rrezikut të cilat përcillen me përgjigje ndaj rrezikut dhe monitorim të nivelit të tij, janë dizajnuar për të qenë në shërbim të arritjes së objektivave strategjike të BQK-së, duke vënë në pah mundësitë dhe rreziqet potenciale. Për të arritur këtë është bërë lidhja në mes qëllimeve strategjike, proceseve të punës që ndihmojnë arritjen e këtyre objektivave dhe rreziqeve që mund të rrezikojnë arritjen e tyre. Për secilën fazë të ciklit të menaxhimit të rrezikut janë zhvilluar procedura, forma dhe vegla për të mbështetur identifikimin, vlerësimin, raportimin dhe monitorimin e nivelit të rrezikut në BQK.


Funksioni i Menaxhimit të Rrezikut ka përgatitur raporte të konsoliduara me rezultatet e nxjerra pas analizave dhe vlerësimeve duke përdor instrumentet e zhvilluara për këtë qëllim. Raportet si produkte finale të dalta pas ekzekutimit të proceseve të menaxhimit të rrezikut janë standardizuar dhe përshtatur për palët e interesit.

BQK i kushton rëndësi të veçantë vazhdimësisë së shërbimeve të saj. Banka planifikon, zbaton dhe monitoron vazhdimisht lloje të ndryshme aktivitetesh që kontribuojnë në ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve të saj kritike dhe rrisin qëndrueshmërinë e bankës në përgjithësi.

Procesi i Analizës së Ndikimit të Biznesit (BIA) është procesi i përcaktimit të burimeve të kërkuara për proceset e shërbimeve kritike të bankës dhe bën të mundur identifikimin e të gjitha burimeve teknike, njerëzore dhe logjistike të nevojshme për ofrimin e këtyre shërbimeve. Ky proces gjithashtu bën identifikimin e palëve të treta të përfshira në ofrimin e shërbimeve kritike, vlerësimin e rreziqeve të mundshme që mund të çojnë në ndërprerjen ose ndërprerjen e ofrimit të shërbimeve, si dhe përcaktimin e kohës minimale që biznesi mund të tolerojë për ndërprerjen e shërbimit dhe afatin kohor të rikuperimit të këtij shërbimi.

Në vitin 2025 është testuar plani i vazhdimësisë së biznesit për të kryer shërbime përkatëse në situata të jashtëzakonshme.

Grafiku 112. Burimet e rreziqeve




Burimi: BQK (2026)

4.2. Menaxhimi i Rrezikut Financiar


BQK menaxhon rezervat e saj bazuar në parimet e sigurisë, likuiditetit dhe kthimit nga investimet. Rreziku financiar i referohet mundësisë që BQK-ja të pësoj humbje financiare si pasojë e ndryshimeve të papritura apo të pakontrolluara në tregje financiare.

Grafiku 113. Struktura e rezervave të BQK-së me 31 dhjetor 2025, në % gjithsej rezervat: EUR 1,695.7 milion




Burimi: BQK (2026)

Grafiku 114. Struktura e rezervave të BQK-së me 31 dhjetor 2024, në % gjithsej rezervat: EUR 1,618.5 milion




Burimi: BQK (2026)

Grafik 115. Klasifikimi kreditor i rezervave të BQK-së 31 dhjetor 2025



Burimi: BQK (2026)

Grafik 116. Klasifikimi kreditor i rezervave të BQK-së 31 dhjetor 2024



Burimi: BQK (2026)

Rreziqet që i përkasin menaxhimit të mjeteve nga ana e BQK-së përbëhen kryesisht nga rreziqet financiare si rreziku kreditor, rreziku i tregut dhe rreziku i likuiditetit.

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare për BQK-në nëse një palë kontraktuese e instrumenteve financiare dështon t'i përmbush detyrimet kontraktuale të saj dhe rrjedh kryesisht nga investimet e BQK-së në letra me vlerë dhe depozita (në tregjet e parasë apo llogari rrjedhëse) në banka të tjera;


Rreziku i tregut është rreziku i humbjeve që rrjedhin nga lëvizjet e çmimeve të tregut si rezultat i ndryshimeve në normat e interesit, normat e këmbimit valutor, çmimet e kapitalit dhe çmimet e mallrave;

Rreziku i likuiditetit nënkupton mundësinë e humbjes financiare si rezultat i mos përmbushjes në kohë të duhur të obligimeve që rrjedhin nga detyrimet financiare;


Rreziku Kreditor

Investimi i mjeteve të BQK-së bëhet në letrat me vlerë të emetuara nga shtetet stabile dhe të zhvilluara, agjencitë më kredibile të Eurozonës, dhe institucionet supranacionale me vlerësim të lartë kreditor investiv nga agjencitë kreditore ndërkombëtare si Standard&Poor's, Moody's, Fitch si dhe në letrat me vlerë të Republikës së Kosovës.

Grafiku 117. Humbja e pritur kreditore sipas llojit të ekspozimeve



Grafiku 118. Humbja e pritur kreditore në raport me vlerë e ekspozuar sipas llojit të ekspozimeve ECL/EAD




BQK menaxhon rrezikun kreditor duke investuar në instrumente financiare me vlerësim të lartë kreditor. Të gjitha investimet realizohen në raport me kriteret e rangimit afatshkurtër dhe afatgjatë kreditor të përcaktuar në Politikën e Investimeve dhe Udhërrëfyesin për Investimet e Portfolios së Rezervave Ndërkombëtare, ku vlerësimi kreditor minimal i pranueshëm është Baa3/BBB- (Moody's/S&P). Po ashtu, për të realizuar diversifikim të investimeve në instrumente financiare sipas Politikës së Investimeve dhe Udhërrëfyesit për Investimet e Portfolios së Rezervave Ndërkombëtare janë përcaktuar kufizime të koncentrimit gjeografik në një shtet të vetëm, në nivel të llojit të emetuesit, vlerësimin kreditor, maturitetit si dhe limite individuale në nivel të palëve të kundërta të miratuara.

Rreziku i tregut


BQK nuk është e ekspozuar ndaj ndryshimeve të çmimeve të letrave me vlerë të ekuitetit dhe çmimeve të mallrave. BQK ka ekspozime ndaj ndryshimit të normave të interesit dhe kursit të këmbimit.

Rreziku i normës së interesit është ekspozimi i fitimeve dhe ekuitetit të BQK-së ndaj ndryshimeve të pafavorshme në normat e interesit, që rrjedh kryesisht nga mospërputhja në kohë e maturimit ose ri-çmimit të pasurive dhe detyrimeve. BQK me qëllim të menaxhimit efektiv të rrezikut të normës së interesit, monitoron në baza të rregullta se si ndryshimet në normat e interesit do të ndikojnë në vlerë ekonomike të ekuitetit si dhe në fitimet e saj. BQK e menaxhon ekspozimin ndaj ndryshimeve të normave të interesit në vlerën ekonomike të ekuitetit duke investuar kryesisht në instrumente afatshkurtra (deri në 1 vit), si letra me vlerë dhe depozita.

Grafik 119. Përbërja e rezervës sipas valutës- 31 dhjetor 2025



Grafik 120. Përbërja e rezervës sipas valutës- 31 dhjetor 2024




Rreziku i kursit të këmbimit është rreziku i humbjes nga ndryshimet në kursin e këmbimit. BQK në portfolion e saj ka instrumente financiare në valuta jo euro në një përqindje të ulët, si rrjedhojë ekspozimi ndaj rrezikut valutor vlerësohet të jetë i ulët. Ndryshimet ndër-valutore ndikojnë në bilancet e llogarive të rivlerësimit në pasqyrën e pozitës financiare si dhe në fitim apo humbje në pasqyrën e të ardhurave. Me 31 dhjetor 2025 pjesëmarrja e valutave jo euro është 8.2% SDR, 3.2%

dollari amerikan dhe 0.3% funta angleze, ndërsa me 31 dhjetor 2024 pjesëmarrja e valutave jo euro është 9.5% n SDR dhe 3.7% dollari amerikan.

Rreziku i likuiditetit është rreziku në përmbushjen në kohë të duhur të obligimeve që rrjedhin nga detyrimet financiare. Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet, si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo rrezikuar dëmtimin e reputacionit të BQK-së. Rrezikun e likuiditetit BQK e menaxhon duke investuar në instrumente financiare likuide si në letra me vlerë me likuiditet të lartë, llogaritë nostro në banka korrespondente dhe depozita në tregun e parasë me maturitet jo më të gjatë se një vit. Me 31 dhjetor 2025, € 994 milionë e rezervës të BQK-s ka maturitet të mbetur deri në tre muaj, ndërsa me 31 dhjetor 2024, € 952 milionë e rezervës kishte maturitet të mbetur deri në tre muaj.

Grafiku 121. Rezervat sipas maturitetit



Burimi: BQK (2026)

4.3. Aktiviteti i BQK-së në aspektin e pajtueshmërisë

Në kuadër të forcimit të mëtejshëm të kornizës së qeverisjes institucionale dhe sistemit të kontrollit të brendshëm, më 1 janar 2025 Divizioni i Pajtueshmërisë është funksionalizuar si divizion i mëvetësishëm në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Ngritja e këtij funksioni në status të pavarur përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt harmonizimit të praktikave institucionale me standardet ndërkombëtare dhe parimet e menaxhimit efektiv të rrezikut të pajtueshmërisë.

Gjatë vitit raportues 2025 është hartuar dhe miratuar Politika e Pajtueshmërisë e cila përcakton kornizën për identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe menaxhimin e rrezikut të Pajtueshmërisë në nivel të BQK-së. Kjo Politikë përbën një element kyç në ndërtimin e një kornize të strukturuar dhe efektive të menaxhimit të rrezikut të Pajtueshmërisë dhe vendos bazat për zhvillimin e mëtejshëm të këtij funksioni.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë hapa konkretë drejt ngritjes së kapaciteteve institucionale të Divizionit të Pajtueshmërisë, përfshirë zhvillimin e procedurave të brendshme, ofrimin e këshillimit për njësitë organizative dhe promovimin e kulturës së pajtueshmërisë në institucion në të gjitha nivelet, në përputhje me parimin e përgjegjësisë së menaxhimit për sigurimin e pajtueshmërisë (ang. tone at the top).

Gjatë vitit 2025 Divizioni i Pajtueshmërisë ka operuar në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi, duke kontribuar në mënyrë aktive në forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe integritetit institucional. Në këtë periudhë Banka Qendrore e Republikës së

Kosovës ka miratuar dhe avancuar një numër të konsiderueshëm aktesh të brendshme rregullative dhe nënligjore, me qëllim të forcimit të kornizës rregullative dhe avancimit të funksionimit institucional, në përputhje me mandatin ligjor dhe standardet ndërkombëtare për Bankat Qendrore.

Në këtë drejtim, Divizioni i Pajtueshmërisë ka luajtur një rol të rëndësishëm këshillues dhe parandalues, përmes ofrimit të opinioneve të pavarura të pajtueshmërisë lidhur me draftimin, rishikimin dhe miratimin e akteve të brendshme, duke u bere kështu pjese integrale e proceseve te brendshme te vendimmarrjes, si vlere e shtuar ne sigurimin e pajtueshmërisë ligjore dhe praktikave me te mira institucionale.

Në funksion të avancimit të njohurive dhe praktikave në fushën e pajtueshmërisë, si dhe të ndërlidhjes së saj me menaxhimin e rrezikut, gjatë vitit 2025 janë realizuar dy vizita zyrtare, në OeNB (Bankën Qendrore të Austrisë) dhe në Banca d'Italia (Bankën Qendrore të Italisë). Përvojat e fituara nga këto vizita kanë kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të Divizionit të Pajtueshmërisë.

Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 kanë kontribuar në vendosjen e bazave për zhvillimin e mëtejshëm të funksionit të pajtueshmërisë në BQK.

5. Burimet Njerëzore

Menaxhimi dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor ka vazhduar të mbetet një ndër prioritetet kryesore institucionale të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) edhe gjatë vitit 2025. Në përputhje me objektivat strategjike të institucionit dhe prioritetet e përcaktuara në Strategjinë Institucionale, BQK-ja ka vazhduar të zhvillojë kapacitetet e saj profesionale përmes një qasjeje të integruar të menaxhimit të burimeve njerëzore.

BQK-ja e konsideron kapitalin njerëzor si një nga asetet më të rëndësishme për realizimin efektiv të mandatit të saj, për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe për mbështetjen e stabilitetit dhe zhvillimit të sistemit financiar në Republikën e Kosovës.

Në fund të vitit 2025, numri i përgjithshëm i të punësuarve në BQK arriti në 253 punonjës. Struktura gjinore e stafit mbetet relativisht e balancuar, ku 54.9% e stafit përbëhet nga femra, ndërsa 45.1% nga meshkuj, duke reflektuar angazhimin e institucionit për promovimin e barazisë dhe përfshirjes në vendin e punës.

Në nivel të pozitive udhëheqëse, 42.6% e pozitive mbahen nga femrat, ndërsa 57.4% nga meshkujt, duke pasqyruar përpjekjet e vazhdueshme për të siguruar përfaqësim të balancuar në proceset vendimmarrëse.

Mosha mesatare e stafit është 42 vjeç, ndërsa përvoja mesatare e punës në BQK është rreth 11.7 vite, çka dëshmon për një nivel të konsiderueshëm të përvojës institucionale dhe për vazhdimësinë profesionale brenda institucionit.

Stafi i BQK-së karakterizohet nga një nivel i lartë i kualifikimit profesional dhe akademik. Rreth 1.6% e stafit ka përfunduar studimet e doktoraturës, 43.9% studime pasuniversitare, ndërsa 46.6% studime universitare. Një përqindje më e vogël e stafit përbëhet nga punonjës me arsim të mesëm 7.5%, ndërsa 0.4% ka edukim bazik.


Kjo strukturë reflekton përkushtimin e institucionit për zhvillimin e një stafi me ekspertizë të specializuar në fushat që lidhen me funksionet dhe mandatin e bankës qendrore.

Investimi në zhvillimin profesional të stafit mbetet një element kyç i menaxhimit të burimeve njerëzore në BQK. Gjatë vitit 2025, punonjësit e institucionit kanë marrë pjesë në 212 aktivitete trajnuese, duke përfshirë trajnime profesionale, seminare, punëtori dhe vizita studimore të organizuara në formatin fizik dhe online.

Këto aktivitete janë realizuar në bashkëpunim me institucione të rëndësishme ndërkombëtare dhe banka qendrore homologe, përfshirë Fondin Monetar Ndërkombëtar (IMF), Bankën Botërore, Joint Vienna Institute (JVI), Center of Excellence in Finance (CEF), OECD/INFE dhe Këshillin e Evropës, si dhe banka qendrore partnere si Banque de France, Deutsche Bundesbank, Banca d'Italia, Banka e Anglisë, Banka Qendrore e Hungarisë dhe Banka Qendrore e Polonisë.

Përveç aktiviteteve trajnuese, gjatë vitit 2025, 26 punonjës të BQK-së kanë përfituar certifikime profesionale, duke kontribuar në forcimin e ekspertizës profesionale dhe në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve teknike të institucionit.

Grafik 122. Struktura sipas edukimit



Burimi: BQK (2026)

Burimi: BQK (2026)

Trajnimet kanë mbuluar fusha të ndryshme që lidhen drejtpërdrejt me funksionet e bankës qendrore, përfshirë mbikëqyrjen financiare, stabilitetin financiar, sistemet e pagesave, tregjet financiare, menaxhimin e rezervave, teknologjinë financiare dhe sigurinë kibernetike, si dhe tema që lidhen me qeverisjen institucionale, menaxhimin e rreziqeve dhe financat e qëndrueshme.

Shpërndarja e stafit sipas shtyllave kryesore organizative paraqitet relativisht e balancuar ndërmjet funksioneve kryesore të institucionit. Kjo shpërndarje e stafit reflekton strukturën funksionale të institucionit dhe mbështet realizimin e mandatit të Bankës Qendrore në fushat e mbikëqyrjes financiare, stabilitetit financiar dhe operacioneve bankare.


Gjatë vitit 2025, proceset e rekrutimit janë fokusuar në forcimin e kapaciteteve profesionale në funksionet kryesore të institucionit, në përputhje me mandatin dhe përgjegjësitë ligjore të BQK-së. Rekrutimi është

orientuar kryesisht në departamentet që mbështesin realizimin e funksioneve sipas mandatit të bankës qendrore, përfshirë mbikëqyrjen financiare, stabilitetin financiar, operacionet bankare, sistemet e pagesave dhe zhvillimin e infrastrukturës teknologjike.

Paralelisht, gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë hapa për forcimin e politikave të brendshme që lidhen me etikën institucionale, menaxhimin e performancës, zhvillimin profesional dhe sistemin e kompensimeve, si dhe për avancimin e strukturës organizative dhe klasifikimin e vendeve të punës.

Përmes këtyre zhvillimeve, BQK ka vazhduar të forcojë kapacitetet profesionale të institucionit dhe të përmirësojë efikasitetin organizativ në funksion të përmbushjes së mandatit të saj.

Grafik 123. Shpërndarja e stafit sipas shtyllave



Burimi: BQK (2026)

6. Teknologjia informative dhe siguria e informacionit

Gjatë vitit 2025, BQK ka forcuar ndjeshëm sigurinë e informacionit përmes ngritjes së një kuadri të konsoliduar strategjik që orienton institucionin drejt zhvillimit të kapaciteteve, rritjes së qëndrueshmërisë operative dhe përmirësimit të gatishmërisë ndaj rreziqeve kibernetike. Ky kuadër përcakton objektivat strategjike për sigurinë kibernetike dhe ofron drejtimin trevjeçar të zhvillimit, duke u harmonizuar me prioritetet institucionale në fushat e ngritjes së kapaciteteve, digjitalizimit dhe modernizimit të proceseve.

Strategjia e sigurisë kibernetike ka shërbyer si boshti kryesor udhëheqës për të gjitha iniciativat e ndërmarra gjatë vitit.

Kuadri rregullues për sigurinë e informacionit përfaqëson bazën institucionale të qeverisjes së sigurisë. Ky kuadër përfshin një set të plotë rregullash dhe udhëzimesh që mbështesin zbatimin e politikave të sigurisë, duke përcaktuar parimet dhe kërkesat kryesore, mekanizmat për mbrojtjen dhe monitorimin e të dhënave, si dhe udhëzimet që rregullojnë qasjen dhe përdorimin e resurseve teknologjike.

Raportimi i rregullt tek menaxhmenti dhe integrimi i rolit të Zyrtarit Kryesor për Siguri të Informacionit (CISO) në strukturën organizative ka forcuar mbikëqyrjen dhe gatishmërinë ndaj rreziqeve, duke krijuar një qasje të unifikuar në mbarë institucionin.

Në fushën e menaxhimit të rrezikut, është ndërtuar një qasje e standardizuar për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve kibernetike. Kjo qasje analizon kërcënimet, dobësitë, ndikimin dhe gjasat, dokumenton rreziqet në mënyrë të strukturuar dhe mundëson integrimin në sistemin e menaxhimit të rrezikut të institucionit. Në këtë mënyrë sigurohet që masat e kontrollit të jenë proporcionale me nivelin e rrezikut, duke rritur kapacitetet parandaluese si dhe cilësinë e raportimit dhe monitorimit.

Në drejtim të menaxhimit të incidenteve të sigurisë, ka nisur ndërtimi i një mekanizmi gjithëpërfshirës që standardizon proceset e raportimit, përshkruan rolet dhe zinxhirët e përgjegjësive, mundëson reagim të koordinuar dhe rikuperim të kontrolluar, dhe forcon aftësinë institucionale për trajtimin e incidenteve komplekse. Përfundimi i kësaj kornize do të kompletojë ciklin e menaxhimit të sigurisë, nga parandalimi deri te reagimi dhe rikthimi.

Është zbatuar edhe një kornizë e qëndrueshme e ndërgjegjësimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, e cila siguron që stafi të kuptojë rolin e tyre në mbrojtjen e informacionit, zhvillon njohuritë mbi kërcënimet aktuale dhe praktikën e sigurta, dhe në të ardhmen do të zgjerohet edhe për palët e treta. Kjo kornizë integron sigurinë në programet orientuese për punonjësit e rinj dhe synon krijimin e një kulture të qëndrueshme sigurie.

Gjatë vitit 2025, janë bartur disa shërbime në infrastrukturën në Cloud, me qëllim modernizimin e infrastrukturës dhe përmirësimin funksionimit të sistemeve të informacionit. Ky proces ka ndikuar në rritjen e sigurisë së të dhënave, përmirësimin e vazhdueshmërisë së shërbimeve dhe uljen e rrezikut nga ndërprerjet operative. Si rezultat është rritur efikasiteti i punës, është përmirësuar qasja në shërbime dhe është rritur stabiliteti i përgjithshëm i sistemeve në mbështetje të proceseve të biznesit.

Po ashtu, është implementuar lidhja satelitore e internetit, me qëllim sigurimin e vazhdueshmërisë së shërbimeve dhe garantimin e funksionimit të sistemeve edhe në rast të krizave apo ndërprerjes së shërbimeve për proceset kritike të institucionit.

Zhvillim tjetër i rëndësishëm gjatë këtij viti është forcimi i mbrojtjes kundër sulmeve kibernetike ndaj shërbimeve të jashtme që BQK ofron për institucionet e jashtme dhe qytetarët.

Janë ndërmarrë masa shtesë teknike dhe organizative për rritjen e reziliencës së këtyre shërbimeve, me synim garantimin e disponueshmërisë, integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave, si dhe reduktimin e rrezikut nga ndërprerjet apo incidentet kibernetike.

Njëkohësisht, është rritur edhe kapaciteti njerëzor në fushën e sigurisë kibernetike, përmes shtimit të numrit të stafit përgjegjës për funksione kyçe të mbrojtjes, monitorimit dhe reagimit ndaj incidenteve, duke forcuar kështu aftësinë institucionale për menaxhimin efektiv të kërcënimeve kibernetike në rritje.

Në përmbledhje, BQK ka bërë përparim të dukshëm në forcimin e sigurisë së informacionit dhe asaj kibernetike, duke ndërtuar korniza strategjike, operacionale dhe teknike që sigurojnë qeverisje të fortë, procese të standardizuara, menaxhim të qëndrueshëm të rrezikut dhe një kulturë organizative të orientuar drejt sigurisë në të gjitha nivelet.

7. Komunikimi me publikun dhe transparencja institucionale

Gjatë vitit 2025, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka shënuar përparim të konsiderueshëm në fushën e komunikimit me publikun dhe në forcimin e transparencës institucionale, duke reflektuar përkushtimin e saj për qeverisje të hapur dhe rritje të llogaridhënies ndaj publikut, brenda dhe jashtë vendit.

Në funksion të këtij objekti, BQK ka rritur në mënyrë të vazhdueshme volumin dhe shpeshtësinë e publikimeve në kanalet zyrtare të komunikimit, me qëllim sigurimin e informimit të rregullt, të qartë dhe në kohë për zhvillimet kryesore institucionale, ekonomike dhe financiare. Këto aktivitete kanë kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e qasjes së publikut në informacion dhe në funksion të transparencës institucionale.

Njëkohësisht, gjatë vitit raportues 2025, BQK ka intensifikuar angazhimin dhe ndërveprimin me qytetarët, mediat dhe palët e tjera të interesit, përmes komunikimit të drejtpërdrejtë dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm, duke forcuar besimin publik dhe rolin e saj si institucion kyç në ruajtjen e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit.

Komunikimi me publikun gjatë vitit është realizuar përmes:

- Publikimit të komunikatave për media dhe njoftimeve zyrtare, lidhur me vendimet, aktivitetet dhe zhvillimet kryesore të institucionit;
- Publikimit të të dhënave statistikore, raporteve dhe informacionit periodik, përfshirë sektorin bankar, sistemin e pagesave dhe institucionet e tjera financiare;
- Hartimit dhe publikimit të raporteve dhe buletineve periodike, përfshirë analizat mbi stabilitetin financiar dhe zhvillimet makrofinanciare; dhe
- Shpërndarjes së materialeve informuese dhe edukuese, si broshura, përmbajtje multimediale, infografika dhe materiale të tjera me karakter informues dhe edukativ, të orientuara drejt rritjes së njohurive financiare të publikut.

Gjatë vitit 2025 në komunikim me publikun qoftë përmes uebfaqes, rrjeteve sociale të BQK-së apo mediave janë publikuar 184 komunikata prej të cilave gjithsej 110 nga përfaqësimi i drejtpërdrejt i Guvernatorit Ismaili. Kumtesat dhe tekstet e rrjeteve sociale janë realizuar nga aktivitetet e zhvilluara si pjesëmarrje në 82 takime, 19 konferenca, 16 panele, momente të nënshkrimit të 4 memorandumeve, nga 25 publikime te veçanta, 16 aktivitete të ndryshme, 14 njoftime dhe po ashtu 8 njoftime për komunikim me publikun nga Bordi. Lidhur me aktivitetet e Guvernatorit Ismaili, gjatë vitit 2025 ai ka zhvilluar 70 takime apo vizita, ka marr pjesë në 10 konferenca, pjesëmarrjes në 15 panele, nënshkrues i 6 memorandumeve dhe pjesëmarrës i 9 aktiviteteve që lidhen drejtpërdrejt me BQK-në.

Gjatë vitit 2025, Guvernatori i BQK-së ka qenë i pranishëm në mediat vendore, i cituar nga mediat rajonale dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në promovimin e rolit dhe politikave të BQK-së në arenën publike dhe profesionale. Në këtë kuadër, janë realizuar disa intervista, paraqitje që kanë shërbyer për të prezantuar zhvillimet financiare dhe ekonomike në Republikën e Kosovës, avancimin institucional të BQK-së, si dhe qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit financiar të vendit.

Po ashtu, gjatë vitit raportues janë realizuar disa televizione/video me pjesëmarrjen e Guvernatorit Ismaili, përfshirë agjencitë e lajmeve si EkonomiaOnline dhe KosovaPress. Përmes këtyre paraqitjeve publike është synuar rritja e transparencës institucionale, informimi i drejtë i publikut dhe adresimi i çështjeve me interes ekonomik dhe financiar.

Përveç pjesëmarrjes në konferenca, Guvernatori i BQK-së ka qenë i pranishëm edhe në publikime profesionale dhe akademike ndërkombëtare. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2025 në kuadër të BIS – Bank for International Settlements (Banka për Rregullime Ndërkombëtare), janë publikuar punime dhe publikime profesionale, duke reflektuar angazhimin e BQK-së në diskutimet ndërkombëtare mbi politikën monetare, stabilitetin financiar dhe zhvillimet ekonomike globale. Këto publikime kanë kontribuar në rritjen e prezencës profesionale dhe kredibilitetit ndërkombëtar të institucionit.

Gjatë vitit 2025, aktiviteti i publikimeve në rrjetet sociale ka qenë koherent me zhvillimet dhe i qëndrueshëm dhe i mirëstrukturuar. Në llogarinë e Facebook, BQK ka realizuar 235 publikime, ndërsa në LinkedIn janë publikuar 225 postime, derisa në X (ish-Twitter) janë regjistruar 170 publikime, si dhe janë publikuar 13 video në YouTube në llogarinë e BQK-së. Ndërkohë, në profilin e Edukimit Financiar në Facebook janë realizuar 21 publikime, si dhe në Instagram janë publikuar 18 postime. Në profil të Guvernatorit të BQK-së në Facebook janë bërë 129 publikime. Këto të dhëna tregojnë një angazhim të vazhdueshëm në komunikimin digjital përgjatë vitit. Gjatë periudhës 2025 është konsoliduar ndjeshëm prania në rrjetet sociale zyrtare të BQK-së, përmes publikimit të materialeve vizuale dhe përmbajtjeve informuese, përfshirë video mesazhe dhe informacione në platformat LinkedIn, Facebook, X (ish-Twitter) dhe YouTube.

Këto aktivitete kanë kontribuar në forcimin e transparencës institucionale, në përmirësimin e komunikimit me publikun dhe palët e interesit, si dhe në ruajtjen dhe rritjen e besimit publik ndaj BQK-së dhe sistemit financiar në përgjithësi.

Këto kërkesa janë administruar përmes adresës zyrtare të kontaktit info@bqk-kos.org dhe media@bqk-kos.org dhe kontakteve të zyrtarëve përgjegjës për fushat specifike duke reflektuar përkushtimin e institucionit për një qasje të hapur, transparente dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve dhe të gjitha palëve të interesuara.

Sa i përket trajtimit të kërkesave për informim dhe komunikimit me publikun në funksion të përmbushjes së objektivit të saj për transparencë dhe informim të publikut, gjatë vitit 2025, BQK ka trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash për informim nga qytetarët dhe palë të tjera të interesuara. Gjatë vitit 2025 janë dhënë 73 përgjigje për mediat vendore, rajonale dhe ato ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2025 janë trajtuar gjithsej 17 kërkesa për qasje në dokumente publike. Prej tyre, 15 kërkesave u është mundësuar qasje e plotë, 1 kërkesë qasje e pjesshme, ndërsa 1 kërkesë është refuzuar në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Trajtimi efikas dhe në përputhje me legjislacionin i kërkesave për qasje në dokumente publike ka kontribuar në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies institucionale.

7.1 Tryezë bashkëbisedimi me gazetarët e ekonomisë

Gjatë vitit 2025, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës organizoi një tryezë bashkëbisedimi me gazetarët që mbulojnë fushën e ekonomisë dhe sektorin financiar, me qëllim forcimin e komunikimit institucional dhe rritjen e njohurive të tyre mbi publikimet dhe aktivitetet e BQK-së.

Tryeza shërbeu si një platformë edukative dhe profesionale për prezantimin e publikimeve kryesore të BQK-së, përfshirë raportet statistikore, vlerësimet e sistemit financiar, zhvillimet makroekonomike dhe publikimet nga sistemi i pagesave. Përmes prezantimeve tematike dhe diskutimeve interaktive, pjesëmarrësit u njohën më nga afër me burimet e të dhënave dhe analizave që BQK vë në dispozicion të publikut.

Ky aktivitet kontribuoi në rritjen e kapaciteteve profesionale të gazetarëve ekonomikë, promovimin e raportimit të saktë dhe të bazuar në të dhëna, si dhe në forcimin e bashkëpunimit

ndërmjet BQK-së dhe mediave, duke mbështetur transparencën dhe informimin cilësor të publikut për zhvillimet në sektorin financiar dhe ekonomik të vendit.

7.2. Konferenca e Fundvitit me mediet

Gjatë vitit 2025, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka vazhduar forcimin e marrëdhënieve me mediat dhe promovimin e transparencës institucionale përmes aktiviteteve të strukturuar të komunikimit me publikun. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, në fund të dhjetorit 2025 u mbajt Konferenca e rregullt e Fund vitit me gazetarët dhe redaktorët e mediave vendore. Kjo konferencë shërbeu si një platformë e rëndësishme për informimin e opinionit publik mbi arritjet kryesore institucionale gjatë vitit, sfidat me të cilat është përballur BQK-ja, si dhe prioritetet dhe objektivat për periudhën në vijim.

Konferenca u zhvillua në një format të hapur dhe interaktiv, duke u mundësuar përfaqësuesve të mediave që të adresojnë çështje me interes publik dhe të marrin përgjigje të drejtpërdrejta nga drejtuesit e institucionit. Në këtë mënyrë, BQK-ja ka kontribuar në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe komunikimit të qartë mbi zhvillimet në sektorin financiar.

Gjatë kësaj ngjarjeje u theksua rëndësia e rolit të mediave në informimin e drejtë dhe të paanshëm të publikut lidhur me çështjet financiare dhe ekonomike, si dhe u shpreh vlerësimi i BQK-së për kontributin e vazhdueshëm të tyre në pasqyrimin korrekt të aktiviteteve dhe arritjeve institucionale gjatë vitit 2025. Në vazhden e bashkëpunimit të konsoliduar me gazetarët e fushës së ekonomisë dhe financave, si dhe duke u ndërlidhur me praktika tashmë të vendosura si traditë institucionale, gjatë vitit 2025, BQK-ja riktheu organizimin e garës së çmimit për gazetari. Në kuadër të kësaj gare u ndanë çmime për gazetari në zhanret kryesore të gazetarisë, me qëllim të inkurajimit të raportimit profesional, të përgjegjshëm dhe cilësor mbi temat financiare dhe ekonomike.

BQK-ja synon që ndarja e çmimeve për gazetari të vazhdojë si aktivitet i rregullt vjetor, në funksion të forcimit të bashkëpunimit me mediat dhe përmirësimit të cilësisë së informimit publik.

7.3. Çmimi për Shkrimin dhe Raportimin më të mirë në gazetari për Sektorin Financiar

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës shpalli thirrjen tradicionale për Çmimin për Shkrimin dhe Raportimin më të mirë në gazetari për Sektorin Financiar, me qëllim të promovimit të gazetarisë profesionale dhe rritjes së cilësisë së raportimit mbi zhvillimet në sistemin financiar. Kjo nismë synon të nxisë prodhimin e përmbajtjeve analitike, objektive dhe të bazuara në fakte, të cilat kontribuojnë në informimin dhe edukimin financiar të publikut.

Çmimi përfshiu katër kategori: shkrimin më të mirë në gazetë, shkrimin më të mirë në media online, raportimin më të mirë televiziv dhe raportimin më të mirë në radio. Punimet e pranuar u vlerësuan nga një komision i përbërë nga profesionistë të gazetarisë dhe përfaqësues të BQK-së, bazuar në kritere si saktësia, objektiviteti, ndikimi publik, cilësia e hulumtimit dhe kreativiteti në trajtimin e temave financiare.

Përmes kësaj iniciative, BQK-ja vazhdoi të mbështesë zhvillimin e gazetarisë ekonomike në Kosovë dhe të inkurajojë raportimin cilësor për sektorin bankar, sigurimet, pensionet, sistemin e pagesave, gjithë përfshirjen financiare dhe inovacionin financiar. Aktiviteti kontriboi në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet BQK-së dhe mediave, si dhe në rritjen e ndërgjegjësimit publik për çështjet financiare.

Fituesit e çmimeve u shpallën në Konferencën e Fund vitit kuadër të shënimit të përvjetorit të themelimit të BQK-së, duke u nderuar me mirënjohje dhe shpërblime financiare për kontributin e tyre në avancimin e raportimit profesional dhe edukimit financiar në vend.

8. Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Integrimet Evropiane

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) gjate vitit 2025 është bërë Anëtare e Asociuar në Organizatën Ndërkombëtare për Mbrojtje të Konsumatorit Financiar (FinCoNet), e cila promovon praktikën më të mira për të siguruar që produktet dhe shërbimet financiare të jenë të drejta, transparente dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. FinCoNet me seli në Francë, është një organizatë ndërkombëtare e autoriteteve mbikëqyrëse të cilat kanë përgjegjësi për mbrojtjen financiare të konsumatorëve. Organizata aktualisht ka 36 anëtarë përfshirë këtu shtetet e zhvilluara si Kanada, Gjermania, Franca, Australia, Italia dhe Holanda.

Anëtarësimi i BQK-së në FinCoNet do të kontribuojë në forcimin dhe promovimin e mbrojtjes së konsumatorit, duke mundësuar bashkëpunim më të ngushtë me autoritetet mbikëqyrëse homologe në zhvillimin më efikas të kornizës rregullative për mbrojtjen e konsumatorit, me theks të veçantë në mbikëqyrjen efektive të sjelljes së tregut.

Përdorimi i standardeve dhe rekomandimeve të FinCoNet po ashtu është një hap i rëndësishëm për përmirësimin e mbikëqyrjes së praktikave të tregut dhe mbrojtjen e konsumatorëve financiarë në BQK.

Mbi të gjitha, anëtarësimi në FinCoNet (International Financial Consumer Protection Organisation) do t'i ndihmojë BQK-së në zhvillimin e Departamentit të Mbrojtjes së Konsumatorit, veçanërisht Divizionit të Mbikëqyrjes së Praktikave të Tregut. Andaj, përdorimi i udhëzimeve të FinCoNet ndihmon në përmirësimin e transparencës, mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së konsumatorëve nga praktikët e padrejta financiarë. Përmes trajnimeve dhe studimeve të thelluara, FinCoNet ofron një bazë të fortë për të rritur cilësinë e mbikëqyrjes së sjelljes së tregut në sistemin financiar.

8.1. Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare dhe Asistencat Teknike

BQK ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet kyçe ndërkombëtare si Banka Qendrore Evropiane (ECB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore (BB), Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), OECD dhe banka qendrore të rajonit dhe më gjerë.

Gjatë vitit 2025, një delegacion i lartë i BQK-së i kryesuar nga Guvernatori Ismaili, mori pjesë në takimet pranverore dhe vjetore të FMN dhe BB në Washington D.C. Përmes mbi 30 takimeve bilaterale dhe shumëpalëshe me përfaqësues të lartë të FMN-së, BB-së, Bankës së Rezervës Federale të SHBA-së, BERZH-it, Bankës së Francës, Bankës së Italisë, EuroClear, IFC dhe institucioneve të tjera relevante, delegacioni i BQK-së diskutoi për një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi strategjike. Delegacioni mori pjesë aktive në diskutimet për perspektivat ekonomike rajonale dhe globale, duke përfaqësuar Kosovën në nivelet më të larta të dialogut ndërkombëtar financiar.

Përgjatë vitit 2025, FMN ka vazhduar përkrahjen e BQK-së me asistencë teknike në fushat kyçe, si:

1. Menaxhimi i rezervave dhe investimeve- për avancimim e praktikave të menaxhimit të rezervave dhe rrezikut
2. Mbikëqyrja Bankare- për rishikimin e manualit aktual të SREP-së dhe zbatimin e tij në procedurat operative
3. Mbikëqyrja e Sigurimeve- për avancimin e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik

4. Statistikave- përmirësimi i plotësisë së statistikave të financave qeveritare (GFS) për vendimmarrje
5. Stabiliteti financiar- për modelimin e Stres Testeve dhe mision përcjellës për FSSR
6. Rreziku operacional- për rishikimin e kornizës së rrezikut operacional dhe themelimin e Komitetit të Riskut
7. Mbikëqyrja e Sistemeve të TI-së për institucionet financiare – Korniza për menaxhimin e rreziqeve kibernetike dhe instrumentet e nevojshme.
8. Kripto-asete- për avancimin e legjislacionit
9. Rimëkëmbje dhe Përmbyllje- për avancimin e kornizës për menaxhimin e krizave

Një proces i rëndësishëm që ka vazhduar gjatë vitit është analiza për rishikimin e Ligjit për BQK që po ashtu po bëhet me asistencë teknike nga FMN. Rishikimi efektiv nën udhëzimet e FMN-se pritet ndihmojë në adresimin e disa çështjeve në Ligjin aktual të BQK-së, në funksion të mandatit të ri dhe avancimit të qeverisjes.

Në kuadër të asistencës teknike nga FMN, BQK ka kaluar një proces të plotë rishikimi të Kodit të Transparencës së Bankave Qendrore (CBT), i cili përfshiu një vetëvlerësim të brendshëm të mbështetur nga një mision zyrtar i FMN-së në Kosovë në qershor 2025. Gjatë këtij misioni, ekspertët e FMN-së zhvilluan takime me drejtuesit dhe stafin e BQK-së, shqyrtuan kuadrin ligjor, operativ dhe të komunikimit të institucionit, si dhe realizuan konsultime me palë të jashtme për të vlerësuar praktikën e transparencës nga perspektiva e përdoruesve dhe akterëve të tregut. Procesi u përbyll me publikimin e raportit të rishikimit, i cili vlerëson progresin e BQK-së në forcimin e transparencës dhe komunikimit publik, duke e pozicionuar atë në përgjithësi në përputhje me standardet e FMN-së dhe duke identifikuar fusha për përmirësim të mëtejshëm në kuadër të Planit Strategjik 2024–2028.

Në të njëjtën kohë, BQK ka përfituar në mënyrë të vazhdueshme nga asistencë teknike e Bankës Botërore. Gjatë vitit 2025, kjo mbështetje është përqendruar në disa fusha kyçe, me qëllim forcimin e zhvillimit institucional dhe përmirësimin e funksioneve mbikëqyrëse të BQK-së:

1. Sistemi i Pagesave: për përgatitjen e anëtarësimit në SEPA, përmes përafrimit të kornizës rregullative me standardet përkatëse evropiane.
2. Mbikëqyrja e Sigurimeve: për zbatimin e standardeve IFRS 17, me qëllim forcimin e mbikëqyrjes së sektorit të sigurimeve.
3. Mbikëqyrja dhe Rregullativa bankare: për zbatimin e udhërrëfyesit strategjik për lidhur me Rreziqeve Klimatike dhe mjedisore në sektorin financiar (2024–2026), si dhe për përmirësimin e kornizës së përmbylljes së bankave dhe raportimit mbikëqyrës (FINREP/COREP).
4. Mbikëqyrje Bankare dhe Stabilitet Financiar – për Studimin për Qëndrueshmërinë e Korporatave si vlerësim gjithëpërfshirës i sektorit korporativ në Kosovë, për të ndihmuar mbikëqyrësit në vlerësimin efektiv të modeleve të vlerësimit të rrezikut të kredisë nga ana e bankave.

Në fushën e bashkëpunimit teknik, në kuadër të bashkëpunimit me IFC për avancimin e Shërbimeve Financiare Digjitale (DFS), gjatë vitit 2025 është vazhduar puna për promovimin dhe rritjen e përdorimit të teknologjive digjitale në sektorin financiar, me qëllim të rritjes së përfshirjes financiare dhe zhvillimit të një sistemi financiar më efikas dhe të qëndrueshëm në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe janë shënuar zhvillime të rëndësishme në komponentën e Bankingut të hapur (ang. Open Banking), duke mbështetur avancimin e shkëmbimit të të dhënave financiare, forcimin e infrastrukturës digjitale dhe nxitjen e inovacionit në shërbimet financiare digjitale për qytetarët dhe bizneset. Bashkëpunimi ka kontribuar gjithashtu në fuqizimin e kapaciteteve teknike dhe

rregullatore të BQK-së, duke adresuar sfidat dhe mundësitë që sjell transformimi digjital në sektorin financiar dhe duke përshpejtuar zhvillimin e zgjidhjeve inovative në treg. Një tjetër bashkëpunim i rëndësishëm mbetet asistenca teknike e IFC-së në hartimin e Ligjit për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo-Banka (IFJB), i cili pritet të finalizohet gjatë vitit 2026. Po ashtu, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, BQK ka vijuar angazhimin në CIS Project, i cili mbështet përmirësimin e kapaciteteve institucionale, forcimin e proceseve mbikëqyrëse dhe përafrimin me praktikatat më të mira ndërkombëtare në fushën e stabilitetit financiar dhe mbikëqyrjes bankare.

Sa i përket bashkëpunimit me BERZH në kuadër të iniciativës “WE Finance Code”, gjatë vitit 2025 kanë vazhduar aktivitetet e planifikuara për zbatimin dhe operacionalizimin e këtij angazhimi në Kosovë, me fokus në avancimin e barazisë gjinore në qasje në financa dhe forcimin e gjithëpërfshirjes financiare. Në këtë kuadër janë organizuar disa punëtori me përfaqësues të sektorit financiar në vend, të cilat kanë shërbyer për të rritur ndërgjegjësimin, për të ndarë praktikatat më të mira dhe për të diskutuar hapat konkretë të zbatimit të standardeve të iniciativës në institucionet financiare vendore. Gjithashtu, përfaqësues të BQK-së kanë marrë pjesë edhe në një punëtori rajonale në Herceg Novi, Mal të Zi, e cila ka mundësuar shkëmbimin e përvojave me bankat qendrore dhe institucionet financiare të rajonit, si dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal në promovimin e financimit gjithëpërfshirës dhe politikave që mbështesin barazinë gjinore në sektorin financiar.

Në vitin 2025, BQK-ja vazhdoi të marrë pjesë si institucion përfitues në Fazën II të Programit për Forcimin e Kapaciteteve të Bankave Qendrore në Ballkanin Perëndimor me Synim të Integritimit në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ), e cila zyrtarisht u përmyll në shtator 2025 pas tri viteve nga lancimi i saj. Gjatë vitit 2025, u zhvilluan 4 trajnime dhe 1 punëtori politikash të nivelit të lartë, në të cilat BQK-ja mori pjesë bashkë me institucionet e tjera përfituese dhe të cilat trajtuan fusha dhe tema me interes për bankat qendrore të regjionit. Po ashtu, gjatë vitit 2025 u përfundua edhe masa e fundit bilaterale e bashkëpunimit me banka qendrore individuale të SEBQ-së, e cila ishte një bashkëpunim me bankën qendrore të Sllovenisë në fushën e kornizës makroprudenciale. Po ashtu, u realizuan edhe 1 praktikë në bankën qendrore të Holandës brenda funksionit të qeverisjes së bordeve dhe 1 praktikë në autoritetin kroat të mbikëqyrjes së shërbimeve financiare brenda funksionit të mbikëqyrjes së sigurimeve.

Në vitin 2026 do të fillojë Faza III e këtij programi, për çka përgatitjet e nevojshme u kryen gjatë vitit 2025 nga BQK-ja krahas bankave të tjera qendrore të përfshira. Ky program është i financuar nga BE-ja dhe realizohet nga 20 banka qendrore nacionale të SEBQ, duke përfshirë edhe bankën qendrore të Gjermanisë, e cila e koordinon dhe administron atë. Po ashtu, Banka Qendrore Evropiane (BQE) kontribuon në realizimin e këtij programi.

Në kuadër të bashkëpunimit me **Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)**, gjatë vitit 2025 BQK ka përfituar asistencë teknike të rëndësishme në drejtim të përafrimit të mëtejshëm me standardet evropiane në sektorin bankar. Në këtë kontekst, është zhvilluar mbështetja për procesin e **vlërësimit të ekuivalencës me kërkesat e Autoritetit Bankar Evropian (EBA equivalency)**, me qëllim avancimin e harmonizimit të kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës të BQK-së me legjislacionin dhe praktikatat e Bashkimit Evropian. Ky proces përfshin analizën e përputhshmërisë së rregulloreve dhe udhëzimeve të BQK-së me direktivat dhe rregulloret përkatëse evropiane (si CRD/CRR), duke kontribuar në rritjen e besueshmërisë ndërkombëtare dhe në lehtësimin e integritetit të sektorit bankar të Kosovës në tregjet financiare evropiane.

Gjithashtu, janë mbajtur takime për të siguruar asistencën nga Thesari Amerikan (U.S. Treasury – OTA), në fushën e forcimit të sistemit të parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit (AML/CFT/CFP) që ka për qëllim avancimin e kapaciteteve rregullatore

dhe mbikëqyrëse të BQK-së, përfshirë përmirësimin e kornizës ligjore dhe rregullative, si dhe rritjen e integritetit të sistemit financiar përmes përafrimit të mëtejshëm me standardet ndërkombëtare të FATF. Gjithashtu, është diskutuar edhe lidhur asistencën për avancimin e tregut të letrave me vlerë.

Në kuadër të bashkëpunimit me **European Fund for Southeast Europe (EFSE)**, BQK ka përfituar mbështetje për zhvillimin e **Platformës për Krahasimin e Produkteve Financiare (Platform for Comparison of Finance)**. Kjo platformë synon rritjen e transparencës në tregun financiar përmes ofrimit të informacionit të krahasueshëm për produktet dhe shërbimet financiare, duke fuqizuar konsumatorët në marrjen e vendimeve të informuara dhe duke nxitur konkurrencë më të drejtë ndërmjet institucioneve financiare. Njëkohësisht, kjo iniciativë kontribuon në rritjen e edukimit financiar dhe mbrojtjes së konsumatorëve në sektorin financiar.

Në fushën e financave të qëndrueshme, në bashkëpunim me **Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (RCC)**, BQK ka përfituar asistencë në zhvillimin dhe promovimin e instrumenteve dhe standardeve për financimin e gjelbër. Në këtë drejtim, janë mbështetur iniciativat për **Zhvillimin e Standardit për Obligacionet e Gjelbra (Green Bond Standard)** si dhe për avancimin e **Taksonisë së Financave të Qëndrueshme (Sustainable Finance Taxonomy)** në nivel rajonal. Këto iniciativa synojnë krijimin e një kornize të përbashkët që lehtëson identifikimin, klasifikimin dhe raportimin e aktiviteteve ekonomike të qëndrueshme, duke kontribuar në mobilizimin e kapitalit drejt investimeve të gjelbra dhe në përkrahjen e tranzicionit drejt një ekonomie me karbon të ulët. Përmes këtij bashkëpunimi, BQK po kontribuon në përafrimin e tregut financiar të Kosovës me standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e financave të qëndrueshme.

8.2. Aktiviteti lidhur me Integrimet Evropiane

Me qëllim të realizimit të perspektivës së vendit për anëtarësim në BE, BQK edhe këtë vit, ka vazhduar t'i përmbushë obligimet e saj në kuadër të procesit të integrimit evropian duke kontribuar në mënyrë të vazhdueshme përmes raporteve të rregullta dhe pjesëmarrjes aktive në takime me institucionet vendore dhe ndërkombëtare të përfshira në procesin e integrimit. Në këtë mënyrë, ka vazhduar bashkëpunimi i ngushtë me Zyrën e Kryeministrit të Kosovës (ZKM), si koordinatore kryesore e procesit të integrimit, si dhe me ministritë përkatëse përfshirë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe Zyrën e BE-së në Prishtinë.

Gjatë vitit raportues, BQK ka dhënë kontributin e rregullt në përgatitjen e Raportit të Vendit, duke ofruar të dhëna dhe analiza të detajuara nga kapitujt që mbulon, për të reflektuar progresin e reformave strukturore dhe përputhjen me standardet evropiane.

Në kuadër të Programit për Reforma në Ekonomi (PRE), Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka vazhduar raportimin e rregullt mbi konkluzionet që rrjedhin nga dialogu ekonomik dhe financiar ndërmjet Bashkimit Evropian dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, duke reflektuar zhvillimet makroekonomike dhe sektoriale përkatëse. Në këtë drejtim, bashkëpunimi me Bankën Qendrore Evropiane (BQE), përmes takimeve e diskutimeve të strukturuar mbi stabilitetin financiar, mbikëqyrjen dhe rregullimin financiar, si dhe konkurrencën në treg, ka pasur rëndësi të veçantë. BQE ka ofruar mbështetje të vazhdueshme teknike dhe profesionale, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale të BQK-së dhe në përparimin drejt integrimit evropian.

Gjatë vitit 2025, një delegacion i ekspertëve të BQK-së morën pjesë në takimin vjetor të Nënkomitetit për Ekonomi, Çështje financiare dhe Statistika, i cili u mbajt në Bruksel. Takimi i 7-të vjetor pati në fokus diskutimin e zhvillimeve makroekonomike, buxhetore dhe statistikore, si

dhe monitorimin e progresit të reformave në fushën shërbimeve financiare, lëvizjes së kapitalit dhe mbrojtjes së euros nga falsifikimi.

Gjithashtu, BQK ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në zbatimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), përmes raportimit për kapitujt relevantë dhe masat e ndërmarra për përmbushjen e reformave të kërkuara në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Në kuadër të veprimeve koordinuese për anëtarësim në SEPA, BQK mori pjesë në takimin themelues të Grupit Drejtues për Implementimin e Zonës së Vetme të Pagesave në Euro me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bankave qendrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Moldavisë, si dhe të institucioneve relevante evropiane dhe ndërkombëtare. Qëllimi i këtij grupi është monitorimi dhe koordinimi i aktiviteteve që lidhen me zgjerimin e shtrirjes gjeografike të SEPA-s, përmes shkëmbimit të përvojave dhe adresimit të çështjeve të implementimit. Në vijim të zhvillimeve që dalin nga plani i Rritjes së Bashkimit Evropian, nisma për themelimin e Grupit Drejtues nga Drejtoria e Zgjerimit (DG NEAR) e Komisionit Evropian, vjen pas një serie të takimeve të nivelit të lartë dhe grupeve teknike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, në kuadër të projektit të Modernizimit të Sistemeve të Pagesave të Ballkanit Perëndimor, ku edhe Republika e Kosovës u përfaqësua nga Banka Qendrore, projekt ky i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Banka Botërore në koordinim me Këshillit të Bashkimit Rajonal (RCC), me mbështetjen e qeverive të shteteve në kuadër të Procesit të Berlinit.

Përkushtimi i BQK-së ndaj reformave është reflektuar në vlerësimin pozitiv të Raportit për Kosovën 2025 të Komisionit Evropian. Në raport theksohet qëndrueshmëria dhe rritja e kapitalizimit të sektorit bankar, dhe përparim të dukshëm në përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian. Raporti vlerëson miratimin e rregullores për shtesat makroprudenciale të kapitalit dhe të planit për zbatimin e Procesit të Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës (SREP), në përputhje me udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian (EBA). Në fushën e pagesave, raporti vlerëson përparimin e bërë me miratimin e Ligjit për Shërbimet e Pagesave dhe anëtarësimin e BQK-së në Shoqatën Evropiane të Shtëpive të Pastrimit Automatik (EACHA), që mundëson bashkëpunim të drejtpërdrejtë me bankat qendrore të vendeve të BE-së për avancimin e pagesave. Komisioni Evropian vlerëson rolin aktiv të Bankës Qendrore të Kosovës në luftën kundër falsifikimit të euros, duke theksuar masat konkrete të ndërmarra për forcimin e mekanizmave të parandalimit dhe zbulimit të monedhave të falsifikuara. BQK ka ndërmarrë hapa për përmirësimin e trajtimit të monedhave euro të falsifikuara dhe për rritjen e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në këtë fushë, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Raporti njeh përmirësimet në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit përmes miratimit të ligjeve të reja për AML/CFT, për shërbimet e pagesave dhe për asetet krypto, të cilat synojnë harmonizimin me direktivën e katërt dhe të pestë të BE-së. Komisioni Evropian ka nënvizuar kalimin e BQK-së nga korniza e mbikëqyrjes së bazuar në rregulla në një kornizë të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, duke harmonizuar praktikatat me standardet ndërkombëtare të FATF dhe BE-së.

Raporti njeh gjithashtu përpjekjet e BQK-së për forcimin e qeverisjes së brendshme, të cilat përfshijnë përfundimin e riorganizimit të strukturës institucionale, fuqizimin e kuadrit të burimeve njerëzore për tërheqjen dhe mbajtjen e profesionistëve, si dhe krijimin e një divizioni të dedikuar për sigurinë kibernetike, të shoqëruar me miratimin e Strategjisë për Siguri Kibernetike 2025–2028.

Me mbështetjen e Bashkimit Evropian, u realizua edhe një projekt i rëndësishëm i financuar përmes programit TAIEX, i cili kontribuoi në forcimin e kapaciteteve institucionale për parandalimin dhe luftimin e parave të falsifikuara.

Paralelisht, janë zhvilluar edhe një sërë takimesh me përfaqësues të misioneve diplomatike, të cilat kanë kontribuar në forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe promovimin e bashkëpunimit ekonomik dhe financiar.

Po ashtu, janë zhvilluar takime me përfaqësues të ambasadave të Austrisë, Gjermanisë dhe Zvicrës, ku janë prezantuar zhvillimet kryesore në sektorin financiar dhe reformat në vijim, me theks të veçantë në avancimin e kornizës ligjore dhe rregullative, si dhe në proceset e lidhura me integrimin evropian, përfshirë sistemin e Kartonit të Gjelbër.

8.3. Konferencat ndërkombëtare dhe rajonale

Gjatë vitit 2025, BQK ka shënuar një angazhim të gjerë dhe të vazhdueshëm në konferenca dhe panele të nivelit të lartë, si në nivel vendor ashtu edhe ndërkombëtar, duke kontribuar aktivisht në diskutimet mbi zhvillimet kryesore ekonomike dhe financiare. Përfaqësimi është realizuar kryesisht nga Guvernatori, zëvendësguvernatorët dhe delegacione të BQK-së:

- Guvernatori Ismaili së bashku me Kryetarin e Bordit mori pjesë në Konferencën e 10-të “Lámfalussy” të Bankës Kombëtare të Hungarisë (MNB), në 100-vjetorin e saj, e cila trajtoi zhvillimin e tregut unik të kapitalit.
- Delegacioni i BQK-së i kryesuar nga Zëvendësguvernatori i Operacioneve Bankare merr pjesë në Forumin e Bankave Qendrore dhe Fondeve Sovrane në Samitin Global të Fondeve dhe Financimit në Luksemburg.
- Guvernatori i BQK-së mori pjesë si folës në Konferencën Ndërkombëtare të Nivelit të Lartë mbi Reformat në Sistemin Pensional në Tiranë, organizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) i Shqipërisë dhe Banka Botërore (BB).
- Kryetari i Bordit Zëvendësguvernatori për Mbikëqyrje Financiare marrin pjesë në Forumin e Nëntë të Nivelit të Lartë të FMN-së për Qeverisjen e Bankave Qendrore, organizuar nga Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në Riad të Arabisë Saudite.
- Delegacioni i lartë i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i kryesuar nga Guvernatori Ismaili merr pjesë në Takimet Pranverore 2025 të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore në Washington DC, të cilët janë takuar me drejtuesit kryesor të institucioneve financiare ndërkombëtare si dhe disa guvernatorët nga vendet e Ballkanit.

Ne takimet Pranverore 2025 të FMN-së dhe BB-së në Washington D.C., janë realizuar aktivitetet si ne vijim:

- Guvernatori Ismaili zhvilloi takim me Zëvendësdrejtorin Menaxhues të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), z. Bo Li, ku prezantoi zhvillimet më të fundit në ekonominë e Kosovës, performancën e sektorit financiar, ruajtjen e stabilitetit financiar dhe përfundimin me sukses të programeve SBA dhe RSF, duke diskutuar gjithashtu prioritetet e bashkëpunimit të mëtejshëm me FMN-në.
- Guvernatori Ismaili zhvilloi takim me Presidentin e Grupit të Bankës Botërore, z. Ajay Banga, ku u diskutua avancimi i projekteve që synojnë rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike, zhvillimin e sektorit financiar dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, si dhe perspektivat për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet BQK-së dhe Bankës Botërore.
- Guvernatori Ismaili realizoi takim me Presidenten e Bankës Qendrore Evropiane (BQE), Christine Lagarde, gjatë të cilit prezantoi progresin e reformave në sektorin financiar dhe avancimin e procesit të para-aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA), duke theksuar rëndësinë e mbështetjes së BQE-së në këtë proces strategjik.

- Delegacioni i BQK-së zhvilloi takime me Institutin për Zhvillimin e Kapaciteteve (ICD) të FMN-së, ku u diskutua mbështetja për zhvillimin e modeleve makroekonomike, forcimin e analizave për politikëbërje dhe parashikim ekonomik, si dhe ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve profesionale të BQK-së.
- Guvernatori Ismaili dhe delegacioni i BQK-së zhvilluan takime me Departamentin për Tregjet e Parasë dhe Kapitalit (MCM) të FMN-së, ku u diskutua zbatimi i rekomandimeve të FSSR-së dhe Safeguard Assessment, si dhe mbështetja e mëtejme në fushat e mbikëqyrjes bankare, sigurimeve dhe pensione, stabilitetit financiar, sigurisë kibernetike dhe avancimit të kornizës institucionale e ligjore të BQK-së.
- Guvernatori Ismaili mori pjesë në takimin e organizuar nga FMN-ja me guvernatorët e bankave qendrore të vendeve të Evropës Qendrore, kushtuar Perspektivës Ekonomike për Evropën (EUR REO), ku u diskutuan zhvillimet dhe perspektivat ekonomike e financiare në kontekstin e sfidave gjeopolitike dhe ekonomike globale.
- Guvernatori Ismaili mori pjesë në takimin e Ministrave të Financave dhe Guvernatorëve të bankave qendrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Moldavisë, ku u diskutua iniciativa për themelimin e Qendrës së FMN-së për Asistencë Teknike në Evropën Juglindore (SEETAC).
- Guvernatori i BQK-së përfaqësoi Republikën e Kosovës në takimin plenar të Komitetit Ndërkombëtar Monetar dhe Financiar (IMFC), organi kryesor këshillues i FMN-së për çështjet e sistemit monetar dhe financiar ndërkombëtar, së bashku me guvernatorët e 191 vendeve anëtare të FMN-së.
- Guvernatori Ismaili zhvilloi takim me Zëvendëspresidenten e Bankës Botërore për Evropën dhe Azinë Qendrore, znj. Antonella Bassani, ku u diskutuan reformat në sektorin financiar, avancimi i procesit të anëtarësimit në SEPA dhe projektet e përbashkëta që përfshijnë sistemin e pagesave të shpejta, kapitalizimin e Fondit të Sigurimit të Depozitave dhe forcimin e Fondit për Garanci Kreditorë.
- Guvernatori Ismaili mori pjesë në takimin e Konstituencës së Bankës Botërore, të kryesuar nga Ministri i Financave i Belgjikës, z. Jan Jambon, ku u diskutuan prioritetet e projekteve zhvillimore dhe bashkëpunimi i mëtejshëm me Grupin e Bankës Botërore, duke theksuar progresin e Kosovës si kontribuuese në fondet e IDA-së.
- BQK mori pjesë në takimin vjetor të Dialogut Ekonomik dhe Financiar (ECOFIN) me partnerët rajonalë, të organizuar nga Komisioni Evropian.
- Guvernatori Ismaili merr pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të nivelit të lartë me temë “Rritja dhe Qëndrueshmëria Ekonomike në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE) në një botë më të fragmentuar”, të organizuar nga Banka Kombëtare e Kroacisë (HNB) në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).
- Guvernatori i BQK-së merr pjesë në Forumin e XII Rajonal dhe në Panelin e Guvernatorëve me temën “SEPA dhe WB6: Një katalizator për konvergjencën me BE-në dhe qasjen në tregun e vetëm evropian”, organizuar nga Banka Qendrore e Malit të Zi në Beçiq.
- Zëvendësguvernatori për Operacione Bankare përfaqëson BQK-në si panelist në Javën Globale të Pagesave 2025 të Bankës Botërore, bashkë organizuar nga Grupi i Bankës Botërore dhe Banka Qendrore e Brazilit.
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka marrë pjesë në ceremoninë e përfundimi me sukses të Fazës së Dytë të Programit për Forcimin e Kapaciteteve të Bankave Qendrore në Ballkanin Perëndimor, që ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe standardeve drejt integritit në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (ESCB).

- Zëvendësguvernatori për Operacione Bankare mori pjesë si panelist në Impact CEE, në diskutimin e nivelit të lartë me temën “Mundësimi i së Ardhmes: Si Rregullatorët Përmes Transformimit Digjital Strategjik po Hapin dhe Integrojnë Tregjet”, së bashku me përfaqësues nga Banka Kombëtare e Rumanisë dhe Autoriteti Kombëtar Rregullativ i Telekomunikimeve të Rumanisë.
- Guvernatori Ismaili merr pjesë në Takimin Vjetor të Forumit për Koordinimit të Bankave Evropiane (Vienna Initiative), duke rikonfirmuar përkushtimin e BQK-së për integrimin evropian.
- Delegacioni i lartë i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i kryesuar nga Guvernatori Ismaili mori pjesë në Takimet Vjetore 2025 të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore në Washington DC.

Ne kuadër të Takimeve Vjetore 2025 të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore në Washington DC janë realizuar këto aktivite:

- Guvernatori Ismaili mori pjesë si folës në panelin e nivelit të lartë të Fondit Monetar Ndërkombëtar me temë “Fuqizimi i qëndrueshmërisë së sistemit financiar në kohëra të pasigurive – Ndërtimi i kapaciteteve në vendet në zhvillim dhe në tranzicion”, ku prezantoi arritjet e sektorit financiar të Kosovës, kontributin e FMN-së në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe reformimin e kornizës mbikëqyrëse e rregullative, si dhe ndikimin e këtyre reformave në ruajtjen e stabilitetit financiar dhe mbështetjen e rritjes ekonomike.
- Guvernatori Ismaili zhvilloi takim me Kryetarin e Bordit Drejtues të Bankës Kombëtare Zvicerane (SNB), z. Martin Schlegel, ku prezantoi zhvillimet në sektorin financiar, progresin drejt anëtarësimit në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA), modernizimin e sistemit të pagesave të shpejta dhe prioritetet strategjike të BQK-së në procesin e harmonizimit me kornizën e Bashkimit Evropian.
- Delegacioni i BQK-së zhvilloi takim me Shefin e Misionit të FMN-së për Kosovën, z. David Amaglobeli, dhe Përfaqësuesin Rajonal Rezident për Ballkanin Perëndimor, z. Sebastian Sosa, ku u diskutuan zhvillimet makroekonomike, reformat në sektorin financiar dhe asistencë teknike e FMN-së në fushat e mbikëqyrjes bankare, politikës makroprudenciale, mekanizmave të përmbylljes dhe modernizimit të infrastrukturës së pagesave.
- Guvernatori Ismaili zhvilloi takim me Ndhimësdrejtoreshen dhe Shefen e Divizionit të Departamentit për Tregjet Monetare dhe të Kapitalit (MCM) në FMN, znj. Mary Goodman, ku u diskutua progresi në zbatimin e projekteve të mbështetura nga asistencë teknike e FMN-së dhe prioritetet e bashkëpunimit të mëtejshëm në forcimin e stabilitetit financiar.
- Guvernatori Ismaili zhvilloi takim me Zëvendësdrejtoreshin Menaxhues të Fondit Monetar Ndërkombëtar, z. Bo Li, ku prezantoi zhvillimet më të fundit ekonomike dhe financiare në Kosovë, progresin në reformat strukturore dhe stabilitetin financiar, ndërsa FMN-ja vlerësoi lart avancimin e sektorit financiar dhe zbatimin e suksesshëm të programeve dhe rekomandimeve të saj.
- Guvernatori Ismaili mori pjesë në mbledhjen e Konstituencës së Bankës Botërore, ku prezantoi arritjet e Kosovës në zbatimin e projekteve të financuara nga Grupi i Bankës Botërore dhe përfitimet nga asistencë teknike në fushat e digjitalizimit dhe zhvillimit të sektorit financiar.
- Guvernatori Ismaili zhvilloi takim me Zëvendëspresidenten e Bankës Botërore për Evropën dhe Azinë Qendrore, znj. Antonella Bassani, ku prezantoi progresin në zbatimin e Planit Strategjik të BQK-së, zhvillimet në sektorin financiar dhe projektet e realizuara me mbështetjen e Grupit të Bankës Botërore.

- Guvernatori Ismaili zhvilloi takim me Drejtorin e Departamentit Evropian të FMN-së, z. Alfred Kammer, ku u diskutuan zhvillimet makroekonomike, avancimi i kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse, zgjerimi i qasjes në financa dhe bashkëpunimi i mëtejshëm ndërmjet FMN-së dhe Kosovës në funksion të zhvillimit ekonomik dhe stabilitetit financiar.
- Zëvendësguvernatori për Operacione Bankare zhvilloi takim me Kryeshefin Ekzekutiv të Clearstream, z. Philip Brown, ku u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit në menaxhimin e rezervave ndërkombëtare, shërbimet e ruajtjes së aktiveve (custody) dhe qasja në produkte të avancuara të tregjeve financiare.
- Me ftesë të Drejtorit të Departamentit Evropian të FMN-së, z. Alfred Kammer, Guvernatori Ismaili mori pjesë si folës në një forum të nivelit të lartë me guvernatorë dhe ministra të financave nga 22 vende evropiane, ku diskutoi gjetjet e raportit “Regional Economic Outlook”, zhvillimet makroekonomike, stabilitetin financiar dhe perspektivat e rritjes së qëndrueshme në Evropë dhe Ballkanin Perëndimor.
- Guvernatori i BQK-së mori pjesë si folës në Konferencën e 16-të Ndërkombëtare mbi Pagesat dhe Infrastrukturat e Tregut, me temë “Rikrijimi i Pagesave për Epokën Digjitale”, organizuar në Ohër nga Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut (NBRM) dhe Banka Qendrore e Holandës (DeNederlandsche Bank – Eurosystem), ku u diskutua integrimi në SEPA dhe zhvillimi i infrastrukturës së pagesave, si dhe në sesionin e nivelit të lartë mbi produktivitetin në Evropë dhe Azinë Qendrore, u potencuar roli i digjitalizimit dhe inovacionit në rritjen ekonomike.
- Guvernatori Ismaili mori pjesë si folës në konferencën ndërkombëtare për nder të 100-vjetorit të Bankës së Shqipërisë, me temë: “Një shekull banking qendror: Nga themelimi institucional te roli si ankorë rajonale”, organizuar nga Banka e Shqipërisë, ku u diskutuan politikat monetare dhe e ardhmja e parasë në një kontekst global në ndryshim.
- Guvernatori Ismaili merr pjesë si panelist në Konferencën Ndërkombëtare mbi Integrimin Ekonomik Evropian (CEEI) 2025 të Bankës Kombëtare të Austrisë (OeNB), i cili kontribuoi në panelin e guvernatorëve me temë “Zhvillimi aktual i tregjeve të kapitalit, bashkëpunimi ndërkufitar, digjitalizimi dhe ndikimet në stabilitetin financiar”, duke trajtuar sfidat e financimit të rritjes, zhvillimet në tregjet e kapitalit, digjitalizimin dhe inovacionin financiar.
- BQK ishte partner institucional në “Brezovica Economic Forum 2025”, ku organizoi panelin e zëvendësguvernatorëve mbi qasjen në financa dhe mundësitë e investimit, ndërsa Guvernatori Ismaili prezantoi rolin e sektorit financiar në mbështetje të ekonomisë reale dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekosistemit financiar.
- Guvernatori i BQK-së mori pjesë si folës në “Green Business & Industry Summit 2025”, ku trajtoi rëndësinë e dekarbonizimit dhe tranzicionit të gjelbër, duke theksuar nevojën për financim të qëndrueshëm, adoptimin e praktikave ESG dhe përgatitjen për kërkesat e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane.
- Në aspektin e stabilitetit financiar dhe rreziqeve klimatike, Zëvendësguvernatori për Mbikëqyrje Financiare mori pjesë si panelist në Konferencën Ndërkombëtare “Rreziqet klimatike dhe stabiliteti financiar: Orientimi në sfida të sotme dhe mundësitë e së nesërme” në Shkup, organizuar nga Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Në nivel vendor, BQK kontribuoi në konferencën për inteligjencën artificiale të organizuar nga shoqata profesionale në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, ku u trajtuan mundësitë dhe rreziqet e përdorimit të teknologjisë në sektorin financiar, me theks të veçantë në etikë, mbrojtjen e të dhënave dhe stabilitetin financiar.

- Në forumin e mbyllur të FMN-së për Perspektivën Ekonomike Rajonale në Evropë, Guvernatori Ismaili diskutoi sfidat makroekonomike dhe rëndësinë e politikave për rritje të qëndrueshme. BQK gjithashtu ishte partner në “Forumit e Pagesave 2025”, duke promovuar zhvillimin e pagesave digjitale dhe përfshirjen financiare.
- Guvernatori Ismaili mori pjesë gjithashtu në Forumit Ekzekutiv të IDA-së dhe Thesarit të Bankës Botërore, ku theksoi transformimin e Kosovës nga përfituese në donatore, si dhe në panelin mbi SEPA dhe integrimin rajonal, duke prezantuar progresin e Kosovës në përmbushjen e kërkesave për integrim në tregun evropian të pagesave.
- Në fushën e investimeve të qëndrueshme, Guvernatori kontribuoi në Forumit e 2-të për Investime të Qëndrueshme, ndërsa në Javën Globale të Pagesave 2025.
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mori pjesë për herë të parë në Takimin Vjetor të Organizatës Ndërkombëtare për Mbrojtjen Financiare të Konsumatorëve (FinCoNet) në Dublin, pas pranimit si anëtare e asociuar në prill 2025.

Në tërësi, këto aktivitete dëshmojnë për një përfaqësim aktiv dhe të qëndrueshëm të BQK-së në arenën ndërkombëtare, duke kontribuar në avancimin e politikave financiare, fuqizimin e kapaciteteve institucionale dhe promovimin e integritetit të Kosovës në sistemin financiar global.

8.4. Anëtarësime dhe marrëveshje të reja

- Nënshkrimi i Letrës së Qëllimit për nisjen e projektit për pagesa të shpejta – TIPS Clone me Bankën e Italisë (Banca d'Italia) dhe bankat qendrore të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Bosnjë e Hercegovinës.
- Memorandum Bashkëpunimi me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) për integrimin e shërbimeve të BQK-së në platformën eKosova.
- Memorandum Bashkëpunimi me Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës për validimin elektronik të llogarive bankare.
- Është vazhduar Linja REPO e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) për BQK-në deri më 31 janar 2027 në shumën maksimale prej 100 milionë euro, e cila shërben si një instrument shtesë parandalues për adresimin e nevojave të mundshme për likuiditet dhe për ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar në Republikën e Kosovës.
- Memorandum Mirëkuptimi me Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) në kuadër të nismës “WE Finance Code”.
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është bërë anëtare e asociuar në Organizatën Ndërkombëtare për Mbrojtje të Konsumatorit Financiar (FinCoNet), e cila promovon praktikën më të mirë për të siguruar që produktet dhe shërbimet financiare të jenë të drejta, transparente dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. FinCoNet, me seli në Francë, është një organizatë ndërkombëtare e autoriteteve mbikëqyrëse me përgjegjësi në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve financiarë. Aktualisht, kjo organizatë numëron 36 anëtarë, përfshirë shtete të zhvilluara si Kanadaja, Gjermania, Franca, Australia, Italia dhe Holanda. Anëtarësimi i BQK-së në FinCoNet pritet të forcojë kapacitetet institucionale në fushën e mbrojtjes së konsumatorit financiar, përmes shkëmbimit të përvojave dhe adoptimit të standardeve ndërkombëtare. Ky zhvillim kontribuon në përmirësimin e kornizës rregullative dhe të mbikëqyrjes së sjelljes së tregut, si dhe në avancimin e praktikave për mbrojtjen e konsumatorëve në sektorin financiar.
- Marrëveshje e Bashkëpunimit ndërmjet Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Bankës së Francës për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të rezervave.

- Memorandum bashkëpunimi ndërmjet BQK-së dhe AKI-së për sigurinë dhe integritetin financiar.
- Nënshkrimi i Letrës së Qëllimit ndërmjet pesë vendeve të Ballkanit Perëndimor me Bankën e Italisë për projektin e pagesave të shpejta – TIPS Clone.
- Zhvillim tejet i rëndësishëm gjatë vitit 2025 është nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet BQK-së dhe Bankës Qendrore Evropiane (BQE) në fushën e luftimit të falsifikimit të kartëmonedhave euro. Kjo marrëveshje synon forcimin e integritetit të parasë së gatshme në qarkullim dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në vend. Marrëveshja është nënshkruar nga Guvernatori i BQK-së dhe Presidentja e BQE-së, znj. Christine Lagarde, duke reflektuar përkushtimin për bashkëpunim të ngushtë institucional në mbrojtjen e sistemit monetar.
- Një tjetër zhvillim i rëndësishëm për sektorin financiar është fillimi i përdorimit të shërbimit Apple Pay në Kosovë. Ky zhvillim u mundëson bankave dhe institucioneve financiare në vend të integrojnë kartelat e tyre me platformën Apple Pay, duke u ofruar qytetarëve dhe bizneseve mundësinë për të kryer pagesa të shpejta, të sigurta dhe pa kontakt përmes pajisjeve Apple, si iPhone, Apple Watch dhe pajisje të tjera të mbështetura.

8.5. Vizitat bilaterale në institucionet homologe

Gjatë vitit raportues, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka realizuar një sërë vizitash bilaterale të nivelit të lartë, me qëllim forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe shkëmbimin e përvojave profesionale në fusha me rëndësi për stabilitetin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar.

Në këtë kuadër, janë zhvilluar takime dhe pjesëmarrje në forume të rëndësishme ndërkombëtare, përfshirë Takimet Vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore në Washington DC, ku janë prezantuar zhvillimet kryesore në sektorin financiar të vendit, reformat në zbatim, si dhe nevojat për mbështetje të mëtejshme teknike. Po ashtu, përfaqësues të institucionit kanë marrë pjesë në aktivitete rajonale dhe ndërkombëtare të fokusuara në qeverisjen e auditimit të brendshëm, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe avancimin e praktikave profesionale në bankat qendrore.

Gjatë vizitave zyrtare në vende të ndryshme evropiane dhe më gjerë, janë zhvilluar takime me institucione homologe dhe organizata financiare ndërkombëtare, ku është diskutuar thellimi i bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes financiare, stabilitetit financiar, rregullimit bankar, funksionit të përmbylljes, si dhe zhvillimit të sistemeve moderne të pagesave:

Në Emiratet e Bashkuara Arabe, delegacioni i BQK-së u mirëprit nga drejtuesit e lartë të Bankës Qëndrore me të cilët u dakordua për fillimin e bashkëpunimit, ndërsa mori pjesë në Kongresin Ndërkombëtar të Investimeve (AIM 2025), me fokus në bashkëpunim ekonomik dhe financiar ndërkombëtar.

- Guvernatori Ismaili pritet në takim nga Presidenti i Deutsche Bundesbank, Dr. Joachim Nagel, në selinë qendrore të bankës në Frankfurt, ku u diskutua mbi zhvillimet aktuale ekonomike dhe financiare në Evropë, politikat monetare, si dhe forcimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet BQK-së dhe Deutsche Bundesbank në funksion të stabilitetit financiar dhe proceseve integruese evropiane.
- Guvernatori i BQK-së u prit në Paris nga Kryetari i Autoritetit Bankar Evropian (EBA), José Manuel Campa, ku u shkëmbyen vlerësime mbi zhvillimet në kuadrin rregullativ evropian të sektorit bankar dhe rëndësinë e harmonizimit të mëtejshëm të standardeve mbikëqyrëse dhe rregullative në kontekst të afrimit me Bashkimin Evropian.

- BQK pjesëmarrëse në takimin e Konstituencës së FMN-së dhe BB-së në Lubjanë, ku krahas Kosovës morën pjesë përfaqësuesit nga vendet anëtare, si Austria, Belgjika, Republika Çeke, Hungaria, Luksemburgu, Sllovakia, Sllovenia dhe Turqia, dhe ku u diskutuan zhvillimet makroekonomike globale, prioritetet e politikave ekonomike dhe çështjet e bashkëpunimit ndërinstitucional në kuadër të grupit të konstituencës.
- Guvernatori Ismaili pritet në selinë e Autoritetit Evropian të Përmbylljes së Bankave në Bruksel nga Kryetari i Bordit të Autoritetit Evropian të Përmbylljes së Bankave (SRB), Dominique Laboureix, ku u trajtuan çështje që lidhen me kornizat e përmbylljes së bankave, menaxhimin e krizave bankare dhe përafrimin e praktikave mbikëqyrëse me standardet e Bashkimit Evropian.
- Delegacioni i BQK-së pritet në vizitë zyrtare nga autoritetet e Maltës, në funksion të kryerjes së auditimit të qeverisjes, si rezultat i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërinstitucional, ku u vlerësuan praktikat e qeverisjes institucionale dhe u shkëmbyen përvoja në funksion të forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimit të kornizës së brendshme të menaxhimit.
- Guvernatori Ismaili u prit në selinë e Autoritetit Evropian për Sigurime dhe Pensione (EIOPA) në Frankfurt nga Kryetarja Petra Hielkema, ku u diskutua zhvillimi i sektorit të sigurimeve dhe pensioneve, avancimi i kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse, si dhe përafrimi gradual me standardet dhe praktikat e Bashkimit Evropian në këto fusha.
- Guvernatori i BQK-së u mirëprit nga Drejtori i ri i Institutit të Vjenës (JVI), Ben Kelmanson, ku takimi u fokusua në thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, veçanërisht në fushën e zhvillimit të kapaciteteve profesionale, analizave ekonomike dhe mbështetjes së politikëbërjes së bazuar në të dhëna.
- Guvernatori Ismaili takohet me Xiaoqing Yu, Drejtore për Ballkanin Perëndimor në Bankën Botërore në Vjenë, ku u diskutua avancimi i bashkëpunimit në projektet ekzistuese dhe të ardhshme, me fokus në forcimin e sektorit financiar, zhvillimin institucional dhe mbështetjen e reformave strukturore në funksion të rritjes së qëndrueshme ekonomike.
- Guvernatori Ismaili merr pjesë në ceremoninë zyrtare të ndërrimit të udhëheqjes në Bankën Kombëtare të Austrisë (Oesterreichische Nationalbank – OeNB), nga Guvernatori Robert Holzmann te Guvernatori i sapoemëruar Martin Kocher.
- Guvernatori i BQK-së gjatë vizitës së tij zyrtare në Vjenë, u prit nga Helmut Ettl, Drejtor i Autoritetit të Tregut Financiar (FMA) të Austrisë, takimi ishte i fokusuar në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, me diskutime që mbuluan mbikëqyrjen bankare, të fondeve pensionale dhe të sigurimeve, mekanizmat e përmbylljes, si dhe rregullimin e kripto-aseteve dhe inovacioneve të tjera financiare.
- Delegacioni i Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës i kryesuar nga Guvernatori Ismaili ka realizuar një vizitë zyrtare në Bankën Qendrore të Estonisë (Eesti Pank) dhe në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Estonisë (Finantsinspeksioon), me synim forcimin e bashkëpunimit institucional, shkëmbimin e përvojave dhe thellimin e bashkëpunimit në fushat kryesore brenda mandateve të institucioneve.
- Përfaqësues të Auditimit të Brendshëm realizuan vizitë në Bankën e Shqipërisë, ku shkëmbyen përvoja në auditim, menaxhim rreziku dhe transparencë institucionale.
- Një delegacion i BQK-së ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Bankën e Italisë me fokus shkëmbimin profesional dhe avancimin e praktikave mbikëqyrëse në kuadër të Supervisory Review and Evaluation Process (SREP), metodologji standarde e Bashkimit Evropian për vlerësimin gjithëpërfshirës të institucioneve bankare.

Gjatë vitit 2025, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka pritur një sërë vizitash zyrtare nga institucione homologe dhe organizata ndërkombëtare, me qëllim thellimin e bashkëpunimit institucional dhe shkëmbimin e përvojave. BQK mirëpriti gjithashtu vizita të delegacioneve të bankave qendrore homologe dhe institucioneve ndërkombëtare, përfshirë Bankën Qendrore të Maltës, Deutsche Bundesbank, Bankën e Italisë, Bankën e Sllovenisë, FMN-në, Bankën Botërore, IFC-në dhe BERZH-in, duke forcuar më tej bashkëpunimin profesional dhe institucional me partnerët strategjikë ndërkombëtarë.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare, u zhvillua gjithashtu një takim me përfaqësues të Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës, ku u diskutuan zhvillimet në sektorin financiar, me theks në mikrofinancat dhe institucionet jo-bankare financiare, përfshirjen financiare dhe reformat rregullatore dhe mbikëqyrëse. Diskutimet përfshinë gjithashtu iniciativat për digjitalizim, zhvillimin e sistemeve të pagesave dhe përgatitjet për integrimin në SEPA, si dhe forcimin e edukimit financiar.

Në tërësi, këto vizita dhe aktivitete ndërkombëtare kanë luajtur rol të rëndësishëm në thellimin e marrëdhënieve me partnerët strategjikë, avancimin e agjendës së reformave dhe fuqizimin e pozitës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare financiare.

9. Qëndrueshmëria financiare e BQK-së

Edhe gjatë vitit 2025, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka vazhduar të konsolidojë qëndrueshmërinë financiare si një nga shtyllat kryesore të pavarësisë institucionale. Ky rezultat është mbështetur në menaxhim të kujdesshëm financiar, politika prudenete, pozicione të qëndrueshme investimi në horizont afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe në administrim të kujdesshëm të shpenzimeve. Në këtë mënyrë, BQK ka ruajtur kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e mandatit të saj ligjor, krahas plotësimit të të gjitha obligimeve dhe nevojave financiare vjetore.


Për vitin financiar 2025, BQK ka realizuar rezultat financiar neto në vlerë prej rreth 23.88 milionë euro. Në përputhje me kërkesat ligjore dhe me arritjen e limitit të përcaktuar të kapitalit dhe rezervave të përgjithshme, të ardhurat e ndashme shpërndahen ndërmjet rezervës së përgjithshme të BQK-së dhe buxhetit të Republikës së Kosovës. Nga rezultati financiar neto i vitit 2025, rreth 11.94 milionë euro do të barten në llogarinë e rezervës së përgjithshme të BQK-së, ndërsa rreth 11.94 milionë euro do t'i transferohen buxhetit të Republikës së Kosovës. Për më shumë, referojuni pasqyrave financiare të BQK-së, shënimi 4(f).

Ecuria dhjetëvjeçare e rezultateve financiare tregon për një trend pozitiv të forcimit të bazës financiare të BQK-së. Në veçanti, periudha 2023–2025 shënon performancë të lartë dhe të qëndrueshme, siç paraqitet ne grafikun 124.

Qëndrueshmëria financiare dhe buxhetore e BQK-së është vlerësuar edhe sipas kornizës buxhetore afatmesme dhe afatgjatë, përmes analizave dhe skenarëve të ndryshëm, përfshirë ndikimin e mundshëm të ndryshimeve në normat e interesit në tregun ndërkombëtar.

Rezultatet e këtyre vlerësimeve mbështesin pritjet për ruajtjen e stabilitetit financiar institucional, forcimin gradual të rezervave dhe vazhdimësinë e kontributit pozitiv në buxhetin e shtetit, duke siguruar bazë të qëndrueshme për përmbushjen e objektivave strategjike dhe ligjore të BQK-së.

Grafik 124. Neto rezultati financiar dhe shpërndarja e të ardhurave të ndashëm ndaj buxhetit shtetëror (periudha 2016 - 2025)



Burimi: BQK (2026)

IV. Pasqyrat Financiare

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Pasqyrat Financiare
më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025
me Raportin e Auditorit të Pavarur

Përmbajtja	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	2
Pasqyra e pozicionit financiar	4
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	5
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	6
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	7
Shënime për pasqyrat financiare	8 - 59

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK" ose "Banka Qendrore"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar në këtë datë, dhe shënimet për pasqyrat financiare duke përfshirë informacione materiale të politikave kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të BQK-së më 31 dhjetor 2025, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë, për vitin e përfunduar në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga BQK-ja në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për një kontroll të brendshëm që menaxhmenti e përcakton se është i nevojshëm për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së BQK-së për të vazhduar vijimësinë, duke shpalosur, sipas rastit, çështjet që lidhen me vijimësinë dhe duke përdorur bazën e vijimësisë të kontabilitetit, përveç rasteve kur menaxhmenti ka ndërmend të likuidojë BQK-në ose të pushojë operacionet, ose nuk ka alternativë realiste përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të BQK-së.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa gabimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e gabimeve materiale të pasqyrave financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve dhe marrin evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se ai që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Kuptojmë kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin në mënyrë që të hartohen procedura auditimi që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të BQK-së.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga menaxhmenti të bazës së vijimësisë të kontabilitetit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e BQK-së për të vazhduar si vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se ekziston një pasiguri materiale, ne na kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit tonë ndaj dhënies së informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të auditorit tonë. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të bëjnë që BQK-ja të të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e BQK-së, ndër të tjera, në lidhje me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë.



BDO
BDO Kosova L.L.C.
audit, accounting and financial advisory
Prishtinë, Kosovë
Burim Ceha
Partner i angazhimit

BDO Kosova L.L.C.
Prishtinë, Kosovë
1 qershor 2026

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Pasqyra e pozicionit financiar
Më 31 Dhjetor 2025

Në mijë Euro	Shënim	2025	2024
Pasuritë			
Pasuritë rrjedhëse			
Paraja e gatshme	7	131,613	77,017
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	41,016	147,633
Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione)	9	243,421	192,364
Plasmanet në tregun e parasë	10	593,858	506,806
Mjetet e ndërlidhura me FMN	11	139,564	154,934
Pasuritë tjera	14	3,203	2,673
Gjithsej pasuritë rrjedhëse		1,152,675	1,081,427
Pasuritë jo-rrjedhëse			
Letra me vlerë (Obligacione)	9	546,240	539,730
Mjetet e ndërlidhura me FMN	11	23,458	25,255
Prona dhe pajisjet	12	4,320	4,179
Pasuritë e paprckshme	13	779	836
Gjithsej pasuritë jo-rrjedhëse		574,797	570,000
Gjithsej pasuritë		1,727,472	1,651,427
Detyrimet			
Detyrimet rrjedhëse			
Detyrime ndaj bankave komerciale në vënd	15	669,177	656,260
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN-në	16	875	1,135
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	613,776	575,185
Detyrime ndaj institucioneve tjera	18	133,256	104,677
Huamarrja/et	19	212	228
Detyrime të tjera	20	2,991	2,042
Gjithsej detyrimet rrjedhëse		1,420,287	1,339,527
Detyrimet jo-rrjedhëse			
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN-në	16	176,580	189,420
Huamarrja/et	19	955	1,256
Detyrime të tjera	20	794	827
Gjithsej detyrimet jo-rrjedhëse		178,329	191,503
Gjithsej detyrimet		1,598,616	1,531,030
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali i autorizuar	21	30,000	30,000
Fondi i rezervave	21a	72,507	56,997
Rezerva nga rivlerësimi	21a, 29	2,473	1,783
Fitimet e mbajtura		23,876	31,617
Gjithsej kapitali dhe rezervat		128,856	120,397
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat		1,727,472	1,651,427

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga organet vendimmarrëse¹ të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 21 prill 2026 dhe është nënshkruar në emër të tyre nga:



Ahmet Ismaili
 Guvernator



Faton Ahmetaj
 Drejtor, Departamenti i Financave

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

¹ Sipas nenit 34 dhe 59 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025

<i>Në mijë Euro</i>	Shënim	2025	2024
Të ardhurat nga interesi			
Të ardhurat nga interesi		36,325	45,149
Shpenzimet nga interesi		(13,426)	(17,922)
Të ardhurat neto nga interesi	22	22,899	27,227
Të ardhurat nga tarifat dhe ndalesat			
Të ardhurat nga tarifat dhe ndalesat		5,261	4,716
Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat		(1,390)	(1,221)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe ndalesat	23	3,871	3,495
Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ dhe të ardhurat tjera operative			
Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ	24	9,698	8,722
Të ardhurat nga grantet	20,25	127	50
Të ardhurat tjera operative	26	-	22
(Humbja)/Fitimi nga kursi i këmbimit	29	(1,605)	783
Të hyrat operative		34,990	40,299
Shpenzimet administrative (operative)			
Shpenzimet e personelit dhe tjera të ndërlidhura:	27		
Pagat, kontributet pensionale dhe sigurimi shëndetësor	27.1	(6,938)	(5,721)
Shpenzimet e tjera të ndërlidhura të personelit	27.2	(1,023)	(315)
Gjithsej shpenzimet e personelit dhe tjera të ndërlidhura		(7,961)	(6,036)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	12,13	(953)	(890)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	28	(2,197)	(1,663)
Gjithsej shpenzimet administrative (operative)		(11,111)	(8,589)
Rezultati financiar para pritjeve për fitimet kreditore		23,879	31,710
Provizionet për humbjet e pritura kreditore	4	(3)	(93)
Fitimi vjetorë		23,876	31,617
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		23,876	31,617

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025

	Kapitali	Fondi rezervë	Rezervat e rivlerësimit	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
<i>Në mijë Euro</i>					
Gjendja më 1 Janar 2024	30,000	39,507	2,018	27,631	99,156
Transferimi në fondin rezervë	-	17,490	(235)	(17,255)	-
Transferim në Thesar – Ministria e Financave	-	-	-	(10,376)	(10,376)
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	-	17,490	(235)	(27,631)	(10,376)
Fitimi për vitin	-	-	-	31,617	31,617
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	31,617	31,617
Gjendja më 31 Dhjetor 2024	30,000	56,997	1,783	31,617	120,397
Gjendja më 1 Janar 2025	30,000	56,997	1,783	31,617	120,397
Transferimi në fondin rezervë	-	15,510	690	(16,200)	-
Transferim ne Thesar – Ministria e Financave	-	-	-	(15,417)	(15,417)
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	-	15,510	690	(31,617)	(15,417)
Fitimi për vitin	-	-	-	23,876	23,876
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	23,876	23,876
Gjendja më 31 Dhjetor 2025	30,000	72,507	2,473	23,876	128,856

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Pasqyra e rrjedhjes së parasë
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025

<i>Në mijë Euro</i>	Shënim	2025	2024
Rrjedhja parave nga aktivitetet operacionale			
Fitimi vjetor		23,876	31,617
Rregullime për:			
Zhvlerësimin	12	665	633
Amortizimin	13	288	257
Të ardhurat nga grantet	25	(127)	(50)
Provizionet për humbjet e pritshme kreditore	4	3	93
Provizionet (tjera)		72	-
Fitimi / humbja neto nga këmbimi valutor	29	1,605	(783)
Të ardhurat nga interesi	22	(36,325)	(45,149)
Shpenzimet nga interesi	22	13,426	17,922
		3,483	4,540
Ndryshime në bono thesari dhe obligacione qeveritare		(69,038)	(4,378)
Ndryshime në plasmanët në tregun e parasë		40,416	(201,000)
Ndryshime në pasuritë e ndërlidhura me FMN-në		(1,096)	(7,513)
Ndryshime në pasuritë tjera		(516)	(170)
Ndryshime në detyrimet ndaj bankave komerciale		12,898	65,622
Ndryshime në detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN-në		(4,964)	937
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve qeveritare		41,342	62,926
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale		28,581	(135,587)
Ndryshime në detyrimet e tjera		281	(6,304)
		51,387	(220,927)
Interesa të marra		35,469	44,869
Interesa të paguara		(13,706)	(17,712)
Paraja neto e rrjedh nga/(përdorur në) aktivitetet operacionale		73,150	(193,770)
Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese			
Blerja e pajisjeve	12	(606)	(428)
Blerja e aseteve të paprekshme	13	(109)	(198)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		(715)	(626)
Rrjedhja e parave nga aktivitetet financuese			
(Ripagesat) nga/për huamarrjet	19	(228)	(224)
Arkëtimet nga grantet	20	92	15
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese		(136)	(209)
Rritja/(zbritja) neto në para dhe ekuivalentet e saj		72,299	(194,605)
Efkti i kursit të këmbimit (në para dhe ekuivalentet e saj)		(476)	1,392
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 Janar		538,843	732,056
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 Dhjetor	30	610,666	538,843

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Subjekti raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (nga këtu e tutje "BQK" ose "Banka Qendrore"), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është një subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota si një person juridik sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. BQK është një subjekt publik i veçantë i cili ka autoritetin për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare në Republikën e Kosovës. Banka vepron në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 "Ligji mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" të cilit tash e tutje i referohemi si ("Ligji për BQK-në"). Sipas këtij ligji objektivat kryesore të BQK-së janë si vijon:

- të nxisë dhe të mbajë një sistem të qëndrueshëm financiar, duke përfshirë një sistem të sigurt, të shëndetshëm dhe efikas të pagesave.
- të kontribuojë në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të brendshëm të çmimeve.
- të mbështes politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë.

Siç është përshkruar në ligj, BQK duhet të veprojë në përputhje me parimet e një tregu të hapur me një konkurrencë të lirë, duke favorizuar ndarjen efikase të resurseve.

BQK vepron nga zyrat e saj që gjenden në Prishtinë. Adresa e regjistruar e zyrës së BQK-së është si më poshtë:
Rr. Luan Haradinaj, nr. 2
Prishtinë, Kosovë.

Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori (organet vendimmarrëse)

Organet vendimmarrëse të BQK-së janë Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori (sipas nenit 34 të ligjit për BQK). Po ashtu, sipas nenit 34, paragrafit 2, si dhe dispozitës së përkohshme të nenit 79, paragraf 2, të Ligjit për BQK-në, Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga **katër anëtar jo-ekzekutiv** dhe **Guvernatori** dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të politikave si dhe mbikëqyrjen e administrimit dhe operacioneve të BQK-së.

Më 31 Dhjetor 2025, Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga këta anëtarë:

- Bashkim Nurboja – Kryetar i Bordit (anëtar jo-ekzekutiv)
- Ahmet Ismaili – Guvernator
- Nora Latifi Jashari – Anëtare (jo-ekzekutiv)
- Nexhat Kryeziu - Anëtar (jo-ekzekutiv)
- Arta Hoxha - Anëtar (jo-ekzekutiv)

Ndërsa, me 31 Dhjetor 2024, Bordi i Bankës Qendrore përbëhej nga këta anëtarë:

- Bashkim Nurboja – Kryetar i Bordit (anëtar jo-ekzekutiv)
- Ahmet Ismaili – Guvernator
- Nora Latifi Jashari – Anëtare (jo-ekzekutiv)
- Nexhat Kryeziu - Anëtar (jo-ekzekutiv)
- Arta Hoxha - Anëtar (jo-ekzekutiv)

Bordi Ekzekutiv në përputhje me nenin 34, paragraf 3, është përgjegjës për zbatimin e politikave të BQK-së dhe të operacioneve të saj. Bordi Ekzekutiv me 31 Dhjetor 2025 përbëhet nga Guvernatori, i cili është Kryesues dhe tre Zëvendësguvernator, po ashtu edhe me 31 Dhjetor 2024.

2. Baza e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”). Zërat janë të rrumbullakuar rreth vlerës së njëmishes (1000) se përafërt, në raste kjo mund të paraqet ndonjë mospërputhje (+/-) rreth asaj vlere si rezultat i këtij rrumbullaksimi të vlerave.

b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuar nga SNRF-ja për secilin lloj të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë shpalosur më në detaje në politikat kontabël në shënimin 3 më në vijim.

c) Valuta funksionale dhe e prezentimit

Këto pasqyra financiare prezantohen në Euro (“EUR”), e cila është valuta funksionale e BQK-së, përveç nëse është specifikuar ndryshe në ndonjë shënim analitik. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është rrumbullakësuar në mijëshen më të afërt. Zërat janë të rrumbullakuar rreth vlerës së njëmishes (1/1000) se përafërt, në raste kjo mund të paraqet ndonjë mospërputhje (+/-) rreth asaj vlere si rezultat i këtij rrumbullakimi të vlerave.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në bazë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informatat në lidhje me fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe vendimeve të rëndësishme për zbatimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të konsiderueshëm në shumat e pranuar në pasqyrat financiare janë përshkruar më poshtë në shënimin 5.

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezentuara në këto pasqyra financiare.

e) Rrethanat mbi rrjedhën e aktiviteteve operative të Bankës Qendrore në 2025

Në vitin 2025, inflacioni mbetet një sfidë për shumicën e ekonomive globale, po ashtu kjo ka qenë edhe tendenca e vitit 2025 krahasuar me vitin 2024, i cili karakterizohet nga rritje më të moderuar të çmimeve. Në vitin 2025, inflacioni u rrit më theksueshëm krahasuar me viti 2024. Ndërsa viti 2024 karakterizohet nga stabiliteti relativ i çmimeve, në vitin 2025 inflacioni u rrit përsëri për shkak të shtrenjtimit të ushqimeve, energjisë dhe disa shërbimeve. Inflacioni u ndikua kryesisht nga rritja e çmimeve të disa ushqimeve, shërbimeve dhe energjisë, ndërsa në disa sektorë si karburantet kishte edhe ulje të çmimeve.

Përsa i përket aktivitetit operativ të Bankës Qendrore (BQK-së), ndikimi i inflacionit në vitin 2025 ka qenë dhe mbetet relativisht i kufizuar. Duhet theksuar se, nga ana tjetër, normat e interesit kanë mbetur stabile me ulje të lehta gjatë vitit 2025. Sidoqoftë, vlera e aseteve financiare të BQK-së nuk është prekur drejtpërdrejt nga rritja e normave të interesit, për shkak të natyrës së portfolios së instrumenteve financiar. Në vitin 2025, ndikimi i të qenit pozitiv për normat e interesit ka pasur një efekt në të hyrat dhe shpenzimet e interesit, duke kontribuar në qëndrueshmërinë e zërit neto të të hyrave nga interesat. Ky trend ka ndihmuar në stabilizimin e zërave financiar të BQK-së dhe në ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare.

Një tjetër faktor që ka qenë në fokus gjatë vitit 2025 ka qenë vlerësimi i ndikimeve të situatës globale, veçanërisht efekti i luftës në Ukrainë dhe tensioneve dhe luftat në Lindjen e Mesme, si dhe forcimi i sanksioneve ndërkombëtare kundër Federatës Ruse. Edhe pse këto konflikte janë ende aktive, gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur ndikime të mëdha në aktivitetet e BQK-së. Megjithatë, BQK vazhdon të monitorojë nga afër zhvillimet dhe të mbetet vigjilente ndaj efekteve të mundshme që këto ngjarje mund të kenë në stabilitetin ekonomik dhe financiar të vendit.

3. Politikat e rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj vlerësohen në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datat e kryerjes së transaksioneve. Pasuritë dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të asaj date. Fitimi apo humbja nga valutat e huaja për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në valutën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të rivlerësuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë rivlerësohen në monedhë funksionale në kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar ajo vlerë e drejtë. Diferencat nga valutat e huaja që rrjedhin nga rivlerësimi njihen si fitim ose humbje.

b) Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi njihen si fitim apo humbje bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që zbrit pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pasurisë ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër) deri në vlerën kontabël të pasurisë ose detyrimit financiar. Norma e interesit efektiv përcaktohet në njohjen fillestare të pasurisë ose detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet dhe shumat e paguara apo kostot e transaksioneve të pranuar dhe zbritjet apo primet që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv.

Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të ngarkueshme drejtpërdrejtë për blerjen, emetimin apo largimin e një pasurie apo detyrimi financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në humbje apo fitim përfshijnë interesat nga pasuritë ose detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e interesit efektiv.

c) Tarifat dhe komisionet

Të hyrat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një mjet apo detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të hyrat tjera nga komisionet dhe tarifat, përfshirë tarifat e transaksioneve për llogaritë operative, tarifat e transferimit të fondeve dhe të licencimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to. Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

d) Përfitimet e punonjësve

BQK aplikon kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, që përcaktohen si kontributet pensionale të punonjësve kur ata dalin në pension. Këto kontribute klasifikohen sipas planeve të kontributit të përcaktuara, bazuar në legjislacionin e Kosovës. Kontributet e BQK-së ngarkohen si shpenzim në të ardhura në momentin kur ato ndodhin.

Po ashtu BQK ndan përfitime të punonjësve në baza jubilarë dhe në formë të shumës së paracaktuar në momentin e pensionimit. BQK njeh këto shpenzime sipas ndodhjes së këtyre ngjarjeve sipas planeve për përfitime afatgjata.

e) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

BQK-ja është e liruar nga tatimi mbi fitimin sipas Ligjit nr. 03/L-209 të miratuar më 22 korrik 2010. Shih shënimin 4 (f) se si BQK-ja alokon fitimin e saj.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare

Pasuritë financiare të BQK-së të përfshira në këto pasqyra financiare klasifikohen si instrumente financiare me kosto të amortizuar (modeli mbaj për të mbledhur) dhe përbëhen nga paraja dhe ekuivalentët e saj, letrat me vlerë, llogaritë e depozitave në bankat jorezidente, asetet e lidhura me FMN dhe pasuritë tjera.

Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse i plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDFH (Vlera e drejtë përmes Humbjes së Fitimit):

- pasuria mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë pasuritë për të mbledhur flukset monetare kontraktuale; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurisë financiare lindin në data të specifikuara tek flukset e parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (SPPI) mbi shumën e mbetur të papaguar.

BQK-ja klasifikon të gjitha detyrimet e saj financiare të matura me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Të ardhurat nga interesi ose shpenzimet e interesit nga detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar, njihen në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare të matura me kosto të amortizuar përfshijnë detyrimet ndaj bankave vendase, institucioneve qeveritare, subjekteve publike dhe tregtare, për shkak të FMN-së, huazimeve dhe detyrimeve të tjera financiare.

i. Njohja

Në njohjen fillestare, një pasuri financiare klasifikohet si i matur në: koston e amortizuar (KA), vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDAGJ) ose vlerës së drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH).

Pasuria financiare apo detyrimi financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të cilës i shtohen, për zë jo me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të tyre.

Siç u përmend më lartë, BQK-ja ka në librat e saj vetëm instrumente financiare me kosto të amortizuar, të cilat plotësojnë kriteret e modelit të mbajtjes për të mbledhur flukset monetare kontraktuale.

ii. Riklasifikimi

Pasuritë financiare të bankës varësisht nga rrethanat respektivisht ndryshimi i modelit të saj të biznesit për administrimin e pasurive financiare mund të ri-klasifikoj këto të fundit edhe pas njohjes fillestare të tyre.

Në qoftë se banka ri-klasifikon një pasuri financiare apo grup të pasurive financiare nga kategoria e matjes me koston e amortizuar tek kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, vlera e drejtë e tyre do të matet në datën e ri-klasifikimit. Çdo fitim ose humbje neto që rrjedh nga një diferencë midis koston të amortizuar dhe vlerës së drejtë të aktivitetit financiar njihet në fitim ose humbje.

iii. Ç'regjistrimi

BQK-ja ç'regjiston një pasuri financiare kur skadojnë të drejtat kontraktuale për rrjedhat e parave nga pasuria financiare, ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhat e parasë kontraktuale në një transaksion në të cilin në thelb janë transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare ose në të cilat BQK as nuk transferon dhe as mban në masë të madhe të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e asetit financiar.

Për ç'regjistrimin e një pasurie financiare, diferencën midis vlerës kontabël të pasurisë (ose vlerës së mbartur të alokuar për pjesën e pasurisë së ç'regjistruar) dhe shumës së (i) vlerësimit të marrë (përfshirë çdo pasuri të re të marrë më pak çdo detyrim të ri supozuar) dhe (ii) çdo fitim ose humbje kumulative që ishte njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ('OCI') njihet në fitim ose humbje. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për ç'regjistrim që është krijuar ose mbajtur nga BQK-ja njihet si pasuri ose detyrim i veçantë.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

BQK-ja hyn në transaksione me të cilat transferon asete të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pasurive të transferuara ose një pjesë të tyre. Në raste të tilla, pasuritë e transferuara nuk ç'regjistrohen. Shembuj të transaksioneve të tilla janë kreditimi i letrave me vlerë dhe transaksionet e shitjes dhe të riblerjes.

Në transaksionet në të cilat BQK as nuk mban dhe as transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një pasurie financiare dhe ai mban kontrollin mbi pasurinë, BQK vazhdon të njohë pasurinë në masën e përfshirjes së tij të vazhdueshme, të përcaktuar në masën tek e cila është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e pasurisë së transferuar.

BQK-ja ç'regjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale përfundohen ose anulohen, ose skadojnë.

iv. Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimeve financiare

Nëse kushtet e një pasurie financiare janë modifikuar, BQK vlerëson nëse flukset monetare të pasurisë së modifikuar janë thelbësisht të ndryshme. Nëse flukset e parave janë në thelb të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga pasuria financiare origjinale konsiderohen të kenë skaduar. Në këtë rast, pasuria fillestare financiare ç'regjistrohet (shiko (iii)) dhe një pasuri e re financiare njihet me vlerën e drejtë.

Nëse flukset e parave të pasurisë së modifikuar të mbartura me kosto të amortizuar nuk janë thelbësisht të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrim të pasurisë financiare. Në këtë rast, BQK-ja rillogarit vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare dhe një shumën që lind nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje e modifikimit në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Nëse një modifikim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ai paraqitet si të ardhura nga interesi.

BQK-ja ç'regjistron një detyrim financiar kur kushtet e saj modifikohen dhe flukset e parave të detyrimit të modifikuar janë thelbësisht të ndryshme. Në këtë rast, një detyrim i ri financiar bazuar në kushtet e modifikuara njihet me vlerën e drejtë. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar të shuar dhe detyrimit të ri financiar me termat e modifikuar njihet në fitim ose humbje. Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk llogaritet si ç'regjistrim, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rillogaritet duke zbritur flukset e modifikuara të pasës me normën fillestare të interesit efektiv dhe fitimi ose humbja që rezulton njihet në fitim ose humbje.

v. Netimi

Mjetet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e gjendjes financiare atëherë dhe vetëm atëherë kur BQK-ja ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë në një bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme.

vi. Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një mjeti ose detyrimi financiar është vlera me të cilën mjeti ose detyrimi financiar matet në momentin e njohjes fillestare, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

vii. Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë (reale) është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një pasurie apo që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt mes pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Kur është e disponueshme, BQK-ja mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet si aktiv, nëse çmimet e kuotuar janë të disponueshme në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe përfaqësojnë transaksionet që ndodhin aktualisht dhe rregullisht në treg në bazë të vullnetshme midis palëve.

Nëse tregu për instrumentin financiar nuk është aktiv, BQK vendos vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit midis palëve të mirë informuara dhe në formë të vullnetshme, (nëse janë të disponueshme), referimin në vlerën e drejtë aktuale të instrumenteve tjera që në thelb janë të njëjta, analizat e zbritjes së rrjedhave të parasë dhe modelet e vlerësimit të çmimit. Teknika vlerësuese e zgjedhur, përdor maksimalisht të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në vlerësimet specifike të BQK-së, përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do t'i merrnin parasysh në vendosjen e çmimit dhe janë në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike për vendosjen e çmimit të instrumenteve financiare. Të dhënat për teknikat vlerësuese paraqesin në mënyrë të arsyeshme pritjet e tregut dhe masat e faktorëve të rrezikut që ekzistojnë në instrumentin financiar. BQK-ja kalibron teknikat vlerësuese dhe i teston ato për vlefshmërinë duke shfrytëzuar çmimet nga transaksionet aktuale të dallueshme të tregut në të njëjtin instrument apo në bazë të të dhënave tjera të dallueshme dhe të disponueshme në treg.

viii. Lejimet e humbjeve

BQK njeh lejimet e humbjeve për humbjet e pritura kreditore "HPK" për pasuritë financiare që maten sipas kostos së amortizuar dhe nuk maten në VDFH. BQK-ja vlerëson lejimet e humbjes në një shumë të barabartë me HPK përgjatë jetëgjatësisë së instrumentit, përveç rasteve të mëposhtme për të cilat ato maten si HPK 12-mujore:

- letrat me vlerë të investimeve të borxhit që përcaktohen të kenë rrezik të ulët kredie në datën e raportimit; dhe
- instrumente të tjera financiare për të cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare.

BQK-ja e konsideron një letër me vlerë të borxhit me rrezik të ulët krediti kur vlerësimi i rrezikut të kredisë është ekuivalent me përkufizimin e kuptuar globalisht "shkallë e investimit". ECL 12-mujore janë pjesa e ECL që rezulton nga ngjarjet e mospagimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Instrumentet financiare për të cilat njihet një ECL 12-mujore referohen si instrumente financiare të Fazës 1.

HPK përgjatë jetëgjatësisë së instrumentit financiar janë HPK që vijnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të paracaktuar gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar. Instrumentet financiare për të cilat njihet një HPK gjatë gjithë jetëgjatësisë, por që nuk janë të efektuar (dëmtuara) nga humbjet kreditore, klasifikohen të "Faza 2 - Nënperformuese e instrumenteve financiare".

Matja e HPK-së

Modeli i zhvlerësimit të HPK-së është një matje e bazuar në probabilitet dhe përfshin ndikimin e rezultateve të ndryshme të mundshme. Operacionalisht, kjo mund të jetë e vështirë për t'u zbatuar dhe zgjedhja e skenarëve përkatës ekonomik mund të jetë sfiduese.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

Për implemetimin e hollësishëm të HPK-së kemi përdorur metodën e thjeshtë që shfrytëzon mundësinë e parashikimit të qasjes së humbjes e cila është:

$$\text{Humbjet e pritura kreditore (HPK)} = \text{Vlera a ekspozuar (VE)} \times \text{Humbja e mundshme e pritur (HP)} \times \text{Probabiliteti i humbjes së mundshme të pritur (PHP)}.$$

VE – Vlera e ekspozuar, është vlera kontabël bruto e pasurive financiare që bien në model për t'u rivlerësuar.

HP - Humbja e mundshme e pritur, është pritshmëria se nga vlera e ekspozuar mund të mos kthehet nëse ndodh humbja. Ne jemi bazuar në gjykimin tonë të brendshëm dhe, gjithashtu jemi mbështetur në disa qasje ndaj rrezikut sipas përcaktimeve të Bazelit për vlerësimin e huamarrësve që dështojnë të mbyllin obligimet.

PHP - Probabiliteti i humbjes së mundshme së pritur, është variabla më e ndjeshme dhe paraqet gjasën e mos pagesës nga pala e tjetër për një periudhë të observuar (12 mujore apo gjate gjithë jetës se instrumentit).

Modeli humbjeve të pritura (HPK) është një vlerësim i ponderuar i humbjeve kreditore dhe vlerësohen si më poshtë:

- pasuritë financiare që janë korrigjuar në vlerë në datën e raportimit: si vlera aktuale e të gjitha pritjeve me pak të parasë së gatshme (d.m.th. ndryshimi midis rrjedhës së parave të gatshme ndaj BQK-së, në përputhje me kontratën dhe rrjedha e parave që BQK-ja pret të marrë);
- pasuritë financiare që janë vlerësuar sipas humbjeve kreditore të pritura në datën e raportimit: si ndryshim midis vlerës së tyre bruto dhe pritjes së humbjes kreditore për të njëjtat.

g) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedhat e gatshme, depozita me bankat dhe pasuri financiare shumë likuide me maturitet origjinal për më pak se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo-domethënës të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga BQK-ja në menaxhimin e detyrimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e gjendjes financiare me kosto të amortizuara.

h) Letrat me vlerë të investimeve

Letrat me vlerë të investimeve, të përbëra nga bonot e thesarit dhe obligacionet, fillimisht maten me vlerën e drejtë plus shtesat për kostot e transaksionit direkt dhe më pas maten sipas kostos se amortizuar (mbajtja e pasurive me qëllim arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale) duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Të gjitha blerjet dhe shitjet e letrave me vlerë të investimeve njihen në datën e shlyerjes, d.m.th. data kur pasuria është marrë, ose dorëzuar tek pala tjetër.

Kostoja e amortizuar/ mbajtja e pasurive me qëllim arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale janë investime në pasuri jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturim fiks që BQK ka qëllimet pozitive dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë të caktuara në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

i) Depozitat dhe huamarrjet

Depozitat dhe huazimet fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot e transaksionit direkt shtesë, dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

j) Pasuritë dhe detyrimet e lidhura me FMN-në

Zërat e llogarive me FMN-në zakonisht paraqitet në zërat e Bankës Qendrore të anëtarit. Mjetet dhe detyrimet e lidhura me FMN-në fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar. Fitimet dhe humbjet nga rivlerësimi i kursit të këmbimit që lindin nga rivlerësimi i mjeteve dhe detyrimeve të FMN-së njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

k) Prona dhe pajisjet

i. Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga ndryshimi në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e mjetit. Kosto e mjeteve të ndërtuara nga vet BQK-ja përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore të drejtpërdrejt, kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e mjetit në gjendjen funksionale që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambientit ku ato janë vendosur.

Programet kompjuterike të blera që janë thelbësore (pjesë përbërëse) për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohen si pjesë e asaj pajisjeje.

Kur pjesë të një elementi të pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponentë kryesor) të pronës dhe pajisjes.

ii. Kosto pasuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të pronës ose pajisjeve njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i atij mjete të rrjedhin në BQK, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të përditshëm të pronës dhe pajisjes (pasurive afatgjata materiale) njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ndodhin.

iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë të secilës pjesë të një elementi të pasurive afatgjata materiale.

Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën aktuale dhe krahasuese është si më poshtë:

	2025	2024
Investimet në objekte me qira	20 vite	20 vite
Pajisje	5 vite	5 vite
Kompjuterë	3 vite	3 vite
Automjete	5 vite	5 vite

Jetëgjatësia e pajisjeve tjera vlerësohet rast pas rasti. Metoda e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rivlerësohen në datën e raportimit.

l) Asetet e paprekshme

Programet kompjuterike të blera nga BQK-ja njihen me koston historike të zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga ndryshimi në vlerë, nëse ka.

Shpenzimet e mëvonshme për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime rrisin përfitimin e ardhshëm ekonomik prej këtij aseti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike të programit kompjuterik, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike bazohet në vlerësimin për shfrytëzimin e atij programi pa qenë nevoja për ndonjë përmirësim të madh, aktualisht nga 3 deri në 10 vite.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

m) Rënia në vlerë e pasurive jo-financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të BQK-së, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për ndryshim në vlerë. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aseti/pasurie ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i asetëve që gjeneron rrjedhë të parasë që janë të pavarura nga mjetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga rënia në vlerë e njësive gjeneruese të parasë shpërndahen në mënyrë proporcionale midis asetëve të tjera të njësive (grupi të njësive) në baza proporcionale. Vlera e rikuperueshme e një pasurie ose e njësive gjeneruese të parasë është më e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritjeje para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për pasurinë. Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk ekziston më.

Një humbje nga rënia në vlerë anulohet nëse ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e pasurisë nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe zhvlerësimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

n) Detyrimet financiare

Burimet e financimit të BQK-së janë depozitat nga institucionet ndërkombëtare, qeveritare, publike, bankare dhe institucione të tjera financiare. Detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv.

o) Të ardhurat nga grantet

Grantet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ekziston një siguri e arsyeshme se ato do të merren dhe se BQK-ja do t'i përmbahet kushteve lidhur me grantin. Grantet që BQK-ja përfiton për shpenzime njihen si fitim ose humbje në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet. Grantet që BQK-ja përfiton për koston e një aseti njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë jetës së përdorimit të asetit.

p) Pagat e financuara nga donatorët

Individë të caktuar të angazhuar në BQK janë ekspertë ndërkombëtar të caktuar dhe financiar për një afat të shkurtër nga organizatat ndërkombëtare. Financimi nga këto organizata ndërkombëtare ndër të tjera përfshin, por nuk kufizohet në pagesën e pagave të këtyre ekspertëve ndërkombëtar. Duke qenë se kjo ndihmë i paguhet personave të caktuar drejtpërdrejt nga organizatat ndërkombëtare, nivelet e pagesës nuk janë të njohura dhe as nuk janë të përfshira në këto pasqyrat financiare.

q) Provizionet

Provizioni njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën, BQK-ja ka detyrime aktuale ligjore ose konstruktive që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që një dalje e parave apo të mirave ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke e zbritur rrjedhjen e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe kur është e përshtatshme, rreziqet specifike për detyrimet.

Provizioni për kontrata të ngarkuara njihet kur përfitimet e pritura për t'u nxjerrë nga BQK-ja nga kontrata janë më të vogla se kostoja e pashmangshme e realizimit të detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet në vlerën aktuale me më të voglën midis koston së pritshme të ndërprerjes së kontratës dhe koston së pritshme neto të vazhimit të kontratës. Përpara se të njihet një provizion, BQK njeh çdo humbje nga rënia në vlerë e asetit të lidhur me atë kontratë.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

r) Ndryshimet në politikat dhe shpalosjet kontabël

(i) Standardet dhe interpretimet efektive për periudhën aktuale

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që kanë hyrë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshimet në SNK 21 “Efekti nga kursi i këmbimit valutor”** – Përcaktimi rreth rastit/ve kur një monedhe nuk është e këmbyeshme në treg (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2025).

Ndryshimet e listuara më sipër nuk kanë pasur asnjë ndikim në shumat e njohura në periudhat e mëparshme dhe nuk pritet të kenë ndonjë ndikim material në periudhat aktuale ose të ardhshme.

(ii) Standardet dhe interpretimet nuk kanë datë efektive në periudhën e raportimit

Sikurse në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, rishikimet dhe interpretimet janë botuar nga BSNK, por ende nuk janë efektive për periudhën e raportimit dhe si të tilla nuk janë aplikuar akoma nga Banka Qendrore:

- **Ndryshimet/përmisimet vjetore 2024 për SNRF 1, 7, 9 dhe 10të si dhe SNK 7të** (publikua në korrik 2024, me datë efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2026),
- **Ndryshimet në SNFR 7 dhe 9 – Instrumentet Financiare** (plotësime dhe ndryshimet në matjen dhe klasifikimet, përfshirë edhe ndryshime në kontratat energjetike ku çmimi, distribuimi dhe furnizimi me energji elektrike janë të varura/ndikojnë nga/në kushtet mjedisore, mund të kenë përditësime në periudhën pas 2025, efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2026),
- **IFRS 18 – Prezantimin dhe shpalosjet në Pasqyrat Financiar** (standard në proces, efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2027).
- **IFRS 19 – Subjektet që nuk kanë përgjegjësi publike** (standard në proces, efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2027),

Këto standarde, ndryshime ose interpretime nuk pritet të kenë ndonjë ndikim material në Banken Qendrore gjatë periudhave aktuale ose të ardhshme të raportimit dhe në transaksionet e parashikueshme në të ardhmen.

Banka Qendrore ka zgjedhur të mos aplikoj këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datës së tyre efektive. Banka Qendrore parashikon që aplikimi i këtyre standardeve, rishikimet dhe interpretimet nuk do të ketë një ndikim më peshë në pasqyrat financiare të Bankës Qendrore. Ndërsa, ndikimi i plotë i tyre do vlerësohet edhe një herë kur vendoset aplikimi i tyre.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

a) Hyrje dhe vështrim

BQK është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga zhvillimi i aktiviteteve të saj dhe po ashtu edhe nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku kreditor
- Rreziku operacional
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion lidhur me ekspozimin e BQK-së ndaj rreziqeve të mësipërme, objektive, politikave dhe procedurave të BQK-së për matjen dhe menaxhimin e rrezikut si dhe administrimi i aktiviteteve dhe po ashtu edhe të kapitalit nga BQK-ja. Shënime të tjera specifike si sasiore po ashtu edhe cilësore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Struktura e menaxhimit të rrezikut

Mbikëqyrja e administrimit të aktiviteteve të BQK-së (përfshirë edhe menaxhimin e rrezikut) është përgjegjësi e Bordit të Bankës Qendrore. Bordi Ekzekutiv ka përgjegjësinë t'i identifikojë dhe t'i vlerësojë rreziqet dhe të hartojë plane, që në rast të papriturash në të ardhmen, të sigurohen vazhdimësia e veprimtarive dhe siguria e Bankës Qendrore. Menaxhmenti i BQK-së raporton rregullisht (në baza tre-mujore) nëpërmjet Departamentit për Menaxhimin e Rrezikut Komitetit të menaxhimit të rrezikut dhe Bordit Ekzekutiv të BQK-së tek Bordi i BQK-së mbi praktikën e administrimit dhe të menaxhimit të rrezikut. Bordi Ekzekutiv, Komiteti i menaxhimit të rrezikut, Komiteti i Investimeve dhe Departamenti për Menaxhimin e Rrezikut e kanë për detyrë në koordinimin me njësitë organizative të bëjnë hartimin dhe monitorimin e politikave të administrimit dhe të menaxhimit të rrezikut të BQK-së. Këto politika zbatohen më pas nga njësitë përkatëse organizative.

Politikat e administrimit dhe të menaxhimit të rrezikut të BQK-së janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet BQK-ja, si dhe të vendos kufizime dhe kontroll të duhur për rreziqet, dhe të monitoroj rreziqet dhe respektimin e limiteve të vendosura. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e ofruara të tregut. BQK-ja, me anë të trajnimeve, standardeve dhe procedurave të administrimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli efektiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të BQK-së po ashtu është përgjegjës për monitorimin dhe rishikimin e pajtueshmërisë me politikën dhe procedurat e administrimit të rrezikut, si dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut lidhur me rreziqet që përballet BQK-ja. Komiteti i Auditimit të BQK-së ndihmohet në kryerjen e detyrave të tij nga Shefit të Auditimit të Brendshëm dhe Auditimi i Brendshëm (njësitë përkatëse). Auditimi i Brendshëm ndërmer auditime të kontrolleve dhe të procedurave të administrimit të rrezikut në mënyrë të rregullt dhe të rastësishme (ad-hoc), rezultatet e të cilave raportohen përmes Shefit të Auditimit të Brendshëm tek Komiteti i Auditimit, pastaj te Bordi i BQK-së.

b) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare për BQK-në nëse një palë kontraktuese e instrumenteve financiare dështon t'i përmbush detyrimet kontraktuale të saj, dhe mund të rrjedh kryesisht nga investimet e BQK-së në instrumente financiar si: letra me vlerë dhe depozita (në tregjet e parasë apo llogari rrjedhëse) në banka të tjera. BQK për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut kreditor, BQK-ja konsideron dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit të rrezikut kreditor (siç është rreziku i ekspozimit kreditor nga: vonesa e përmbushjes së detyrimeve individuale, rreziku i vendit dhe sektorit).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

b) Rrezikut kreditor (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut kreditor

i. Investimet dhe ekspozimi ndaj rrezikut kreditor në BQK

BQK-ja e kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditimit duke investuar vetëm në letra të lëshuara nga qeveritë e vendeve të BE-së dhe korporata multinacionale dhe duke pasur depozita pranë bankave të huaja, detyrimet afatshkurtra të cilave i janë vlerësuar në një nga dy kategoritë më të larta nga agjencitë ndërkombëtare të njohura për vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Duke pasur parasysh vlerësimet e larta kreditore, menaxhmenti nuk pret që ndonjë nga palët kontraktuese të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të veta.

Menaxhimi i rrezikut bëhet përmes:

- Kufizimit të fushëveprimit dhe kohëzgjatjes së instrumenteve financiare,
- Kufizimit të emetuesve të palëve, me vlerësim të pranueshëm kredie për klasën e investimit dhe me lartë,
- Kufizimit të shumës dhe përqendrimit maksimal me palët.

ii. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor më 31 Dhjetor 2025 dhe 31 Dhjetor 2024, paraqitet nga vlera e bartur e llogarive rrjedhëse me bankat e huaja, letrave me vlerë (Bono të thesarit dhe Obligacione) dhe depozitave me bankat (përfshirë ato rezidente dhe jo rezidente). Për detaje mbi ekspozimin referohuni edhe te shënimet 8, 9 dhe 10.

Vlerësimi kreditor për instrumentet financiare që BQK ka ekspozim për periudhën që përfundon me 31 Dhjetor 2025 është prej AAA deri BB-/ Aaa deri Baa3/AAA deri BB-.

Tabela në vijim paraqet vlerat bartëse të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor të ndara sipas rangimit kreditor dhe të shprehura edhe pjesëmarrja në përqindje me gjithsej.

Shpërndarja sipas llojit dhe vlerësimit kreditor

31 Dhjetor 2025						
Rangimi kreditor (S&P/Moody's/Fitch)	Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	Plasmanë t në tregun e parasë	Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)	Llogaritë e ndërlidhur a me FMN (DVT dhe shfrytëzimi i fondeve)	Gjithsej vlera bartëse	% e peshës me gjithsej
AAA/Aaa/AAA	29,876	200,305	180,623	-	410,804	25.87%
AA+/Aa1/AA+	777	6,213	131,729	-	138,719	8.73%
AA/Aa2/AA	839	30,020	-	-	30,859	1.94%
AA-/Aa3/AA-	950	95,143	45,965	-	142,058	8.94%
A+/A1/A+	3,672	104,022	135,932	-	243,626	15.34%
A/A2/A	3,154	35,014	30,426	-	68,593	4.32%
A-/A3/A-	1,430	67,250	37,282	-	105,962	6.67%
BBB/Baa2/BBB	327	41,052	35,566	-	76,945	4.84%
BBB-/Baa3/BBB-	-	-	-	-	-	-
BB-/Ba3/BB-	-	14,970	192,607	-	207,577	13.07%
N/A [pa vlerësim (FMN)]	-	-	-	163,022	163,022	10.26%
Gjithsej	41,025	593,989	790,130	163,022	1,588,165	100.00%

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Shpalosje sipas llojin dhe vlerësimit kreditor

31 Dhjetor 2024						
Rangimi kreditor (S&P/Moody's/Fitch)	Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	Plasmanet në tregun e parasë	Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)	Llogaritë e ndërlidhur a me FMN (DVT dhe shfrytëzimi i fondeve)	Gjithsej vlera bartëse	% e peshës me gjithsej
